

## R A P O R T

### I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI GJENDJEN E TRANSPORTIT DHE MASAT QË DUHEN MARRË PËR FORCIMIN E ORGANIZIMIT DHE TË ZHVILLIMIT TË TIJ NË SHËRBIM TË EKONOMISË DHE TË POPULLATËS»

13 tetor 1982

Partia qysh në fillim u ka kushtuar një vëmendje të posaçme fuqizimit dhe organizimit të transportit mbi bazën e kushteve konkrete dhe nevojave të vendit. Me përpjekje të gjithanshme, me investime jo të pakta dhe me kujdes të vazhdueshëm për ripërtëritjen dhe zgjerimin e rrjetit rrugor dhe të mjeteve lëvizëse transportuese, arritëm në një kohë relativisht të shkurtër të krijojmë një transport të fuqishëm dhe të kohës, si për plotësimin e nevojave të ekonomisë, ashtu dhe për lëvizjen e udhëtarëve.

Karakteristikë e këtij zhvillimi ka qenë, veç të tjerave, edhe krijimi i transportit hekurudhor e atij detar, që nuk ekzistonin më parë në vendin tonë dhe që sot përballojnë përkatësisht 43 dhe 28 për qind të transportit të mallrave, brenda dhe jashtë vendit.

Në të njëjtën kohë, në uzina, në fabrika, në miniera, në pyje, në ara dhe kudo që prodhohet, janë rritur e fuqizuar llojet e ndryshme të transportit të brendshëm të prodhimit.

Në qoftë se më parë mirëmbajtja e mjeteve të transportit dhe shtimi i tyre varej tërësisht nga importi, tani janë krijuar kushte të tilla që ai të jetë sa më i pavarur nga jashtë. Pjesën dërrmuese të pjesëve të ndërrimit, të nevojshme për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit, e prodhojmë në vend; po kështu, kanë filluar të prodhohen dhe rimorkio 10 dhe 12 tonëshe, vagonë të rëndë hekurudhorë, anije metalike të tonazhit të vogël e të mesëm, karroceri autobusësh dhe pajisje mekanike për ngarkim-shkarkim në porte dhe në stacione hekurudhore.

E gjithë kjo punë është shoqëruar me kujdesin e Partisë, të organeve shtetërore dhe të ekonomisë për të përgatitur dhe kualifikuar punonjësit e specialistët e nevojshëm për të gjitha llojet e transportit, të cilët, me frymë të lartë revolucionare e shpirt krijues, kanë luftuar dhe luftojnë për të plotësuar me sukses detyrat.

Gjatë pesëvjeçarit të gjashtë detyrat e transportit, në përgjithësi, u plotësuan mirë dhe u shënuan rritje të reja të mëtejshme. Në vitin 1980, në krahasim me vitin 1975, vëllimi i transportit të mallrave u rrit 30 për qind, nga i cili për sistemin e Ministrisë së Komunikacioneve rreth 35 për qind. Transporti hekurudhor, duke vënë në jetë orientimet e Komitetit Qendror të Partisë, është zhvilluar me përparësi dhe me ritme 2 herë më të larta se transporti automobilistik.

Masa të rëndësishme për intensifikimin e transportit hekurudhor u morën sidomos gjatë vitit 1981, pas vërejtjeve dhe porosive që dha shoku Enver. Me hekurudhë u transportuan në këtë vit 12 për qind më shumë ton-mallra se në vitin 1980. Linja të reja hekurudhore iu shtuan vendit dhe u rajonizua më mirë transporti automobilistik, duke u zhvendosur një pjesë e tij tej skajeve të hekurudhës. Si rrjedhim i këtyre masave, u arrit që të ulen shpenzimet e transportit për një ton-mall në 17,1 lekë, nga 18,9 lekë që ishte në vitin 1980, me një kursim që vlerësohet afro 35 milionë lekë.

Me gjithë këto arritje e suksese të punonjësve të transportit në realizimin e detyrave të planifikuara, kemi pasur të meta e mosplotësime, që kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në treguesit e planit të transportit dhe në krijimin e vështirësive të përkohshme në degë të prodhimit e të shërbimeve.

Është fakt se gjatë pesëvjeçarit të kaluar Ministria e Komunikacioneve, megjithëse i plotësoi detyrat e vëllimit të përgjithshëm të transportit 100,7 për qind në ton dhe 100,8 për qind në ton-km, në transportin hekurudhor dhe në atë detar të brendshëm detyrat e planit nuk u realizuan plotësisht.

Edhe në vitin 1981, duke lënë pa realizuar disa zëra dhe lloje transporti, nuk u plotësuan 5,5 për qind e kontratave sipas planit, gjë që solli vonesa dhe mungesa në qarkullimin e mallrave. Ndërsa këtë vit vihen re përmirësime dhe detyrat e planit e të kontratave po realizohen më mirë.

Në analizat e bëra për këto deficite, del qartë se shkak kryesor i këtyre të metave dhe mosplotësimeve është organizimi i pamjaftueshëm i përdorimit racional të të gjitha mjeteve të transportit e në veçanti të transportit hekurudhor, puna e pamjaftueshme për rritjen e shkallës së mekanizimit të ngarkim-shkarkimeve, si dhe dobësitë në bashkërendimin e planeve dhe të detyrave për lëvizjen e mallrave si nga prodhuesit, ashtu dhe nga transportuesit.

Mirëpo, në stadin e sotëm të zhvillimit ekonomik-shoqëror të vendit, detyrat e rëndësishme që shtroi Kongresi i 8-të i Partisë për zhvillimin e të gjitha degëve të ekonomisë, objektivat që ai caktoi nuk mund të arrihen pa mënjanuar këto të meta e dobësi, pa fuqizuar dhe zgjeruar të gjitha llojet e transportit dhe pa ndërmarrë e realizuar një varg aksionesh konkrete për zhvillimin e shpejtë të transportit, mbështetur në studimet shkencore për këtë qëllim.

Në këtë pesëvjeçar janë përcaktuar një varg masash, të cilat kanë filluar t'i shërbejnë zgjerimit dhe fuqizimit të transportit dhe që do të bëjnë të mundur që në vitin 1985, vetëm për Ministrinë e Komunikacioneve, vëllimi i përgjithshëm i mallrave në ton-km të jetë 40 për qind më i madh sesa në vitin 1980, ndërsa në shkallë kombëtare 34-36 për qind.

Me gjithë këto, siç vuri në dukje edhe një herë shoku Enver në takimin me disa quadro të rretheve Korçë e Pogradec, në fushën e forcimit dhe të zhvillimit të mëtejshëm të transportit në të gjitha llojet e tij, që ai t'u përgjigjet më mirë se deri tani kërkesave të ekonomisë, në dinamikën e zhvillimit të saj, dhe të udhëtarëve, dalin një varg detyrash e masash konkrete, që duhen marrë, të cilat po i analizojmë më poshtë:

**1. — Për zhvillimin dhe fuqizimin e mëtejshëm të transportit hekurudhor dhe për përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomikë të tij.**

Politika e drejtë që ka ndjekur Partia për krijimin dhe zhvillimin e transportit hekurudhor, si një ndër transportet më masive dhe më të leverdishme, ka bërë që rrjeti hekurudhor nga njëri pesëvjeçar në tjetrin të rritet e të shtrihet në 10 rrethet e vendit, që kanë vëllime të mëdha mallrash për transport. Kjo shtrirje ka synuar dhe synon për të lidhur me hekurudhë vendburimet kryesore të naftës, të mineraleve dhe të produkteve industriale e bujqësore me qendrat e rëndësishme të përpunimit, të përdorimit apo të eksportit.

Furnizimi me lëndë të parë dhe transporti i prodhimeve të kombinatit metalurgjik «Çeliku i Partisë», i prodhimeve të Uzinës së Përpunimit të Thellë të Naftës në Ballsh, i mallrave të eksportit e të importit dhe i shumë vëllimeve të tjera të mëdha mallrash, sidomos mineralesh, as që mund të mendohet sot pa transportin hekurudhor. Në të njëjtën kohë, ai është dhe transporti më i leverdishëm për ekonominë, pasi për një ton-km me hekurudhë harxhohet rreth 3 herë më pak karburant dhe është 2,5 herë më rentabël sesa transporti automobilistik. Jo vetëm kaq, transporti hekurudhor mënjanon ato koncepte e forma artizanale të punës që bart me vete transporti i vogël automobilistik.

Sot, rrjeti kryesor hekurudhor arrin në 350 km, nga 196 km që ishte në vitin 1970. Vëllimi i mallrave të transportuara me

hekurudhë në vitin 1981, në krahasim me vitin 1970, është rritur mbi 3 herë; vëllimi i punës me hekurudhë zinte rreth 41 për qind të vëllimit të përgjithshëm të transportit të Ministrisë së Komunikacioneve, nga 24 për qind që ishte në vitin 1970 dhe, në të njëjtën kohë u rrit ngarkesa e linjës nga 800 mijë ton-km për kilometër, në 1,6 milionë ton-km për kilometër.

Gjatë pesëvjeçarit të shtatë transporti hekurudhor do të rritet me ritme akoma më të larta. Vëllimi i mallrave në vitin 1985 do të jetë 84 për qind më i madh se në vitin 1980, ndërsa pesha specifike do të arrijë 47 për qind të vëllimit të përgjithshëm të transportit të Ministrisë së Komunikacioneve.

Me vënien në shfrytëzim të linjave hekurudhore: Laç—Hani i Hotit, Fier—Vlorë dhe të disa degëzimeve të rëndësishme, gjatësia e linjave hekurudhore do të arrijë në 440 kilometra. Në të njëjtën kohë, do të intensifikohet shfrytëzimi i linjave ekzistuese, duke rritur ngarkesën e linjës në 2,2 milionë ton-km për kilometër.

Zhvillimi intensiv i ekonomisë dhe përgatitja më e mirë e perspektivës kërkojnë që jo vetëm këto detyra të ngjeshura, të parashikuara në pesëvjeçarin e shtatë, të arrihen dhe të tejkalohen, por qysh tani të merren masa organizative-teknike dhe administrative për të siguruar një ecuri më të shpejtë dhe një shfrytëzim më të lartë të transportit hekurudhor.

Nga studimet e bëra për përgatitjen e këtij Plenumi, midis të tjerave, del se ka mundësi të zgjerohen më tej degëzimet hekurudhore të cilat ulin 3-5 lekë shpenzimet e transportit për ton-mall të transportuar, shkurtojnë 30 për qind kohën e dorëzimit dhe mënjanojnë mjaft dëmtime të mallrave. Prandaj gjatë këtij pesëvjeçari, të ndërtohen dyfishi i degëzimeve të parashikuara dhe po kaq të ndërtohen dhe në pesëvjeçarin e ardhshëm. Organet projektuese, ndërtuese dhe të shfrytëzimit, vetë organizatat e Partisë, të vlerësojnë projektimin dhe ndërtimin e degëzimeve njëjloj si hekurudhat e reja.

Për pesëvjeçarin e ardhshëm, duke marrë parasysh vëllimet e transportit të lëndëve të para dhe të prodhimeve masive, zhvillimin ekonomik-shoqëror të rajoneve të ndryshme të vendit, si dhe mundësitë tekniko-ekonomike të ndërtimit të linjave të reja hekurudhore, të mbahet parasysh zgjatja e linjave ekzistuese hekurudhore në drejtim të vendburimeve minerale dhe qendrave të mëdha prodhuese.

Linjat e reja hekurudhore që do të ndërtohen, të projektohen e të zbatohen së bashku me degëzimet për në qendrat kryesore prodhuese, që kanë vëllime të mëdha për transport.

Por tani dhe në të ardhmen kryesore mbetet intensifikimi i punës në hekurudha duke shfrytëzuar më mirë se deri tani rrjetin ekzistues hekurudhor. Sipas detyrave të pesëvjeçarit, rreth



80 për qind e shtesës së vëllimit të punës me hekurudha do të përballohet me rritjen e intensitetit të shfrytëzimit të këtyre linjave. Kjo do të thotë që të rritet aftësia e lëvizjes së trenave në këto linja, si dhe ngarkesa e vetë linjave; të rritet shpejtësia mesatare e lëvizjes së trenave, si dhe vetë pesha e trenit; të rritet xhiro-vagoni; të përsoset sistemi i sinjalizimit etj.

Realizimi i këtyre detyrave kërkon, para së gjithash, të krijohet një koncept i qartë për vlerësimin e transportit me hekurudhë, si transporti që ka dhe duhet të ketë përparësi ndaj gjithë llojeve të transportit. Lidhur me këtë çështje, shoku Enver na porositi:

«... të ndryshohet koncepti ekzistues për llojet dhe për prioritetet e transportit, duhet lëvizur nga binarët ku jemi ngulur dhe të kalojmë në binarë të tjerë, më modernë, më masivë, më ekonomikë, më të shpejtë. **Ky është një revolucion në transport që ka ardhur koha ta bëjmë, se e kemi përgatitur terrenin për ta realizuar e për ta thelluar**»<sup>1</sup>

E theksojmë këtë, sepse, me gjithë porositë që janë dhënë herë pas here për përgatitjen e kushteve të transportit të të gjitha mallrave me hekurudhë, akoma vërehen dhe lëvizje paralele dhe gjenden një varg justifikimesh për t'i transportuar me automjete. Natyrisht, janë konceptet artizanale të prodhuesi, transportuesi dhe pritësi ato që pengojnë mënjanimin e plotë të transportit me automjete në rrugët paralele. Por, në të njëjtën kohë, këtë e pengojnë zvarritjet e masave që duhet të merren për ambalazhimin, për ruajtjen e mallit, për tranzitimin e shpejtë të tij me hekurudhë etj., që lidhen me organizimin e bashkërendimin e pamjaftueshëm të detyrave për lëvizjen e mallrave. Jo vetëm kaq, por dhe kontrolli për zbatimin e porosive e vendimeve përkatëse nuk është akoma në lartësinë e duhur, meqë ka ende raste të lëvizjeve paralele të mallrave, që mund dhe duhet të lëvizin me hekurudhë.

Prandaj është e domosdoshme që edhe organizatat e forumet e Partisë në rrethe ta marrin mirë në dorë punën për zbatimin e porosive dhe vendimeve që rregullojnë lëvizjen e mallrave me përparësi me hekurudhë dhe të thyejnë përfundimisht konceptet artizanale të transportit të vogël.

Në të njëjtën kohë, organet përkatëse shtetërore të ristudionjnë dispozitat në fuqi, si dhe tarifat e transportit për të nxitur përparësinë e transportit hekurudhor, shpejtimin e shkarkimit të mjeteve, si dhe kontrollin për lëvizjet e qëndresat tej afateve të mallrave në stacione e porte.

1. Enver Hoxha, «Për planin e shtatë pesëvjeçar», f. 433.

Për intensifikimin e punës në hekurudhë rëndësi të veçantë merr dendësimi i lëvizjes së trenave në 24 orë, që përbën një nga rezervat e rëndësishme për rritjen e kapacitetit transportues. Po të merren dhe të zbatohen një varg masash tekniko-organizative, krijohen mundësi të rritet mbi 50 për qind lëvizja e trenave në 24 orë. Për të arritur këtë duhet të ngrihet në një nivel më të lartë puna e vetë organeve drejtuese të hekurudhës, për hartimin dhe zbatimin e grafikëve sa më racionalë të lëvizjes së trenave, duke organizuar më mirë se deri tani edhe formimin e trenave dhe shkëmbimin e tyre në stacione. Për këtë qëllim duhet të rritet 40-45 kilometra gjatësia e linjave në stacionet e ndërrimit dhe të formimit të trenave dhe të zgjerohet e të modernizohet sistemi i ndërlidhjes dhe i sinjalizimit me pajisje elektronike dhe me ordinatorë, duke i futur ato pjesërisht qysh në këtë pesëvjeçar, dhe sidomos në pesëvjeçarin e ardhshëm.

Krahas këtyre, përpjekje të gjithanshme duhet të bëhen për rritjen e peshës së një treni. Arritjet e deritanishme tregojnë që mjaft makinistë të pararojës dhe stacione hekurudhore, duke përmirësuar strukturën e vagonëve dhe formimin e trenave, kanë tejkaluar 10 deri 30 për qind peshën mesatare të trenit, që është arritur vitin e kaluar. Është detyrë e organeve dhe organizatave të Partisë, organeve ekonomike në hekurudhë që të marrin masa që brenda këtij pesëvjeçari pesha mesatare e trenave, mbështetur në këtë përvojë, të rritet jo më pak se 20 për qind.

Krahas këtyre, rritja e xhiro-vagonit, duke futur teknologjitë dhe mënyrat e reja të ngarkim-shkarkimit dhe të përpunimit të mallrave, si dhe fuqizimi i stacioneve me mekanizma, instalime e sheshe tranzitimi të tyre, përbëjnë tani një detyrë sa të rëndësishme aq dhe të ngutshme. Është e palejueshme që koha në pritje e vagonëve të jetë dy-tri herë më e madhe se ajo në lëvizje. Sot koha mesatare e nisjes dhe e kthimit të një vagoni në stacion arrin 2,4 ditë, kur dihet që rrezja mesatare e lëvizjes së tij, nuk i kalon 200 kilometra. Ministria e Komunikacioneve dhe dikasteret e tjera të marrin masa të shpejta e sa më të plota, që të ulet koha e qëndrimit të vagonëve në pritje të mallrave apo për shkarkimin e tyre. Puna e filluar për përgatitjen dhe përdorjen e kontenierëve, sheshkave, apo kolive të mëdha mallrash, si dhe mjetet përkatëse për ngarkimin e shkarkimin e këtij ambalazhi relativisht më të madh, duhet thelluar më tej, për të ulur kohën e qëndrimit të vagonëve, për të mos i kthyer ata «në depo» pranë stacioneve hekurudhore e ndërmarrjeve pritëse të mallit. Po kështu, zgjidhja që i është dhënë transportimit të çimentos ose karburanteve me ambalazhet e vagonë të specializuar duhet të shtrihet më tej edhe për mallra të tjera të ngjashme.

Degëzimet, stacionet dhe depot e reja që do të ndërtohen gjatë këtij pesëvjeçari, t'u përgjigjen plotësisht dhe sa më mirë

këtyre ndryshimeve teknologjike të përpunimit të mallrave, jo vetëm me ndërtimin e sillosëve apo depove të specializuara, por edhe me futjen e transportit stacionar mekanik, pneumatik apo hidraulik për lëvizjen e mallit nga depoja në vagon. Ndërsa për degëzimet, stacionet dhe depot ekzistuese të stacioneve e të ndërmarrjeve ekonomike, të bëhen dora-dorës zgjerime, plotësime e rikonstruksione me konceptime të reja «industriale» për lëvizjen e mallrave.

Së fundi, për intensifikimin e punës në hekurudhë për rritjen e kapacitetit transportues, rëndësi të veçantë ka edhe rritja e shpejtësisë së lëvizjes së trenave në linjë. Me gjendjen ekzistuese të linjave hekurudhore, shpejtësia e lëvizjes së trenave nuk është akoma e mjaftueshme, prandaj të merren masa për të përmirësuar gjendjen e mbishtresës së linjave hekurudhore dhe zëvendësimin me kryqësore të parandëruara me qëllim që shpejtësia maksimale e lëvizjes së trenave në pesëvjeçarin e ardhshëm të rritet 35-40 për qind.

Një faktor tjetër për intensifikimin e transportit hekurudhor është elektrifikimi i linjave hekurudhore. Duke përpunuar dhe zbatuar një politikë largpamëse, Partia prej kohësh ka orientuar dhe punuar për zhvillimin me ritme të shpejta të bazës energjetike të vendit. Është pikërisht rezultat i kësaj politike të drejtë e largpamëse që edhe në situatat e krizës botërore energjetike vendi ynë ka një bilanc energjetik pozitiv. Ky fakt bën të mundshëm që qysh tani të mendohet e të punohet për elektrifikimin e disa linjave kryesore hekurudhore, që jo vetëm siguron një efektivitet më të lartë në transport, por edhe rrit aftësinë transportuese.

Nga disa studime paraprake të bëra për këtë çështje, del se në vitet e pesëvjeçarit të ardhshëm, pasi të bëhen më parë studimet e plota, duhet të fillojë elektrifikimi i disa linjave kryesore hekurudhore.

Intensifikimi i lëvizjes në hekurudhë, për vetë natyrën e saj, është i lidhur ngushtë me zbatimin me rigorozitet të rregullave të sigurimit teknik të lëvizjes, pasi çdo shkelje e tyre është me pasoja të rënda. Me masat e marra kohët e fundit dhe me forcimin e organeve të kontrollit, në këtë drejtim ka përmirësime, megjithatë vërehen akoma shfaqje të liberalizmit në kryerjen e detyrës dhe në vlerësimin e rregullave teknike. Prandaj, organet, organizatat-bazë të Partisë dhe levat e saj, në rrethet ku kalon hekurudha, t'u kushtojnë një vëmendje të veçantë sidomos punës me njerëzit për forcimin e ndjenjës së përgjegjësisë dhe të disiplinës proletare e asaj teknike, rritjes së kujdesit për zbatimin e masave për sigurimin teknik të lëvizjes së trenave dhe të ngrenë opinionin shoqëror kundër çdo shkeljeje të rregullave të qarkullimit.

Lidhja e hekurudhës me linjat e vendeve të tjera shtron qysh tani disa probleme dhe detyra të reja e të rëndësishme jo vetëm për punonjësit e hekurudhës, por edhe për vetë Ministrinë e Komunikacioneve dhe dikasteret e tjera të interesuara. Në radhë të parë, ato duhet të studiojnë e të përvetësojnë praktikat dhe rregullat ndërkombëtare të lëvizjes së vagonëve në linjat e jashtme, mënyrat e livrimit e të trajtimit të mallrave në këto linja e stacione dhe të realizojnë lidhje e marrëveshje me vendet dhe organizatat përkatëse, me kushte të leverdishme për vendin tonë. Qeveria të planifikojë shtimin e vagonëve të nevojshëm dhe të pajisjeve të ngarkim-shkarkimit dhe të sinjalizimit në nivelet që kërkon lëvizja në linjat ndërkombëtare, nisur nga synimi që dora-dorës transporti i mallrave të bëhet në masën 50 për qind me mjetet tona.

Shtrirja më tej e rrjetit hekurudhor, shtimi i mjeteve, i pajisjeve dhe i mekanizmave hekurudhorë, kërkesat e reja që shtrohen për intensifikimin hekurudhor, diktojnë nevojën e zgjerimit dhe të fuqizimit të bazave mekanike të hekurudhës, me qëllim që të sigurohen mirëmbajtja dhe riparimet themelore, prodhimi i pjesëve të ndërrimit, i pajisjeve dhe i mekanizmave të nevojshëm, i nyjeve dhe agregateve, e në mënyrë të veçantë prodhimi i vagonëve për mallra dhe udhëtarë. Si prodhimi, ashtu dhe riprodhimi e mirëmbajtja e mjeteve hekurudhore të mbështeten në teknologji të reja dhe në tipa më të përshtatshëm për kushtet e vendit tonë.

**2. — Të mobilizojmë të gjitha mundësitë e rezervat për shfrytëzimin sa më të plotë dhe racional të transportit automobilistik në të gjitha degët e ekonomisë.**

Prej vitesh transporti automobilistik ka përballuar pjesën kryesore të nevojave të ekonomisë e të popullatës për transport. Ai është zgjeruar, forcuar e konsoliduar si nga ana organizative, ashtu dhe nga ana teknike. Megjithëkëtë, edhe në transportin automobilistik ka pasur dhe ka dobësi e mosplotësime, pakujdesi e të meta, që kanë ndikuar negativisht si në shfrytëzimin jo të plotë e racional të automjeteve, ashtu dhe në lëvizjen e mallrave dhe të udhëtarëve.

Nuk janë të pakta rastet, kur, megjithëse planifikohet shfrytëzimi i automjeteve me aftësi të plotë, apo përdorimi sa më i madh i rimorkiove, në fakt vërtetohen mjaft ditë-punë të humbura, udhëtime boshe, pa ngarkesë të plotë, pa rimorkio etj. Përveç kësaj, këto vitet e fundit, kur është intensifikuar puna për lëvizjen e mallrave me distanca të shkurtra, është bërë problem shqetësues ngarkim-shkarkimi i mjeteve dhe vonesat në depot e magazinat. Bëhet punë e pamjaftueshme për mirëmbajtjen dhe gatishmërinë e mjeteve në parqet automobilistike, dhe aq më tepër në sektorë të ndërmarrjeve të tjera. Janë pikërisht këto arsye



që kanë ndikuar në disa raste në rënien e rendimentit të shfrytëzimit të automjeteve, si dhe për krijimin e situatave të vështira për lëvizjen e mallrave në momente të caktuara.

Është e domosdoshme që organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike, të analizojnë thellë të gjithë këta faktorë, që përbëjnë dhe rezervat kryesore në shfrytëzimin më racional të aftësisë transportuese për realizimin e detyrave të qarkullimit të mallrave. Në radhë të parë, ato duhet të studiojnë dhe të programojnë detyra për përgjithësimin e përhapjen e përvojës së përparuar, që edhe në këtë sektor nuk mungon. Ka mbi 1 000 shoferë që punojnë për llogari të pesëvjeçarit të ardhshëm, pa folur këtu për mjaft heronj të punës socialiste dhe shoferë të pararojës, që realizojnë brenda një viti dy plane vjetore, si: Dhimitër Delijorgji, Spiro Lera, Selim Shabani, Thimio Gazeli e të tjerë.

Masa të rëndësishme kërkohet të merren kudo, e në veçanti në parqet e përqendruara, me qëllim që të rritet gatishmëria teknike e mjeteve nëpërmjet futjes së teknologjive të reja të riparimit dhe përmirësimit të cilësisë së tyre, përdorimit më të gjerë të metodave të riparimit me agregat, kryerjes së shërbimeve teknike me ndërresa, shkurtimit të afateve të remontit etj., si faktorë të rëndësishëm për zgjatjen e kohës nga njëri remont në tjetrin dhe në tërësi të jetës së automjeteve.

Çështja e prodhimit dhe e ripërtëritjes së pjesëve të ndërrimit përbën një ndër problemet kryesore për rritjen e përdorimit të automjeteve. Sukseset që kemi arritur në prodhimin e një llojshmërie të gjerë të pjesëve të ndërrimit në vend, nuk duhet të na kënaqin, për vetë faktin se një pjesë e tyre është akoma larg kërkesave cilësore që ka transporti, sidomos për kollodokë, cilindra, çifte konike, kutitë e shpejtësisë, bateritë, buloneritë etj., të cilat jo vetëm nuk plotësojnë nevojat në sasi, por duke mos pasur cilësinë e duhur kanë, për pasojë, afate të shkurtra në përdorim. Një gjë e tillë nuk duhet lejuar nga uzinat prodhuese, aq më tepër tani që njihen teknologjitë e përparuara për prodhimin e tyre dhe janë krijuar kushtet materiale e teknike për një cilësi si ato të importit. Me qëllim që të rritet më tej cilësia e pjesëve të ndërrimit, brenda vitit 1985 të rishikohen kushtet teknike të prodhimit dhe të rriten treguesit tekniko-cilësorë të tyre.

Krahas prodhimit të pjesëve të ndërrimit, në të gjitha ndërmarrjet që bëjnë riparimet e automjeteve, brenda këtij pesëvjeçari të organizohen linja dhe reparte të veçanta për ripërtëritjen e një emërtese të caktuar pjesësh ndërrimi dhe të zbatohen teknologji të përparuara.

Ministria e Industrisë dhe e Minierave, Ministria e Komunikacioneve, Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Ndërtimit, brenda vitit 1984, të përcaktojnë emërtesën e pjesëve që do të ripër-

tërihen dhe linjat e specializuara për to, me synim që brenda vitit 1985 me to të plotësohen 65 për qind e nevojave me pjesë ndërrimi.

Zbatimi i këtyre masave për mirëmbajtjen dhe riparimin e automjeteve, si dhe i masave të tjera organizativo-teknike, do të bëjnë të mundur që koeficienti i përdorimit në vitin 1985 të realizohet jo më pak se 70 për qind.

Një drejtim tjetër për të rritur aftësitë transportuese është dhe përdorimi gjerësisht i rimorkiove. Komiteti Qendror disa herë ka porositur dhe këmbëngulur në këtë çështje dhe, për pasojë, është rritur përdorimi i tyre, por megjithëkëtë, këtu ka akoma shumë rezerva jo vetëm në transportin automobilistik të Ministrisë së Komunikacioneve, por sidomos në ato të ministrive të tjera. Nga Ministria e Komunikacioneve sot me rimorkio përballohet 26 për qind e vëllimit të autotransportit, kurse nga të gjitha ministrinë e tjera përballohet vetëm 9 për qind.

Krahas masave që do të merren për një shfrytëzim më racional të rimorkiove ekzistuese, Ministria e Komunikacioneve dhe ministrinë e tjera kanë përcaktuar detyra për shtimin e numrit të rimorkiove në përdorim, si dhe për rritjen e kapacitetit bartës të tyre. Me këto masa, vëllimi i punës me rimorkio në vitin 1985 do të përfaqësojë 30 për qind të të gjithë vëllimit të punës së autotransportit të Ministrisë së Komunikacioneve dhe 12 për qind të atyre të ministrive të tjera, kurse në fund të pesëvjeçarit të ardhshëm të arrihet që këto raporte të përfaqësojnë përkatësisht deri 33 dhe 15 për qind. Për këtë qëllim gjatë këtij pesëvjeçari do të prodhohen 4 000 copë rimorkio, prandaj, duke filluar nga ky vit, prodhimi i rimorkiove në vend të orientohet në ato të tonazhit të madh pa lënë pas dore dhe ato të tonazhit të vogël për bujqësinë, ndërtimin e tregtinë. Rimorkiot e tonazhit të vogël që ka në përdorim Ministria e Komunikacioneve t'u kalojnë dora-dorës degëve të tjera të ekonomisë, sidomos bujqësisë, dhe ato të zëvendësohen me rimorkio të tonazhit më të madh.

Për të rritur rendimentin e shfrytëzimit të automjeteve, të zgjerohet puna me dy shoferë. Arritja e kësaj detyre kërkon që organet dhe organizatat e Partisë, si dhe organet shtetërore dhe ekonomike të marrin masa për organizimin e punës me dy dhe tri ndërresa jo vetëm për transportin, por edhe për nisësit dhe pritësit e mallrave, dhe të luftojnë konceptet frenuese dhe ngurrimet që ndeshen.

Shfrytëzimi më i mirë i automjeteve lidhet dhe me masa të tjera, që duhen marrë nga parqet automobilistike të mallrave, nga sektorët e transportit dhe në veçanti nga agjencitë, për një shpërndarje më racionale të automjeteve në drejtimet dhe frontet e punës të rrjedhjes së mallrave dhe për të forcuar disiplinën e kontrollin në qarkullimin e tyre, me qëllim që të mënjanohej udhëtimet boshe dhe me ngarkesë jo të plotë.



Realizimi i masave të mësipërme të shoqërohet kudo, nga baza në qendër me një punë më të studiuar për planifikimin dhe bashkërendimin e treguesve dhe pjesëve të planit të autotransportit.

Për të përsosur planifikimin e lëvizjes së mallrave dhe shfrytëzimin racional të mjeteve, të bëhen studime më të plota, duke futur gjerësisht edhe metodat e reja matematike për programimin linear ku të aktivizohet Qendra Llogaritëse, në mënyrë që qysh në planifikim, veç të tjerave, të mënjanohen kryqëzimet e transportit të mallrave apo lëvizjet pa ngarkesë.

Një drejtim tjetër me rëndësi për të rritur efektivitetin e transportit automobilistik është dhe ai i përqendrimit të mjeteve në njësi të organizuara. Menjëherë pas Kongresit të 6-të të Partisë, në bazë të orientimeve që dha ai, u organizuan 17 parqe të specializuara mbi bazë sistemi në vartësi të dikastereve përkatëse, ndërsa këtë vit u vendos të krijohen edhe 8 parqe të tjera në bazë sistemi, si dhe 5 parqe në vartësi të Ministrisë së Komunikacioneve. Megjithatë, mbetet akoma një numër i madh mjeteve të papërqendruara në parqe e sektorë të veçantë që kanë në përdorim dikasteret e tjera. Prandaj është e nevojshme të thellohet më tej përqendrimi i automjeteve në parqe të specializuara, fillimisht në vartësi të dikastereve të tjera dhe dora-dorës ato të thithen nga Ministria e Komunikacioneve, ndërsa shtimi i automjeteve të reja, të tonazheve të ndryshme, të bëhet kryesisht në sistemin e Ministrisë së Komunikacioneve. Organet dhe organizatat e Partisë të bëjnë një punë më të dendur sqaruese dhe bindëse për epërsitë e përqendrimit dhe për të luftuar prirjet që vihen re në ndërmarrje të ndryshme për të pasur secila automjete më vete.

Duke marrë parasysh nivelin e pakënaqshëm të riparimeve themelore për të gjitha llojet e sasive të automjeteve, është e domosdoshme të organizohet më mirë se deri tani dhe të përqendrohet më tej riparimi i tipave masivë në oficinat riparuese të specializuara për këtë qëllim dhe të futen në këto procese teknologji të reja. Në të njëjtën kohë, të prodhohen dhe pjesë ndërrimi rezervë për të plotësuar tërësisht nevojat për këto riparime mbi bazën e kriteve dhe normativave të studiuara.

Mirëmbajtja e zakonshme e të gjitha automjeteve të kryhet në parqet dhe sektorët e transportit të ministrive përkatëse, ndërsa për automjetet e kooperativave bujqësore, si rregull, ajo të bëhet në sektorë të specializuar, që duhet të ngrihen pranë SMT-ve, duke filluar nga viti 1983.

Zbatimi i këtyre masave tekniko-organizative, për vetë specifikën që ka transporti automobilistik, kërkon nga Partia dhe levat e saj të bëjnë më mirë se deri tani një punë të organizuar me njerëzit për edukimin dhe kalitjen ideologjike të shoferëve dhe të punëtorëve të mirëmbajtjes e të riparimeve, për intensifikimin

e luftës kundër shfaqjeve të huaja në qëndrimin ndaj punës e pronës, për rritjen e mobilizimit e të gatishmërisë për realizimin e detyrave etj. Organet dhe organizatat e Partisë të vlerësojnë më mirë se deri tani edhe kushtet e punës e të jetës së shoferëve të dislokuar, të forcojnë kontrollin dhe disiplinën në qarkullimin e automjeteve dhe ruajtjen e mallrave, për të mënjanuar shpërdorimet, dëmtimet e përfitimet në rrugë të padrejta etj.

Në përputhje me zhvillimin ekonomik-shoqëror të vendit, është rritur dhe fuqizuar shërbimi i transportit të udhëtarëve, me një shtrirje më të gjerë, që arrin deri në zonat e thella të vendit.

Megjithëkëtë, nevojat në rritje për këtë lloj shërbimi, që lidhen me zhvillimin e forcave prodhuese, me hapjen e fronteve të reja të punës, me intensifikimin e bujqësisë dhe me mënjanimin e një vargu të metash që ekzistojnë aktualisht në këtë shërbim, shtrojnë detyrën për të marrë masa të mëtejshme e të shumanshme për zgjerimin dhe përmirësimin e tij.

Sot vërehen dhe raste thyerjeje të grafikëve në lëvizjen e udhëtarëve me tren apo autobus, raste të mbingarkesës në periudha të ndryshme, mungesa në shërbimin e kulturuar, shfaqje e qëndrime të huaja ndaj shërbimit të popullit, ndaj punës dhe pronës socialiste etj. Kundër këtyre dobësive dhe të metave organet e transportit duhet të marrin sa më parë masa për forcimin e disiplinës e të rregullit në shërbimin e udhëtarëve dhe të studiojnë e të realizojnë forma sa më të përshtatshme për organizimin e tij, për plotësimin e nevojave, me një shfrytëzim sa më të mirë të kapaciteteve ekzistuese dhe nëpërmjet shtimit të prodhimit të karrocive të autobusëve dhe vagonëve në vend. Edhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve të studiojnë dhe të organizojnë më mirë lëvizjen e udhëtarëve dhe të punëtorëve për në qendrat e punës, me një shkallëzim më të saktë të orareve, të lëvizjes së tyre. Ndërsa organet dhe organizatat-bazë të Partisë, levat e tyre t'i kushtojnë një vëmendje të veçantë punës me njerëzit dhe të ngrenë më mirë opinionin shoqëror kundër qëndrimeve dhe shfaqjeve të huaja. Gjithashtu, të merren masa që qysh këtë pesëvjeçar të shtohet 10 deri 15 për qind numri i mjeteve në linjat urbane dhe deri në fund të pesëvjeçarit të ardhshëm të shtohet në masën 30-50 për qind e të ripërtërihet inventari i taksive.

Me gjithë porositë e herëpashershme dhe punën e bërë, akoma mbetet problem zbatimi i rregullave teknike të qarkullimit të autotransportit. Si pasojë e shkeljeve të tyre, kanë ndodhur dhe aksidente me pasoja të rënda. Prandaj Ministrisë së Komunikacioneve, Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe ministrive të tjera u del detyra që të forcojnë kontrollin në zbatimin e rregullave dhe të marrin masa më të plota tekniko-organizative për parandalimin e aksidenteve.

3. — Vëmendja më e madhe t'i kushtohet shfrytëzimit racio-

**nal të transportit detar e automobilistik për lëvizjen e mallrave të eksport-importit.**

Në kushtet e thellimit e të ashpërsimit të krizave të botës borgjezo-revizioniste dhe të ndikimeve, presioneve dhe bllokadës së saj ndaj vendit tonë, është e domosdoshme të forcojmë punën për shfrytëzimin më të plotë e me leverdi të flotës sonë detare-tregtare dhe të automjeteve të parkut të specializuara për jashtë. Në vitin e kaluar me mjetet tona detare ne përballuam vetëm 20 për qind të vëllimit të eksportit, si dhe 53 për qind të importit të mallrave që u livruan në rrugë detare dhe 61 për qind të atyre që u livruan me automjete. Në një kohë kur tarifatat e mjeteve të huaja të transportit rriten nga dita në ditë, është e papranueshme që aftësitë ekzistuese të transportit tonë, të caktuara për lidhjen me jashtë, të mos shfrytëzohen plotësisht dhe si duhet.

Në këtë çështje të rëndësishme, përveç punës së madhe që duhet të bëjnë vetë punonjësit e transportit detar e automobilistik, detyra shumë të rëndësishme kanë punonjësit e tregtisë së jashtme, që janë porositësit e ekspeditorët e vetëm të këtyre mjeteve të mëdha e të rëndësishme. Ata, në marrëveshjet e kontratat që lidhen me vendet e firmat e huaja, detyrimisht duhet të përcaktojnë kushtet e plota dhe më të favorshme për vendin tonë, për mënyrën dhe mjetet e livrimit të mallrave, për zbatimin e tarifave të arsyeshme e të leverdishme për ne. Kujdes të veçantë ata t'u kushtojnë përcaktimit në kohë të lëvizjes së këtyre mjeteve jashtë vendit dhe sigurimit të ngarkesës sa më të plotë në vajtje-ardhje, për të pasur sa më pak lëvizje pa ngarkesë.

Bashkërendimi tremujor e mujor i grafikëve të lëvizjes së anijeve dhe automjeteve nga organet përkatëse të Ministrisë së Tregtisë së Jashtme dhe të Ministrisë së Komunikacioneve të vlerësohet si një detyrë e rëndësishme për shfrytëzimin racional të flotës sonë tregtare e të parkut automobilistik të specializuar të eksportit. Nuk duhen lejuar më raste që të ndryshohen planet e grafikët apo të ndërrohet itinerari i anijeve në udhëtim, siç ka ndodhur deri tani, sepse kjo praktikë ka çuar në atë që shpesh anijet apo automjetet tona të bëjnë dhe rrugë pa ngarkesë, kur për mallrat tona merren me qira anije e kamionë të huaj.

Punonjësit e flotës tregtare, si dhe ata të parkut të eksportit, të shtojnë kujdesin dhe punën e tyre për rritjen e gatishmërisë së mjeteve dhe për shfrytëzimin sa më intensiv të tyre, mbi bazën e rregullave ndërkombëtare të lundrimit e të lëvizjes në vendet e tjera. Në vitin e kaluar, në anijet «Arbëria» dhe «Vlora», për dobësi të punës së tyre, janë shkaktuar avari serioze. Jo vetëm kaq, por në ndonjë rast ka pasur vonesa të pajustificueshme në ngarkim-shkarkimet në porte apo qytete të ndryshme jashtë.

Organizatata e Partisë në këto ndërmarrje duhet të intensifikojnë punën ideopolitike me njerëzit, të ngrënë ndërgjegjen dhe

krenarinë e njeriut tonë socialist në lidhje me botën e jashtme dhe të ngulin këmbë për korrektësinë e plotë në zbatimin e rregullave tona e atyre ndërkombëtare, si dhe të ruajnë e të përfaqësojnë denjësisht figurën morale të njeriut tonë të ri.

Një punë sistematike dhe të organizuar më mirë se deri tani duhet të bëjnë punonjësit e flotës, të portit dhe të kantierit detar për mirëmbajtjen e riparimin e gjithë anijeve tona dhe mekanizmave portuale të ngarkim-shkarkimit. Kontrolli dhe shërbimi teknik i tyre duhet të zbatohet mbi bazën e grafikëve të rreptë dhe të sigurohen kushtet që dora-dorës edhe riparimet themelore në vend të vijnë duke u rritur. Drejtuesit, personeli teknik i anijes dhe regjistri detar të kontrollojnë sigurimin e të gjitha kushteve teknike të lundrimit, për t'u dalë përpara çdo avarie e ndalese të anijeve në lundrim apo në portet e huaja.

Ministria e Komunikacioneve një kujdes më të madh duhet t'i kushtojë përdorimit të anijeve të vogla për lëvizje të shkurtra brenda dhe jashtë vendit. Për kushtet tona, kur kontingjentet e mallrave të importit apo të eksportit formojnë parti relativisht të vogla, livrimi i tyre me barka e anije të tonazhit të vogël bëhet më i leverdishëm. Jo vetëm kaq, por këto barka e anije duhet të përdoren më gjerë dhe në ujërat e brendshme, tani për tani në kaskadën e Drinit, për lëvizjen e lëndës drusore e të mineraleve që tërhiqen nga rajonet përreth saj. Në të njëjtën kohë, të merren masa për të zgjeruar transportin detar të brendshëm, duke ndër-tuar për këtë qëllim pontile për ngarkim-shkarkim të mjeteve detare. Në këtë vështrim, edhe prodhimi i anijeve metalike, që ka filluar dhe po realizohet me sukses në kantierin detar, duhet të zgjerohet dhe të orientohet nga ndërtimi i barkave e anijeve të vogla dhe të tonazhit 500 e 2 000 tonë.

**4. — Zhvillimi intensiv i ekonomisë kërkon të zgjerohet e të fuqizohet më tej transporti i brendshëm në prodhim, si dhe të zgjidhen më mirë se deri tani edhe disa probleme të veçanta.**

Zgjerimi dhe shtimi i pandërprerë i prodhimit, thellimi i kooperimit dhe i revolucionit tekniko-shkencor, rritja e vëllimit të lëvizjes së mallrave dhe e udhëtarëve, si dhe detyrat që shtruan më sipër për rritjen e efektivitetit të transportit, nxjerrin në pah domosdoshmërinë e shfrytëzimit më të mirë të mjeteve të tjera të transportit të brendshëm, si të teleferikëve, karro-qerreve, tubacioneve etj., rektifikimin, përmirësimin dhe shtrirjen më të gjerë të rrugëve, sidomos në ekonominë bujqësore, rritjen e shkallës së mekanizimit të ngarkim-shkarkimeve në të gjitha llojet e transportit dhe, së fundi, një punë më të kujdesshme për përgatitjen e kualifikimin e kuadrit.

**a) Të zgjerohet me lloje të reja dhe të fuqizohet transporti i brendshëm në të gjitha qendrat e prodhimit.**

Në vitet e pesëvjeçarit të kaluar u bënë hapa të rëndësishëm



për zgjerimin dhe fuqizimin e transportit të brendshëm në ndërmarrjet ekonomike dhe kooperativat bujqësore. Numri i mekanizmave dhe makinave që përdoren për këtë qëllim është rritur rreth 30 për qind. Vetëm në industrinë minerare, me këto makineri dhe mekanizma në vitin 1981 janë lëvizur rreth 8 milionë tonë minerale, sterile dhe materiale të ndryshme. Ndërsa në ndërmarrjet të tilla, si në kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë», në uzinat kimike e mekanike lëvizen çdo ditë me mijëra tonë lëndë të para, materiale, produkte të gatshme etj. Me gjithë këto, në industri ka vend akoma për të mekanizuar transportin e brendshëm teknologjik. Në industrinë minerare vetëm 76 për qind e vëllimit të përgjithshëm të transportit të brendshëm përballohet me mekanizma. Në industrinë kimike dhe mekanike ky nivel është akoma më i ulët, ndërsa në mjaft ndërmarrje të industrisë së lehtë e ushqimore nuk arrin as edhe 50 për qind.

Edhe në ekonomitë bujqësore gjendja nuk është e kënaqshme, megjithëse aty sot lëvizin rreth 23 milionë tonë mallra e prodhime, dhe në vitin 1985 parashikohet të lëvizin mbi 27 milionë tonë. Një pjesë e këtij vëllimi të transportit, natyrisht, kryhet me mjete të SMT-ve, por megjithëkëtë, në distanca të shkurtra bëhet me karro-gerre e kafshë dhe shumë pak me automjete. Kjo gjendje ka bërë që, për ndonjë rast, të mos realizohen mirë dhe në kohë shërbimet për tokën dhe bimën, të mos përballohet tërheqja e plotë dhe në kohë e prodhimeve nga fusha e blloqet frutore, të hasen vështirësi për lëvizjen e foragjereve, të plehrave, të kashës etj.

Për t'u dhënë një shtytje të mëtejshme zgjerimit dhe fuqizimit të transportit të brendshëm, dikasteret dhe ekonomitë prodhuese të shqyrtojnë një për një gjendjen dhe rrugët e përmirësimit të saj, me synim që brenda këtij pesëvjeçari të mekanizohen 10 deri 20 për qind e lëvizjeve që bëhen sot me krahë, dhe në pesëvjeçarit e ardhshëm kjo punë të thellohet më tej. Ndërmarrjet dhe repartet mekanike të të gjitha degëve të marrin masa për të rritur prodhimin e mekanizmave dhe llojeve të ndryshme të mjeteve transportuese teknologjike, mbështetur në specializimin që kanë sot.

Në të njëjtën kohë, në ndërmarrjet minerare, gjeologjike, në ato të shfrytëzimit të pyjeve, në ndërmarrjet e kooperativat bujqësore me terrene të thyera, kodrinore-malore e masive prodhuese në to, të bëhen studime konkrete për vendosjen e teleferikëve, si mjete transporti mjaft të leverdishme e të thjeshta në përdorim.

Për të vënë mbi baza më të mira teknike e organizative prodhimin dhe vendosjen e teleferikëve, Ministria e Industrisë dhe e Minerave të marrë masa për organizimin e një ndërmarrjeje të veçantë, të profilizuar për studimin, projektimin, prodhimin, mon-

timin në vend dhe vënien në shfrytëzim të teleferikëve. Ndërmarrja të ketë dhe byronë projektuese, që të kryejë studimet e projektimet e nevojshme dhe të përcaktojë efektivitetin e përdorimit të teleferikëve në vendet ku ata do të instalohen.

Fillimisht prodhimi të organizohet mbi bazën e importit të materialeve të nevojshme që nuk sigurohen në vend, dhe në të ardhmen, me zgjerimin e uzinës së telit në kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë», të sigurohen në vend jo vetëm prokatet, por dhe litarët e çelikut, të nevojshëm për teleferikët.

Për projektimin, montimin dhe vendosjen e teleferikëve të fillohet nga puna qysh në vitin 1983, me synim që deri në fund të pesëvjeçarit të ardhshëm të vihen në përdorim rreth 60-70 teleferikë stacionarë në ndërmarrjet industriale të minierave e pyjeve, dhe rreth 300 teleferikë të lëvizshëm në ekonomitë bujqësore e pyjore.

Përdorimi i teleferikëve, sidomos në masivet pyjore për lëndën drusore, në miniera për tërheqjen e mineraleve dhe në bujqësi për masivet frutore e blegtorale, qofshin këta dhe zbritës të thjeshtë me gravitacion, ka leverdi ndaj çdo lloj transporti tjetër. Prandaj, qysh në këtë pesëvjeçar të rriten 20-30 për qind investimet e planifikuara për këtë qëllim, dhe në pesëvjeçarit e ardhshëm të planifikohen linjat e parashikuara në studimin e bërë për këtë çështje.

Në transportin e brendshëm rëndësi t'i jepet edhe transportit me dekovil. Prandaj të studiohet dhe të zbatohet më gjerë dhe ky lloj transporti, kudo që është i mundshëm.

Në bujqësi, edhe në të ardhmen transporti i brendshëm me karro-gerre do të zërë një vend të rëndësishëm për vetë natyrën e prodhimit, si dhe për të mënjeluar bërjen e rrugëve të dendura në tokat nën kulturë, që ulin sipërfaqet e punueshme.

Prandaj të rritet ngarkesa për çdo karro-gerre rreth 50 për qind dhe, nga ana tjetër, Ministria e Industrisë dhe e Minerave dhe vetë ekonomitë bujqësore të marrin masa që të rritet prodhimi i karro-gerreve, me pikësynim që brenda vitit 1985, në zonat ku ato mund të përdoren, të pajisen me karro-gerre të gjithë pendët e qeve dhe të kuajve. Në të njëjtën kohë, të prodhohen pjesët e ndërrimit, të nevojshme për mirëmbajtjen dhe ripërtëritjen e karro-gerreve.

Krahas shtimit të numrit të qeve, Ministria e Bujqësisë t'i kushtojë një vëmendje të madhe shtimit të njëthundrakëve dhe sidomos të pelave. Të thellohet studimi që ka nisur për përqendrimin e pelave dhe për përmirësimin e kushteve të mbarështimit e të rritjes së pjellorisë së tyre. Të punohet për përmirësimin racor të njëthundrakëve, me synimin që të shtohen kuajt me forcë tërheqëse e aftësi bartëse më të madhe.

b) Të përqendrohet më tepër vëmendja në përmirësimin, zgje-



**rimin dhe shtrirjen e rrugëve automobilistike, për të rritur përshkueshmërinë e tyre në çdo stinë.**

Gjatë viteve të pushtetit popullor rrjeti rrugor automobilistik është rritur, zgjeruar dhe përmirësuar mjaft. Pothuajse të gjitha rajonet prodhuese dhe pjesa më e madhe e fshatrave janë të lidhura me rrugë automobilistike të kalueshme në çdo stinë. Me gjithë këto, në rrjetin rrugor ekzistues ka mjaft pjesë që kërkojnë rrektifikime, zgjerime dhe përmirësime, përveç asaj që ende kemi fshatra të zonave të thella që lidhen me rrjetin rrugor automobilistik vetëm me rrugë verore të ngushta dhe të pashtuara. Veçanërisht më prapa për lidhjen e fshatrave me rrugë të kalueshme në çdo stinë janë rrethet: Pukë, Dibër, Berat, Gramsh dhe Elbasan. Nga rrjeti rrugor që administrojnë Ministria e Komunikacioneve, ka ende rrugë të paasfaltuara, megjithëse dihet që asfaltimi i rrugëve i ul në një masë të konsiderueshme shpenzimet e transportit. Veç kësaj, edhe disa nga rrugët kryesore të asfaltuara kanë nevojë për riasfaltim, zgjerime e rikonstruksione, të cilat të shpjen dhe në shkurtimin e tyre. Duke marrë parasysh këtë gjendje, si dhe mundësitë që ka ekonomia për shtrirjen dhe përmirësimin e rrugëve automobilistike, është e nevojshme të merren disa masa të ngutshme:

Me aksion, qysh në vitin 1983 të fillojë, atje ku nuk e kemi, lidhja e qendrave të kooperativave bujqësore dhe të sektorëve të NB-ve me rrugët kryesore automobilistike. Ndërtimi i këtyre rrugëve të bëhet kryesisht me shpenzimet e shtetit dhe të përfundojë deri në fund të vitit 1986. Ministria e Ndërtimit të marrë masat e nevojshme për projektimin, ndërtimin e rrugëve të reja dhe përmirësimin e atyre ekzistueseve. Ndërsa për lidhjen e sektorëve me qendrat e kooperativave bujqësore të ndërmerren aksione nga vetë fshatarësia kooperativiste për hapjen dhe ndërtimin e këtyre rrugëve, duke u ndihmuar nga shteti për projektimin e tyre, si dhe me transport, çimento, hekur, parafabrikate etj. Gjithashtu, gjatë studimit dhe projektimit të rrugëve të reja minerare, pyjore etj., që bëjnë ndërmarrjet shtetërore, të mbahet parasysh që të lidhin edhe fshatrat apo qendrat e banuara që ndodhen në afërsi të këtyre rrugëve.

Të përsoset më tej puna për asfaltimet dhe mirëmbajtjen e rrugëve, dhe në pesëvjeçarin e ardhshëm të rriten ritmet e asfaltimit duke përdorur teknologji të përparuar, të bëhen asfaltime në rrugë të reja, sidomos në drejtim të minierave, sharrave dhe qendrave bujqësore.

Organet e Partisë e të pushtetit në rreth të marrin masa për të organizuar aksione lokale me rininë e Frontin për hapjen e rrugëve të brendshme të fshatit dhe të organizohen skuadra të veçanta në kooperativat bujqësore për mirëmbajtjen e rrugëve.

Ministria e Ndërtimit dhe organet e saj projektuese e zbatue-

se, duke nxjerrë mësim nga të metat e vërtetuara, të marrin masa për të rritur cilësinë e projekteve dhe të ndërtimit të rrugëve automobilistike e të hekurudhave, me qëllim që ato të lejojnë një qarkullim më të shpejtë të mjeteve të transportit dhe të kenë një qëndrueshmëri më të lartë. Hekurudhat e reja që do të ndërtohen, të projektohen e të zbatohen me çakëll dhe doradorës të futen në trasetë edhe traversat e paranderura.

**c) Mbi rritjen e shkallës së mekanizimit të ngarkim-shkarkimeve.**

Rritja e shpejtë e efektivitetit të të gjitha llojeve të transportit, duke filluar nga karro-qerret deri te hekurudha apo anijet, varet shumë nga shkalla e mekanizimit të proceseve të ngarkim-shkarkimeve. Në mjaft raste, koha e ngarkim-shkarkimeve është më e madhe se vetë koha e lëvizjes së mjeteve. Jo vetëm kaq por në këto procese zihen edhe një numër i madh punëtorësh që kryejnë një punë relativisht të lodhshme.

Gjatë viteve të këtij pesëvjeçari janë parashikuar një varg masash për të prodhuar disa lloj mekanizmash për këto procese, si dhe janë sjellur e do të vijnë pajisje stacionare e të lëvizshme për këtë qëllim. Megjithëkëtë, gjendja nuk është për t'u kënaqur. Nga llogaritjet e bëra për disa lloje transporti del se shkalla e mekanizimit të vëllimit të punës të ngarkim-shkarkimeve sot është si vijon: për transportin hekurudhor ajo arrin rreth 72 për qind, për transportin automobilistik 50 për qind, për transportin detar 82 për qind, ndërsa në kooperativat bujqësore dhe në tërësi për transportin në ekonomi, shkalla e mekanizimit në procesin e ngarkim-shkarkimeve është e ulët.

Këto të dhëna tregojnë se Ministria e Komunikacioneve dhe ndërmarrjet e saj, por sidomos dikasteret e tjera, përfshirë këtu dhe ndërmarrjet e ekonomitë bujqësore, nuk kanë punuar si duhet për zgjidhjen e këtij problemi sa të rëndësishëm aq dhe të mprehtë. Mendimi krijues dhe nismat edhe në këtë fushë nuk kanë qenë të pakta, por jo kurdoherë ato janë mbështetur dhe vlerësuar mirë. Janë për t'u lavdëruar përpjekjet dhe rezultatet pozitive të disa ndërmarrjeve për prodhimin e vinçave, transportierëve, shesheve të pjerrëta, thithësve pneumatikë apo të bunkerëve ngarkues etj. Po kështu, ka ardhur koha të rishikohet dhe forma e ambalazhimit të vogël të një vargu mallrash që lëvizin me arka, me thasë, me kutia kartoni etj., të cilët gozhdohen për një kohë të gjatë mjetet e transportit dhe rritin shpenzimet e ngarkim-shkarkimeve. Është e kohës që në ngarkim-shkarkimet e tyre të futen sa më shpejt teknologji të reja të ambalazhimit e të lëvizjes së mallrave me kontenierë, me kosha, me sheshka etj., si dhe të punohet për mekanizimin e mëtejshëm të ngarkim-shkarkimeve të mallrave rifuso, si: drithëra, luledielli, panxhar-sheqeri, materiale inerte etj. Gjithashtu, nuk është e udhës që eko-

nomitë bujqësore të mbesin akoma për një kohë të gjatë të sfurku dhe lopata, për ngarkim-shkarkimin e plehut, foragjereve dhe prodhimeve të ndryshme. Edhe në vetë stacionet hekurudhore, depot e pranimit dhe të shpërndarjes të disa mallrave kanë nivel të ulët të ngarkim-shkarkimit.

Në qoftë se sot ne jemi në gjendje të prodhojmë vinça të mëdhenj portualë, makineri të ndërlikuara për veprat, sonda shpimi, vagonë etj., a mund të pranojmë mendimin që del aty-këtu se rritja e shkallës së mekanizimit të ngarkim-shkarkimit kushtëzohet me lopatat vetëshkarkuese, me grifera apo autovinça etj. nga importi? Natyrisht, ne kemi sjellë e do të sjellim të tilla pajisje, kur ato janë të domosdoshme, por më parë duhet të mobilizojmë dhe të shfrytëzojmë të gjitha mundësitë materiale, teknike e shkencore që ka dhe krijon ekonomia jonë, aftësitë dhe dijenitë e kadrove, specialistëve dhe novatorëve, të cilët, kur janë mobilizuar me ndërjegje të lartë socialiste, kanë bërë mrekulli. Prandaj organet dhe organizatat e Partisë të analizojnë gjendjen e ngarkim-shkarkimeve në çdo një të lëvizjes së mallrave dhe të vënë në lëvizje gjithë levat e tyre, me synim që, me një program të veçantë, brenda këtij pesëvjeçari shkalla e mekanizimit të rritet 10-15 për qind nga gjendja ekzistuese, dhe në fund të pesëvjeçarit të ardhshëm ajo të rritet më tej.

Ministria e Industrisë dhe e Minierave, Ministria e Ndërtimit, Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Komunikacioneve qysh në vitin e ardhshëm të marrin masa për fuqizimin e bazave e të linjave të prodhimit të mekanizmave të ngarkim-shkarkimit, duke planifikuar dhe investimet e nevojshme për to. Njëkohësisht të merren masa për ngritjen e depove dhe siloseve të mekanizuara në stacionet hekurudhore dhe, si rregull, të mos lejohet më ndërtimi i depove pa mekanizma ngarkim-shkarkimi.

#### **d) Mbi punën për kualifikimin dhe përgatitjen e kuadrit.**

Detyrat që përmendëm më sipër kërkojnë që të thellohet edhe puna për përgatitjen, kualifikimin dhe kalitjen e kuadrit në të gjitha llojet e transportit, në çdo hallkë të tij.

Partia, krahas zhvillimit e zgjerimit të transportit, ka treguar një kujdes të veçantë edhe për përgatitjen, kualifikimin e kalitjen e kuadrit punëtor dhe specialist. Sot në ndërmarrjet e sektorët e transportit, të të gjitha degëve, punojnë me mijëra punëtorë dhe mjeshtra të talentuar, inxhinierë e specialistë, si dhe kuadro të profileve të ndryshme. Megjithëkëtë, niveli arsimor në këtë degë është relativisht i pamjaftueshëm.

Kjo tregon se në ndërmarrje dhe në rrethe, si dhe nga vetë dikasteret përkatëse nuk punohet si duhet për përgatitjen dhe kualifikimin e kuadrit të nevojshëm. Për këtë flet fakti se në këtë vit pak punëtorë vazhduan shkollat pa shkëputje nga puna për ngritjen e nivelit arsimor të tyre, dhe në to kanë pasur rezultate

kaluese vetëm 60 për qind. Këtej del detyra që të shtohet puna e Partisë për një pjesëmarrje e një përfitim më të plotë në shkollat pa shkëputje nga puna dhe, në të njëjtën kohë, të tregohet më tepër kujdes që të merren punëtorë të rinj në punë, me arsim përkatës, sipas kërkesave të vendeve të punës. Si rregull, në vendet ku punëtorit i besohet një agregat, një makinë apo një aparaturë e mekanizëm i ndërlikuar, të shtohen kërkesat për arsimin e mesëm, dhe me ta të organizohen kurse kualifikimi. Gjithashtu, të shtohen kontingjentet e pranimit në shkollën 2-vjeçare e në ato të mesme të transportit dhe të zgjerohet profilizimi i këtyre shkollave, duke përfshirë dhe transportin hekurudhor.

Është pozitiv fakti që tani 32 për qind e punëtorëve përfshihen në kurset e kualifikimit, por ende kemi 23 për qind të punëtorëve të sistemit të Ministrisë së Komunikacioneve të pakualifikuar. Prandaj për kurset të tregohet kujdes i veçantë që ato të vazhdojnë në rregull dhe të përfitohet prej tyre sa më shumë.

Punë më të mirë për përgatitjen dhe kualifikimin e punonjësve të transportit duhet të bëjnë dikasteret e tjera për sektorët përkatës, të cilët shpesh konsiderohen si sektorë të parëndësishëm dhe lihen pas dore. Kjo në mënyrë të veçantë për ndërmarrjet e minierave, të gjeologjisë, të sharrave, të ndërtimit, të NB-ve dhe të kooperativave bujqësore.

Një vend të rëndësishëm në punën e forumeve në rrethe dhe të vetë organizatave të Partisë në bazë duhet të zërë puna për kuadrin, sepse nga studimet e bëra del se në sektorë e në ndërmarrjet e transportit të të gjitha llojeve kemi akoma mjaft drejtues pa arsim përkatës, pak specialistë e kuadro të rinj.

Krahas përgatitjes dhe kualifikimit të punëtorëve, organet e organizatat e Partisë dhe levat e tyre të dendësojnë punën për edukimin ideopolitik të tyre. Veçanërisht t'u kushtohet kujdes forcimit të qëndrimit socialist ndaj punës dhe pronës, rritjes së ndërjegjes dhe figurës morale gjatë shërbimit, sepse nuk janë të rralla rastet që disa shoferë ose punonjës të tjerë të transportit kryejnë veprime që bien në kundërshtim me normat e moralit komunist.

Lufta për realizimin e detyrave të planit të transportit dhe për kalitjen revolucionare të punonjësve të këtij sektori kërkon të gjallërohet më tej dhe jeta e brendshme e organizatave-bazë të Partisë, kritika dhe autokritika, të rritet forca përgjithësuese e tyre dhe të ngrihen në një nivel më të lartë iniciativa dhe vetëveprimi.

Krahas këtyre, organet e organizatat e Partisë duhet t'u kushtojnë një punë e kujdes më të madh shtrirjes e shpërndarjes së komunistëve, si dhe shtimit të radhëve të tyre me gjak të ri, që pranimet e reja në Parti të jenë në nivelin e degëve të tjera të ekonomisë.

Komitetet e Partisë të rretheve duhet t'u qëndrojnë më afër organizatave të transportit, të thellohen në problemet e tyre, të japin një ndihmë të kualifikuar për t'i bërë ato më luftarake e më të mobilizuara për plotësimin e tejkalimin e detyrave të mëdha që kanë.

Këto ishin disa nga problemet kryesore që menduam të shtrojmë në këtë mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë. Byroja Politike ka besim të patundur se komunistët, kuadrot dhe gjithë punonjësit e transportit, me guximin e vendosmërinë që i karakterizon, do të mobilizojnë të gjitha forcat dhe energjitë e tyre krijuese për t'i plotësuar detyrat si revolucionarë.

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 249 (10 676), 17 tetor 1982*

## V E N D I M

### I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH PËR GJENDJEN E TRANSPORTIT DHE MASAT QË DUHEN MARRË PËR FORCIMIN E ORGANIZIMIT DHE TË ZHVILLIMIT TË TIJ NË SHËRBIM TË EKONOMISË DHE TË POPULLATËS

14 tetor 1982

Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i mbledhur më 13 e 14 tetor 1982, pasi dëgjoi e shqyrtoi raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH, «Mbi gjendjen e transportit dhe masat që duhen marrë për forcimin e organizimit dhe të zhvillimit të tij në shërbim të ekonomisë dhe të popullatës» mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave, shoku Pali Miska,

#### *Vendosi:*

1. — Të miratojë raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë «Mbi gjendjen e transportit dhe masat që duhen marrë për forcimin e organizimit dhe të zhvillimit të tij në shërbim të ekonomisë dhe të popullatës».

2. — Të porositë organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organizatat e masave, organet shtetërore e të ekonomisë, komunistët, kuadrot dhe gjithë punonjësit e transportit që të mobilizojnë të gjitha forcat dhe energjitë e tyre krijuese, të marrin të gjitha masat e duhura për realizimin e detyrave të planit të transportit.

Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë t'u kushtojnë vëmendje të veçantë punës për gjallërimin e mëtejshëm të jetës së



brendshme të organizatave-bazë, shtrirjes e shpërndarjes së komunistëve, si dhe shtimit të radhëve të Partisë të sektorëve dhe reparteve të transportit me gjak të ri.

## PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

14 tetor 1982

Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë mbledhet më 13 e 14 tetor 1982, past dëgjoi e diskutoi raportin e Byrosë Politike të KQ të PPSH. Mbi gjendjen e transportit dhe masat që duhen marrë për forcimin e organizimit dhe të zhvillimit të tij në shtetin të cilin në shtetin të ekonomisë dhe të popullsisë në raport me raportin e Byrosë Politike dhe shtetshkrimit të Komitetit të Mbrojtjes së Mbrojtjes së Ballit të Mbrojtjes.

Vendosja:

1. — Të analizohet raporti i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë - Mbi gjendjen e transportit dhe masat që duhen marrë për forcimin e organizimit dhe të zhvillimit të tij në shtetin të ekonomisë dhe të popullsisë.  
2. — Të përcaktohet organi dhe organizatat-bazë të Partisë, organizatat e masave, organet shtetërore e të ekonomisë, komitetet kuadrot dhe gjithë punonjësit e transportit dhe të mobilizimit të gjitha forcat dhe energjitë e tyre krijuese, të marrin të gjitha masat e duhura për realizimin e detyrave të planit të transportit.  
Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë t'u kushtojnë veprimet të veçantë punës për gjerësimin e rrjetshëm të jetës së

## V E N D I M

### I SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH PËR TË PËRKUJTUAR 100-VJETORIN E VDEKJES SË KARL MARKSIT

17 nëntor 1982

Më 14 mars 1983 mbushen 100 vjet nga dita e vdekjes së Karl Marksit, revolucionarit dhe mendimtarit gjenial, themeluesit të lavdishëm të komunizmit shkencor, udhëheqësit dhe mësuesit të proletariatit ndërkombëtar. Emri dhe mësimet e tij të pavdekshme kanë udhëhequr dhe udhëheqin gjithë revolucionarët, të shtypurit e të shfrytëzuarit në luftë për të shkatërruar botën kapitaliste, borgjeze e revizioniste dhe për të krijuar shoqërinë e re socialiste e komuniste.

Komunistët dhe populli shqiptar, që mbajnë lart flamurin e ideve të Marksit, që me luftën, punën e veprën e ndërtimit socialist në Shqipëri provojnë forcën e vitalitetin e marksizëm-leninizmit, nderojnë me respekt e admirim të thellë veprën e Karl Marksit, frymëzohen nga shembulli e heroizmi i tij.

Për të përkujtuar 100-vjetorin e vdekjes së Karl Marksit dhe me qëllim që kjo t'i shërbejë propagandimit të ideve të tij të mëdha, Komiteti Qendror i PPSH,

### V e n d o s i :

1. — Të organizohet në të gjithë vendin përkujtimi i 100-vjetorit të vdekjes së Karl Marksit.
2. — Të zhvillohen në Tiranë në ditën e 100-vjetorit të vdekjes së Karl Marksit mbledhje përkujtimore.
3. — Të organizohet nga Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste dhe nga Shkolla e Partisë «V.I.Lenin» konferencë shkencore kushtuar jetës dhe veprës së pavdekshme e gjithnjë aktuale të Karl Marksit.
4. — Të organizohen në rrethe aktivitete të ndryshme, si

konferenca përkujtimore, biseda e leksione, të hapen fotoekspozita, ekspozita me vepra të Karl Marksit, si edhe aktivitete të tjera propagandistike, kulturore e artistike.

5. — Shtypi të botojë artikuj propagandistikë e teorikë për idetë dhe veprën e Karl Marksit, Radiotelevizioni të përgatitë e të transmetojë emisione të posaçme kushtuar jetës dhe veprimtarisë së Karl Marksit, kinostudioja «Shqipëria e re», të përgatitë e të shfaqë një film dokumentar.

6. — Të ngrihet në qytetin e Tiranës statuja e Karl Marksit dhe sheshit ku do të vendoset t'i vihet emri i tij.

7. — Të botohen dhe të vihen në qarkullim vepra të Karl Marksit ende të pabotuara në gjuhën shqipe, si dhe të ribotohen disa vepra të tjera të tij. Të botohen, gjithashtu, fotoekspozitë me tablo nga jeta dhe nga veprimtaria e Karl Marksit, portrete të tij dhe seri pullash për 100-vjetorin e vdekjes së Karl Marksit.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## V E N D I M

### I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR MASAT QË DUHEN MARRË PËR INTENSIFIKIMIN ME PËRPARËSI NË 6 RRETHET E ZONËS FUSHORE E BREGDETARE TË VENDIT

10 dhjetor 1982

Në zbatim të orientimeve e të detyrave të caktuara nga Kongresi i 8-të i PPSH për intensifikimin me përparësi të prodhimit bujqësor e blegtoral në zonën fushore e bregdetare të vendit, Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e saj të datës 10 dhjetor 1982, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave të RPSSH,

#### *V e n d o s i :*

1. — Organet e organizatat e Partisë, në qendër e në bazë, Këshilli i Ministrave, Ministria e Bujqësisë dhe ministrinë e tjera të marrin masa të gjithanshme politike, ideologjike e organizativo-teknike për kuptimin dhe zbatimin e plotë të direktivës së Kongresit të 8-të të PPSH për intensifikimin me përparësi të prodhimit bujqësor e blegtoral në 102 mijë hektarë të zonës fushore, si fillimi i një etape të re zhvillimi, duke kapërcyer edhe fazën e krijimit të kooperativave të tipit të lartë në këtë zonë që do të vazhdojë në rajone të tjera.

2. — Intensifikimi me përparësi në zonën e caktuar të rretheve Tiranë, Durrës, Lushnjë, Fier, Berat dhe Elbasan (zona e Peqinit), krahas intensifikimit të gjithë bujqësisë së vendit, të bëhet i shkallëzuar. Nga 25 mijë hektarë, që është arritur në vitin 1982, të arrijë në 46 mijë hektarë në vitin 1983, në 70 mijë hektarë në vitin 1984 dhe në vitin 1985 intensifikimi të arrihet në tërë sipërfaqen e kësaj zone, duke realizuar dhe rendimentet e parashikuara në ritudimin e bërë.

3. — Përqendrimi, specializimi dhe qarkullimet bujqësore sipas përvojës së KTL të Plasës, të vlerësohen si faktorë që sje-

llin ndryshime në zhvillimin e ekonomisë dhe koncepte të reja të prodhimit të madh socialist.

Ministria e Bujqësisë, Komisioni i Planit të Shtetit dhe organet e Partisë e të pushtetit në rrethe e në bazë të ndjekin zbatimin e kësaj përvoje që në vitin 1983 në zonën fushore të rretheve Tiranë, Durrës e Lushnjë. Ndërsa në zonën fushore të rretheve Fier, Berat dhe Elbasan (zona e Peqinit) zbatimi të bëhet i shkallëzuar në vitet 1984-1985. Ekonomitë bujqësore të kësaj zone të zbatojnë me disiplinë të rreptë shkencore përqendrimin, specializimin dhe qarkullimet bujqësore të miratuara.

4. — Ministria e Bujqësisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve ta rishpërndajnë bazën materialo-teknike të diferencuar, duke ndihmuar me përparësi ekonomitë e sektorit që janë më prapa me rendimentet dhe që i kanë kushtet për t'u ngritur në nivelin e të përparuarve.

5. — Këshilli i Ministrave, Komisioni i Planit të Shtetit, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Financave dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve të përcaktojnë kriteret dhe masat që kooperativat bujqësore të zakonshme të zonës që intensifikohet me përparësi të trajtohen si kooperativa të tipit të lartë.

6. — Këshilli i Ministrave, me dikasteret përkatëse, brenda vitit 1983, të kryejë studime perspektive për përsosjen e mëtejshme të marrëdhënieve në fushën e këmbimit, për mënyrat dhe rrugët e thithjes së produkteve bujqësore, për furnizimin e anëtarëve të kooperativave bujqësore në zonën që intensifikohet me përparësi etj.

7. — Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Këshilli i Ministrave me organet e tij vartëse.

Byroja Politike shpreh bindjen se komunistët e punonjësit e bujqësisë do të mobilizohen e do të bëjnë realitet detyrat e shtruar nga Kongresi i 8-të i Partisë për intensifikimin e bujqësisë dhe për plotësimin gjithnjë e më mirë të kërkesave të popullit dhe të ekonomisë për produkte bujqësore e blegtorale.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## ORIENTIME

### TË BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR RITMET DHE KRITERET E SHTIMIT TË RADHËVE TË PARTISË PËR PERIUHDHËN 1982-1986

20 janar 1983

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 20 janar 1983, pasi shqyrtoi «Disa konkluzione e detyra që dalin nga studimi mbi ritmet dhe kriteret e shtimit të radhëve të Partisë për periudhën 1982-1986»,

#### *Orienton:*

1. — Shtimi i radhëve të Partisë për pesë vjetët e ardhshëm të bëhet me ritëm mesatar vjetor rreth 4 për qind.

2. — Të vazhdojë shtimi me përparësi i radhëve të Partisë me komunistë punëtorë. Pranimet nga punëtorët të zënë rreth 42-43 për qind.

Organet dhe organizatat-bazë të Partisë, gjithnjë e më mirë, të punojnë e të bëjnë kujdes që në Parti të mos lejohen shfaqje të pranimeve «punëtorë për punëtorë», por të pranohen punëtorët më të mirë, me tiparet më të shquara të klasës, që punojnë në degët kryesore të prodhimit, në frontet dhe profesionet më të rëndësishme të tij si në industri, miniera e gjeologji, ndërtim, transport, ndërmarrjet bujqësore etj. Të pranohen më shumë simdomos minatorë, naftëtarë, gjeologë, metalurgë, mekanikë, ndërtesues, teknologë e kimistë, shoferë e mekanizatorë, bujq e blegtorë e të tjerë.

3. — Pranimet në Parti nga radhët e kooperativistëve të zënë rreth 41-42 për qind.

Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë të konkretizojnë më mirë detyrat që dalin nga orientimet e Kongresit të 8-të për të shpejtuar realizimin e pikësnyimet që, në efektivin e Partisë,



komunistët kooperativistë, në perspektivë, të dalin në vendin e dytë, pas punëtorëve.

Pranimet të bëhen nga bujqit, blegtorët e pemëtarët më të mirë, që janë në ballë të prodhimit, që duan fshatin e punën në ekonominë kooperativiste dhe kanë tërë cilësitë e tjera që kërkohen.

Të luftohet kundër shfaqjeve liberale, të familjaritetit e të vënies së interesit personal mbi atë të përgjithshëm që nxitin e lejojnë largimin e komunistëve nga kooperativat bujqësore.

4. — Nga radhët e nëpunësve pranimet të zënë rreth 15-16 për qind. Të pranohen në Parti ata që japin prova besnikërie e devotshmërie për zbatimin e vijës së Partisë, që kanë nivel të lartë ideopolitik e kulturor, arsimor, teknik e shkencor, që punojnë në sektorët më të rëndësishëm të ndërtimit socialist e të mbrojtjes, në ato vende dhe nga ato specialitete që ka më shumë nevojë Partia.

Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë të thellojnë e të zhvillojnë pareshtur luftën për të parandaluar çdo shfaqje të teknokratizmit në shtimin e radhëve të Partisë.

Më mirë se deri tani në shpërndarjen e kuadrove të mbahet parasysh edhe qenia e tyre në Parti, për të parandaluar grumbullimin e tyre, siç vihet re herë-herë, në disa vende, më shumë sesa është nevoja dhe për të pasur kështu një raport sa më të drejtë të komunistëve me punonjësit e paorganizuar në Parti, sidomos në dikastere dhe në aparate të tjera në qendër e në rrethe.

5. — Të rriten më tej kujdesi dhe puna për shtimin e radhëve të Partisë me shoqe. Pranimet e reja nga radhët e tyre të zënë rreth 45-50 për qind.

6. — Të ndiqet më mirë moshë mesatare e efektiviteti të Partisë për të ruajtur gjithnjë freskinë e saj edhe në këtë drejtim.

Pa cenuar cilësinë, të bëhet kujdes për një moshë mesatare më të re në pranimet e reja. Si orientim, pranimet nga radhët e punëtorëve dhe të kooperativistëve të jenë me moshë mesatare rreth 21-23 vjeç dhe nga nëpunësit rreth 26-28 vjeç.

Në të ardhmen mund të pranohen më shumë se deri tani të rinj para se të shkojnë ushtarë, nga ata që kryejnë shërbimin ushtarak dhe studentë në shkollat civile e ushtarake, duke punuar me kujdes e me përgjegjësi për zgjedhjen e tyre.

7. — Vendimtare ka qenë dhe mbetet cilësia e pranimeve. Organet dhe organizatat-bazë të Partisë të punojnë për kuptimin më të mirë nga komunistët e punonjësit të orientimeve që theksoi Kongresi i 8-të për këtë çështje dhe të sigurojnë zbatimin si duhet të tyre.

8. — Ndjekja e pranimeve në Parti dhe e përjashtimeve nga radhët e saj është një nga problemet më të rëndësishme në punën e Partisë. Komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë të

bëjnë punë më të kualifikuar e shkencore për shtimin e radhëve të saj. Të luftohet me vendosmëri çdo shfaqje formale e burokratike, çdo prirje për të qenë në rregull me shifrat e përqindjet, për t'i trajtuar si plan edhe studimet që janë bërë.

Të rritet e të përsoset më tej sidomos roli i organizatës-bazë për pranimet e reja në Parti. Ky të jetë një preokupacion i vazhdueshëm e gjithnjë në rritje për organet e Partisë. Komitetet e Partisë dhe aparatet e tyre të ndihmojnë më drejtpërdrejt e më me efektivitet organizatat-bazë për këtë qëllim.

9. — Për zbatimin e këtyre orientimeve ngarkohen komitetet e Partisë të rretheve e të njëjive ushtarake dhe aparati i Komitetit Qendror të Partisë.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## PLENUMI I 6-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 24-25 janar 1983

### KOMUNIKATË

#### E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 24 dhe 25 janar 1983, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi i 6-të i Komitetit Qendror të PPSH, i cili mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Për plotësimin e planit të vitit 1982 dhe detyrat kryesore të projektplanit të vitit 1983», mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të RPSSH, shoku Besnik Bekteshi<sup>1</sup>.

Pasi diskutoi gjerësisht rreth raportit të paraqitur dhe dëgjoi konkluzionet që bëri për këtë çështje anëtari i Byrosë Politike dhe sekretar i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Ramiz Alia, Plenumi i Komitetit Qendror e miratoi atë njëzëri dhe mori vendimet përkatëse.

Plenumi i 6-të i Komitetit Qendror, me propozimin e Byrosë Politike, shoqen Lenka Çuko, anëtare e Byrosë Politike të Komitetit Qendror, e zgjodhi sekretare të Komitetit Qendror të PPSH.

#### PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

1. Në Kongresin e 9-të të PPSH u zgjodh anëtar i Byrosë Politike të KQ të PPSH.

## R A P O R T

### I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «PËR PLOTËSIMIN E PLANIT TË VITIT 1982 DHE DETYRAT KRYESORE TË PROJEKTPLANIT TË VITIT 1983»

25 janar 1983

Shokë,

Në të gjithë vendin, viti që kaloi u karakterizua nga rritja e mobilizimit dhe e përpjekjeve të masave të gjera punonjëse për vënien në jetë të vendimeve historike të Kongresit të 8-të të Partisë, të detyrave të planit dhe të mësimëve të vazhdueshme të shokut Enver Hoxha.

Organet dhe organizatat e Partisë, organet shtetërore, ato ekonomike dhe gjithë organizatat e masave bënë një luftë të vendosur e më të organizuar për të kapërcyer vështirësitë e rritjes dhe të bllokadës imperialisto-revizioniste, për të likuiduar ndikimet e veprimtarisë armiqësore të poliagjentit Mehmet Shehu dhe të bandës së tij.

#### I. Mbi plotësimin e detyrave të planit të vitit 1982

Në vitin 1982, treguesit e përgjithshëm dhe përpjesëtimet kryesore të ekonomisë kanë shënuar përmirësime të mëtejshme. Prodhimi shoqëror u rrit 4,4 për qind dhe të ardhurat kombëtare 4,5 për qind, në një kohë që popullsia u shtua 2,1 për qind. Këto rritje janë nga më të mëdhatë e viteve të fundit dhe dëshmojnë qartë për mundësitë që ka ekonomia jonë për të ecur me ritme relativisht të shpejta, duke u mbështetur plotësisht në forcat tona.

Zhvillimi dinamik i ekonomisë krijoi mundësi që të përmirësohen edhe përpjesëtimet kryesore të saj. Rritja e të ardhurave kombëtare ishte më e lartë nga ajo e produktit shoqëror,

produkti për shoqërinë u rrit me ritme më të shpejta se produkti për vete, fondi i mallrave eci më shpejt se fuqia blerëse e popullit.

Këto arritje në vitin e kaluar dëshmojnë për vijën dhe politikën e drejtë të Partisë, për forcën dhe vitalitetin e ekonomisë sonë socialiste, për epërsinë e padiskutueshme të rendit tonë shoqëror ndaj botës kapitalisto-revizioniste që është zhytur në një krizë të thellë e të gjithanshme.

Te ne edhe vitin e kaluar u zhvilluan dhe ecën përpara të gjitha degët dhe sektorët kryesorë të ekonomisë dhe të kulturës.

**Produkti i përgjithshëm industrial** u rrit 4,7 për qind. Plani u plotësua apo u tejkalua në nxjerrjen e gazit, të qymyrgurit, të një sërë mineralesh e prodhimesh të industrisë mekanike, kimike, të materialeve të ndërtimit, të mallrave të konsumit të gjerë etj. Por në të njëjtën kohë nuk u realizuan plotësisht nxjerrja e naftës, prodhimi i çeliqueve, ai i karbonatit bazik të nikelit, i koncentratit të hekurit, i sheqerit etj.

Këto mosrealizime kanë ndikuar në mënyrë të ndjeshme në ekonomi dhe sidomos në bilancin valutor, në shtyrjen e disa veprave të reja etj. Nga analizat që u kanë bërë organet dhe organizatat e Partisë këtyre mosplotësimeve, si dhe nga shqyrtimi që i bëri Byroja Politike realizimit të planit të vitit 1982, del qartë se shkaqet e këtyre deficiteve kanë kryesisht karakter subjektiv. Ato kanë të bëjnë me dobësitë që vihen re në punën e organeve e të organizatave të Partisë, të organeve shtetërore dhe të ekonomisë, me punën e pamjaftueshme të kuadrove e të institucioneve shkencore...

Me të drejtë vihet pyetja: Përse ecet në sektorin e naftës me dobësi të përsëritura nga viti në vit? Përse planet nuk mbështeten në studime të thelluara? Përse thyhen herë pas here grafikët e punimeve dhe disiplina teknike e organizative? Si është niveli i punës së Partisë me njerëzit dhe për njerëzit? Si është niveli i ndihmës dhe i kontrollit të organeve të Partisë dhe i atyre shtetërore në rreth dhe në qendër? Por për deficitet në këtë degë duhet të përgjigjen për pjesën e tyre edhe organet e tregtisë së jashme, të cilat nuk u janë përgjigjur kërkesave të domosdoshme të kësaj dege.

Kështu shtrohet çështja dhe për metalurgjinë e zezë, ku deficitet e çelikut, të koncentratit të hekurit apo të karbonatit bazik të nikelit vlerësohen me disa milionë dollarë. Në kombinatin metalurgjik «Çeliku i Partisë» ndikim të thellë negativ për vitin e kaluar ka pasur puna e dobët për përvetësimin e zbatimin e teknologjisë së prodhimit në të gjitha uzinat e në veçanti në Uzinën 12 dhe prapambetja në prodhimin e rigjenerimin e pjesëve e të nyjeve të ndërrimit për gjithë makineritë e kombi-

natit. Këto të meta, me këmbëngulje e me një punë të thelluar shkencore mund të kapërcehen, sepse është fakt që kur u arrit një kombinim i drejtë i mineraleve dhe zbatim i saktë i teknologjisë në Uzinën 12 u morën, brenda një dite, rreth 800 tonë koncentrat.

Të metat e karakterit subjektiv kanë penguar dhe në degë të tjera të industrisë, si në nxjerrjen e kromit, sidomos në Minierën e Bulqizës, në disa fabrika pasurimi mineralesh, në Uzinën e Uresë, në atë të Pirometalurgjisë në Laç, në industrinë tekstile, në zënie e peshkut apo në Kombinatin e Sheqerit etj. Prandaj dikasteret përkatëse dhe organet e tyre vartëse në rreth e në bazë, me shembullin konkret të komunistëve dhe të organizatave-bazë që militojnë në këto organe, të nxjerrin mësimet dhe detyra luftarake, që dobësi të tilla të mos përsëriten gjatë këtij viti.

**Në bujqësi**, me gjithë thatësinë e jashtëzakonshme, prodhimi i përgjithshëm u rrit 5 për qind kundrejt vitit 1981, ndërsa grurë u prodhua më shumë se çdo vit tjetër i periudhës së pasçlirimit. Drithëra buke u morën më shumë 72 mijë tonë, qumësht mbi 35 mijë tonë, perime 17 mijë tonë etj.

Megjithëkëto, në krahasim me planin u krijua një deficit në prodhimin bujqësor... që pati ndikimet e veta në eksport dhe në drejtime të tjera.

Këto deficite nuk mund të justifikohen thjesht me kushtet e vështira klimatike. Ato kanë të bëjnë në një masë të madhe me mobilizimin dhe organizimin e pamjaftueshëm të njerëzve dhe të mjeteve materiale, me mungesat në zbatimin e disiplinës shkencore e të teknologjive të reja, me spontanitetin që vërehet ende në disa raste për përhapjen dhe zbatimin e përvojës së përparuar. Fakti është se në mjaft ekonomi dhe bile në mjaft rrethe, si ai i Sarandës, Krujës, Lezhës, Shkodrës, dhe në fushën e Korçës, u arritën rezultate të kënaqshme edhe në kushtet e vështira të vitit të kaluar. Në këto rrethe dhe në ekonomitë e përparuara, me këmbëngulje e vendosmëri u punua për të shfrytëzuar racionalisht dhe me efektivitet të lartë gjithçka që u shërbente kapërcimit të vështirësive të motit dhe plotësimit të tejkalimit të detyrave.

Ministria e Bujqësisë, komitetet e Partisë dhe ato ekzekutive të rretheve Durrës, Lushnjë, Fier, Berat dhe Elbasan që kanë sipërfaqe të gjera të përfshirë në zonën e caktuar për t'u intensifikuar me përparësi, me gjithë porositë e dhëna dhe studimet e konkretizimet e kryera, nuk morën në kohë e me vendosmëri masat e nevojshme që të arrihen e të tejkalohen objektivat që u caktuan për këtë zonë. Kështu, në vend që ato të paraprinin me rezultatet e tyre, për disa tregues të planit krijuan deficite të ndje-



shme dhe mbeten më prapa se mjaft rrethe që nuk përfshihen në këtë zonë.

Komiteti Qendror ka dhënë porosi të herëpashershme, për të studiuar e për të zbatuar me këmbëngulje përvojën shumë të mirë të kooperativës bujqësore të Plasës, atë të ndërmarrjeve bujqësore Vrinë e Maliq dhe të kooperativave të Dajçit, të Greccallisë, të Bushatit, të Lapardhasë etj. Ministria e Bujqësisë, organet shtetërore ekonomike në rreth e në bazë më mirë duhet t'u futen problemeve të përqendrimit, specializimit e të qarkullimeve bujqësore mbi bazën e teknologjive të reja. Ato duhej të analizonin më me kujdes, mbi baza shkencore, faktorët që çuan në arritjet e larta, por anuan më shumë në aspektet e përgjithshme e propagandistike. Kështu mund të shpjegohet edhe ajo prapambetje që patën mjaft rrethe për prodhimin e fasules, të patates, të ullirit etj.

Thatësira e gjatë vërtet na vështirësoi për disa prodhime, por për pambukun si zor të përsëritet një vit kaq i përshtatshëm, përfshirë këtu dhe vjeshtën, por, siç jeni në dijeni, edhe këtë vit plani i prodhimit të pambukut nuk u realizua veçse 83 për qind, kur rrethi i Beratit, që ka toka nën ujë më pak nga rrethet e tjera, plotësoi detyrën, ose kooperativa bujqësore e Lapardhasë tejkaloi planin dhe disa brigada morën mbi 24 kv për hektar.

Në goftë se në prodhimin e frutave, agrumeve dhe rrushit, si rrjedhim i një pune më të mirë që u bë sidomos për mbrojtjen nga dëmtuesit, detyrat e planit u plotësuan dhe u tejkaluan, nuk u tregua i njëjti kujdes për ullirin. . .

Në blegtori u bënë hapa të mirë përpara. U punua më seriozisht për bazën ushqimore. U futën teknologji të reja në mbarëshkrimin dhe ushqimin e bagëtive. Filloi një punë më e thelluar gjenetike për përmirësimet racore, duke përfshirë këtu edhe bagëtitë e tufëzuara. Megjithatë edhe në blegtori janë vërtetuar të meta e dobësi. Numri i krerëve të gjedhit, të të imëtave dhe dosave nuk u rrit sipas planit. Po kështu nuk u rrit edhe rendimenti për kokë goftë i qumështit, goftë i mishit. Më keq ato u realizuan nga bagëtitë e tufëzuara, duke u krijuar kështu mungesa të ndjeshme në furnizimin e fshatit me prodhime blegtorale. Prandaj, Ministria e Bujqësisë, institucionet e saj kërkimore-shkencore, rrethet dhe vetë sektorët e blegtorisë në ekonomitë bujqësore, duhet të nxjerrin konkluzione e të thellohen për këtë gjendje, sepse jo pak tokë e mjete janë destinuar për blegtorinë, jo pak investime janë bërë dhe vazhdojnë të bëhen për të, ndërsa frytshmëria e tyre është akoma e pamjaftueshme.

**Në fushën e investimeve dhe të ndërtimeve plani u plotësua 90 për qind. Me përjashtim të banesave, për të gjithë sektorët e tjerë investimet nuk janë plotësuar sipas planit. Mosrealizimet në objekte të rëndësishme, si në disa fabrika pasurimi mi-**

neralesh apo në Kombinatin e Tekstileve në Berat, në disa linja të reja dhe zgjerime të aftësisë prodhuese kanë ardhur kryesisht sepse u punua dobët për projektimin dhe prodhimin e makinerive e pajisjeve në vend. Edhe Ministria e Tregtisë së Jashtme nuk siguroi në kohë e në sasi materialet bazë dhe makineritë që ishin planifikuar nga importi. Byroja Politike dhe Komiteti Qendror, qysh në fillim të vitit të kaluar, u tërhoqën vëmendjen dhe i kritikuan [disa shokë të Plenumit]. . . për prapambetjen në disa objekte të rëndësishme, për nënvleftësimin e prapambetjen në plotësimin e detyrave nga dikasteret që këta drejtonin. Me gjithë përmirësimet, prapambetja nuk u kapërcye plotësisht. Kjo prapambetje ndikon edhe këtë vit, sepse shtyhen afatet e vënies në shfrytëzim të këtyre objekteve e krijohen pasoja të padëshirueshme për prodhimin dhe për zënien me punë të forcave të reja.

Vitin e kaluar janë vërtetuar dhe raste që fondet e investimeve nuk janë administruar si duhet. Në disa objekte ato janë tejkaluar mbi preventivat apo mbi kufijtë e planifikuar, ka pasur objekte që janë shtyrë e të tjera që janë avancuar. Këto raste dhe prapambetja që kemi për investimet flasin qartë për një punë pa përgjegjësi nga investitorët, nga institucionet projektuese, por edhe për dobësi të kontrollit financiar e bankar. Akoma nuk është vendosur një disiplinë e regjim i fortë kursimi për investimet e ndërtim-montimet. Në sektorin e ndërtimit kërkohet një vlerësim më i drejtë i mendimit ekonomik për domosdoshmërinë dhe leverdinë e veprave të reja, për uljen e kostos së materialeve të ndërtimit dhe gjetjen e rrugëve për kursime.

**Plani i eksportit dhe ai i importit nuk u realizuan plotësisht.** Sikurse theksuam dhe më sipër këtu kanë ndikim të madh mosrealizimet në karburante, bitume, energji elektrike, disa prodhime të bujqësisë e të industrisë së lehtë, por përgjegjësi të rëndë kanë edhe organet e tregtisë së jashtme. Me gjithë premtimet e herëpashershme për të ulur gjendjen e mallrave në depo, në limitet e caktuara, edhe gjatë vitit të kaluar kthesa nuk u bë. Në fund të vitit kishte gjendje mallrash për eksport mbi limitet. Përpjekjet të pamjaftueshme u bënë për gjetjen e tregjeve për mineralet e reja.

Duke mos siguar të ardhurat nga eksporti, edhe importi nuk u plotësua. Veç kësaj pati vonesa në kontraktimet me jashtë, si dhe për tërheqjen e mallrave nga portet e vendeve të huaja. . .

Me gjithë vështirësitë e krijuara, **financat tona u fuqizuan më tej** dhe përballuan me sukses nevojat e zhvillimit të ekonomisë, të kulturës e të forcimit të mbrojtjes. Nga ulja e kostos u siguroa një akumulim prej afro 270 milionë lekë.

U forcuan më tej organizimi dhe drejtimi i ekonomisë dhe u trajtuan me kujdes disa probleme të përsosjes së marrëdhënieve ekonomike, sidomos në fshat.

Zhvillimi i mëtejshëm i ekonomisë gjatë vitit 1982, krijoi mundësi për garantimin dhe ngritjen e mirëqenies së popullit.

Në sektorin shtetëror u zunë me punë rreth 30 mijë punonjës. Zënia me punë e të gjitha forcave të reja në qytet e në fshat, thellimi i masave favorizuese për kooperativat e zonës kodrinore malore dhe ulja e çmimeve bënë që të ardhurat monetare të popullatës të rriten 5,9 për qind, ndërsa veçanërisht të ardhurat e kooperativistëve 16,5 për qind. Edhe qarkullimi i mallrave u realizua mirë, sidomos në tregtinë shtetërore dhe furnizimi i popullatës ka qenë normal. Ndërsa për fshatin plani i xhiros së tregtisë kooperativiste u realizua vetëm 82 për qind. Në vitin e kaluar u ndërtuan mbi 9 mijë apartamente banimi. Nga Partia u caktuan masa të rëndësishme për ngritjen cilësore të punës në shkolla dhe për përmirësimin e shërbimit shëndetësor e komunal ndaj popullit.

Përvoja e këtij viti na mësoi edhe një herë se kur organet dhe organizatat e Partisë mobilizohen si duhet, vënë në lëvizje mirë të gjitha levat, i ndihmojnë e i kontrollojnë sistematikisht ato, kur të gjithë komunistët me punën e shembullin e tyre realizojnë rolin udhëheqës, aty ku derdhen mudi dhe djersa e punonjësve dhe vihet në jetë mendimi krijues i tyre, sado të ngjeshura e të vështira të jenë detyrat e planit, ato plotësohen me sukses. Këto mësimet t'i kemi parasysh dhe t'i zbatojmë gjerësisht gjatë këtij viti në të gjithë vendin.

## II. Detyrat kryesore të planit të vitit 1983

Plani i këtij viti mbështetet në arritjet e viteve të kaluara dhe në objektivat e planit të shtatë pesëvjeçar, të miratuar në Kongresin e 8-të të Partisë. Ai pasqyron drejt direktivat që ka shtruar Komiteti Qendror kohët e fundit dhe porositë e vazhdueshme të shokut Enver Hoxha për mjaft probleme të rëndësishme.

Detyrat e planit të vitit 1983 në përgjithësi janë më të larta nga ato të vitit të kaluar. Prodhimi shoqëror do të jetë 8,1 për qind më i lartë dhe të ardhurat kombëtare 8,3 për qind. Prodhimi industrial do të rritet 6,1 për qind, ai bujqësor mbi 17 për qind, investimet 5,7 për qind dhe qarkullimi i mallrave 7 për qind.

Objektiva të rëndësishme janë caktuar për rendimentin e punës, për kursimin e vlerave materiale dhe financiare, si dhe për përdorimin sa më të plotë të aftësive prodhuese. Me këto detyra krijohen mundësi për të rritur më tej efektivitetin e ekonomisë, për shtimin e akumulimit, për përmirësimin e mirëqenies materiale e kulturore të popullit, në qytet e në fshat, dhe për forcimin e mëtejshëm të aftësisë mbrojtëse të atdheut.

Arritja e këtyre objektivave kërkon një mobilizim më të madh të masave të gjera punonjëse nën drejtimin e Partisë, një aktivizim e shfrytëzim më të plotë e shkencor të bazës materialo-teknike dhe përsosjen e mëtejshme të organizimit e të drejtimit dhe rritjen e efektivitetit të ekonomisë në të gjitha fushat.

Byroja Politike e sheh të nevojshme gjithashtu të vërë në dijeni Plenumin se si pasojë e mosrealizimeve në prodhim, në ndërtim dhe në eksport, detyrat e parashikuara janë diçka më të ulëta nga plani pesëvjeçar për vitin 1983 i miratuar në Kongres. Këto ulje janë në prodhimin industrial, në atë bujqësor, në eksport, në qarkullimin e mallrave dhe në të ardhurat financiare. Kjo sjell edhe ndonjë shpërpjesëtim midis rritjes së rendimentit të punës dhe të ardhurave reale për frymë të popullsisë, midis rritjes së produktit për shoqërinë dhe të produktit për vete, të cilat mund të jenë të pranueshme vetëm përkohësisht. Prandaj ne duhet të reflektojmë e të thellohemi më shumë në porosinë që na ka dhënë shoku Enver Hoxha në librin «Për planin e shtatë pesëvjeçar» se mbajtja e ritmeve dhe përpjesëtimeve që po planifikojmë

**«...shtrojnë me tërë forcën vetëm një alternativë: mobilizimin total dhe plotësimin deri në një të detyrave të planit...»<sup>1</sup>.**

Të gjithë shokët janë të njohur me detyrat e parashikuara për planin e vitit 1983. Prandaj këtu do të ndalemi vetëm në disa nga objektivat dhe problemet kryesore të degëve të ekonomisë dhe të kulturës.

1. — **Në industri** do të bëhet një hap i rëndësishëm përpara për shtimin e prodhimit, për përmirësimin e strukturës së mallrave, për ndërtimin dhe rikonstruksionin e disa veprave të rëndësishme. Për zhvillimin e kësaj dege do të përdoren afro 49 për qind të investimeve shtetërore. Në krahasim me realizimin e vitit 1982 rritje do të ketë në të gjitha degët e industrisë së rëndë e të lehtë, duke bërë përjashtim diçka në nxjerrjen e kromit, ku kemi gjendje të konsiderueshme akoma pa eksportuar. Kundrejt realizimit të vitit 1982 prodhimi industrial do të rritet 6,1 për qind.

### **Nxjerrja e naftës...**

Për plotësimin e planit në naftë Ministria e Energjetikës duhet të marrë masa të forta e të gjithanshme që të arrihet kuota medoemos çdo ditë, çdo javë e çdo muaj.

Një punë shumë më e thelluar dhe e argumentuar shken-

1. Enver Hoxha, «Për planin e shtatë pesëvjeçar», f. 528.



cërisht kërkohet të bëhet për investimet e mëdha që bëhen në naftë për të rritur efektivitetin e tyre, për zbulimin e fushave të reja naftë dhe gazmbajtëse. Gjithashtu nuk duhet të lihen pas dore fushat apo strukturat që më parë kemi atakuar me një apo dy puse, pa bërë përgjithësime të plota shkencore dhe pa nxjerrë konkluzione bindëse për t'u larguar nga to. Nga Instituti Gjeologjik i Naftës, si institucion shkencor, kërkohet të bëjë jo një punë sot për sot, por një punë të thelluar shkencore dhe me perspektivë. Gjithashtu të hapet më mirë perspektiva e kërkimeve në ranoret dhe në bregdet dhe të merren masa të shpejta për shfrytëzimin sipas planit të rërave bituminoze, ku vihet re një prapambetje e palejueshme. Të këmbëngulet e të kërkohet llogari për zbatimin e detyrës së Kongresit që metodat e dyta dhe intensifikuese të shtrihen gjerësisht dhe të shtojnë prodhimin.

Organet dhe organizatat e Partisë, organet shtetërore e ato ekonomike, të rritin mobilizimin e naftëtarëve dhe të luftojnë si euforinë, ashtu edhe hezitimet për vlerësimin e rezervave të nxjerrshme dhe të regjimeve të shfrytëzimit të vendburimeve. Në të njëjtën kohë ministrinë e tjera, sidomos ajo e Industrisë dhe e Minierave dhe ajo e Tregtisë së Jashtme të plotësojnë në kohë dhe me cilësi detyrimet që kanë ndaj industrisë së naftës.

**Industria mekanike** të zbatojë më mirë direktivat e Kongresit të 8-të të Partisë për prodhimin e makinerive e të pajisjeve për objektet e reja, për rikonstrukcionet dhe zgjerimin e aftësive prodhuese, sepse po krijon vështirësi e prapambetje. Po kështu dhe dikasteret e tjera porositëse të përgatitin në kohë e sipas metodologjisë së planifikimit kërkesat, projektet dhe bazën materiale për to. Në vitin 1983, kundrejt vitit të kaluar, prodhimi i makinerive dhe i pajisjeve për veprat e reja rritet 30 për qind. Vetëm për 173 vepra do të duhet të prodhohen 673 lloje makinerish e pajisjesh me 9 mijë copë. Po ashtu prodhimi i pjesëve të ndërrimit rritet 8 për qind dhe ripërtëritja e tyre afro 13 për qind.

Komiteti Qendror i Partisë nuk mund të pajtohet me atë javashllëk, zvarritje, mungesë organizimi dhe kooperimi të dobët të industrisë mekanike. Në të gjitha degët e ekonomisë ajo, megjithëse i realizon planet në global, megjithëse ka aftësi të mëdha prodhuese, nuk u përgjigjet në kohë kërkesave dhe nevojave të ekonomisë për prodhimin e makinerive e të pajisjeve për veprat e planifikuara për t'u ndërtuar me forcat tona. Instituti i Studimeve dhe i Projekttimeve Mekanike, byrotë projektuese e teknologjike në ndërmarrje dhe ata mijëra quadro të lartë e të mesëm të kësaj dege duhet të vihen para përgjegjësisë për prapambetjen që po vazhdojnë të krijojnë dhe për ngritjen e nivelit shkencor. Të reflektohet me frymë revolucionare dhe të bëhen përmirësime për vërejtjet që kanë konsu-

matorët për cilësinë, për koston e prodhimit dhe për jetëgjatësinë e pjesëve të ndërrimit. Po ashtu të luftohen hezitimet e zvarritjet për zbatimin e orientimeve të Kongresit të 8-të të Partisë për ripërtëritjen e pjesëve të ndërrimit.

Më mirë duhej të ishte punuar për këto çështje edhe nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe nga Komisioni Shtetëror i Industrisë Mekanike. Edhe Komisioni i Planit të Shtetit duhet t'i kishte ngritur me kohë e me forcë para Partisë këto probleme dhe të ndikonte më shumë me forcën e planit në këtë fushë.

Të kuptohet thellë nga të gjithë porosia e shokut Enver Hoxha në mbledhjen e Byrosë Politike se industria mekanike, **pavarësisht nga vartësia administrative, me një plan e kooperim shkencor duhet medoemos t'u përgjigjet nevojave të të gjithë vendit.** Në kuadrin e këtij kooperimi të industrisë mekanike, më shumë detyra e përgjegjësi të marrin për veprat e reja të 400 e ca bazat mekanike të vendit dhe sidomos uzinat e mëdha të kombinatit të autotraktorëve «Enver Hoxha», të kombinatit metalurgjik «Çeliku i Partisë», uzinat mekanike të naftës, të Ministrisë së Ndërtimit dhe të Komunikacionit, UMB-të, deri tek ofiçinat më të vogla pranë ndërmarrjeve.

Vëmendje të veçantë kërkohet zgjidhja e problemeve dhe kapërcimi i vështirësive në **Kombinatit Metalurgjik...** Organizata e Partisë në kombinat duhet të vërë më mirë në lëvizje specialistët e punëtorët për përvetësimin e plotë të aftësive prodhuese, për zbatimin rigoroz të teknologjisë dhe për rritjen e gatishmërisë teknike në Uzinën 12 dhe në atë të Çelikut, nga të cilat varet shumë edhe arritja e objektivave për vitet e tjera të pesëvjeçarit. Më shumë duhet të drejtohen sytë nga minerali ynë i hekur-nikelit, duke ulur normativat e tij dhe të të gjitha lëndëve djegëse, që sot i kemi ende mjaft të larta dhe na rëndojnë ekonominë. Edhe problemet e organizimit të prodhimit, të disiplinës e të kursimit kërkohet të tërheqin më shumë vëmendjen e Ministrisë së Industrisë e të Minierave, të Komitetit të Partisë të Rrethit të Elbasanit dhe të organizatave-bazë e të drejtorisë në kombinat.

Në bazë të orientimeve të Kongresit të 8-të të Partisë, plani i vitit 1983 shtrihet detyra të rëndësishme edhe para punonjësve të industrisë së lehtë e ushqimore. Kjo industri, me mundësitë që janë krijuar, duhet të shpejtojë masat për përmirësimin e strukturës së mallrave të konsumit e të cilësisë së tyre, nga ato më të rëndësishmet deri te produktet më të imta, por të domosdoshme për popullin. Gjithashtu në kushtet e prodhimit të madh bujqësor, del e nevojshme që mbi bazën e investimeve të planifikuara të fuqizohen industria ushqimore, sektori i grumbullimit, bazat e ruajtjes së produkteve, me synim që të zgjidhen më



mirë vështirësitë që lindin në mjaft raste për thithjen e prodhimit bujqësor, për ruajtjen dhe përpunimin e tij. Kjo do të shpjerë edhe në vlerësimin më të mirë të prodhimit bujqësor, në rritjen e të ardhurave të fshatarësisë dhe në plotësimin më të mirë të nevojave të popullit. Për këtë qëllim të përqendrohemi veçanërisht në realizimin e atyre investimeve të planifikuara që rritin aftësitë përpunuese të produkteve bujqësore e blegtorale qysh në sezonin e këtij viti. Gjithashtu, të luftohet pritmëria nga ndërmarrjet industriale. Drejtuesit e tyre duhet të lidhen e të bashkëpunojnë ngushtë me ekonomitë bujqësore, në mënyrë që të mos shkojë dëm asnjë sasi produkti, qoftë edhe e vogël.

Një problem serioz mbetet për industrinë ushqimore, por edhe për bujqësinë, rritja e rrezes së nxjerrjes së sheqerit, të vajit e të nënprodukteve të tjera të dobishme nga lëndët e para bujqësore, ku sot vihet re një prirje në rënie. Çfarë bëjnë Instituti i Studimeve dhe i Projekttimeve të Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore, Instituti i Kërkimeve të Bujqësisë dhe ata qindra specialistë që punojnë në këto degë? Prandaj të këmbëngulet për studime dhe eksperimentime në fushën e farërave e të teknologjisë industriale, për përgjithësimin e nismave e të përvojave të përparuara.

2. — **Projektplani i vitit 1983 në bujqësi** pasqyron orientimet e Kongresit të 8-të të Partisë dhe porosinë e rëndësishme të shokut Enver Hoxha të dhëna në Drilon<sup>1</sup>. Gjatë këtij viti përvoja e Plasës do të zbatohet në zonën e intensifikuar të rretheve Durrës, Lushnjë, Tiranë dhe në zonën fushore të rretheve Korçë e Pogradec. Do të bëhet një përqendrim forcash e mjetesh në rreth 1/4 e të gjithë zonës fushore bregdetare që intensifikohet me përparësi. Do të kthehen me drejtim blegtoral 29 kooperativa kodrinore e malore. Do të ngrihen disa qendra për rritjen e përqendruar të gjedhit e të remontit, dhe do të merren masa për intensifikimin e foragjereve në të gjithë vendin. Gjithashtu do të shpejtohen investimet për përvetësimin e tokave të kripura. Aftësia ujitëse do të shtohet me rreth 12 mijë hektarë, nga afro 7 mijë hektarë që parashikojnë kuotat e pesëvjeçarit. Nga këto përmirësime strukturore në planin e vitit 1983 është parashikuar të ulet sipërfaqja e drithërave të bukës dhe e disa bimëve të tjera për rreth 16 mijë hektarë për të shtuar kryesisht foragjeret e nevojshme për fuqizimin e blegtorisë. Kjo do të sjellë qysh këtë vit një shtesë modeste në prodhimin e qumështit, të mishit e të vezëve, ndërsa në vitet e ardhshme do të japë efektin e plotë të saj.

Këto masa dhe të gjithë faktorët e tjerë që janë krijuar

1. Shih: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1982-1983», f. 166.

në bujqësi, kërkohet t'i përdorim me dobi sa më të madhe, sepse në vitin 1983 duhet të realizojmë medoemos një hop në rritjen e rendimenteve të prodhimeve bujqësore e blegtorale. Prodhimi i përgjithshëm bujqësor parashikohet të rritet me afro 1/5 e prodhimit të realizuar në vitin 1982. Duhet të prodhohen më shumë 88 mijë tonë drithëra buke, 42 mijë tonë patate, mbi 15 mijë tonë luledielli, afro 12 mijë tonë fasule dhe 57 mijë tonë qumësht. Në zonën që intensifikohet me përparësi parashikohet të merren rendimente akoma më të larta. Realizimi i këtyre parashikimeve kërkon që t'u kushtohet vëmendje të gjitha kulturave, me përparësi drithërave të bukës dhe të luftohen nënvleftësimet që u vunë re vitin e kaluar për fasulen, për pataten, për bimët industriale dhe ullirin.

Në projektin e vitit 1983 blegtorisë i jepet një mbështetje e fuqishme dhe vihen më mirë në rrugën e zgjidhjes mjaft probleme. Ndërmarrjeve e kooperativave bujqësore u del detyrë që të marrin masat për të siguruar numrin e krerëve dhe rendimentet sipas parashikimeve të bëra, të cilat janë më të larta nga ato të pesëvjeçarit. Gjithashtu duhet të punohet me kujdes për qendrat e remontit dhe në të gjitha ekonomitë bujqësore të vihet një kontroll i plotë për therjet e bagëtive. Kooperativat bujqësore pas vitit 1983 të jenë në gjendje të bëjnë ripërtëritjen e plotë të tufave dhe të sigurojnë edhe rritjen e kopesë theme-lore të parashikuar në planin pesëvjeçar.

Detyrë e mprehtë për vitin 1983 mbetet rritja e rendimentit për kokë për qumështin e sidomos për mishin, ku nuk ka pasur rritje. Për këtë të rriten peshat në therje për gjedhët rreth 50 për qind, për qengjat mbi 20 për qind, për kecat rreth 30 për qind dhe të luftohet që këta objektiva të arrihen në të gjitha tufat e kafshëve, në fushë dhe në malësi. Gjithashtu rendimenti i foragjereve në tokat e ujtitshme të arrijë jo më pak se 80-100 kv njësi ushqimore për hektar, të përmirësohet struktura e tyre dhe të futim gjerësisht teknologjinë bashkëkohore në të ushqyerit e kafshëve. Për një mbështetje më të mirë shkencore të ushqimit të blegtorisë, Byroja Politike vendosi që stacioni i foragjereve të ngrihet në shkallë instituti.

Në pemëtari puna të përqendrohet në plotësimin e boshllëqeve në blloqet ekzistuese, në krijimin dhe në vazhdimin e disa masiveve të reja, në intensifikimin e shërbimeve në tërësi dhe mbi baza shkencore, për të shpejtuar futjen në prodhim të masiveve të reja, si dhe për rritjen e prodhimit të drufrutorëve etj. Në të njëjtën kohë të shtohet kujdesi për pyjet, ku prerjet janë ende të larta dhe ka shpërdorim të lëndës drusore.

Duke i paraqitur Plenumit këto detyra të ngjeshura për bujqësinë, Byroja Politike thekson se edhe mundësitë për arritjen e tyre ekzistojnë. Marrja në rreth 60 mijë hektarë të zonës

fushore të vendit e një rendimenti mesatar prej mbi 40 kv për hektar grurë dhe në 30 mijë ha të zonës kodrinore 28 kv për hektar flet për masivizimin e përvojës së përparuar, duke kapërcyer tanimë kufijtë e ekonomive të veçanta. Arritjet e përparuara të vitit 1982 të shërbejnë si një shembull i madh e një përvojë shkencore masive për të revolucionarizuar kudo mendjet e njerëzve dhe prodhimin.

Plotësimi i detyrave për bujqësinë duhet të mbështetet, në radhë të parë, në punën e atyre qindra mijë njerëzve që kemi në ekonomitë bujqësore e që në vitin 1983 do të shtohen edhe me 36 mijë të tjerë. Gjithashtu ai mbështetet në bazën materialo-teknike ekzistuese dhe në investimet e reja, të cilat janë afro 160 milionë lekë më shumë nga sa parashikohej në pesëvjeçar. Këto shtesa bëhen kryesisht për të rritur sipërfaqen nën ujë dhe mobilimin e mëtejshëm të tokës.

**Rruga kryesore për arritjen e këtyre objektivave është ajo e intensifikimit të bujqësisë,** prandaj kjo të kuptohet si një detyrë jo vetëm e organeve të Partisë e të pushtetit për rrethet e zonës që intensifikohet me përparësi, por për të gjithë vendin. Në këtë kuadër të luftohet për zbatimin pa hezitim të përvojës së çmuar të Plasës, duke e kthyer atë në një lëvizje të madhe në të gjithë vendin.

Vëmendje më e madhe duhet përqendruar në rritjen e pjellorisë së tokës që përbën themelin e punës për plotësimin e detyrave në bujqësi. Gjithashtu të përgatitemi seriozisht për ujitjen e bimëve për të përballuar çdo situatë që mund të krijohet edhe këtë vit, për të garantuar plotësimin e detyrave të planit dhe për ta bërë bujqësinë më të pavarur nga kushtet e motit. Çdo ekonomi të marrë masa për shfrytëzimin e të gjitha rezervave të mundshme ujore duke ndërtuar ujëmbajtës të vegjël, sidomos në zonat kodrinore-malore. Gjithashtu nga Ministria e Bujqësisë të merren masa për vënien në shfrytëzim të disa veprave të reja ujitëse qysh në gjashtëmuorin e parë të vitit 1983. Kjo kërkon që organizatat e Partisë në rrethe ta drejtojnë këtë aksion dhe Ministria e Tregtisë së Jashtme, ajo e Ndërtimit si dhe Ministria e Industrisë e Minierave të marrin masa për të realizuar, edhe ato, detyrat që kanë sipas planit për sigurimin e bazës materiale dhe të investimeve të nevojshme në afate të shpejtuara.

Rritja e rendimenteve në kushtet kur sasia e plehrave kimike qëndron pothuajse në nivelin e vitit 1982, kërkon organizimin e aksioneve masive për shtimin e plehrave organike. Për këtë të punohet për përhapjen e përvojës së kooperativave të Cakranit<sup>1</sup>, të Bushatit<sup>2</sup>, të Kryeziut në rrethin e Pukës, të

1. Në rrethin e Fierit.

2. Në rrethin e Shkodrës.

Ishmit në rrethin e Durrësit etj., që në sajë të shtimit e përdorimit të plehrave organike kanë krijuar qëndrueshmëri në rritjen e prodhimeve bujqësore. Ministria e Bujqësisë dhe ajo e Ekonomisë Komunale, të marrin masa për ngritjen e qendrave industriale të përpunimit të plehrave e të hedhurinave të qyteteve.

Realizimi i rendimenteve është i lidhur ngushtë edhe me zgjerimin e përdorimit të farërave e të racave me aftësi të larta prodhuese, kur institutet kërkimore-shkencore të mbajnë peshën që u takon dhe të kontrollohet puna e tyre. Laboratori i punës së tyre të jenë fushat tona, ashtu siç veprohet për misrin e orizin nga Instituti i Misrit dhe i Orizit i Shkodrës dhe për grurin nga Instituti i Kërkimeve Bujqësore i Lushnjës. Por edhe ekonomitë bujqësore duhet t'u hapin rrugë arritjeve të shkencës, sepse ka jo pak raste konservatorizmi e pune të dobët për zbatimin e teknologjive të reja.

Si për këtë vit ashtu dhe për vitet e tjera të pesëvjeçarit, problem i rëndësishëm mbetet konsolidimi dhe vazhdimi i tufëzimit. Fakt është se me përfundimin e tufëzimit të të imëtave në shkallë vendi dhe të lopës në 13 rrethet fushore, u ndjenë qysh në vitin e kaluar epërsitë e tufëzimit dhe rrjedhimet pozitive ekonomiko-shoqërore të kësaj mase që mori Partia. Por në të njëjtën kohë, në disa raste konkrete kur nuk u morën masa të plota për të fuqizuar bazën ushqimore apo numrin e krerëve të lopëve dhe kur nga tufat e oborrit, për dobësitë organizative, u morën rendimente mjaft të ulëta, u vështirësua furnizimi i fshatarësisë me qumësht apo mish. Këndej duhet të nxjerrim dhe konkluzionin se në këto ekonomi nuk është kuptuar drejt direktiva e Partisë, që me tufëzimin e bagëtisë duhet të rriten rendimentet e qumështit dhe të përmirësohet furnizimi i fshatarësisë me prodhime blegtorale.

Prandaj në vazhdimin e tufëzimit të lopëve në zonat kodrinore-malore të mbahet mirë parasysh zgjidhja e problemit të furnizimit të kooperativistëve me qumësht e mish, sipas planeve që vihen.

Komitetet dhe organizatat e Partisë, komitetet ekzekutive dhe kryesitë e këtyre kooperativave, që vazhdojnë tufëzimin, të përcaktojnë qysh tani masa të plota dhe grafikë konkretë e të shkallëzuar për tufëzimin e lopëve, duke mbajtur parasysh që për realizimin e planit të furnizimit të kooperativistëve me bulmet e mish si dhe të dorëzimit në ndërmarrjet e grumbullimit, të llogariten së bashku tufat e oborrit dhe ato të vetë kooperativës.

Kujdes i posaçëm të tregohet për skartimet, si të lopëve, ashtu dhe të të imëtave, për të rritur si numrin e krerëve, sipas



planit, ashtu dhe për të arritur përmirësimet e nevojshme gjetike.

3. — **Vëllimi i investimeve dhe i ndërtimeve** të këtij viti parashikohet të jetë përkatësisht 360 dhe 181 milionë lekë më shumë se plotësimi i vitit 1982.

Byroja Politike thekson se në këtë fushë duhet të bëhet kujdes i jashtëzakonshëm. Kjo diktohet nga vështirësitë që janë krijuar për burimet valutore e financiare, nga prapambetjet në ndërtimin e veprave të reja, nga kostoja ende e lartë e ndërtimeve, si dhe nga dobësitë organizative në ndërtim e në sektorët që lidhen me të.

Për të garantuar më mirë plotësimin e detyrave për tani dhe për vitet e tjera të pesëvjeçarit, Byroja Politike ka orientuar që të merren një varg masash, sidomos për radhën e ndërtimit të objekteve:

— Në të gjitha degët e ekonomisë përparësi t'i jepet përfundimit dhe vënies në shfrytëzim në një kohë më të shpejtë të veprave që vijnë nga viti 1982, sidomos për minierat dhe fabrikat e pasurimit, për rikonstrukcionet dhe zgjerimet e uzinave kimike, të kombinateve të tekstilit dhe të disa veprave të industrisë ushqimore.

— Të ndiqen me përparësi gjithashtu ndërtimi i hidrocentralit të Komanit, i Gjançit, linja e tensionit të lartë për eksportin e energjisë elektrike, uzina e vajrave lubrifikante, ajo e pastrimit të gazit të naftës, zgjerimi e fuqizimi i disa uzinave mekanike, ndërtimi i disa rrugëve e degëzimeve hekurudhore që janë avancuar nga parashikimet e pesëvjeçarit.

— Të përfshihen në plan disa vepra që nuk ishin parashikuar në pesëvjeçar, por që janë të domosdoshme për kursimin e lëndëve djegëse dhe përdorimin më gjerësisht të qymyrgurit.

— Vëmendje e veçantë t'u kushtohet investimeve në bujqësi, duke u dhënë përparësi disa rretheve kodrinore-malore që kanë më pak sipërfaqe nën ujë, si dhe për shpejtimin e ndërtimit të disa komplekseve blegtorale dhe për përpunimin industrial të ushqimeve. Për të mbështetur më mirë prodhimin, investimet e kooperativave bujqësore parashikohet të rriten 135 milionë lekë mbi kuotën e pesëvjeçarit.

Plotësimi i këtyre orientimeve dhe detyrave kërkon një punë shumë më të organizuar nga Këshilli i Ministrave, nga ministritë dhe institucionet e tjera shkencore, nga komitetet ekzekutive të rretheve dhe nga të gjitha ndërmarrjet që lidhen me investimet e ndërtimit.

Rritja e vëllimit të ndërtim-montimeve në vitin 1983 mbështetet, në radhë të parë, në shfrytëzimin më të mirë të mekanizmave ekzistues të ndërtimit e të bonifikimit. Krahas me këtë do të bëhet edhe fuqizimi i mëtejshëm i kësaj baze. Për përdori-

min më të plotë të mekanizmave të ndërtimit, kërkohet të organizohet më mirë lëvizja e tyre nga një objekt në tjetrin, kur krijohen mundësi për avancimin e punimeve në sektorë të tjerë.

Ministria e Ndërtimit duhet të marrë masa më të forta për përfundimin në kohë të objekteve, duke përqendruar forcat e mjetet dhe duke përdorur më gjerësisht metodën e aksionit. Viti 1983 të shënojë kthesë në këtë drejtim. Kthesë duhet të realizohet gjithashtu në uljen e kostos së materialeve të ndërtimit, sidomos brenda rretheve, sepse shpenzimet e transportit janë ende të larta, si dhe për përmirësimin e cilësisë së tyre. Të bëjmë një punë më të organizuar për përgatitjen dhe kualifikimin e specialistëve të ndërtimit nga çdo rreth.

4. — Për të përballuar nevojat e ekonomisë, **transporti i mallrave** parashikohet të rritet në tonë afro 8,2 për qind dhe në ton/km 6 për qind. Në bazë të detyrave që shtroi Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të Partisë bëhen përmirësime të mëtejshme në strukturën e transportit, duke i dhënë përparësi transportit hekurudhor, i cili parashikohet të rritet në tonë/km 13 për qind, duke përballuar kështu 46 për qind të vëllimit të transportit të mallrave të Ministrisë së Komunikacionit.

Për të shfrytëzuar aftësitë transportuese të hekurudhës, krahas masave për zgjerimin e mekanizmit të depove, duhet të luftohen edhe disa teprime në kërkesat e prodhuesve e të hekurudhës për ambalazhe të kushtueshme, me qëllim që t'i presim rrugën harxhimit pa vend të dhjetëra mijëra metra kub lëndë druri. Ministria e Komunikacionit dhe ministritë e tjera, të marrin masa efikase për të kufizuar më tej transportin e mallrave me automjete paralel me hekurudhën e në kryqëzimet, si dhe për të zgjeruar përdorimin e rimorkiove, sidomos të atyre vetëshkarkuese e të tonazhit të madh.

Për vënien në jetë të detyrave që shtroi Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror, kudo në rrethe u zhvilluan aktive të Partisë, ku u shtruan një varg problemesh dhe u përcaktuan masa konkrete për përmirësimin e punëve në të gjitha llojet e transportit. Detyra është që këto vendime të vihen në jetë. Kujdes të tregohet sidomos për përmirësimin e zgjerimin e rrjetit rrugor, për transportin e brendshëm në ndërmarrje e kooperativa, për ndërtimin e teleferikëve e në drejtime të tjera.

5. — Për realizimin me sukses të detyrave të planit të këtij viti, rëndësi të veçantë ka zbatimi i plotë e i përditshëm i detyrave që ka shtruar Partia për **uljen e importit dhe rritjen e eksportit**.

Organet e tregtisë së jashtme dhe organizatat e Partisë që i udhëheqin ato duhet të bëjnë një punë më këmbëngulëse dhe të zgjuar, të djersitin si gjithë punonjësit e prodhimin, për të siguruar eksportimin e të gjitha mallrave që caktojmë për eksport.



Ato të njohin më mirë se deri tani koniunkturat e tregjeve të jashtme dhe të sigurojnë, si për eksportin, ashtu dhe për importin efektivitet të lartë dhe korrektësi të plotë.

Kujdes t'i kushtohet dhe importimit në kohë, në sasi e në cilësi të mallrave të importit, duke siguruar në radhë të parë lëndët e para e materialet që kushtëzojnë vazhdimin e prodhimit, si dhe makineritë e pajisjet për objektet e reja dhe për zgjerimet që planifikojmë.

Detyra po kaq të rëndësishme kanë dhe gjithë prodhuesit e mallrave për eksport, për t'i realizuar ato sipas kërkesave të tregjeve të jashtme, në kohën, në sasinë, në cilësinë dhe me ambalazhimin e duhur.

Vetëm kështu do të vihen plotësisht në jetë porosia e Partisë dhe mësimi i shokut Enver se pa eksport nuk ka import dhe se para se të blejmë duhet më parë të shesim.

6. — Byroja Politike analizoi me kujdes edhe zgjidhjen e problemeve të zënies me punë të forcave aktive dhe të rritjes së rendimentit të punës... Kujdes më të madh për zënien me punë duhet të tregojnë organet dhe organizatat e Partisë në qytetet Tiranë, Durrës, Berat, Krujë, Shkodër dhe Vlorë, ku kërkohet të kryhen studime të mëtejshme për çeljen e fronteve të reja, duke përdorur më mirë mundësitë lokale. Organet e Partisë e të shtetit të nxjerrin mësim e përgjithësime nga përvoja e vitit të kaluar, sidomos në rrethin e Tiranës dhe në atë të Durrësit, ku pati arritje më të mira. Gjithashtu Këshilli i Ministrave të shpejtojë e të zgjerojë studimet për masat që do të nxitin vajtjen e forcave aktive, sidomos të rinjve në sektorët më të vështirë, në qendrat e punës larg qyteteve, në bujqësi e në zonat e Veriut. Edhe organizatat e rinisë t'i kushtojnë vëmendje të posaçme edukimit të rinjve e të rejave që mbeten të pazënë në punë, në kërkim të punëve të preferuara, për t'iu përgjigjur kërkesave aty ku ka nevojë atdheu.

Zhvillimi i vrullshëm i forcave prodhuese në të gjithë vendin dhe aktivizimi sa më i plotë i pasurive natyrore e bëjnë të domosdoshme një manovrueshmëri më të madhe të forcave aktive dhe forcimin e koncepteve të drejta për punën, arsimimin, kualifikimin në çdo lloj pune e në të gjitha zonat e vendit. Ky është një drejtim i rëndësishëm pune për organet dhe organizatat e Partisë, për organet e shtetit e të ekonomisë dhe organizatat shoqërore, sepse është një terren ku kemi të bëjmë me njerëzit, me interesat e tyre jetikë, por edhe me perspektivat e zhvillimit të vendit në rrugën e socializmit. Në këtë fushë kërkohet të mbahen më mirë parasysh edhe detyrat për rritjen e rendimentit të punës, për zgjerimin e mekanizimit e në drejtime të tjera, sepse ka raste që problemi i zënies me punë

të forcave të reja aktive shikohet i njëanshëm, jashtë këtyre kërkesave të domosdoshme.

7. — Me mundësitë që krijon zhvillimi i ekonomisë, gjatë këtij viti mirëgenia materiale e popullit do të garantohet e do të ngrihet më tej si dhe do të çohet përpara zhvillimi i arsimit, i kulturës dhe i shëndetësisë. Të ardhurat reale për frymë të popullit parashikohet të rriten mesatarisht 5,3 për qind, nga të cilat 2,8 për qind në qytet dhe 7,8 për qind në fshat. Kjo rritje e të ardhurave reale është gati dy herë më e lartë se rritja e rendimentit shoqëror të punës. Veç kësaj në vitin 1982, siç ka ndodhur edhe vitet e fundit, ndërsa në qytet plotësohen e tejkalohen të ardhurat reale për frymë të popullsisë, në fshat ato kanë njëfarë rritje, por jo sipas planit dhe detyrave që caktoi Kongresi. Prandaj këtu të përqendrohet më shumë vëmendja dhe kujdesi i organeve dhe organizatave të Partisë.

Qarkullimi i mallrave me pakicë parashikohet të rritet 7 për qind. Ndërkohë fondet e mallrave parashikohet të rriten 10 për qind. Kështu do të përmirësohet furnizimi i tregut me mallra, do të fuqizohen rezervat e mallrave në tregti dhe do të rritet konsumi për frymë i artikujve industrialë e ushqimorë, sidomos në fshat.

Këto detyra parashikohet të realizohen duke shtuar vetëm 1,2 për qind monedhën në qarkullim. Prandaj në treg të hidhen mallra me strukturën që kërkohet e me cilësi, sepse këtu kemi të bëjmë me nevojat e njerëzve dhe me një fushë të ndjeshme të politikës së Partisë.

Gjatë vitit të ardhshëm, do të zgjidhen më mirë nevojat e popullit për strehim. Me numrin e apartamenteve të parashikuara për t'u ndërtuar, arrihet objektivi i pesëvjeçarit për vitet 1981-1983 të marrë së bashku. Shërbimet komunale do të rriten 7,7 për qind. Për përmirësimin e mëtejshëm të tyre, sidomos në fshat, organeve komunale u janë caktuar detyra të zgjerojnë llojshmërinë, të rritin cilësinë dhe të shkurtojnë afatet e kryerjes së tyre.

Për arsimin janë konkretizuar detyrat e vendimit të Byrosë Politike për ngritjen e nivelit dhe të cilësisë së përgatitjes së nxënësve e të studentëve, numri i të cilëve do të arrijë në 719 mijë vetë, ose 3,4 për qind më shumë. Me nevojat që kanë dalë për specialistë, pranimet e reja në shkollat e larta janë parashikuar 14,6 për qind më shumë nga sa parashikohen në pesëvjeçar. Gjithashtu do të përgatiten 6 050 vetë si punëtorë të rinj në shkollat e ulëta profesionale ose mbi 1 100 më shumë nga sa është parashikuar në planin pesëvjeçar.

Në sektorin e kulturës, të arteve e të fizkulturës aktivitetet janë parashikuar me rritje, duke synuar zgjerimin e mëtejshëm të veprimtarisë dhe ngritjen cilësore të saj, me qëllim që të

ndikohet më aktivisht në edukimin klasor revolucionar të masave punonjëse. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, komitetet ekzekutive të rretheve dhe organet e specializuara në këto fusha të shfrytëzojnë më mirë kushtet e krijuara deri në fshatrat më të thella dhe të punojnë më mirë për gjallërimin sidomos të jetës së rinisë, për ta frymëzuar e përgatitur më mirë atë për punën, për jetën e mbrojtjen.

Treguesit e shërbimit shëndetësor në përgjithësi ruhen sipas pesëvjeçarit dhe, në disa raste, përmirësohen më tej, si për numrin e shtretërve, ashtu edhe për fuqizimin e bazës materialo-teknike. Për të përmirësuar shërbimin shëndetësor do të kryhen 32 milionë lekë investime, ku përfshihen vënia në shfrytëzim e Uzinës së Antibiotikëve, Qendra e Dhënies së Gjakut, disa spitale, shtëpi lindje, çerdhe për fëmijë etj. Përmirësimi i cilësisë në shërbimin shëndetësor, profilaktik e kurativ, të jetë një nga detyrat kryesore për të gjitha organizatat-bazë, komunistët e punonjësit e tjerë në Ministrinë e Shëndetësisë dhe në institucionet e qendrat e shëndetësisë.

8. — Në hartimin e projektplanit të vitit 1983, Byroja Politike kujdes të veçantë i kushtoi orientimit të Kongresit të 8-të të Partisë që zhvillimi i forcave prodhuese të shoqërohet me përsosjen e marrëdhënieve në prodhim. Prandaj në projektplan janë pasqyruar problemet që lidhen me zonën e intensifikuar me përparsi, dyfishimi i investimeve shtetërore për zonën kodrinore-malore, kthimi i 2-3 kooperativave të tipit të lartë në ndërmarrje bujqësore, ngritja e disa kooperativave të reja të tipit të lartë, zbatimi i një varg masash për përsosjen e organizimit të drejtimit të ekonomisë e të rolit të organeve të planifikimit të financës.

Gjithashtu janë dhënë porosi që organet përkatëse shtetërore dhe ekonomike të kryejnë disa studime për levat ekonomike, për furnizimin materialo-teknik, për metodologjinë dhe metodikat e planifikimit, për strukturat drejtuese të ndërmarrjeve etj. Për këto çështje, si dhe për tërë problemet e zhvillimit të ekonomisë kërkohet të mbahen mirë parasysh porositë e mësimet e çmuara që jepen në librin e shokut Enver Hoxha «Për planin e shtatë pesëvjeçar».

### III. Disa drejtime të tjera të punës së Partisë e të levave të saj për plotësimin e detyrave të planit

Detyrat e planit që po shqyrtojmë, si dhe problemet e mprehta që kanë dalë diktojnë nevojën që organizatat e Partisë e levat e tyre të mbajnë ndezur hovin revolucionar të masave të gjera punonjëse dhe të rritin më tej rezultatet e veprimtarisë së tyre

krijuese në prodhim, në mbrojtje e kudo gjetkë. Prandaj e tërë puna të përqendrohet më mirë sidomos në këto drejtime kryesore:

1. — Të forcojmë e të përsosim më tej organizimin dhe drejtimin e ekonomisë në të gjitha hallkat e saj.

«Drejtimi dhe organizimi, — theksoi shoku Enver Hoxha në Kongresin e 8-të të Partisë, — janë një hallkë nga më të rëndësishmet pas së cilës duhet të kapemi fort për t'i çuar përpara punët kudo, në ekonomi, në arsim, në shkencë, në kulturë, në të gjitha fushat e veprimtarisë shoqërore»<sup>1</sup>.

Ky drejtim kërkohet të përmirësohet, në radhë të parë, nga Partia, sepse ajo është në krye të punëve dhe përgjigjet për ecurinë e drejtë të të gjithë sektorëve të jetës. Këtu të gjithë duhet të reflektojmë më thellë për kuptimin dhe për vënien në jetë të problemeve që ngre shoku Enver Hoxha në Kongresin e 8-të të Partisë për rolin udhëheqës e drejtues të saj.

Plotësimi i detyrave të planit që kemi përpara kërkon që organet dhe organizatat e Partisë të mbajnë mirë në dorë problemet kryesore të ekonomisë dhe të mobilizojnë të gjithë komunistët në rolin e tyre pararojë, por edhe të dëgjojnë me kujdes e të vlerësojnë mendimet e përparuara të kuadrove, të specialistëve e të gjithë punonjësve dhe të nxitin veprimtarinë e tyre. Për detyrat e planit organet dhe organizatat e Partisë të vënë më mirë në lëvizje levat e tyre, organet shtetërore, ato ekonomike dhe organizatat e masave. Kështu do të zbatojmë më mirë në praktikë orientimin e Kongresit të 8-të se puna e Partisë nuk është vetëm ajo që kryejnë drejtpërdrejt organet dhe organizatat-bazë, por edhe ajo e organeve shtetërore dhe ekonomike, e organizatave të masave, e të gjithë punonjësve, sepse të gjithë udhëhiqen dhe duhet të udhëhiqen nga ideologjia e nga vija e Partisë, zbatojnë vijën e politikën e Partisë dhe ligjet e shtetit në sektorët e tyre.

Nga organet dhe organizatat e Partisë kërkohet të futin një frymë më luftarake e revolucionare në të gjitha organet drejtuese nga qendra deri në bazë dhe të zërë vend gjerësisht metoda e aksionit me një organizim të përsosur të tyre. Metoda e aksionit është një përvojë e madhe e Partisë dhe e shtetit tonë që buron nga epërsitë e rendit socialist, gjë që u vërtetua edhe një herë me zhdukjen brenda 40 ditëve të pasojave jo të vogla të tërmetit, me rezultatet që u arritën në Durrës për ndërtimin

1. Shih në këtë vëllim, f. 145.

me kontribut vullnetar të afro 1000 apartamenteve, aq sa ishin ndërtuar gjatë 3 vjetëve të mëparshëm të marrë së bashku, si dhe një varg aksionesh e nismash të tjera revolucionare në bujqësi, në ndërtim e gjetkë.

**Fryma luftarake e revolucionare karakterizohet nga disiplina e fortë dhe ndjenja e lartë e përgjegjësisë.** Kjo kërkon një punë të gjallë dhe konkrete me njerëzit dhe për njerëzit. Nuk është e mjaftueshme që punonjësve vetëm t'u flasim dhe t'u kërkojmë të punojnë me disiplinë, por edhe t'u plotësojmë kushtet për zbatimin e kësaj disipline. Gjithashtu disiplina e fortë presupozon që secili t'u dalë zot detyrave dhe të mbajë përgjegjësi deri në fund për to. Ndjenja e përgjegjësisë forcohet kur rritet kërkesa e llogarisë, kur ushtrohet kontroll ndaj cilitdo për zbatimin e detyrave.

**Objektiv kryesor i përmirësimit të punës së Partisë në fushën e ekonomisë ka qenë dhe mbetet sigurimi i plotësisht frontalisht të detyrave të planit.** Qysh tani në fillim të vitit e vazhdimisht të këmbëngulim dhe të luftojmë për këtë. Sivjet, përgjithësisht, u bë një punë më e organizuar dhe e bashkërenduar për hartimin dhe zërthimin e planit nga ministritë e deri në njësitë më të vogla në bazë. Prandaj nuk ka vend për justifikime. Detyrë e të gjithëve mbetet që të gjejnë rrugët më të përshtatshme e të mobilizojnë rezervat e brendshme, që ekzistojnë kudo, për të arritur plotësimin dhe tejkalimin e detyrave të planit me mjetet dhe me burimet që janë vënë në dispozicion, bile edhe duke i kursyer ato.

Objektivat e mëdhenj që kemi përpara për zhvillimin e ekonomisë, të kulturës dhe për forcimin e mbrojtjes kërkojnë që Partia të luftojë më shumë për një drejtim me baza shkencore, duke u mbështetur fort në ligjet e zhvillimit ekonomik e shoqëror, në studime e analiza të thella.

«Sot, — theksoi shoku Enver Hoxha në Kongresin e 8-të të Partisë, — nuk mund të punohet me empirizëm e praktikizëm të ngushtë. Drejtimi dhe organizimi duhet të mbështeten në njohuri e dije të thella, në parime dhe kritere të shëndosha shkencore, që burojnë nga ligjet e zhvillimit ekonomik e shoqëror»<sup>1</sup>.

Potenciali i madh njerëzor, material, shkencor që ka çdo degë e ekonomisë, çdo ndërmarrje e kooperativë, nuk mund të japë efektivitetin e kërkuar pa studime të thelluara dhe të lidhura ngushtë

1. Shih në këtë vëllim, f. 145.

me jetën. Thellimi i punës studimore bëhet akoma më i ngutshëm në këtë vit që ministritë, organizmat shkencorë dhe organet drejtuese në rrethe do të angazhohen në një varg studimesh konkrete për hartimin e pesëvjeçarit të ardhshëm, si dhe për ripunimin e metodologjisë dhe përpilimin e metodikave të planifikimit ekonomik e financiar.

Partia të kërkojë gjithashtu që organet shtetërore të njohin e të zbatojnë me rigorozitet ligjet shtetërore dhe rregullat në fuqi, sepse në praktikë vihen re qëndrime liberale dhe bëhen shkelje të tyre. Ka jo pak raste të shkeljes së kërkesave të metodologjisë së planifikimit, të rregullave të administrimit e të qarkullimit të mallrave, të kooperimit e të rregullave të caktuara për mbrojtjen në punë të punëtorëve. E keqja është se në mjaft raste këto lejohen që nga drejtuesit kryesorë në bazë, në rrethe e në qendër, gjoja për të zgjidhur në mënyrë operative problemet, por disa herë ato bëhen për të mbuluar interesat e ngushtë vetjakë e të grupit, hatëret e akraballëqet.

**2. — Të zbatojmë kudo një regjim të rreptë kursimi në përdorimin e kohës së punës dhe të vlerave materiale e financiare.** Sikurse na mëson shoku Enver Hoxha, ne duhet të mendojmë, të gjejmë rrugët e të luftojmë për kursime vazhdimisht, të 365 ditët e vitit. Ky është një nga parimet bazë të ekonomisë sonë socialiste, por që bëhet më imperativ veçanërisht për vitet që kanë mbetur të këtij pesëvjeçari. Fusha e kursimit është shumë e gjerë, por tani duhet të përqendrohemi në ato hallka dhe drejtime që janë kyç për realizimin e objektivave të planit të vitit 1983.

**Rritja e rendimentit të punës kërkon kudo një kujdes të veçantë.** Vitin e kaluar e gjithë shtesa e prodhimit industrial u realizua nga rritja e numrit të punëtorëve, në një kohë kur ishte parashikuar që mbi 40 për qind të vinte nga rritja e rendimentit. Edhe për këtë vit, me gjithë detyrat e vëna, rendimentin e planifikojmë nën kuotat e pesëvjeçarit. Mirëpo këtu kemi të bëjmë me një nga objektivat kryesorë që ka vendosur Kongresi i 8-të i Partisë. Prandaj organizatat e Partisë të luftojnë kundër atyre presioneve që bëhen nga baza dhe nga ministritë për t'i ulur më tej detyrat e rendimentit të punës. Ato të vihen në ballë të luftës për përdorimin me kursim të kohës së punës, për rritjen e shkallës së mekanizimit e të automatizimit, ku ende nuk kemi një punë të organizuar mirë dhe ndeshen shfaqje të spontaneitetit e të euforisë, për rishikimin e normave të vjetruara dhe plotësimin e tyre nga të gjithë punëtorët e kooperativistët.

Plani i vitit 1983 është mbështetur në normativa të reja të harxhimit të lëndëve të para, të materialeve, të lëndëve djegëse dhe të energjisë, që në 17 mijë zëra normativat janë më të ulta



nga ato të vitit të kaluar. Kjo t'u bëhet mirë e qartë nga organizatat e Partisë, si drejtuesve, ashtu dhe punonjësve dhe të mbështetësit qysh tani, me fillimin e vitit, me masa të gjithanshme organizative, teknike dhe shkencore dhe me aksione konkrete, përndryshe kontingjentet e materialeve të planifikuara do të harxhohen para kohe, gjë që do të çonte në ndërprerjen e prodhimit. Në radhë të parë të bëhet kujdes për përdorimin me kursim të karburanteve, të energjisë elektrike, të lëndëve të para e të materialeve të importit, si dhe të prodhimeve deficitare të vendit.

Organet, organizatat e Partisë dhe levat e tyre të mbështetësit dhe të nxitin nismat revolucionare që kanë shpërthyer kudo në rrethe për rishikimin e normave të punës e të harxhimit të materialeve, për grumbullimin e hekurishteve dhe shkrirjen e tyre në metalurgji, për grumbullimin dhe rigjenerimin e gomave të automjeteve e të traktorëve, për grumbullimin e tubave të përdorura në naftë, për kthimin e kaldajave për të punuar me qymyrguri, për avancimin e veprave ujitëse në bujqësi që t'i shërbejnë realizimit të planit të këtij viti etj. Me qëllim që këto nisma të mos mbeten fakultative, vetëm si angazhime, është e nevojshme që efektet ekonomike të tyre të përfshihen në plan dhe të mbështesin realizimin e tejkalimin e tij.

**I gjithë kursimi, siç thotë Marksi, në fund të fundit përmblidhet në kursimin e kohës së punës. Kjo kërkon që t'i kushtohet një vëmendje e veçantë uljes së kostos, që sintetizon uljen e shpenzimeve të prodhimit.** Këtu, porosit shoku Enver Hoxha, duhet bërë qilizëm. Kjo do të realizohet kur drejtuesit dhe punëtorët do të njohin më nga afër koston e do të shqetësohen për uljen e saj, kur të luftohen shfaqjet e globalizmit në planifikim e në ndjekje të këtij treguesi nga organet e planit e të financës dhe personeli inxhiniero-teknik. Çështja e uljes së kostos do një angazhim të madh e serioz, sepse për këtë vit pothuaj e tërështesa e burimeve të akumulimit është planifikuar të sigurohet nga ulja e saj.

Të ardhurat e buxhetit për këtë vit do të rriten 3 për qind dhe shpenzimet do të përballojnë tërësisht nevojat e ekonomisë, të kulturës dhe të mbrojtjes. Për zhvillimin e ekonomisë do të përdoren 57,5 për qind të shpenzimeve të buxhetit, ndërsa shpenzimet socialkulturore do të zënë 26,2 për qind të shpenzimeve të buxhetit.

Për këto shpenzime të mëdha duhet bërë kujdes i madh që ato të përdoren me kursim e sipas destinacionit të planifikuar për të pasur frytshmëri sa më të lartë. Për to të forcohet kontrolli me anë të lekut dhe të rritet roli aktiv i organeve të planit, të financës dhe të bankës.

**3. — Organet shtetërore dhe ekonomike të matin punën e**

**tyre edhe me rritjen e efektivitetit të ekonomisë.** Në veprën e vet «Për planin e shtatë pesëvjeçar» shoku Enver Hoxha na tërheq vëmendjen për seriozitetin e këtij problemi, si një ndër detyrat më të mëdha e më të vështira të pesëvjeçarit. Ai na mëson

«...të mos kemi iluzione se efektiviteti ekonomik i shpenzimeve të prodhimit dhe i investimeve themelore do të arrihet pa mbështetur si duhet dhe pa realizuar në praktikë detyrat për prodhimin, rendimentin, koston, forcimin e regjimit të kursimit, zbatimin e përparimit tekniko-shkencor dhe përsosjen e marrëdhënieve ekonomike socialiste»<sup>1</sup>.

Mirëpo ky mësim i shokut Enver nuk pajtohet me ato fenomene që kemi në mjaft raste dhe që e ulin efektivitetin e ekonomisë. Një luftë e vendosur duhet bërë kundër gjendjes relativisht të madhe të prodhimeve që nuk përdoren dhe që janë stoqe. Në miniera, në karrera e në stacione kemi mbi normativat e planifikuara dhjetëra mijë tonë krom e koncentrat, qymyrguri, mermer e minerale të reja. Në depot e degëve të ndryshme të industrisë, të bujqësisë, të tregtisë së jashtme e të brendshme ka sasira jo të pakta materialesh, pjesësh ndërrimi e mallra stoqe apo me përdorim të ngadalshëm. Prandaj ministritë dhe organet shtetërore në bazë të marrin masa urgjente për t'i futur në qarkullimin ekonomik të gjitha këto vlera materiale që na bllokojnë burimet e akumulimit. Gjithashtu, në zbatimin e planit, ministritë prodhuese, ajo e Financave dhe Komisioni i Planit të Shtetit të gjejnë rrugë e të marrin masa që, pa ulur detyrat e planit të vitit 1983, të mos lejojnë prodhimin e mallrave të tjera stoqe.

Nga ana tjetër edhe organet e tregtisë së jashtme ta shohin si detyrë të dorës së parë sigurimin e çmimeve sa më të leverdishme për ekonominë tonë për mallrat që eksportohen dhe importohen. Të mos lejohen të përsëriten më raste të tilla, si ai i domateve që për mijëra tonë nuk u siguruan as shpenzimet e prodhimit apo të transportit.

**Problem tjetër i madh mbetet shfrytëzimi i plotë i aftësive prodhuese në mjaft objekte të rëndësishme, por edhe të vogla si: në Kombinatin Metalurgjik dhe në tërësi në industrinë mekanike, në fabrikat e letrës, në serrat e bujqësisë, në komplekset**

1. Enver Hoxha, «Për planin e shtatë pesëvjeçar», f. 488.

blegtorale, në ndërmarrjet ushqimore etj. Kjo është një rezervë e madhe për të shtuar prodhimin, për të zënë njerëzit me punë dhe për të rritur akumulimin, pa investime suplementare.

«Për këtë, — thekson shoku Enver Hoxha, — nuk ka nevojë për teorira e llafe të shumta, por të shikohen e të zgjidhen konkretisht problemet»<sup>1</sup>.

Bujqësia jonë ka hyrë në shkallë të gjerë në rrugën e intensifikimit dhe kjo ka filluar të japë rezultatet e veta në rritjen e rendimenteve. Por Partia kërkon që në procesin e intensifikimit, rritja e rendimenteve në bujqësi e në blegtori të shoqërohet me rritjen e efektivitetit, pra me uljen e kostos për njësi prodhimi. Intensifikimi në kushtet e vendit tonë ka veçoritë e veta. Ai duhet të sigurojë e të mbështetë politikën e Partisë për të mbajtur kurdoherë të populluar fshatin, për të ngushtuar me ritme më të shpejta dallimet midis fshatit e qytetit, për të fuqizuar pronën e grupit dhe për ta çuar atë drejt pronës së gjithë popullit. Pra, problemi i kostos në bujqësi, si dhe në të gjitha degët e tjera nuk është një problem i thjeshtë e me interes vetëm imediat, por është një çështje e madhe parimore që lidhet me gjithë zhvillimin tonë socialist, në përputhje me vijën marksiste-leniniste të Partisë.

4. — Shkenca dhe teknika të vihen më mirë në shërbim të plotësisht të detyrave të planit dhe të çeljes së perspektivave të reja. Në Kongresin e 8-të të Partisë u theksua se objektivi kryesor i gjithë punës studimore-shkencore është që të mbështetë si duhet pesëvjeçarin e shtatë për të siguruar realizimin e plotë të tij. Krahas kësaj detyre dhe objektiv me rëndësi i shkencës sonë është që qysh tani të fillojë nga kryerja e studimeve për pesëvjeçarin e ardhshëm. Është fakt që pas Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror dhe Kongresit të 8-të të Partisë puna kërkimore-shkencore ka marrë një hov më të madh dhe është in granu më mirë për zgjidhjen e problemeve të zhvillimit ekonomik e shoqëror të vendit.

Megjithëkëtë, organizimi dhe drejtimi i punës kërkimore-shkencore nga drejtoritë e disa instituteve, por edhe nga shkolla e lartë, nga vetë Komiteti i Shkencës e i Teknikës dhe nga Akademia e Shkencave, ka boshllëqe të ndjeshme, sidomos për aktualitetin e problemeve që studiohen, për ritmet e ngadalshme, si edhe për ndjekjen e zbatimit të studimeve, gjë që i largon ato nga lufta për plotësimin e planit. Kjo u duk edhe në punën që u bë për detajimin e planit të këtij viti ku organizmat shkencorë u in granuan pak në këtë punë. Puna kërkimore-shkencore

1. Enver Hoxha, «Për planin e shtatë pesëvjeçar», f. 107.

është pjesë e planit unik, prandaj duhet të bëhet si rregull që bashkë me diskutimin e hartimin e planit të analizohet e të kërkohet llogari edhe për veprimtarinë kërkimore-shkencore.

Dobësi dhe të meta ka për ndjekjen e kontrollin e punës shkencore dhe të rezultateve që arrijnë organizmat studimorë e kërkimorë dhe grupet e ngritura për thellimin e revolucionit tekniko-shkencor. Dikasteret përkatëse të drejtojnë më mirë këto forca dhe të rritin kontrollin e ndjenjën e përgjegjësisë, sidomos tek ata punonjës shkencorë e specialistë që nuk i kanë kryer si duhet detyrat. Po ashtu nga ministrinë t'i bëhet një analizë dhe t'u kërkohet llogari sa më parë të gjitha grupeve që janë dërguar jashtë shtetit për të marrë eksperiencë apo për të zgjidhur probleme konkrete dhe të merren masa ndaj atyre që janë treguar neglizhentë e të paaftë.

Organet dhe organizatat e Partisë të vënë më mirë në vendin e tyre personelin inxhiniero-teknik, t'i largojnë ata nga puna rutinë, sepse ashtu siç punohet sot ende një pjesë e mirë e specialistëve të lartë nuk bëjnë punën që u takon. Këtu do mbajtur mirë parasysh dhe të zbatohet kudo porosia e shokut Enver Hoxha që ashtu siç ka plan punëtori, po ashtu duhet të ketë edhe personeli inxhiniero-teknik për rritjen e shkallës së mekanizimit, për zbatimin e teknologjisë së përparuar dhe për prodhimin e artikujve të rinj, për përmirësimin e organizimit të prodhimit dhe të kushteve të punës, për të çuar përpara normimin teknik dhe efektivitetin e prodhimit.

Shokë,

Sikurse shihet, detyrat e këtij viti janë të mëdha. Realizimi i tyre është plotësisht i mundshëm, por edhe i domosdoshëm. Kjo edhe për faktin se gjatë dy vjetëve të kaluar, veçanërisht nga disa rrethe dhe degë të ekonomisë janë krijuar deficite kundrejt detyrave të pesëvjeçarit, të cilat duhet medoemos të kompensohen gradualisht në këto tre vjet që kanë mbetur. Çdo ndërmarrje e kooperativë, çdo rreth dhe ministri për sektorin e ekonomisë e të kulturës që mbulon duhet të ballafaqohet me direktivat e Kongresit të 8-të të Partisë për planin e shtatë pesëvjeçar...

Plotësimi i detyrave të planit të vitit 1983 është vendimtar për të arritur objektivat edhe për vitet e tjera të pesëvjeçarit. Prandaj, të mobilizojmë të gjithë Partinë, klasën punëtore, fshatarësinë kooperativiste dhe inteligjencien popullore për ta çuar, pa u ndalur, përpara zhvillimin ekonomik e shoqëror të vendit, për të forcuar e çelikosur më tej aftësinë mbrojtëse të atdheut tonë socialist. Me frymën e shëndoshë të optimizmit revolucionar

dhe të aksionit, me dashurinë e thellë për Partinë dhe shokun Enver Hoxha, në çdo qelizë, degë dhe sektor të ekonomisë dhe të kulturës të plotësohen deri në një detyrat e këtij plani dhe të luftohet në të gjitha drejtimet për tejkalimin e tij, për t'i bërë kështu realitet direktivat e Kongresit të 8-të të Partisë.

**Botohet për herë të parë, me ndonjë shkurtim, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin**

**Qendror të Partisë**

PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

## VENDIM

### I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH PËR PËRFUNDIMET E ARRITURA NË PLOTËSIMIN E PLANIT TË VITIT 1982 DHE DETYRAT KRYESORE TË PROJEKTPLANIT TË VITIT 1983

25 janar 1983

Plenumi i 6-të i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i mbledhur në datën 24 dhe 25 janar 1983, pasi dëgjoi e shqyrtoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH, «Për plotësimin e planit të vitit 1982 dhe detyrat kryesore të projektplanit të vitit 1983» mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike dhe zëvendëskryetari i Këshillit të Ministrave të RPSSH, shoku Besnik Bekteshi,

#### Vendosi:

1. — Të miratojë raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Për plotësimin e planit të vitit 1982 dhe detyrat kryesore të projektplanit të vitit 1983».

2. — Të porositen organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organizatat e masave, organet shtetërore dhe të ekonomisë, kuadrot, komunistët dhe punonjësit e mbarë vendit, që të mobilizojnë të gjitha forcat dhe energjitë e tyre krijuese për të zbrëthyer dhe për të realizuar deri në një detyrat e planit të vitit 1983.

Organet dhe organizatat e Partisë duhet të luftojnë akoma më tepër që fryma e shëndoshë e optimizmit revolucionar dhe e aksionit që ka shpërthyer në çdo qelizë, në çdo degë dhe në çdo sektor të ekonomisë të ngrihet më lart, që zhvillimi ekonomik e shoqëror i vendit tonë të ecë përpara pa u ndalur, që objektivat



e vitit 1983, i cili është viti vendimtar për plotësimin e detyrave të krejt pesëvjeçarit të shtatë, të plotësohen me sukses në të gjitha fushat.

## PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

25 janar 1983

Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në mbledhje të datuar më datën 24 dhe 25 janar 1983, pasi dëgjoi dhe diskutoi raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH për plotësimin e planit të vitit 1983 dhe detyrat kryesore të prodhimit të vitit 1983-impajtur nga kandidatët i Byrosë Politike dhe zëvendësuesit të Komitetit të Ministrave të PPSH, miratimi i Dekretit të Komitetit Qendror të PPSH.

Vendos:

I. — Të miratohet raporti i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH për plotësimin e planit të vitit 1983 dhe detyrat kryesore të prodhimit të vitit 1983.

II. — Të përcaktohet organet dhe organizatat-pasë të Partisë, organizatat e masave, organet shtetërore dhe të ekonomisë, kushtet dhe komandantët dhe personelit e mbare vendit, që të mobilizohen të gjitha forcat dhe energjitë e tyre kryesore për të shpërtëyer dhe për të realizuar detyrat e planit të vitit 1983.

Organet dhe organizatat e Partisë duhet të luftojnë akoma më tej për lëvizjen e shëndoshë e optimizimit revolucionar dhe aksionit që ka shpërtëyer në çdo detyrë, në çdo degë dhe në çdo sektor të ekonomisë të ngjitur me lartë zhvillim ekonomik e shpërtëyer i vendit tonë të ecë përpara pa u ndalur, që objektivat

... të plotësohen me sukses në të gjitha fushat. ... të plotësohen me sukses në të gjitha fushat. ... të plotësohen me sukses në të gjitha fushat.

## VENDIM

### I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË ZONAVE KODRINORE-MALORE

25 shkurt 1983

Partia e Punës e Shqipërisë kurdoherë ka zbatuar një politikë të drejtë marksiste-leniniste për transformimin socialist të fshatit. Kujdesi i vazhdueshëm që është treguar edhe për zonat kodrinore-malore ka ndikuar në zhvillimin ekonomik e shoqëror të tyre dhe në rritjen e prodhimit. Megjithëkëtë mjaft nga objektivat e parashikuar nuk janë arritur plotësisht dhe investimet e bëra akoma nuk po japin efektivitetin e kërkuar.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, pasi mori në shqyrtim raportin e paraqitur nga Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Financave «Për gjendjen dhe detyrat për zhvillimin me ritme më të shpejta të zonave kodrinore-malore»,

### Vendosi:

1. — Organet dhe organizatat e Partisë, organet e pushtetit dhe të ekonomisë edhe në të ardhmen t'i kushtojnë kujdes punës ideopolitike për të krijuar bindje se, në radhë të parë, ekonomia do të rritet e do të forcohet dhe të ardhurat do të shtohen me punën e vetë kooperativistëve, duke përdorur për këtë qëllim me efektivitet të lartë edhe ndihmën e shtetit. Në të njëjtën kohë të merren masa për të përsosur më tej organizimin dhe drejtimin në ekonomitë bujqësore.
2. — Në ekonomitë bujqësore të zonave kodrinore-malore kujdes të tregohet, gjithashtu, për zhvillimin më të shpejtë të mjeteve kryesore të prodhimit dhe për shfrytëzimin me rendiment dhe

efektivitet të lartë të tyre. Për këtë qëllim, të merren masa për të plotësuar e për të tejkaluar detyrat për sistemimin dhe përmirësimin e tokave ekzistuese duke përdorur çdo vit rreth 40 milionë lekë investime. Për të rritur qysh këtë vit ritmet e sistemimit të tokës, në dy vitet e fundit të pesëvjeçarit të ngadalësohen përkohësisht ritmet e hapjes së tokave të reja, duke realizuar 25-30 për qind të planit të dy vjetëve.

Të studiohen mundësitë për të shtuar sipërfaqen e ujitshme mbi detyrat e pesëvjeçarit, duke rritur investimet 35-40 për qind, dhe duke fuqizuar njëkohësisht ndërmarrjet e bonifikimit e ato të ujërave.

3. — Ekonomitë bujqësore të këtyre zonave të planifikojnë dhe të zbatojnë masat e nevojshme për përmirësimin e shpejtë të strukturës së prodhimit dhe të të ardhurave, për harmonizimin e degëve kryesore të ekonomisë, me qëllim që të shfrytëzohen në mënyrë më të plotë të gjitha mundësitë dhe rezervat për rritjen e prodhimit. Në përputhje me kushtet konkrete dhe krahas rritjes së prodhimit të bimëve të arave, t'i jepet përparësi blegtorisë, me objektiv që nga ajo të merren jo më pak se 20-25 për qind e të ardhurave, si dhe të përmirësohen rrënjësisht gjendja dhe struktura e blegtorisë në këto zona. Për këtë duke filluar nga viti 1983 të kthehen 29 kooperativa bujqësore me drejtim kryesor blegtoral dhe gradualisht në vitet e ardhshme, të shikohen mundësitë edhe për kooperativa të tjera.

4. — Të mbështetet zhvillimi i blegtorisë si me rritjen e rendimentit të bimëve foragjere e të kullotave natyrore, ashtu dhe me shtimin e sipërfaqeve të zëna me to sipas planeve të aprovuara.

5. — Për përmirësimin e strukturës së prodhimit në këto zona të luftohet që nga pemëtaria të merren jo më pak se 10-12 për qind e të ardhurave. Kjo të arrihet nëpërmjet plotësimit të boshllëqeve në blloqet e pemëtarisë, rikonstruksionit të tyre dhe mbjelljeve të reja. Të përmirësohet cilësia e punës për trajtimin e drufrutoreve me baza shkencore.

6. — Organet shtetërore, të rritin kujdesin dhe ndihmën për këto zona, sidomos për tërheqjen e prodhimeve bujqësore e blegtorale dhe për ngritjen e nivelit të jetesës.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH shpreh bindjen se organet dhe organizatat e Partisë, organet e pushtetit e të ekonomisë, në qendër e në bazë, do të marrin të gjitha masat e nevojshme, që dhe në zonat kodrinore-malore të shpejtohen rritja dhe zhvillimi i prodhimit dhe e nivelit materialo-kulturor të popullit.

Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministria e Bujqësisë, Ministria e Financave, aparati i Komitetit Qendror dhe organet e Partisë e të pushtetit në rrethe.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë

22 shkurt 1983

22 shkurt 1983

Në zbatim të direktivave të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë të datës 8-të të Partisë për zhvillimin intensiv të bujqësisë dhe për përmirësimin e strukturës së prodhimit në fshat, Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në bazë të propozimit të Këshillit të Ministrave, shpërfaqet mundësitë e kalimit të dy kooperativave të tregtisë në ndërmarrje bujqësore.

Për më se një dekadë, me ndihmën e shtetit kooperativat e tregtisë janë, kanë ecur në rrugën e tyre të zhvillimit ekonomik-kooperativ në përputhje me direktivat e Partisë. Ajo kanë qenë përparës me ritme të shpejta, prodhimin bujqësor e blegtoral si dhe marrëdhëniet në prodhim, me synim që të përcjellin në mënyrë të shpejtë në prodhim e të ardhurave të tyre. Duke marrë parasysh se në dy kooperativat ky nivel është arritur, Byroja Politike e Komitetit Qendror,

22 shkurt 1983

Vendos:

1. — Të miratohet kalimi e kooperativave të tregtisë në fshat (në rrethin e Korçës) dhe të Greqësisë (në rrethin e Për-  
t) në ndërmarrje bujqësore, sipas rregullave të caktuar.

2. — Të miratohet kalimi e të dy kooperativave bujqësore të tregtisë në kooperativë të tregtisë sipas listës së bashkë-  
ngjitur.

3. — Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Financave të përcaktojnë masat përkatëse për ka-  
limin e të dy kooperativave bujqësore të zakonshme në kooperativë

## V E N D I M

### I BYROSE POLITIKE TE KQ TE PPSH PER KALIMIN E DISA KOOPERATIVAVE TE TIPIT TE LARTE NE NDERMARRJE BUJQESORE

25 shkurt 1983

Në zbatim të direktivave të Kongresit të 8-të të Partisë për zhvillimin intensiv të bujqësisë dhe për përsosjen e marrëdhënieve socialiste në fshat, Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në bazë të propozimit të Këshillit të Ministrave, shqyrtoi mundësitë e kalimit të dy kooperativave të tipit të lartë në ndërmarrje bujqësore.

Për më se një dekadë, me ndihmën e shtetit kooperativat e tipit të lartë, kanë ecur në rrugën e tyre të zhvillimit ekonomiko-shoqëror në përputhje me direktivat e Partisë. Ato kanë çuar përpara me ritme të shpejta, prödhimin bujqësor e blegtoral si dhe marrëdhëniet në prodhim, me synim që të përsosen organizimin dhe shoqërizimin i pronës së grupit e të arrihet niveli i nevojshëm për shndërrimin e saj në pronë të të gjithë popullit.

Duke marrë parasysh se në dy kooperativa ky nivel është arritur, Byroja Politike e Komitetit Qendror,

#### V e n d o s i :

1. — Të miratojë kalimin e kooperativave të tipit të lartë të Plasës (në rrethin e Korçës) dhe të Grecallisë (në rrethin e Fierit), në ndërmarrje bujqësore, sipas rregullave të caktuara.
2. — Të miratojë kalimin e tetë kooperativave bujqësore të zakonshme në kooperativa të tipit të lartë, sipas listës së bashkëngjitur.
3. — Ngarkohen Këshilli i Ministrave, Ministria e Bujqësisë dhe Ministria e Financave të përcaktojnë masat përkatëse për kalimin e tetë kooperativave bujqësore të zakonshme në kooperativa

të tipit të lartë dhe të kthimit të dy kooperativave të tipit të lartë në ndërmarrje bujqësore.

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH shpreh bindjen se këto masa do të rritin më tej mobilizimin e fshatarësisë kooperativiste dhe të punonjësve të bujqësisë për vënien në jetë të direktivave të Kongresit të 8-të të Partisë për intensifikimin e prodhimit dhe për përsosjen e vazhdueshme të marrëdhënieve ekonomiko-shoqërore në fshatin tonë socialist.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## PROTOKOLL

### I SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH PËR KRYERJEN E PUNËS DREJTPËRDREJT NË PRODHIM NGA KUADROT

28 shkurt 1983

Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në mbledhjen e datës 28 shkurt 1983, pasi analizoi rezultatet e punës drejtpërdrejt në prodhim nga ana e kuadrove, arriti në këto përfundime:

I. Përvoja 16-vjeçare ka vërtetuar dobinë e madhe dhe rëndësinë e direktivës së Partisë për punën drejtpërdrejt në prodhim nga kuadrot. Ajo ka ndihmuar, krahas gjithë punës tjetër, për revolucionarizimin e mëtejshëm të tyre. Vendosja edhe në Kushtetutën e Republikës e kësaj kërkesë me rëndësi të madhe ideologjike ka pasur e ka për qëllim që të luftohet rreziku i burokratizimit të kuadrove, që këta të lidhen më mirë me masat, të punojnë, të djersijnë, të ndiejnë e të jetojnë si masat; të kuptojnë madhësitinë dhe vështirësitë e problemeve të tjera jashtë zyrës ku punojnë; të shohin në praktikë drejtësinë dhe ecurinë e vendimeve të marra, duke parë në pasqyrën e luftës praktike, në terren, veprimet e tyre drejtuese, udhëheqëse. Puna drejtpërdrejt në prodhim bashkë me punëtorët e me fshatarët dhe jeta në gjirin e tyre i kalit kuadrot, u jep atyre një përvojë të pasur nga realiteti në bazë, i bën që të kuptojnë si duhet vështirësitë e punës për prodhimin e të mirave materiale.

Këto qëllime e kërkesa mbeten edhe për të ardhmen, prandaj puna drejtpërdrejt në prodhim duhet të vazhdojë të vlerësohet e të organizohet gjithnjë e më mirë për t'u shërbyer sa më efektivisht qëllimeve që ka caktuar Partia.

II. Prirjet për ta normuar punën drejtpërdrejt në prodhim të kuadrove me rregulla të njëjta me ato të punëtorëve dhe të kooperativistëve, që janë vënë re në praktikën e zbatimit të këtij orientimi, e zbehin qëllimin edukativ të saj. Puna në prodhim e punonjësve të administratës nuk mund të kronometrohet apo

të normohet si ajo e punëtorëve të fabrikave apo të kooperativistëve, për arsye se këta nuk e kanë shkallën e kualifikimit dhe as shprehitë e punës si njerëzit e prodhimit. Të mbahet gjithnjë parasysh se kjo masë është, në radhë të parë, e karakterit ideologjik.

III. Me qëllim që puna drejtpërdrejt në prodhim e kuadrove dhe e punonjësve të tjerë të administratës t'i shërbejë më mirë qëllimit për të cilin është caktuar, duke ruajtur orientimet e dhëna nga Partia dhe karakterin ideologjik të saj, Sekretariati i Komitetit Qendror

#### Porosit:

1. — Të mbahen parasysh këto kritere të përgjithshme:
  - a) Puna drejtpërdrejt në prodhim nga nëpunësit, sidomos nga ata të administratave, të vazhdojë të kryhet veçanërisht në punimet bujqësore dhe të ndërtimit, në punimet mbrojtëse e në aksionet e ndryshme lokale apo kombëtare e, sipas rastit, ajo mund të kryhet edhe në sektorët e industrisë ushqimore, veçanërisht në kohën e grumbullimit e të përpunimit të prodhimeve bujqësore. Kjo punë të ketë efektivitet të lartë, sidomos për revolucionarizimin e kuadrove, por edhe ekonomik e financiar, si rezultat i qëndrimit gjithnjë e më të ndërgjegjshëm ndaj punës, pa qenë nevoja të normohet e as të prekë pagën e kuadrove.
  - b) Kuadrot dhe punonjësit e administratave qendrore dhe lokale, si rregull, ta kryejnë punën prodhuese me grupe e jashtë qendrave të banimit, sidomos në kooperativat e ndërmarrjet bujqësore dhe në ndërmarrjet e ndërtimit, duke gjetur kohën më të përshtatshme, kur ato kanë më tepër nevojë. Në këto raste shpenzimet e udhëtimit, vajtje e ardhje, të përballohen nga qendrat e punës ku janë efektivë, kurse ushqimi të përballohet nga ndërmarrjet apo nga kooperativat ku do të punojnë.
  - c) Kuadrot që dërgohen të bëjnë punën në prodhim, mund të aktivizohen në kooperativat apo në ndërmarrjet ku shkojnë edhe për punë të tjera, sipas profilit që kanë. Për disa specialistë mund të kërkohet më pak punë drejtpërdrejt në prodhim e më shumë punë me masat, sipas specialitetit të tyre. Kështu, për shembull, mjekët mund të merren me kontrollin e të sëmurëve, me probleme të higjienës, të profilaksisë, të depistimit etj; inxhinierët me riparimin e makinerive, apo me bërjen e ndonjë projekti, me eksperimentime etj; njerëzit e artit e të kulturës, duke shkuar të grupuar e në kohë të përshtatshme, të shfrytëzohen për të dhënë shfaqje e koncerte të ndryshme etj. etj. Të gjitha këto, të shoqëruara me punën drejtpërdrejt në prodhim,

i ndihmojnë ata të lidhen me masat, të jetojnë tok me to e me shqetësimet e tyre, por edhe prodhimi ka përfitim, qoftë edhe në mënyrë indirekte.

c) Nëpunësit e ndërmarrjeve dhe të kooperativave bujqësore punën drejtpërdrejt në prodhim, si rregull, mund ta kryejnë brenda ndërmarrjes apo kooperativës ku punojnë. Të gjendet koha më e përshtatshme, si gjatë fushatave në bujqësi, kur bëhet remonti i makinerive, zgjerimi i reparteve, ndërtimi i linjave të reja etj.

d) Oficerët dhe nënoficerët e Ministrisë së Mbrojtjes Popullore, të Ministrisë së Punëve të Brendshme, si rregull, ta bëjnë punën prodhuese ashtu si deri tani, bashkë me trupat, në punimet mbrojtëse, fortifikuese, rikonjicione etj.

dh) Mësuesve t'u llogaritet si punë drejtpërdrejt në prodhim edhe puna e dobishme shoqërore që bëjnë bashkë me nxënësit në bujqësi apo në aksionet e ndryshme. Për mësuesit e fshatit, që bëjnë jetën e fshatarëve dhe marrin pjesë tok me ta në punë prodhuese në rast fushatash apo fatkeqësish, mund të mos u kërkohet punë tjetër drejtpërdrejt në prodhim.

e) Specialistët që punojnë në njësitë e prodhimit, siç janë inxhinierët e reparteve, agronomët e zooveterinerët e sektorëve, gjeologët e ekspeditave, si dhe oficerët që punojnë me trupa (batalion, grup e poshtë) mund të përjashtohen nga puna drejtpërdrejt në prodhim, duke marrë parasysh që ata janë gjithnjë afër prodhimit, në mes të punëtorëve, kooperativistëve dhe ushtarëve. Po kështu mund të përjashtohen nga puna prodhuese kirurgët.

Brigadierët e kooperativave bujqësore, sipas rastit, mund të punojnë tok me brigadën edhe drejtpërdrejt në prodhim, pa qenë nevoja të kenë ditë të caktuara.

ë) Gratë që kanë mbushur moshën 45 vjeç dhe burrat mbi 50 vjeç të përjashtohen nga kërkesat për të kryer punën drejtpërdrejt në prodhim. Në rrugë e forma të tjera të vazhdojnë të forcojnë lidhjet me masat.

Koha e punës si për gratë e martuara dhe për ato të pamaruara të jetë 15 ditë.

2. — Komiteteve të Partisë të rretheve dhe komiteteve ekzekutive të këshillave popullorë u lihen kompetenca më të gjera për ta udhëhequr tërë këtë punë me më tepër iniciativë. Ato të studiojnë e të përcaktojnë, duke u bazuar në kriteret e përgjithshme të përmendura më lart, se kush nga kuadrot duhet të bëjë e kush jo punë drejtpërdrejt në prodhim, kush duhet ta bëjë të plotë e kush të kufizuar, ku e kur duhet ta bëjnë etj. Ato, për nevoja të justifikueshme, mund të pezullojnë për një kohë nga puna në prodhim ose mund të tërhiqen prej saj kuadro që nevojiten për detyra më të rëndësishme.

Duke pasur parasysh rëndësinë e punës drejtpërdrejt në prodhim, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të rretheve do të dinë t'i përdorin këto kompetenca gjithnjë drejt e si duhet.

3. — Kryerja me ndërgjegje të lartë e punës drejtpërdrejt në prodhim është, në radhë të parë, një kërkesë që shtrohet ndaj gjithë kuadrove dhe nëpunësve të administratës për qëllimet që u thanë më lart, dhe ata me siguri, duke e kuptuar këtë si një domosdoshmëri për kalitjen e tyre, do të punojnë që të realizohet gjithnjë e më mirë.

Organizatat e Partisë në qendrat e punës ku janë efektive dhe atje ku venë për të punuar kuadrot, organizatat e masave, veçanërisht bashkimet profesionale dhe organizata e Frontit, të ndiejnë më mirë përgjegjësinë e tyre që kjo direktivë e Partisë të realizohet me të gjitha kërkesat e saj.

Komitetet ekzekutive të rretheve të marrin masa serioze si në drejtim të planifikimit më të mirë, të caktimit drejt të fronteve të punës dhe të kohës, ashtu edhe për të marrë të gjitha masat organizative që puna prodhuese e kuadrove të realizohet në bazë të kërkesave që ka Partia.

Përgjegjësit e punës, veçanërisht sektorët e kuadrit ku kuadrot janë efektive dhe ku ata venë të kryejnë punën në prodhim, të ndjekin më mirë jo vetëm grafikët, por veçanërisht rezultatet e punës në prodhim, zbatimin e orientimeve që ka caktuar Partia etj.

4. — I rekomandohet Këshillit të Ministrave që të rishikojë dispozitat që ka për këtë punë, si për t'i unifikuar ato, ashtu edhe për të bërë përmirësimet e nevojshme, për të pasqyruar drejt qëllimin që ka caktuar Partia për kryerjen e punës drejtpërdrejt në prodhim nga kuadrot, si dhe udhëzimet që jepen në këtë protokoll<sup>1</sup>.

Partia kërkon nga të gjithë funksionarët e saj të shtetit që të kryejnë si duhet detyrat e tyre atje ku janë caktuar, dhe këtu, në radhë të parë, të vërtetojnë cilësitë e aftësitë e tyre, ndërgjegjen e vendosmërinë për të mbrojtur e për të zbatuar me besnikëri vijën e Partisë. Në të njëjtën kohë, gjithë organizatat e Partisë, komunistët e kuadrot duhet të kuptojnë drejt edhe rëndësinë

1. Në zbatim të kësaj detyre doli vendimi i posaçëm i Këshillit të Ministrave për organizimin e për kryerjen e punës drejtpërdrejt në prodhim të kuadrove.

e madhe që ka puna drejtpërdrejt në prodhim për kalitjen e komunistëve dhe të funksionarëve të shtetit dhe ta zbatojnë atë me ndërgjegje të lartë e me sa më shumë efektivitet.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## V E N D I M

### I BYROJË POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR MIRATIMIN E STUDIMEVE PËR PESËVJEÇARIN E TETË (1986-1990)

28 mars 1983

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 28 mars 1983, mori në shqyrtim «Orientimet e përgjithshme për studimet që do të kryhen për hartimin e projektplanit të pesëvjeçarit të tetë, për vitet 1986-1990, të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të RPSSH», paraqitur nga Këshilli i Ministrave i RPSSH dhe, pasi diskutoi gjerësisht për domosdoshmërinë e studimeve që duhen bërë, për të përgatitur një plan real dhe mobilizues, mbështetur plotësisht në forcat e veta, për vitet 1986-1990,

#### *Vendosi:*

1. — Të miratojë orientimet e përgjithshme të Këshillit të Ministrave të RPSSH për studimet që do të kryhen për hartimin e projektplanit të pesëvjeçarit të tetë, për vitet 1986-1990, për zhvillimin e ekonomisë dhe të kulturës të RPSSH.

2. — Porositen organet dhe organizatat e Partisë, organet drejtuese shtetërore dhe ekonomike t'u kushtojnë kujdes të veçantë caktimit të njerëzve më të aftë për këto studime dhe kryerjes në kohë e me nivel të lartë cilësor të tyre.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*



## O R I E N T I M E

### TË BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR KRYERJEN E STUDIMEVE PËR HARTIMIN E PROJEKTPLANIT TË PESËVJEÇARIT TË TETË (1986-1990) TË ZHVILLIMIT TË EKONOMISË DHE TË KULTURËS TË RPSSH

28 mars 1983

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë, pasi mori në shqyrtim programin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave për kryerjen e studimeve për hartimin e projektplanit të pesëvjeçarit të tetë (1986-1990) të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës,

#### *O r i e n t o i :*

Me qëllim që të qartësohen sa më mirë objektivat kryesorë ekonomik-shoqërorë që duhet të arrihen në pesëvjeçarin e tetë (1986-1990) dhe në zbatim të detyrave të Kongresit të 8-të të Partisë për ngritjen e nivelit shkencor të planifikimit, duke u mbështetur dhe në përvojën pozitive të fituar për hartimin e planit të pesëvjeçarit të shtatë, të gjitha organet shtetërore dhe ekonomike, duke filluar nga administratat e ndërmarrjeve dhe kooperativat bujqësore, në komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, nga ministratë dhe institucionet e tjera qendrore, në institutet shkencore dhe në shkollat e larta, të fillohet menjëherë nga puna për kryerjen e studimeve, që do të mbështesin shkencërisht hartimin e projektplanit të pesëvjeçarit të tetë. Studimet të përfshijnë forcat prodhuese dhe marrëdhëniet në prodhim dhe për mjaft drejtime të shtrihen edhe përtej pesëvjeçarit të tetë.

Studimet, që do të kryhen, të synojnë këta objektiva kryesorë: mbajtjen e ritmeve relativisht të larta në zhvillimin e prodhimit shoqëror në tërësi dhe për çdo degë të ekonomisë; ritmet e shtimit të produktit shoqëror të jenë rreth 2-3 herë më të shpejta se ato të shtimit të popullsisë; rritjen më të madhe të vlerës së

pasurive tona kombëtare, duke çuar më tej përpunimin e plotë e më të thellë të tyre; futjen në qarkullimin ekonomik të pasurive të reja të vendit; aktivizimin e plotë e me rendiment më të lartë të burimeve të punës, krahas futjes më të gjerë të teknikës dhe të teknologjisë më të përparuar; zbatimin gjerësisht të shkencave, sidomos atyre aplikative në prodhim dhe në fusha të tjera; rritjen në mënyrë të gjithanshme të efektivitetit të ekonomisë, forcimin e regjimit të kursimit dhe sigurimin e burimeve financiare të nevojshme; forcimin më tej të pavarësisë së ekonomisë dhe të aftësisë mbrojtëse të vendit.

Arritja e këtyre objektivave në pesëvjeçarin e tetë t'i shërbejë qëllimit kryesor të prodhimit shoqëror: rritjes shkallë-shkallë e në mënyrë të sigurt të nivelit të mirëqenies materiale e kulturore të popullit, duke ecur më tej e me ritme më të shpejta se deri tani edhe në ngushtimin e dallimeve midis fshatit dhe qytetit, për zgjidhjen e problemeve të strehimit, për zhvillimin e mëtejshëm të arsimit, të kulturës, të shëndetësisë dhe të sferës së shërbimeve.

Të arrihet fuqizimi i eksporteve me mallra më të garantuara për shitje dhe përmirësimi i mëtejshëm i strukturës së importeve në favor të makinerive dhe pajisjeve për të siguruar një pavarësi më të madhe të ekonomisë, rendiment dhe efektivitet më të lartë të saj.

Marrëdhëniet socialiste në prodhim t'i përshtaten më mirë nivelit të arritur të zhvillimit të forcave prodhuese dhe t'i çelin rrugë zhvillimit të mëtejshëm e të harmonizuar të ekonomisë.

Byroja Politike e vlerëson kryerjen e këtyre studimeve si një aksion të madh politik, ekonomik, shoqëror dhe shkencor që duhet të kryhet krahas punës për plotësimin e planit të këtij viti. Për kurorëzimin me sukses të këtij aksioni dhe për kryerjen me cilësi të lartë të studimeve nën drejtimin e Partisë të mobilizohen organet e shtetit e të ekonomisë në qendër e në bazë, institucionet kërkimore-shkencore dhe shkolla e lartë, forcat krijuese, specialistët, shkencëtarët, punëtorët e pararojës në degët dhe sektorët e ndryshëm të ekonomisë.

#### DISA DREJTIME KU DUHET TË SYNOJNË STUDIMET PËR ZHVILLIMIN E DEGËVE DHE SEKTORËVE TË NDRYSHËM TË EKONOMISË E TË KULTURËS

##### a) Në industri

Në sektorin e gjeologjisë, studimet të synojnë në përcaktimin e drejtimeve kryesore të zhvillimit të punimeve të kërkim-zbulimit. Kërkimet në naftë të synojnë në dy drejtime: në rivlerësi-

min më të plotë të fushave ekzistuese, si dhe në zbulimin e fushave të reja. Po ashtu të bëhet një vlerësim më i plotë i pasurive të tjera minerare, të kromit, të bakrit, të qymyrgurit, të hekur-nikelit dhe të mineraleve të tjera të njohura dhe të reja, duke përcaktuar rrugët që duhet të ndiqen për të shtuar rezervat industriale, gjeologjike e prognoze, si dhe raportet e përshtatshme midis tyre, në sasi dhe në cilësi. Synimi të jetë sigurimi i nxjerrjes së mineraleve për pesëvjeçarin e tetë dhe për më tej, si dhe për të rritur efektivitetin e zbulimit të tyre. Në këtë bazë të parashikohen mundësitë e zhvillimit të industrisë nxjerrëse e përpunuese.

Në shpime dhe në kërkime minerare të synohet në përcaktimin e masave për të përmirësuar teknologjinë në përshtatje me rritjen e thellësisë dhe për të shpejtuar ritmin e kryerjes së tyre.

**Për industrinë energjetike** studimet dhe projektimet të synojnë në përcaktimin e nevojave të vendit për energji të të gjitha llojeve (elektrike, termike, karburante, qymyre etj.) në përputhje me kërkesat e zhvillimit ekonomik e kulturor të vendit, si dhe me mënyrat e me mjetet për plotësimin e këtyre nevojave, duke shfrytëzuar me përparësi, rezervat disponibël hidroenergjetike dhe qymyret e varfëra. Të synohet në gjetjen dhe në zbatimin e metodave tekniko-shkencore, në zbatimin e teknologjive më të përparuara në prodhimin e në përdorimin me efektivitet të burimeve dhe të lëndëve energjetike.

**Nxjerrja e naftës dhe gazit** të mbështetet kurdoherë në rezervat e zbuluara, duke thelluar studimet, në përcaktimin dhe në zbatimin praktik të metodave më efektive të veprimit të shtresë për të rritur naftënxjerrjen përfundimtare, në përpunimin e metodave intensifikuese për përmirësimin e teknologjisë së nxjerrjes së naftës së rëndë dhe në pusët e thella, me qëllim që të rritet efektiviteti i investimeve dhe i shpenzimeve në fushën e nxjerrjes së naftës e gazit.

Në përpunimin e naftës studimet të synojnë në përpunimin më të thellë të saj për pakësimin e humbjeve, si dhe për të rritur më tej efektivitetin ekonomik në këtë degë.

**Në industrinë nxjerrëse minerare** studimet të synojnë për vënien në qarkullimin ekonomik edhe të mineraleve të reja, në përmirësimin e teknologjisë së nxjerrjes e të pasurimit të mineraleve që të shfrytëzohen në mënyrë sa më të plotë rezervat, duke ulur kondicionin dhe varfërimin. Të bëhet një shfrytëzim më me leverdi i mineraleve që kanë përmbajtje të ulët të komponenteve të dobishëm, duke zgjeruar pasurimin e mineraleve të varfëra, në bazën e një rendimenti sa më të lartë.

**Në industrinë përpunuese minerare**, krahas përvetësimit sa më shpejt të treguesve dhe të aftësive të projektuara, të synohet për të rritur më tej shkallën e përpunimit në vend të lëndëve

të para me cikël sa më të plotë. Ky përpunim të rritet në gjerësi dhe në thellësinë e tij, në bazë të leverdishmërisë dhe të efektivitetit ekonomik.

**Shpejtimi i ritmeve të ndërtimit për vënien në shfrytëzim të minierave të reja dhe për përvetësimin sa më parë të aftësive nxjerrëse** është një drejtim tjetër i punës studimore në këtë sektor.

**Në industrinë kimike** të synohet drejt plotësimin të nevojave që nxjerr intensifikimi i bujqësisë për plehra kimike, insekticide, pesticide etj. Të studiohet mundësia e ngritjes së industrisë petrokimike, si dhe prodhimi i një game të gjerë artikujsh kimikë, farmaceutikë dhe materialesh për ndërtime e për industrinë mekanike, duke shfrytëzuar në radhë të parë lëndët e para të vendit.

**Për industrinë mekanike** studimet të synojnë për të zgjidhur problemet e prodhimit sidomos të makinerive e të pajisjeve, për prodhimin e pjesëve të ndërrimit e rigjenerimin, si dhe për përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomikë, duke ngritur në një nivel më të lartë studimet e projektimet, si dhe teknologjinë e prodhimit. Të synohet për një shfrytëzim kompleks më të thelluar të bazës ekzistuese dhe të mundësive që jepen për zgjerimin në të ardhmen të industrisë mekanike, si dhe për të dalë nga gjendja e prapambetur në cilësinë e prodhimeve mekanike dhe në koeficientin e shfrytëzimit të metaleve. Ato të synojnë, gjithashtu, për një kthesë të madhe në specializimin, përqendrimin e kooperimin në industrinë mekanike dhe struktura e mjeteve kryesore të saj t'u përgjigjet nevojave të zhvillimit të të gjitha degëve të ekonomisë. Vëmendje e veçantë t'i kushtohet studimit për rritjen e sasisë, llojshmërisë dhe cilësisë së pjesëve që rigjenerohen.

**Në industrinë e materialeve të ndërtimit**, krahas rrugëve për zgjerimin e prodhimit, t'u jepet përgjigje problemeve të tilla të mëdha, siç janë: lehtësimi i materialeve të ndërtimit dhe zgjerimi i gamës së tyre, rritja e nivelit të mekanizimit kompleks në punimet e ndërtimit, ulja e ndjeshme e kostos dhe rritja e vëllimit të parafabrikateve etj. Të rritet prodhimi i çimentos për nevojat e vendit dhe për eksport. Të bëhet kthesë në teknologjinë e prodhimeve qeramike që ato të jenë më të forta, më të lehta dhe estetike. Të synohet që 50-60 për qind e prodhimit të tullave të jenë tulla të lehta; në ndërtim të futen materiale prej plastmase dhe një gamë më e gjerë materialesh të tjera të lehta, funksionale etj.

**Studimet për industrinë e lehtë e ushqimore** të synojnë në shfrytëzimin kompleks të lëndëve të para të vendit, në zgjerimin e produkteve dhe të asortimenteve dhe në përmirësimin e cilësisë së prodhimeve, në përshtatje me nivelin material e kulturor të popullsisë. Zhvillimi i industrisë ushqimore të afrojë përpunimin pranë burimeve të lëndëve të para e të përmirësojë tek-

nologjinë e ruajtjes e të konservimit të tyre, për të ulur humbjet, si dhe të zgjidhë problemet e sezonalitetit e të pikut të përpunimit të produkteve bujqësore e blegtorale.

#### b) Në bujqësi

Të synohet që **struktura e bujqësisë** të sigurojë më mirë furnizimin dhe përmirësimin e ushqimit të popullit në qytet e në fshat, zgjidhjen më të mirë të nevojave që ka industria për lëndë të para, shtimin e eksportit me sa më shumë produkte bujqësore e blegtorale të përpunuara e të freskëta, si dhe rritjen e efektivitetit të shpenzimeve që bëhen për bujqësinë.

Studimet në bujqësi t'u japin zgjidhje sa më të drejtë detyrave të caktuara nga Kongresi i 8-të i Partisë **për zgjerimin e zonës me intensifikim më të lartë**, për zbatimin e përvojës së përparuar dhe të teknologjive të reja që do të duhet të përdoren për arritjen e rendimenteve të larta në prodhimet bujqësore e blegtorale.

**Në bimët e arave** studimet duhet të përqendrohen në zgjidhjen e problemeve për rritjen e prodhimit nëpërmjet intensifikimit dhe zbatimit të teknologjive të reja, duke plotësuar më mirë nevojat e popullit e të industrisë dhe për të rritur eksportin.

**Në drithërat**, përveç sigurimit të bukës dhe të rezervave të drithit, të studiohet me synimin që të arrihet edhe plotësimi i nevojave të blegtorisë për koncentrate.

**Në bimët industriale**, përveç masave për rritjen e prodhimit, të thellohet, puna studimore për gjetjen e rrugëve që duhet të ndiqen për përmirësimin e strukturës së llojeve me përmbajtje më të lartë sheqeri e vaji dhe fije më të gjatë të pambukut, me synim që gradualisht të pakësohet importi i yndyrnave e i sheqerit dhe të rritet eksporti i duhanit.

**Në perime, patate e fasule** të studiohet e të gjenden rrugë që, përveç shtimit të prodhimit për plotësimin e nevojave të vendit, të rritet eksporti i tyre e sidomos nëpërmjet hershmërisë së prodhimit.

**Në pemëtari** vëmendje t'i kushtohet përcaktimit të drejtimit të zhvillimit perspektiv të kulturave drufrutore, të strukturës së llojeve e varieteteve, për t'iu përgjigjur më mirë kërkesave të reja të industrisë, të tregut të brendshëm dhe të eksportit. Gjithashtu të studiohen mundësitë që janë për rritjen e efektivitetit të investimeve të kryera në këtë sektor, nëpërmjet shtimit të futjes në prodhim të blloqeve të reja. Për rritjen e prodhimit të ullirit, studimet të synojnë në zbatimin e masave për zgjerimin dhe për shpejtimin e vënies nën ujë, në sistemin e ullishtave dhe në zgjerimin e mekanizimit të nevojshëm. Të futen më gjerë edhe varietete më prodhimtare se ato ekzistueset.

**Në blegtori** studimet duhet të synojnë në gjetjen e rrugëve

dhe të mjeteve për rritjen e prodhimeve blegtorale nëpërmjet zbatimit të teknologjive të reja në të ushqyerit dhe në mbarë-shtimin e bagëtive, në thellimin dhe në zgjerimin e rritjes së përqendruar të blegtorisë, në komplekset blegtorale dhe në ekonominë bujqësore me drejtim blegtoral, në rritjen e efektivitetit të ushqimeve duke rikonstruktuar më tej sipërfaqet kullosore, që të ulët kostoja e prodhimit dhe të mënjanohen humbjet nga **ky sektor**.

**Në ekonominë pyjore** duhet të synohet që, nëpërmjet mbarë-shtimit shkencor të pyjeve, të plotësohen nevojat e ekonomisë me lëndë drusore dhe të garantohen ato në perspektivë. Për këtë, vëmendje t'i kushtohet vendosjes së raporteve më të drejta midis prerjeve dhe rritjes vjetore të pyjeve, si dhe shfrytëzimit racional të tyre. Gjithashtu të thellohen studimet për zhvillimin kompleks të pyjeve, për zgjerimin e aktiviteteve ndihmëse dhe për rritjen e prodhimeve të dyta, sidomos të atyre për eksport.

Të përcaktohen masat që duhet të merren për **fuqizimin e mëtejshëm të bazës materialo-teknike** të bujqësisë, sidomos për shtimin e sipërfaqes së ujitshme, për rritjen e vazhdueshme të pjellorisë së tokës, për rritjen e mekanizimit kompleks, për fuqizimin e transportit dhe për ruajtjen e produkteve bujqësore e blegtorale.

#### c) Në ndërtim

Studimet të synojnë rritjen e efektivitetit dhe uljen e kostos, për të lirësuar në maksimum vleftën e objekteve që në projektim, për të shkurtuar afatet e ndërtimit të veprave, për të zgjeruar tipizimin e ndërtimeve etj. Në zgjedhjen e teknologjive dhe të llojit të ndërtimeve të synohet që vëllimi i ndërtimeve të zëjë një peshë sa më të vogël në investimet gjithsej për veprën, si dhe të pakësohet sipërfaqja e tokës që zihet me ndërtime. Të përsoset më tej procesi i projektimit nëpërmjet studimit të zgjidhjeve më racionale e vlerësimit në kompleks (teknologjik e ndërtimor) e në më shumë variante të veprave, futjes më gjerë të skemave e metodave të përparuara llogaritëse e sidomos nëpërmjet eksperimentimeve e modelimeve, tipizimit të strukturave e të elementeve etj.

Për rritjen e rendimentit në ndërtim dhe për shkurtimin e afateve të ndërtimit, studimet të synojnë në zgjidhjen më optimale të mekanizimit të ndërtimeve, duke vënë theksin sidomos në ndërtimet masive, pa lënë mënjane edhe mekanizimin e vogël. Të caktohen detyra konkrete për prodhimin e mekanizmave të nevojshëm për të gjitha llojet e punimeve në ndërtim etj.

#### c) Në transport

Studimet të synojnë në rritjen e vazhdueshme të përparësisë së transportit hekurudhor, në zgjerimin e transportit detar dhe për një kombinim sa më racional të strukturës së mjeteve (he-



kurudhor, automobilistik e detar) në transportin e mallrave që të sigurojë një lëvizje të shpejtë e me kosto sa më të ulët të mallrave.

Gjithashtu, studimet të përqendrohen edhe në përmirësimin e strukturës së mjeteve të transportit automobilistik në tërësi dhe sipas zonave, me synim që të sigurohen kursimi i karburantëve dhe tregues më të lartë tekniko-ekonomikë, në përshtatje me kushtet dhe me kategoritë e rrugëve të çdo rrethi; në fuqizimin e transportit të brendshëm të ndërmarrjeve ekonomike dhe të kooperativave bujqësore; në futjen më gjerë të mekanizimit të proceseve të ngarkim-shkarkimit e të transportit me kontejnerë; në rikonstruksionin e rrugëve automobilistike etj.

#### d) Për eksportin

Studimet të synojnë në gjetjen e rrugëve për rritjen e mallrave të përpunuara për eksport, në përshtatje me kërkesat e tregjeve të jashtme, duke luftuar edhe nga tregtia e jashtme që produktet tona të vlerësohen sa më mirë. Në rritjen e eksportit të studiohen mundësitë e mëdha që ka për të rritur jo vetëm artikujt tradicionalë, por edhe mineralet e reja, si dhe mundësitë e shfrytëzimit të florës e të faunës sonë.

Për importin të synohet për të përmirësuar strukturën duke ulur peshën specifike të lëndëve të para, në bazë të prodhimit në vend të mallrave që importojmë.

#### dh) Në fushën e mirëqenies

Synimi të jetë zgjidhja e problemeve shoqërore të zënies me punë të burimeve të reja për çdo rreth (këtu duke përfshirë ato të qyteteve e të qendrave të punës, si dhe të kooperativave).

Të përcaktohen mundësitë e rrugët për të ngushtuar dallimet thelbësore midis nivelit të jetesës së fshatit e të qytetit dhe brenda fshatit.

Të qartësohen problemet që lidhen me kushtet e punës së punëtorëve e veçanërisht të punëtorëve që punojnë në miniera e në sharra, të gjeologëve e të kooperativistëve, me zgjerimin e sigurimeve shoqërore e të konsumit shoqëror, me zgjidhjen e problemit të banesave në qytet dhe në fshat, të ujit të pijshëm, me zhvillimin e arsimit, të kulturës, të shëndetësisë, të shërbimeve komunale e të tregtisë.

#### e) Në fushën e efektivitetit

Studimet të synojnë në uljen e shpenzimeve të prodhimit, të ndërtimeve, të shërbimeve etj. Vëmendja të përqendrohet në uljen e shpenzimeve materiale, duke ulur normativat e harxhimit për njësi, në zëvendësimin e materialeve të shtrenjta me më të lira, të importit me të vendit, duke përmirësuar cilësinë e prodhimeve dhe duke rritur rendimentin e punës së gjallë dhe kursimin e gjithanshëm. Në këtë bazë të arrihen rritja e rentabilitetit dhe e të ardhurave financiare, përdorimi me efektivitet të lartë i fondeve të akumulimit, sidomos të investimeve, për

t'i përdorur ato në radhë të parë për riprodhimin e zgjeruar. Të përcaktohen qartë rrugët për të nxjerrë nga humbja ndër-marrjet ose sektorët që vazhdojnë të realizojnë më pak të ardhura nga shpenzimet që bëjnë.

Të studiohet struktura e eksportit për një efektivitet sa më të lartë, si dhe për të siguruar mundësi për blerjen e mallrave të importit me çmime sa më të ulëta.

#### f) Në fushën e punës studimore-shkencore

Studimet të përcaktojnë edhe drejtimet e fushat ku duhet të synojë puna studimore-shkencore e projektuese gjatë pesëvjeçarit të tetë, me qëllim që nga ato të dalin problemet konkrete që do të përfshihen më vonë në tematikën studimore. Drejtimet e punës shkencore të lidhen me realizimin e detyrave të pesëvjeçarit të tetë dhe të hapin perspektivë për të ardhmen. Ato të synojnë në shfrytëzimin optimal të burimeve pasurore të vendit, të bazës materialo-teknike ekzistuese, në modernizimin e saj, në futjen më gjerë të teknologjisë së re dhe në përdorimin e metodave matematike e fizike.

Gjithashtu, studimet dhe projektimet të nxjerrin të dhëna për rrugët dhe për mundësitë e futjes në prodhim të arritjeve të reja të shkencës, të informatikës, të teknikës e të teknologjisë, siç janë: energjia bërthamore, elektronika e aplikuar, biokimia, rrezet lazer, për automatizimin e proceseve të punës e të tjera. Për këto të dalin fushat konkrete ku mund të aplikohen, investimet përkatëse, forcat njerëzore dhe baza materiale e nevojshme.

#### g) Për përsosjen e mëtejshme të marrëdhënieve në prodhim

Studimet të përfshijnë përsosjen e anëve të veçanta të marrëdhënieve në fushën e pronësisë, e sidomos në fshat, për të realizuar në rrugë sa më të drejtë orientimet e Partisë në këtë fushë. Kujdes t'u kushtohet marrëdhënieve të shpërndarjes, të këmbimit e të drejtimit, për t'i përputhur me kërkesat që nxjerr rritja e nivelit të zhvillimit të forcave prodhuese.

Puna për hartimin e projektplanit të pesëvjeçarit të tetë (1986-1990) të kryhet sipas afateve të pasqyrës bashkëlidhur.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

## V E N D I M

### I SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË PUNËS DHE TË JETESËS SË PUNËTORËVE

30 mars 1983

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 30 mars 1983, mori në shqyrtim raportin e Këshillit të Përgjithshëm të BPSH «Për përmirësimin e kushteve të punës e të jetesës së naftëtarëve, minatorëve, gjeologëve e sharrëtarëve» dhe diskutoi gjerësisht jo vetëm për kushtet e punës së punëtorëve të këtyre degëve, por në tërësi për të gjithë punëtorët.

Sekretariati i Komitetit Qendror vlerësoi punën e mirë të deritanishme, por dhe kritikoi ashpër shfaqjet e qëndrimet burokratike, zvarritjet e neglizhencat, nënvleftësimet e pakujdesitë, që vihen re në plotësimin e kushteve të domosdoshme e të përshtatshme të punës e të jetesës, për ruajtjen e shëndetit të punëtorëve e rritjen e rendimentit.

Duke marrë parasysh këto të meta dhe me qëllim që këto të kapërcehen sa më parë e të përmirësohen kushtet e punës e të jetesës së punëtorëve në të gjitha qendrat e punës e të prodhimit, Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH,

#### V e n d o s i :

1. — T'i rekomandojë Këshillit të Ministrave që të marrë masa të plota për realizimin brenda vitit në vazhdim të të gjitha investimeve dhe fondeve të planifikuara për vitin 1983 për përmirësimin e kushteve të punës e të jetesës së punëtorëve. Në të njëjtën kohë të studiojë mundësitë për të caktuar fonde e mjete të tjera plotësuese qoftë dhe duke ulur disi shpenzimet joprodhuese apo duke përdorur rezerva të brendshme të ndërmarrjeve dhe të ministrive përkatëse. Në këtë drejtim t'u jepet përparësi ndërtimit të banesave në qendrat punëtoresh, si dhe strehimit të punëtorëve.

2. — Organizatat e bashkimeve profesionale të rritin punën dhe kontrollin e tyre për zbatimin e direktivës së Partisë për përmirësimin e vazhdueshëm të kushteve të punës e të jetesës së punëtorëve. Ato duhet të luajnë rolin që u ka dhënë Partia për të luftuar deri në fund burokratizmin dhe të mbajnë qëndrim ndaj kujtdo që nuk plotëson detyrat dhe pengon zbatimin e vijës së Partisë.

3. — Zbatimi i këtij vendimi të kontrollohet, nën drejtimin e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë, nga grupe të kontrollit punëtor, nga organet shtetërore dhe ato të prokurorisë, të cilat të kenë kompetenca të plota për të marrë masa ndaj kujtdo që do të zvarritë ose do të pengojë realizimin e detyrave që përcakton ky vendim dhe të atyre që do të miratojë Këshilli i Ministrave.

Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë ka besim dhe shpreh bindjen e thellë se ky kujdes i Partisë do t'i shërbejë klasës punëtoresh për të mobilizuar të gjitha forcat, energjitë e vullnin e saj revolucionar për të plotësuar me nder detyrat e mëdha të planit të shtatë pesëvjeçar, për të rritur rendimentin e punës, për të forcuar disiplinën proletare dhe për zhvillimin dhe ruajtjen e pronës së përbashkët.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## PROTOKOLL

### I SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH PËR PËRMIRËSIMIN E KUSHTEVE TË PUNËS DHE TË JETESËS SË GRAVE DHE FËMIJËVE

9 maj 1983

Sekretariati i KQ të PPSH, në mbledhjen e datës 9 maj 1983, dëgjoi raportin e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë «Mbi disa çështje të punës së Partisë për rritjen e rolit të organizatës së gruas në rrethet Dibër, Mat dhe Librazhd» dhe arriti në këto konkluzione:

1. — Në përgjithësi, si në gjithë vendin, edhe në këto rrethe është bërë një punë e madhe, në kuadrin e përgjithshëm të rritjes së mirëqenies së mbarë popullit, për krijimin e kushteve të përshtatshme për punë e jetesë edhe për gratë e fëmijët. Kudo vihet re një mendim i ri për rolin e aftësitë e grave, një angazhim më i plotë i tyre për plotësimin e detyrave dhe një kujdes më i madh i shoqërisë e familjeve për nënën dhe fëmijët.

Por duhet luftuar kundër njëfarë euforie që i mat arritjet në krahasim me të kaluarën, që shikon kryesisht përqindjen që zënë gratë në Parti, në këshillat popullorë etj. dhe nuk shikon sa duhet kërkesat që shtron Partia në tërësi për emancipimin e plotë të gruas.

2. — Më mirë e më me forcë duhet luftuar nga organizatat e Partisë kundër koncepteve e praktikave patriarkale e bajraktare që ndeshen akoma, sidomos në disa zona të malësisë, që e denigrojnë gruan, i ndrydhin energjitë e saj dhe ruajnë ndjenjën e inferioritetit. Është e pafalshme që akoma në disa zona të ligjërohet ngarkesa e gruas, duke caktuar dhe norma për këtë punë. Sikur të ishte punuar kudo me vëmendjen e duhur për zbatimin e porosive të dhëna, do të ishte plotësuar gradualisht numri i nevojshëm i kafshëve të ngarkesës në çdo kooperativë dhe do të ishte hequr ngarkesa me krahë, sidomos për gratë. Tash e prapa kjo detyrë të zgjidhet me përparësi nga Ministria e Bujqësisë,

komitetet ekzekutive të rretheve dhe vetë kooperativat bujqësore.

Ajo që kërkohet nga organizatat e Partisë, pushteti dhe organizatat e masave në këtë drejtim është të shkulet nga rrënjët koncepti i vjetër patriarkal, që e quan gruan një qenie inferiore, që e konsideron si diçka të zakonshme ngarkesën e saj dhe turp ngarkesën e burrave. Sepse edhe në të ardhmen mund të lindë nevoja në malësi, madje dhe në fushë, që të transportohen me krahë, në distanca të shkurtra, prodhime të ndryshme bujqësore, por kjo duhet të bëhet, në radhë të parë, nga burrat e pastaj, po qe nevoja, dhe nga gratë.

3. — Të insistohet për një përdorim më të mirë të të ardhurave të familjes në interes të të gjithë pjesëtarëve të saj. Të konsiderohen të papajtueshme me kërkesat e shoqërisë sonë socialiste shpenzimet e tepërta që bëhen individualisht nga burrat. Duhet të bëhet më shumë punë sqaruese me burrat dhe me gratë për një administrim racional të buxhetit familjar, për plotësimin sa më mirë të nevojave të çdo anëtarit të saj, duke luftuar sidomos që t'u bëhet një trajtim i veçantë, në çdo familje, nënës shtatzënë apo lehonë dhe fëmijëve. Shteti ka krijuar në këtë drejtim kushte lehtësuese e ka marrë shumë masa favorizuese, që kanë ardhur gjithnjë në rritje. Por ato duhen shoqëruar edhe me kujdesin e posaçëm të vetë familjes.

4. — Në lidhje me porositë e vazhdueshme që ka dhënë Partia për kujdesin për njeriun, që përbën qëllimin kryesor të të gjithë veprimtarisë së shoqërisë sonë, të ndiqet me rreptësi nga organizatat e Partisë, organet e pushtetit, nga bashkimet profesionale dhe nga organizata e gruas plotësimi i të gjitha kushteve për mbrojtjen në punë dhe për shëndetin e nënës dhe të fëmijës. Ministria e Shëndetësisë dhe këshillat popullorë të kontrollojnë e të sigurojnë një shërbim shembullor në shtëpitë e lindjes e në çerdhet, ku, me gjithë masat e marra, ka akoma mjaft mungesa. S'duhet të lejohen më lindje pa asistencë, mosndjekje sistematike të ecurisë së barrës dhe fëmijëve të lindur, moszbatim i vendimit të Këshillit të Ministrave për pajisjen dhe ushqimin në çerdhet etj.

Me këmbëngulje duhet të punohet edhe nga organet e pushtetit, por dhe nga organizata e Frontit dhe e gruas për higjienën në familje, për higjienën vetjake, si dhe për higjienën e punës.

5. — Të luftohet pa ndërprerje kundër zakoneve prapanike që lidhen sidomos me fejesat, martesat, mortet etj. Të mos lejohet të kthehen në forma të reja zakonet e vjetra, siç po ngjjet me pajën, që kërkohet në formë kontrate, me listë, me mblesëritë gjoja me dashuri, me një të parë etj. Organizatat e rinisë dhe ato të gruas duhet të luftojnë më tepër kundër këtyre fenomeneve dhe kundër çdo koncepti, shfaqjeje e praktike që ul dinjitetin dhe personalitetin e vajzës e të nënës.



Organet tregtare dhe ato komunale duhet të marrin masa që t'i plotësojnë popullit, sipas zonave, disa kërkesa tradicionale që s'kanë të bëjnë me zakone prapanike e fetare, por me veshjen karakteristike, me organizimin thjesht të ceremonive të ndryshme etj.

6. — Organet e Partisë duhet të udhëheqin dhe të kontrollojnë më mirë tërë punën që bëhet e duhet bërë për rritjen e rolit të gruas dhe për trajtimin e saj e të fëmijëve. Më tepër studime duhen bërë për arsyet dhe për rrënjët e koncepteve të vjetra, patriarkale e bajraktare që kanë mbizotëruar në të kaluarën dhe e poshtëronin gruan. Organizatat e Partisë duhet të interesohen e të ngarkojnë organizatën e gruas e të rinisë jo vetëm me detyra e aksione ekonomike, por më shpesh edhe për problemet shoqërore. Në radhë të parë, të mbajnë gjithmonë ngritur opinionin e shëndoshë për barazinë e plotë të gruas me burrin në të gjitha fushat dhe kudo, në punë, në shoqëri e në familje. Ecja gjithnjë përpara në rrugën socialiste e shoqërisë sigurohet vetëm duke ecur krah për krah burrat dhe gratë.

Sekretare e Komitetit Qendror të PPSH

*Lenka Çuko*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## V E N D I M

### I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR RIORGANIZIMIN E HETUESISË DHE VEÇIMIN E SAJ NGA ORGANET E PUNËVE TË BRENDSHME

8 qershor 1983

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 8 qershor 1983, analizoi studimin për riorganizimin e hetuesisë dhe për veçimin e saj nga organet e Punëve të Brendshme dhe konstatoi se vendimi i Byrosë Politike nr. 160 datë 21 dhjetor 1973 për forcimin e rolit të prokurorisë dhe përqendrimin e hetuesisë ishte një masë e drejtë që mori Partia për revolucionarizimin e organeve të hetuesisë dhe për rritjen e efektivitetit të hetimit, zbulimit dhe parandalimit të veprave penale. Por vendimi u sabotua nga armiqtë K. Hazbiu e F. Shehu, që drejtonin në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ata e kthyen hetuesinë në shtojcë të sektorit operativ dhe dëmtuan politikën e Partisë në zbatimin e ligjshmërisë.

Praktika vërtetoi se përqendrimi i hetuesisë në Ministrinë e Punëve të Brendshme, përveç sabotimit që u bë nga armiqtë, krijoi dhe krijon rreziqe në vazhdimësi për hetime të plota, të gjithanshme e objektive.

Për t'i dhënë hetuesisë vendin e saj në mekanizmin shtetëror dhe për të rritur frymën klasore, partishmërinë dhe objektivitetin në luftën kundër veprave penale, për të fuqizuar zbatimin e parimit të ligjshmërisë socialiste, për të rritur kërkesat për cilësinë e punës, fuqinë zbuluese dhe zbatimin e metodave të reja, për të vënë veprimtarinë e saj mbi baza shkencore, për të mbrojtur rendin juridik socialist dhe interesat e ligjshëm të shtetasve, Byroja Politike

#### V e n d o s i :

1. — Hetuesia të riorganizohet, të ndahet nga organet e Punëve të Brendshme dhe të veprojë si organ më vete, i pavarur

nga çdo organizëm tjetër i drejtësisë dhe i organeve administrative. Hetuesia të jetë organ që ka për detyrë hetimin e veprave penale. Ajo, në veprimtarinë e saj, t'u përmbahet parimit të luftës së klasave, zbatimit të vijës së masave dhe respektimit me rreptësi të ligjshmërisë socialiste.

2. — Hetuesia të jetë organ në vartësinë e Kuvendit Popullor. Ajo zgjidhet nga Kuvendi Popullor, përgjigjet dhe jep llogari para tij dhe, midis sesioneve, para Presidiumit të Kuvendit Popullor.

3. — Hetuesia të jetë organ monokratik i ndërtuar mbi bazën e centralizmit demokratik. Ky organ në qendër të emërtohet «Hetuesia e përgjithshme» dhe në bazë «Hetuesia e rrethit».

4. — Hetuesia me Sigurimin e Shtetit, me Prokurorinë dhe me Gjykatën bashkëpunojnë ngushtë, po pa shkelur kompetencat e njëri-tjetrit. Këto kanë detyrat e tyre të caktuara me ligj dhe janë plotësisht përgjegjëse për gjykimet, procedimet dhe vendimet që marrin.

Hetuesia të rritë e të forcojë bashkëpunimin edhe me organet e tjera shtetërore, si dhe me organizatat ekonomike e shoqërore për hetimin, zbulimin dhe parandalimin e veprave penale.

Hetuesia dhe organet e Punëve të Brendshme të organizojnë një bashkëpunim të vazhdueshëm dhe të ndihmojnë njëri-tjetrin për zbulimin në thellësi të veprimtarisë armiqësore e keqbërëse.

5. — Të bëhen propozimet e nevojshme për ndryshimet në Kushtetutën e Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë dhe në Kodin e Procedurës Penale të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë.

Këshilli i Ministrave të marrë masat e nevojshme për krijimin e kushteve për veprimtarinë normale të organeve të hetuesisë.

6. — Komitetet e Partisë të rretheve të marrin masa për ndjekjen dhe të ndihmojnë për zbatimin e vendimit të Byrosë Politike për riorganizimin e hetuesisë.

Ndarja e hetuesisë nga Sigurimi i Shtetit është një masë e drejtë dhe parimore që do të forcojë ligjshmërinë dhe do të shmangë gabimet e rënda që u vërtetuan kur në Ministrinë e Punëve të Brendshme drejtonin armiqtë dhe agentët e të huajve Mehmet Shehu, Kadri Hazbiu dhe Feçor Shehu.

Byroja Politike ka besim se hetuesia, nën udhëheqjen e Partisë, do të ngrejë në një shkallë më të lartë rolin dhe veprimtarinë e saj. Hetuesia do të jetë kurdoherë një armë e dashur në duart e klasës punëtore e të masave punonjëse për mbrojtjen

e Partisë së Punës të Shqipërisë, shtetit socialist, do të ndihmojë ndërtimin socialist të vendit sipas parimit të mbështetjes në forcat e veta.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

## V E N D I M

### I SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMET EKZISTUESE TË KOMITETIT QENDROR MBI STAZHIN E KANDIDATIT PËR ANËTAR PARTIE

10 qershor 1983

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur në datën 10 qershor 1983, pasi shqyrtoi propozimin e aparatit të Komitetit Qendror të Partisë për disa ndryshime në udhëzimet ekzistuese të Komitetit Qendror mbi stazhin e kandidatit për anëtar partie,

#### V e n d o s i :

1. — Të gjithë kandidatët për anëtarë partie që pranohen nga radhët e nëpunësve në ndërmarrje, kooperativa bujqësore e institucione, si dhe në brigada, regjimente e më poshtë në ushtri lejohet ta kryejnë stazhin në vendin e punës dhe në funksionin që kanë kur pranohen në Parti.

Kur organizata-bazë dhe komiteti i Partisë e shohin të arsyeshme, edhe nga këta kandidatë për anëtarë partie mund të dërgohen që të kryejnë stazhin në një vend tjetër më afër prodhimit, nga qyteti në fshat, nga një rreth në tjetrin, në veprat e mëdha dhe në aksionet kombëtare e lokale.

2. — Të mos lejohet të kryhet stazhi i kandidatit për anëtar partie nga radhët e nëpunësve në aparatet e komiteteve ekzekutive dhe të organizatave të masave në rreth e rajon, në dikasteret qendrore (aparati i Presidiumit të Kuvendit Popullor, i Kryeministrit, në ministritë dhe në Akademinë e Shkencave), si dhe në shtabin e divizionit e të njësive të tjera të një rangu me të.

— Për raste shumë të veçanta, autorizohet sekretari i Komitetit Qendror të Partisë që, me propozim të organizatës-bazë dhe të komitetit përkatës të Partisë, të bëjë përjashtime nga kjo kërkesë.

3. — Kandidatët për anëtarë partie nga radhët e punëtorëve, kooperativistëve në prodhim dhe nëpunësve, gjatë kohës së stazhit të mos ngrihen në përgjegjësi më të larta e të mos çohen në punë më të lehta nga ato që kanë pasur kur janë pranuar në Parti.

4. — Koha e punës drejtpërdrejt në prodhim gjatë stazhit nga kandidatët për anëtarë partie që vijnë nga radhët e nëpunësve, të jetë 6-12 muaj. Në realizimin e saj të vepohet sipas këtyre kritereve më kryesore:

a. — Mund të bëjnë 6 muaj punë drejtpërdrejt në prodhim kandidatët për anëtarë partie nga radhët e inteligjencies teknike, që në kohën e pranimit punojnë afër prodhimit, oficerët e nën-oficerët e Ushtrisë Popullore dhe të organeve të Punëve të Brendshme kur shërbejnë në batalion e poshtë, kandidatët nëpunës që çohen për ta bërë tërë kohën e stazhit nga qyteti në fshat ose në veprat e mëdha, drejtorët dhe kryeinxhinierët e ndërmarrjeve, kryetarët e kooperativave bujqësore dhe kryetarët e degëve të prodhimit në to.

— Të gjithë kandidatët e tjerë të bëjnë një vit punë drejtpërdrejt në prodhim.

b. — Në raste të veçanta mund të mos bëjnë fare punë drejtpërdrejt në prodhim kandidatët për anëtarë partie: oficerët që shërbejnë në batalion e poshtë, kur repartet kompletohen në mënyrë të ndjeshme me ushtarë aktivë; pilotët dhe teknikët e avionëve; oficerët e anijeve luftarake; oficerët e pikave dhe të postave të kufirit; mjekët kirurgë; ndonjë balerinë a këngëtar.

c. — Kandidatët për anëtarë partie nga radhët e studentëve, pas mbarimit të shkollës, të bëjnë jo më pak se 3-4 muaj punë drejtpërdrejt në prodhim për çdo vit të stazhit që u mbetet deri në pranimin anëtar partie.

d. — Koha e punës drejtpërdrejt në prodhim gjatë stazhit të kandidatit për anëtar partie të kryhet në ndërmarrje e kooperativa bujqësore, në punë me normë dhe në këtë rast shpërblimi të bëhet sipas punës. Ajo, zakonisht, të kryhet pandërprerë, por dhe në raste të veçanta asnjëherë më pak se 6 muaj radhazi.

— Kandidatët për anëtarë partie nga radhët e oficerëve dhe nënoficerëve të Ushtrisë Popullore kohën e punës drejtpërdrejt në prodhim ta kryejnë tok me ushtarët në punimet mbrojtëse e fortifikuese. Të njihet e vlefshme si punë drejtpërdrejt në prodhim edhe koha e pjesëmarrjes së tyre në stërvitje me trupa, kur shërbejnë në reparte që kompletohen në mënyrë të ndjeshme me ushtarë aktivë, si dhe caktimi me shërbim në reparte e nënreparte ushtarake ku të flenë e të hanë bashkë me ushtarët.

e. — Gjatë kohës së punës në prodhim kandidatët për anëtarë partie jetën e Partisë ta kryejnë në organizatat-bazë ku kryejnë punën në prodhim. Ato, në këtë rast, t'i bëjnë kandidatit



karakteristikë për këtë periudhë, të cilën t'ia dërgojnë komitetit të Partisë.

5. — Koha e shërbimit ushtarak të ketë vlerë si kohë e njohjes në punë të përbashkët për efekt të pranimit në Parti. Në këtë rast të veprohet sipas këtyre kritereve:

a. — Të rinjtë ushtarë, të zgjedhur me kujdes e nga më të mirët, mund të pranohen kandidatë për anëtarë partie me rekomandime nga organizata e rinisë dhe komunistët e organizatës-bazë ku do të pranohen, të cilët ta njohin të rekomanduarin jo më pak se një vit në ushtri, ndërsa për kohën tjetër të njohjes deri tre vjet të merret karakteristikë dhe mendim nga organizata-bazë e Partisë që ka mbuluar sektorin ku ka punuar i riu para se të vinte ushtar.

— Të rinj të tillë, pasi të kenë kryer një vit shërbim ushtarak, mund të pranohen kandidatë për anëtarë partie edhe me rekomandime nga komunistët e organizatës-bazë të Partisë dhe të organizatës së rinisë ku kanë kryer shkollën e mesme.

b. — Të rinjtë më të mirë, kur mbarojnë shërbimin ushtarak, mbas jo më pak se një vit pune, mund të pranohen kandidatë për anëtar partie në ndërmarrje, kooperativa bujqësore e institucione me rekomandime nga organizata e rinisë dhe komunistë të organizatës-bazë të Partisë që mbulon sektorin e tyre të punës, ndërsa për kohën tjetër të njohjes deri tre vjet të merret karakteristikë dhe mendim nga organizata-bazë e Partisë që ka mbuluar repartin ku ka kryer shërbimin ushtarak.

Vendimi hyn në fuqi menjëherë. Për zbatimin e tij ngarkohen organet dhe organizatat-bazë të Partisë në rrethe, rajone e njësi ushtarake, si dhe aparati i Komitetit Qendror të Partisë.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## PROTOKOLL

### I SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH PËR DISA PROBLEME TË FORCIMIT TË LIDHJEVE E TË BASHKËPUNIMIT USHTRI — TERREN

10 qershor 1983

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 10 qershor 1983, mori në shqyrtim raportet e paraqitura nga komitetet e Partisë të reparteve ushtarake «N» të Gjirokastrës dhe të Elbasanit «Për punën e bërë për zbatimin e udhëzimit të Byrosë Politike për forcimin e lidhjeve ushtri-terren».

Nga raportet e paraqitura dhe nga diskutimet doli se organet dhe organizatat-bazë të Partisë në ushtri dhe në terren, në luftë për zbatimin e vendimeve të Kongresit të 8-të të Partisë, të plenumeve të kohëve të fundit të KQ dhe të mësimëve të shokut Enver Hoxha, kanë bërë një punë të mirë për forcimin e gatishmërisë dhe për përgatitjen luftarake të popullit ushtar. Lidhjet e bashkëpunimi ushtri-terren, si në rreth edhe në bazë, janë forcuar e janë zgjeruar më tej. Me punë të përbashkët janë përballuar me sukses detyrat që kanë shtruar Komiteti Qendror i Partisë dhe Këshilli i Mbrojtjes për forcimin e pandërprerë të ushtrisë e të aftësisë mbrojtëse të vendit.

Puna politike dhe ideologjike e Partisë, lufta për zbatimin në praktikë të udhëzimit të Byrosë Politike për lidhjet dhe bashkëpunimin ushtri-terren, kanë bërë të mundur që te komunistët, te kuadrot dhe në masat punonjëse të krijohet një opinion më i shëndoshë për problemet e mbrojtjes, të ketë një shkallë njohjeje më të gjerë, vlerësim e interesim më të madh për këto probleme. Çështjet e përgatitjes ushtarake të popullit ushtar, të forcimit të gatishmërisë luftarake të rrethit, të ndërmarrjeve, të kooperativave bujqësore dhe të institucioneve po zënë gjithnjë e më mirë vendin e duhur në jetën e organeve e të organizatave-bazë të Partisë, organeve të pushtetit, të ekonomisë dhe të organizatave të masave. Si rezultat, stërvitja ushtarake e të gjitha strukturave në shkollat e lira dhe në repartet ushtarake është

përsosur më tej, gatishmëria luftarake është forcuar, kuadrot dhe repartet aktive të ushtrisë po lidhen më mirë dhe njohin më nga afër problemet e zhvillimit ekonomik-shoqëror të rrethit dhe të zonës ku janë vendosur.

Puna e bërë dhe rezultatet e arritura vërtetojnë plotësisht drejtësinë e direktivave dhe të orientimeve të Partisë për forcimin e lidhjeve e të bashkëpunimit ushtri-terren. Por organet dhe organizatat-bazë të Partisë duhet të bëjnë një punë akoma më të madhe që këto lidhje të mos kuptohen e të mos zbatohen si çështje thjesht organizative, që kanë të bëjnë vetëm me kontaktet individuale midis kuadrove, me koordinimin e aktiviteteve të përbashkëta dhe me informimet reciproke. Lidhjet ushtri-terren burojnë nga vetë karakteri popullor i ushtrisë dhe i mbrojtjes sonë, prandaj forcimi e përsosja e mëtejshme e tyre duhen parë të lidhura ngushtë me realizimin e detyrave që shtrohen për rritjen e aftësisë luftarake të strukturave të mbrojtjes, për forcimin e pandërprerë të gatishmërisë dhe për revolucionarizimin e stërvitjes ushtarake të të gjithë popullit.

Në këtë drejtim, me gjithë punën e mirë dhe rezultatet pozitive që janë arritur, është e nevojshme që lidhjet e bashkëpunimi ushtri-terren të forcohen më shumë për problemet kryesore të gatishmërisë luftarake e të stërvitjes së të gjitha strukturave, me qëllim që të kapërcehen sa më parë boshllëqet dhe dobësitë që ende vihen re në këto çështje.

Kujdes më i madh të tregohet për rritjen e cilësisë së përgatitjes ushtarake e sidomos të stërvitjes së vogël. Ajo të vihet më mirë nën drejtimin e nën kontrollin e organeve dhe të organizatave-bazë të Partisë, të komandave e shtabeve në njësitë e repartet e ushtrisë. Të përsoset më tej puna për hartimin e programeve të stërvitjes dhe për zbatimin e tyre, me qëllim që ato t'u përgjigjen sa më mirë nivelit të strukturave dhe detyrave gjithnjë në rritje. Ministria e Mbrojtjes Popullore dhe komandat e njëjësive ushtarake të bëjnë një punë sa më të studiuar e shkencore në hartimin e programeve të përgatitjes politiko-luftarake të strukturave, duke mbajtur parasysh nivelin arsimor dhe aftësitë ushtarake që fitojnë kontingjentet në shkollat e mesme, të larta, si dhe gjatë stërvitjeve disavjeçare, si: ushtarë, rezervistë, vullnetarë e paraushtarakë. Në këtë mënyrë programet do të jenë të shkallëzuara e të diferencuara, me vite shërbimi, të vijnë gjithnjë në ngjitje, duke shmangur kështu përsëritjet e panevojshme dhe monotoninë.

Organet dhe organizatat-bazë të Partisë duhet t'i kushtojnë kujdes të veçantë zhvillimit të stërvitjeve ushtarake në kushte sa më të përafërta me ato të luftës. Të punohet që të njihen sa më mirë kërkesat e Artit Ushtarak të Luftës Popullore, terreni, armët në përdorim, armiqet tanë të mundshëm dhe çdo gjë që

u duhet kuadrove, ushtarëve, vullnetarëve, nxënësve dhe studentëve për t'u përgatitur sa më mirë ushtarakisht. T'i jepet më shumë përparësi përgatitjes taktike të ushtarit, të skuadrës, të togës e të kompanisë dhe të konsiderohet ajo sintezë e të gjitha llojeve të tjera të përgatitjes luftarake. Komunistët, kuadrot dhe gjithë efektivat e strukturave të mbrojtjes duhet ta kuptojnë e ta vlerësojnë stërvitjen taktike si një çështje komplekse e shkencore që kalit fizikun, zhvillon imagjinatën, nxit debatin për gjetjen e varianteve më të mundshme për sulm, për manovër, për mbrojtje, lufton monotoninë e shabllonizmin në stërvitje etj.

Organet e Partisë në ushtri e në terren, organet shtetërore dhe ekonomike, në bashkëpunim me komandat e njëjësive, të shtojnë më tej përpjekjet për kompletimin dhe për përsosjen e bazës materiale të nevojshme për stërvitje. Në mënyrë të veçantë të shtohet kujdesi për filialet e shkollave të lira ushtarake, në mënyrë që stërvitja ushtarake e gjithë popullit të bëhet sa më intensive, e larmishme dhe konkrete. Poligonet, fushat e stërvitjes dhe gjithë baza materiale që është në përdorim të ruhen, të mirëmbahen, të administrohen me kujdes, por edhe të perfeksionohen në përputhje me kërkesat e Artit Ushtarak të Luftës Popullore dhe të luftës së sotme moderne.

Forcimi i lidhjeve dhe i bashkëpunimit ushtri-terren të çojë në ngritjen e mëtejshme të nivelit të punës në shkollat e lira ushtarake, si qendra bazë të përgatitjes ushtarake të gjithë popullit. Organet dhe organizatat-bazë të Partisë të luftojnë çdo shfaqje nënvleftësimi që vihet re në disa raste ndaj këtyre shkollave. Të bëhen më shumë përpjekje nga komandat e njëjësive e të reparteve dhe ato të shkollave të lira për rritjen e rendimentit e të cilësisë së stërvitjes, për zbatimin pa lëshime e thjeshtime të programeve të përgatitjes politiko-luftarake. Koha e caktuar për stërvitjen e strukturave në Shkollën e Lirë Ushtarake është e mjaftueshme, prandaj të luftohet që ajo të shfrytëzohet me intensitet dhe efektivitet.

Programi i stërvitjes për çdo shkollë të lirë duhet të hartohet dhe të zbatohet sipas kushteve e nevojave që kanë strukturat. Me rezervistët e vullnetarët t'i jepet përparësi anës praktike të zhvillimit të stërvitjes, pa nënvleftësuar atje ku duhet edhe anën teorike-metodike. Kujdes kërkojnë përgatitja dhe aftësimi i pandërprerë i kuadrove rezervistë e vullnetarë, me qëllim që ata të zotërojnë në perfeksion armët e teknikën dhe të jenë në gjendje të drejtojnë e të komandojnë me përpikëri repartet dhe nënrepartet ku janë caktuar.

Kuadrot aktivë të shkollave të lira, të njëjësive e të reparteve ushtarake duhet ta kuptojnë mirë se në problemet e përgatitjes ushtarake të popullit kanë detyrën dhe përgjegjësinë kryesore. Prandaj të luftohen shfaqjet e njëanshmërisë e të shkarkimit të

përgjegjësisë që vihen re në ato raste kur vëmendja e tyre përqendrohet vetëm tek ushtarët e rinj të shërbimit aktiv, duke hequr kujdesin për ushtarët e vitit të dytë, për rezervistët, për vullnetarët, apo edhe shërbimin e rojave operative në fshatra e qendra pune. Kuadrot e Partisë, të pushtetit e të ekonomisë në terren kanë detyrat e tyre për mbrojtjen dhe për ushtrinë, të cilat duhet t'i kryejnë më mirë e të ndikojnë më efektivisht në bashkëpunim të ngushtë me kuadrot e njësive dhe të reparteve ushtarake.

**Organet dhe organizatat-bazë të Partisë në ushtri të forcojnë kontrollin e kërkesën e llogarisë ndaj komandave dhe kuadrove aktivë, që ata kurdoherë të jenë në krye të detyrave që u ka caktuar Partia.** Ato të ndiejnë më shumë përgjegjësi për problemet e stërvitjes e të gatishmërisë të njësive, të reparteve dhe të gjithë strukturave të mbrojtjes, sepse e kanë të vetmin objekt kryesor të punës së tyre. Të mbahet parasysh fakti se organet e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë në terren merren me një mori problemesh të shumëllojshme, politiko-ideologjike, ekonomiko-shoqërore, zgjidhja e drejtë e të cilave siguron mbrojtjen, forcon ushtrinë, gjendjen ekonomike, politike e kulturore të popullit tonë. Organizatat e Partisë, komandat dhe kuadrot në ushtri i njohin në hollësi problemet e mbrojtjes, prandaj të luftojnë për të siguruar vazhdimisht angazhimin e shokëve të terrenit në problemet kryesore të stërvitjes e të gatishmërisë, të lidhen më mirë me ndërmarrjet, me kooperativat bujqësore, me institucionet e t'u ngrënë ato çështje që preokupojnë, jo për të ndarë përgjegjësinë, por për t'i zgjidhur bashkërisht. Të nxiten dhe të inkurajohen shembujt e mjaft kuadrove të ushtrisë që dinë të komunikojnë e t'i zgjidhin drejt problemet e njësive e të reparteve në bashkëpunim të ngushtë me organizatat-bazë të Partisë dhe me kuadrot e terrenit. Të bëhet kudo si rregull praktika që përdorin këta kuadro që, pas zhvillimit të stërvitjeve apo prova-ve të gatishmërisë, informojnë organizatat-bazë të Partisë dhe kolektivat punonjës për rezultatet që arritën punonjësit e tyre dhe për problemet që mbeten për t'u zgjidhur në të ardhmen. Në këtë drejtim të shfrytëzohen më mirë avantazhet që ka krijuar ngri-tja e shkollave të lira ushtarake si hallka të rëndësishme për forcimin e mëtejshëm të lidhjeve e të bashkëpunimit ushtri-terren.

**Me punën e madhe që ka bërë Partia, tani komitetet, byrotë dhe organizatat-bazë të Partisë në terren merren më mirë dhe më konkretisht me problemet e ushtrisë e të mbrojtjes. Megjithatë interesimi i tyre për këto probleme duhet të jetë i vazhdueshëm.** Për këtë qëllim të shfrytëzohen të gjitha rrugët e mundësitë për t'i njohur e për t'i zotëruar sa më mirë problemet ushtarake, si analizat, informacionet nga njësitë, repartet dhe shkollat e lira ushtarake, veprimtarinë e komunistëve që zgjidhen në

forumet e Partisë në ushtri, komitetet e Partisë të shkollave të lira ushtarake etj.

Edhe në të ardhmen organet dhe organizatat-bazë të Partisë në terren duhet t'i trajtojnë me iniciativë problemet e mbrojtjes, por tematika e këtyre çështjeve të jetë e studiuar, e lidhur ngushtë me stërvitjen dhe me gatishmërinë luftarake, të dalë nga nevojat e nga shqetësimet që kanë vetë rrethet apo njësitë ushtarake dhe të përgatiten ato me kujdes, në mënyrë që ta çojnë punën përpara. Detyrat që nxjerrin forumet e Partisë në rreth nga këto analiza jo vetëm t'u dërgohen organizatave të Partisë në ushtri dhe shkollave të lira ushtarake, por zbatimi i tyre të ndiqet e të kontrollohet në rrugë e në forma të ndryshme.

Organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organet e pushtetit, të ekonomisë dhe organizatat e masave të vlerësojnë më mirë problemet e stërvitjes e të gatishmërisë luftarake që u ngrënë organizatat e Partisë, komandat dhe kuadrot e ushtrisë dhe të marrin masa për zgjidhjen në kohë të çështjeve që varen prej tyre. Ato të ndihmojnë më shumë edhe për përgatitjen fizike të të gjithë popullit, e sidomos të rinisë, për ruajtjen e për mirëmbajtjen e teknikës, armatimit dhe të vlerave materiale që kanë rezervistët në përdorim, si dhe për të luftuar ato shfaqje e koncepte të luaja që manifestojnë disa kuadro, ushtarë, rezervistë e vullnetarë gjatë ditëve të stërvitjes në Shkollën e Lirë Ushtarake.

Kujdes i veçantë t'i kushtohet rritjes së efektivitetit të punës të organizatave të rinisë për edukimin atdhetar e revolucionar dhe për kalitjen e mëtejshme fiziko-ushtarake të rinisë. Të nxiten dhe të inkurajohen nismat e lëvizjet revolucionare të rinisë, që synojnë njohjen në perfeksion të teknikës e të armatimit, studimin dhe zbatimin me krijimtari të kërkesave të Artit Ushtarak të Luftës Popullore, njohjen e terrenit dhe të traditave luftarake të popullit tonë etj. Organizatat e Partisë në ushtri t'i qëndrojnë më afër dhe të vlerësojnë më mirë organizatën e rinisë, si organizata më masive në njësi e reparte, për vetë rolin e rëndësishëm që ajo luan në përsosjen e përgatitjes dhe të gatishmërisë luftarake.

Komitetet e Partisë të rretheve, veç punës që bëjnë me komunistët, me kuadrot dhe me forumet e Partisë e të levave të saj për njohjen e zberthimin e vijës ushtarake të Partisë, të kujdesen për aftësimin e mëtejshëm të instruktorëve të sektorit ushtarak, si kuadro të specializuar për problemet e mbrojtjes, me qëllim që të zotërojnë si duhet vijën ushtarake të Partisë, Artin Ushtarak të Luftës Popullore dhe problemet e stërvitjes e të gatishmërisë ushtarake të njësive, të reparteve dhe të strukturave të tjera të mbrojtjes. Në këtë mënyrë, ata do të jenë në gjendje të ngrënë probleme kryesore para forumeve të Partisë, levave të saj e aparateve të tyre dhe t'u japin një ndihmë efektive organizata-



ve-bazë të Partisë, njësave, reparteve dhe shkollave të lira ushtarake.

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH shpreh bindjen se organet dhe organizatat-bazë të Partisë në ushtri dhe në terren, organet shtetërore, ekonomike, organizatat e masave, komandat ushtarake të njësave dhe të reparteve, në bazë të detyrave që shtrohen në këtë protokoll, do të marrin të gjitha masat e nevojshme për t'i forcuar e për t'i përsosur vazhdimisht lidhjet e bashkëpunimin ushtri-terren, me qëllim që të ngrihen në një shkallë më të lartë përgatitja dhe gatishmëria luftarake e popullit dhe të fuqizohet më tej aftësia mbrojtëse e atdheut tonë socialist.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

*Simon Stefani*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**V E N D I M**  
**I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR MASAT QË DUHEN MARRË PËR VËNIEN NË BAZA MË SHKENCORE TË SEKTORIT TË BLEGTORISË**

15 shtator 1983

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë, në mbledhjen e datës 15 shtator 1983 shqyrtoi raportin e paraqitur nga Ministria e Bujqësisë «Për punën e bërë dhe detyrat që dalin për vënien në baza më shkencore të sektorit të blegtorisë», dhe, pasi diskutoi gjerësisht për gjendjen dhe detyrat për zhvillimin me ritme më të shpejta të saj,

*V e n d o s i :*

1. — Organet dhe organizatat-bazë të Partisë, Ministria e Bujqësisë, institucionet kërkimore e shkencore dhe ekonomitë bujqësore të intensifikojnë më tej punën me njerëzit për një kuptim më të drejtë e vlerësim më të madh se deri tani të blegtorisë.
2. — Organet shtetërore dhe ekonomike në punën për zhvillimin e blegtorisë, të mbajnë parasysh që të ecin si me shtimin numerik të krerëve, ashtu dhe në drejtim të rritjes së rendimenteve blegtorale. Në këtë drejtim të tregohet kujdes për rritjen e pjellorisë së bagëtive, për ruajtjen dhe mirërritjen e të vegjëlve dhe disiplinimin e skartimeve.
3. — Të vazhdojnë të zbatohen metoda të reja për shpejtimin e përmirësimit racor të të gjitha llojeve të kafshëve. Ministria e Bujqësisë dhe institucionet e saj kërkimore e shkencore të përcaktojnë, brenda vitit 1984, shtrirjen e përbërjes racore dhe të rajonizimit për të gjitha llojet e kafshëve, sipas zonave, rretheve dhe ekonomive. Të mbahet parasysh që, deri në vitin 1990, të arrihet mbi 90 për qind përmirësimi racor i gjedhit e i dhenve në shkallë republike. Gjithashtu, të merren masa më të shpejta dhe më të efektshme për shpejtimin e përmirësimit racor të de-

rrave e të shpendëve, të cilët duhet të kenë përparësi dhe në strukturën e prodhimit të mishit.

4. — Shtimi i prodhimeve blegtorale dhe përmirësimi racor i blegtorisë, të mbështeten në bilance të bazës ushqimore në përputhje e në përshtatje me llojet dhe me teknologjitë e reja të të ushqyerit.

Për këtë qëllim të përmirësohet struktura e kulturave foragjere dhe të rritet rendimenti i tyre sipas detyrave që caktoi Kongresi i 8-të i Partisë. T'u jepet përparësi kulturave leguminoze për sigurimin e proteinave, misrit për silazh e koncentre dhe kulturave livadhore. Njëkohësisht të merren masa që, brenda vitit 1985, për këto kultura të sigurohen farna me kapacitet të lartë prodhues dhe në sasi të mjaftueshme.

Të merren masa për përmirësimin rrënjësor të kullotave natyrore. Brenda vitit 1985, të përfundojë projektimi në disa masive kryesore kullosore të vendit dhe të arrihet që, në vitin 1990, të dyfishohet aftësia kullosore e tyre.

Institucionet kërkimore-shkencore të punojnë më me kujdes për përmirësimin e mëtejshëm të teknologjisë së të ushqyerit për llojet e ndryshme të kafshëve dhe të organizojnë ndihmën e kontrollin në të gjitha ekonomitë bujqësore për zbatimin e tyre.

5. — Ministria e Bujqësisë të përcaktojë dhe të marrë masa për sigurimin e prodhimit të ushqimeve të industrializuara të blegtorisë në nivelin që kërkon teknologjia e përparuar.

Për këtë qëllim industria mekanike të planifikojë e të realizojë prodhimin e pajisjeve e të makinerive për komplekset blegtorale, ndërsa industria e lehtë e ushqimore të marrë masa për shtimin e prodhimit të koncentreve nga mbetjet teknologjike, sipas kërkesave zooteknike dhe standardeve të përmirësuara.

6. — Ministria e Bujqësisë të programojë detyrat që dalin nga ky vendim dhe Këshilli i Ministrave të marrë masa për të ndjekur e për të kontrolluar zbatimin e tij.

7. — Ky vendim të punohet në organizatat e Partisë të sektorit të blegtorisë si dhe në ato që kanë lidhje me detyrat e tij.

Për ndjekjen dhe për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet aparati i Komitetit Qendror të Partisë.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## PLENUMI I 7-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 20-21 shtator 1983

### K O M U N I K A T Ë

#### E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Në datën 20 dhe 21 shtator 1983, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi i 7-të i Komitetit Qendror të PPSH, i cili mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Mbi gjendjen e ndërtimeve dhe problemet që dalin», mbajtur nga sekretari i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Vangjel Çërrava.*

*Pasi diskutoi gjerësisht rreth raportit të paraqitur dhe dëgjoi konkluzionet që bëri për këtë çështje kandidati i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave, shoku Besnik Bekteshi, Plenumi i Komitetit Qendror i miratoi këto njëzëri dhe mori vendimet përkatëse<sup>1</sup>.*

#### PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

1. Si pikë të dytë të rendit të ditës Plenumi dëgjoi edhe një raport «Mbi gjykimin e organizatës kundërrevolucionare puçiste, komplotiste dhe terroriste të kryesuar nga poliagjenti Mehmet Shehu e të tjerë». Lidhur me këtë çështje, në mbyllje të Plenumit, shoku Enver Hoxha mbajti një fjalim të rëndësishëm. (Shih: Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1982-1983», f. 365.)

## R A P O R T

### I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH «MBI GJENDJEN E NDËRTIMEVE DHE PROBLEMET QË DALIN»

20 shtator 1983

Shokë,

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë mendoi t'i paraqitë për diskutim mbledhjes së këtij Plenumi gjendjen e ndërtimeve dhe problemet që dalin tani dhe në të ardhmen në drejtim të rritjes së efektivitetit të ndërtimeve dhe të ngritjes së mëtejshme të nivelit shkencor dhe estetik të tyre.

Në politikën e investimeve themelore, që ka ndjekur e ndjek Partia, ndërtimet kanë zënë dhe do të vazhdojnë të zënë vendin kryesor, jo vetëm se për to përdoren 40-50 për qind e të gjitha fondeve të investimeve, por edhe për faktin se me to lidhen drejtpërdrejt e në një masë të madhe ritmet e zhvillimit të ekonomisë, rritja e pandërprerë e mirëqenies, efektiviteti i tyre, kursimi apo tejkalimi i kufijve materialë e financiarë të planifikuar për to etj. Prandaj, në kushtet kur gjithë veprat i projektojmë dhe i ndërtojmë plotësisht me forcat tona, duhet, si kurrë ndonjëherë, t'i realizojmë ato sipas orientimit të Partisë: «Më mirë, më shpejt e më lirë».

Populli ynë ka tradita të lashta e të mira në fushën e ndërtimeve. Ai i ka ruajtur dhe i ka zhvilluar ato në përputhje edhe me kushtet politiko-shoqërore të vendit. Vendi ynë, vetëm në vitet e Partisë dhe nën kujdesin e drejtpërdrejtë të saj, u kthye në një kantier të vërtetë ndërtimi. Ky zhvillim në fushën e ndërtimeve i ka ndryshuar faqen atdheut tonë, e ka bërë atë të fuqishëm, të beгатë dhe më të bukur.

Me gjithë vështirësitë që janë ndeshur, ndërtimet tona kanë ecur me ritme të larta dhe u janë përgjigjur mirë programeve të Partisë për zhvillimin ekonomiko-shoqëror e kulturor të vendit dhe për mbrojtjen e atdheut.

Por detyrat e rëndësishme që shtroi Kongresi i 8-të i Partisë në fushën e ndërtimeve, perspektivat e reja që hapen me planin e tetë pesëvjeçar e bëjnë të domosdoshëm kapërcimin e disa mangësive dhe të metave që janë vërtetuar. Këndej rrjedh dhe nevoja për ta diskutuar këtë çështje në këtë mbledhje të Plenumit.

### I. Të ngrihet niveli shkencor e teknik i punës studimore për planifikimin dhe për projektimin e çdo vepre që ndërtojmë

Dihet që ndërtimet, nga njëri pesëvjeçar në tjetrin, kanë ecur me ritme të larta dhe janë realizuar përparime të dukshme, si në studimin e projektimin, ashtu dhe në zbatimin e në mirëmbajtjen e tyre. Këto përparime i shohim jo vetëm nga përmasat dhe nga vëllimet e ndërtimeve, por edhe nga niveli teknik e shkencor, funksional dhe ideoestetik i tyre. Fakti është se studimet nga njëra vepër në tjetrën janë bërë më të thelluara, projektimet më të plota, niveli i organizimit dhe i drejtimit shkencor e teknik është rritur e është zgjeruar etj. Sot ndërtuesit tanë projektojnë dhe realizojnë vepra të mëdha e të ndërlikuara, të bukura e dinjitoze, ku mishërohen hapat tanë të mëdhenj të zhvillimit ekonomiko-shoqëror, si në qytet, ashtu dhe në fshat. Nga godinat njëkatëshe të viteve të para të Çlirimit, nga punishtet e vogla dhe kanalet e thjeshta bonifikuese, sot ndërtojmë hidrocentrale të fuqishme, uzina e kombinatet të mëdha, komplekse të tëra urbanistike, vepra të rëndësishme bonifikuese e prodhuese në bujqësi, hekurudha e porte, rrugë e ura, vepra mbrojtëse etj., etj., që janë të niveleve të përparuara.

Këto tregojnë qartë për punën e madhe dhe të kujdesshme të punëtorëve, të kuadrove dhe të specialistëve të ndërtimit në të gjitha degët e ekonomisë, për kujdesin e vazhdueshëm të Partisë për ta çuar përpara ndërtimin në të gjitha fushat. Në këtë drejtim ka dhe disa probleme që lidhen jo vetëm me vështirësitë e rritjes dhe me ndonjë mungesë objektive, por edhe me punën e pamjaftueshme në fushën e planifikimit, të studimeve e të projekteve, të organizimit e të drejtimit të ndërtimeve, pra, në të gjitha degët e ekonomisë, që kanë ndikuar negativisht në mjaft tregues të planit. Komiteti Qendror kërkon që t'u qepemi me forcë këtyre të metave subjektive, për t'i kapërcyer në një kohë sa më të shkurtër.

Vëllimi i investimeve dhe i ndërtimeve të parashikuara në këtë pesëvjeçar, sikurse e theksoi Kongresi i 8-të i Partisë, është i barabartë me vëllimin e atyreve që kemi realizuar për katër



pesëvjeçarët, të marrë së bashku (për vitet 1951-1970) ose rreth një e katërta më shumë se në pesëvjeçarin e kaluar, ku përfshihen mbi 350 vepra të rëndësishme të sferës prodhuese. Ky vëllim kaq i madh i ndërtimeve kërkon dhe një angazhim po kaq të madh të punonjësve të ndërtimit dhe të vetë investuesve me komunistët në krye.

Për çdo vepër që planifikojmë dhe në veçanti për ato prodhueset, zanafilla e këtij kujdesi është puna konkrete studimore për planifikimin dhe për projektimin e saj. Në këtë drejtim janë bërë hapa përpara. Organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike, punonjësit dhe specialistët e fushave të ndryshme janë përpjekur dhe përpiqen që këto t'i vënë gjithmonë e më mirë në baza shkencore, t'i ngrenë nga ana teknike dhe ekonomike për t'iu përgjigjur sa më mirë kushteve dhe situatave konkrete të vendit. Për t'u shënuar është fakti se, ashtu si në vitet 60-të, kur revizionistët sovjetikë likuiduan një sërë projektesh e studimesh për veprat e planifikuara dhe në ndërtim e sipër, po kështu edhe pas vitit 1978, kur revizionistët kinezë, në përmasa akoma më të mëdha, përsëritën të njëjtën gjë, kuadrot, punëtorët e specialistët tanë i vunë gjoksën punës dhe e treguan veten të vendosur e të aftë për të bërë pluhur e hi planet djallëzore të tyre. Ata e çuan në vend fjalën e Partisë për vazhdimin e ndërtimeve me forcat tona, duke punuar me ritme akoma më të shpejta dhe me shpenzime më të pakta. Megjithëkëtë ne duhet të pranojmë se detyrat e shtruara në stadin e tanishëm të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës kërkojnë rritje të mëtejshme të nivelit të punës edhe në sektorin e ndërtimeve.

Partia dhe personalisht shoku Enver kanë theksuar vazhdimisht se për investimet e ndërtimet duhet bërë kujdes i veçantë qysh në studimet fillestare, për t'i përfshirë ato në planet periodike, deri te llogaritjet e hollësishme për teknologjinë dhe prodhimin e makinerive, për projektimin, ndërtimin dhe për vënien në shfrytëzim të plotë të tyre. Por, me gjithë përmirësimet e bëra, akoma nuk është arritur të zbatohen plotësisht kudo dhe për çdo vepër këto orientime dhe mësimet të rëndësishme; kemi pasur edhe vepra që planifikohen e ndërtohen me studime e llogaritje jo të plota, me projekte të pjesshme etj. Përvoja jo e mirë e planifikimit dhe e ngritjes së veprave të tilla, si Fabrika e Përpunimit të Felspateve në Lavrushk, e prodhimit të nikel-silikatit në Korçë, e peletizimit të pluhurave të mineralit të bakrit në Kukës etj., flasin për mungesa e cektësi në studimet që bëjnë sidomos investuesit.

Komitetit Qendror i tërheq vëmendjen fakti që, në disa raste, dikasteret investuese dhe rrethet apo ndërmarrjet në bazë nuk i kuptojnë sa duhet në thelb detyrën dhe përgjegjësinë që kanë ato për studime të thelluara teknike dhe ekonomike

për çdo vepër të planifikuar. Praktika ka treguar se ka raste që ato bëhen të shpejtuara vetëm sa për të argumentuar futjen e tyre në plan. Investuesi, na mëson shoku Enver, për çdo vepër që ndërtojmë është figura qendrore jo vetëm në planifikimin e saj, por dhe për detyrat e projektimit që cakton, për fondet që investon, për ndjekjen dhe kontrollin e projektimit, të zbatimit e të përfundimit të veprës. Ai mban përgjegjësi të plotë para Partisë dhe organeve shtetërore dhe duhet të përgjigjet deri në fund për ngritjen dhe për vënien në shfrytëzim të veprës, për arritjen e treguesve tekniko-ekonomikë të saj dhe për efektivitetin e lartë e vetëshlyerjen e investimeve që bëjmë.

**Kjo duhet kuptuar thellë nga të gjithë.**

Megjithëse është theksuar disa herë që çdo studim duhet të zgjidhë në tërësinë e tij domosdoshmërinë dhe leverdinë ekonomike të ndërtimit të veprës, problemet që lidhen me sigurimin e lëndës së parë, të lëndëve energjetike, të ujit, të fuqisë punëtore, të teknologjisë që do të zbatohet, problemet e trajtimit, të ruajtjes e të shpërndarjes së prodhimeve të gatshme, të ruajtjes së mjedisit, të sigurimit teknik dhe deri te lidhjet me rrugë e linja hekurudhore, perspektivën e zgjerimit etj., prapë ka raste, kur investuesit, të prirur nga nevoja për të kapërcyer ndonjë vështirësi të çastit, sidomos ato që kanë të bëjnë me fondet dhe me realizimin e tyre në kohë, nuk i zgjidhin si duhet çështje të tilla të rëndësishme.

**Studimet duhet t'i nënshtrohen një diskutimi të thellë në rrethe specialistësh, punëtorësh etj.,** ku të dalin qartë anët pozitive e negative të çdo varianti, në mënyrë që oponenca dhe kritika, të cilat, gjithashtu, duhet të organizohen e të bëhen më mirë, të arrijnë në variantin optimal. Prandaj, dikasteret investuese, rrethet dhe ekonomitë që planifikojnë këto vepra medoemos duhet t'i mënjanojnë sa më parë këto mangësi, të aktivizojnë dhe të angazhojnë në këto studime, për kohën e duhur, punonjësit më të aftë e më të mirë, njerëzit që i njohin mirë problemet shkencore, teknologjike dhe ekonomiko-financiare.

Sikurse jeni në dijeni, Byroja Politike e Komitetit Qendror miratoi kohët e fundit një program të gjerë studimesh për të përgatitur pesëvjeçarin e tetë. Një pjesë e mirë e tyre do të konkretizohet me propozime për ngritjen e veprave prodhuese, të shërbimit dhe socialkulturore. Ky është një aksion i rëndësishëm, ku do të tërhiqet në formë të organizuar mendimi krijues e shkencor i masave dhe sidomos i instituteve studimore e projektuese. Çështja shtrohet që këto studime të bëhen me një nivel shkencor të kohës, të kenë gjerësinë dhe kompleksitetin e duhur dhe t'u përgjigjen politikës së Partisë në fushën përkatëse, ritmeve të zhvillimit tonë ekonomiko-shoqëror dhe kushteve e situatave, në të cilat jetojmë.

Kur objektet e reja studiohen dhe argumentohen shkencërisht, planifikimi i tyre u hap rrugë proceseve të tjera studimore, që përfshijnë studimet urbanistike, gjeologo-gjeodezike, ekologjike, demografike, sociologjike, të përgatitjes së kuadrit etj., të cilat, gjithashtu, duhet të jenë më të thelluara e në baza shkencore.

Me kryerjen e studimeve dhe me përfshirjen në projektplan të veprave, puna e investuesit kalon në fazën e hartimit të detyrave të projektimit, të cilat, në thelb, sintetizojnë kërkesat për anën ndërtimore të zbatimit të saktë e të plotë të studimit të kryer. Kjo fazë, që është po aq me përgjegjësi sa dhe vetë studimi, nuk lejon pasaktësi e cungime. Mirëpo edhe këtu praktika tregon se për disa vepra që ndërtojmë, detyrat e projektimit hartohen me mungesa. Nuk janë të pakta rastet që, pa filluar mirë të ndërtohet vepra, dhe aq më keq kur ajo ka hedhur shtat, bëhen sugjerime e ndryshime, shtojca, zgjerime për boshllëqe e mangësi në detyrat e projektimit që jo vetëm vonojnë vënien e veprës në shfrytëzim, por dhe rritin fondet e investimeve e të ndërtimeve, siç ka vepruar Ministria e Industrisë dhe e Minierave për Fabrikën e Pasurimit të Bakrit në Repe, për uzinën «Dinamo», për impiantin e pasurimit të kromit në Klos, për Uzinën e Sodës etj., gjë që ka ndryshuar disa herë detyrat e projektimit, si dhe ka rritur fondet përkatëse deri në dyfish.

Si për studimet, ashtu dhe për detyrat e projektimit, projektuesit e ndërtuesit, porosit shoku Enver, duhet t'u jepen në kohën e caktuar të dhëna të sakta e të plota për të bërë dhe ata një punë të saktë e të nivelit të lartë. Për asnjë rast nuk duhet pranuar planifikimi i objekteve të çfarëdolloji pa studime të plota, as edhe projektimi i tyre pa detyra të sakta projektimi dhe tej afateve të caktuara me ligj. Për pesëvjeçarin që vjen nuk lejohet të përsëritet situata që patëm në fund të vitit 1980, kur për më se 580 vepra të reja kufi, që parashikoheshin për planin e shtatë pesëvjeçar, nuk ishin hartuar akoma detyrat e projektimit për 36 për qind të tyre, ndërsa projektet e zbatimit dhe preventivat për afro 43 për qind.

Megjithëse ka vendim që të mos futet në plan asnjë objekt pa studimet e nevojshme dhe pa projektet e preventivat përkatës, pothuajse çdo vit Këshilli i Ministrave është detyruar të bëjë lëshime, sepse këto procese të domosdoshme janë zvarritur, janë nënvleftësuar e për më tepër kanë penguar fillimin në kohë të punimeve. Edhe për këtë vit janë futur në plan vepra kufi e nënkufi pa projekte e preventiva të plotë. Kësaj praktike i duhet dhënë fund dhe të vihen para përgjegjësish drejtuesit e specialistët që nuk i kryejnë në kohë e me cilësi të lartë këto detyra.

**Partia vazhdimisht ka theksuar se të gjitha studimet, detyrat e projektimit dhe vetë projektet e çdo veprë duhet të karakterizohen nga thjeshtësia e nga kursimi i fondeve të planifikuara, pra-**

ndaj të luftohet me forcë e vazhdimisht çdo prirje për teprime, për mbishpenzime e për kërkesa të fryra të njerëzve dorëlëshuar. Të gjithë investuesit, projektues e zbatues, duhet të shqetësohen kur shohin se me detyrat e projektimit apo në projektet e preventivat, që hartohen, del se kapërcëhen kufijtë e fondeve të planifikuara. Organet e organizatat e Partisë, organet e pushtetit e të ekonomisë, detyrimisht duhet të ndalen e të kërkojnë jo vetëm të respektohen fondet e planifikuara, por të mënjanojnë teprimet e të ri-studiohen mundësitë për uljen e shpenzimeve.

Lidhur me kursimin e fondeve të investimeve e të ndërtimit ndodh, në ndonjë rast, që bëhen dhe propozime e veprime të shtrembëra, kur nga projektet, dhe aq më tepër në zbatim të tyre, hiqen ose shkurtohen shpenzimet për përmirësimin e kushteve të punës dhe të sigurimit teknik. Fakti është se për këta dhjetë vjetët e fundit investimet e ndërtimet për këtë qëllim u realizuan 60 për qind, ndërsa këtë vit, pas kritikës së rreptë që bëri Sekretariati i Komitetit Qendror, prapë nuk u mendua drejt, sepse, për të realizuar porosinë që boshllëqet e krijuara të plotësohen sa më parë, dikasteret përkatëse të industrisë, të bujqësisë e të komunikacionit etj., në vend që të shkurtojnë nga fondet e investimet joproduuese, propozojnë t'i heqin këto fonde nga reparte e nyje produuese, për të cilat u shfaqën të një mendimi edhe Komisioni i Planit të Shtetit dhe Ministria e Financave. Prandaj organizatat e Partisë të analizojnë shkaqet e kërkesave të fryra apo shkurtimeve pa vend, të mbajnë qëndrim ndaj atyre që nuk kuptojnë e nuk zbatojnë porosinë e Partisë për ta kaluar «nëpër vrimë të gjilpërës» çdo shpenzim që bëjmë për investimet e ndërtimet.

Projektimi i çdo veprë, duke përfshirë dhe preventivin e saj, përbën hallkën kryesore për uljen e shpenzimeve të ndërtimit, prandaj kërkohet që për çdo projekt të bëhet një punë e thelluar studimore e krijuese dhe me ndjenjë të lartë përgjegjësie.

Projektuesve u vihet detyrë që asnjëherë të mos e shkëpusin punën e tyre studimore e projektuese nga efektiviteti ekonomik, nga shpenzimet materiale e monetare. Është kjo arsyeja që projektuesi ynë, qoftë ky teknolog, arkitekt, konstruktor, ndërtues apo specialist, për punimet e tjera inxhinierike, medoemos duhet të njohë kriteret bazë të llogaritjes së kostos, të leverdishmërisë dhe të efektivitetit e të vetëshlyerjes së veprës që projekton, të futet në anën ekonomiko-financiare dhe, në bashkëpunim me ekonomistët, të sigurojë kursim sa më të madh pa dëmtuar anën funksionale e teknologjike, anën estetike dhe të kushteve të punës.

Mbi bazën e projektdeyrave dhe të studimeve të shesheve të ndërtimit, të sigurimit të materialeve të ndërtimit e të dhënave të tjera të domosdoshme, për projektimin e veprës hartohet në disa variante projektideja e saj që detyrimisht duhet t'i nënshtro-



het diskutimit të specialistëve e punëtorëve, investuesve, projektuesve e zbatuesve, duke përfshirë këtu dhe ekonomistët, për të zgjedhur variantin më të mirë dhe për të parë rrugë dhe mundësi të tjera për të ulur shpenzimet e ndërtimit të saj. Mirëpo në disa raste nuk veprohet kështu. Projektideja nuk i nënshtrohet një kritike të thellë, të dhënat e studimet që e mbështetin atë, gjithashtu, nuk verifikohen e nuk ballafaqohen kurdoherë me orientimet, me normativat e kriteret e caktuara, por merret një mendim e miratim i shpejtuar dhe formal i investuesit ose drejtuesit të projektit, në bazë të të cilit fillon puna e projektit përfundimtar. Kështu ndodhi në Hidrocentralin e Komanit, ku u desh të bëjmë shpenzime suplementare, sepse të dhënat gjeologjike nuk kishin bazë të mjaftueshme shkencore, ose në tunelin e Qafëthanës, në Gurin e Kuq në Pogradec, në baterinë e koksit në Elbasan. Këto veprime, me dëme ekonomike e financiare, kanë ndodhur edhe ngaqë Ministria e Ndërtimit ka lënë pas dore shërbimin gjeologjik, prandaj ajo duhet të marrë të gjitha masat e nevojshme për forcimin e punës dhe të cilësisë së studimeve gjeologjike të veprave që ndërtojmë.

**Përgatitja e projekteve të zbatimit** përbën hallkën e fundit të punës studimore, sepse vetë projekti është fryt i një pune kërkimore, studimore e projektuese. Prandaj projektuesit duhet të kërkojnë e të futin metodat më të përparuara të projektimit e të llogaritjeve bashkëkohore, të vërtetuara jo vetëm nga praktika jonë, por edhe nga ajo botërore, siç janë, për shembull, llogaritjet e konstruksioneve nëntokësore apo në hapësirë me metodën e gjendjes kufitare, me ndikimin e kohës në rritjen e markës së betoneve, në llogaritjet e betoneve të armuara apo metodat e reja statistikore krahasuese në studimet gjeologjike e inxhinierike etj., etj. Në të njëjtën kohë, duke u mbështetur në përdorimin e materialeve të vendit, që janë të lehta e të bukura, në përdorimin e parafabrikateve, në radhë të parë, duhet të tërhiqet gjerësisht mendimi krijues i masave, sidomos i ndërtuesve zbatues që verifikojnë në praktikë studimet e përlllogaritjet e projekteve.

Fakti është se puna projektuese nga viti në vit ka shënuar rritje të nivelit shkencor. Projektuesit tanë, që tani janë me qindra, kanë përballuar detyra të rëndësishme, si projektimin e hidrocentraleve të fuqishme, të kombinatave e të fabrikave të mëdha, të veprave ujore e socialkulturore etj., të arrira, si nga ana konstruktivo-inxhinierike e funksionale, po ashtu dhe nga ajo ekonomike dhe estetike dhe që tregojnë qartë nivelin dhe mundësitë që kemi arritur. Ky është rezultat i një pune të gjerë e të vazhdueshme që ka bërë Partia për përgatitjen, kualifikimin dhe kalitjen e tyre, i mobilizimit dhe i vullnetit të vetë projektuesve, si dhe i luftës së pareshtur të organizatave-bazë të Par-

tisë të institucioneve studimore projektuese për të rritur nivelin ideologjik e shkencor të tyre.

Por detyrat më të mëdha që na vihen përpara, kërkesat cilësore e teknike më të larta që na shtrohen, si dhe mangësitë e vërtetuara kërkojnë që e gjithë kjo punë të kontrollohet nga ana teknike dhe ekonomike për të mënjeluar një herë e mirë gjithçka që nuk u përgjigjet kohës dhe kërkesave që shtrohen. Nuk mund të pranohet më që, për të qenë brenda e për të mos na dalë telashe, të projektojmë me rezerva në konstruksione, që, për mungesë të materialeve të mira e të parashikuara, të përdoren të tjera që rritin vlerën e veprës.

Nuk është e drejtë të futim kudo betonin e armuar, kur as ana funksionale e teknologjike nuk i kushtëzon llogaritjet inxhinierike. Ka ardhur koha që në projektet tona të gjejë zgjidhje racionale edhe sistemi i dherave, duke hequr dorë nga transportimi i tyre që rrit shpenzimet.

Për të rritur nivelin shkencor të punës projektuese, veç të tjerave, sot kërkohet që në institucionet e projektimit raporti studim-projektim të ndryshojë në favor të studimeve, të cilat sot zënë afërsisht 10 për qind të punës së tyre, si dhe raporti midis kuadrove me arsim të lartë me ata me arsim të mesëm, për të çliruar projektuesin nga puna e thjeshtë e kopjesit dhe disenjatorit. Në këto institucione, si dhe në zyrat e projektimit në rrethe, të bëhet një punë më e mirë dhe e programuar për studimin e thelluar të një sërë çështjesh që lidhen me standardizimin, modulimet, tipizimet e konstruksioneve, me futjen e matematikës llogaritëse, me përqendrimin e specializimin e grupeve projektuese, me përpunimin e kriterëve shkencore të metodikave të përparuara të punës projektuese, deri tek ulja e mëtejshme e afateve dhe e normativave në zbatim. Projektimi i veprave të mëdha e të vogla është një punë konkrete dhe dallohet, si për veçoritë që ka çdo vepër, ashtu dhe për kriteret e përbashkëta që ato kanë. Në këtë fushë çdo projektues, gjatë procesit të punës së tij, është e domosdoshme të sigurojë bashkëveprimin krijues jo vetëm me përvojën e fituar në shkallë vendi për projektim, por sidomos edhe me ekonomistët, me teknologët e me zbatuesit për të arritur në zgjidhjen më të mirë e më të lirë të veprës.

Në institutet tona të projektimit nuk duhet të ndërpritet puna për studimin e vazhdueshëm të kushteve teknike, të manualeve, të normativave të projektimit, të tipizimeve e të standardizimeve të parafabrikateve, në të cilat fshihen akoma rezerva. Ato duhen rishikuar në çdo pesëvjeçar dhe duhen përsosur si elemente bazë të projektimit. Në këtë punë, veç studimeve dhe eksperimentimeve shkencore, që duhet të bëjnë vetë institutet kërkimore e projektuese, ato duhet të ingranojnë më mirë se deri tani edhe byrotë e projektimit në rrethe e në ndërmarrje dhe të



tërheqin mendimin novator e krijues të mijëra mjeshtrave e punëtorëve të dalluar të ndërtimit. Puna kërkimore-shkencore të zgjidhë më mirë problemet që ndeshen në praktikën e ndërtimit dhe, njëkohësisht, të hapë perspektivën për t'i çuar përpara shkencën dhe teknikën e ndërtimeve në kushtet tona konkrete.

**Për çdo objekt të mbahet parasysh kursimi i truallit ku ai ndërtohet.** Toka duhet vlerësuar e duhet shfrytëzuar në maksimum. Në këta dhjetë vjetët e fundit, me ndërtimet kemi zënë mjaft tokë, kryesisht në fusha e në toka bujqësore, kur e dimë që tokat e reja i hapim në kodër dhe në mal. Partia vazhdimisht ka ngulur këmbë për të kursyer çdo pëllëmbë tokë, por kjo porosi e Partisë nuk zbatohet si duhet, po nuk u thyen prirjet që vihen re për t'u shtrirë në gjerësi, për të ndërtuar vetëm në fushë dhe godina njëkatëshe, për të krijuar boshllëqe të mëdha midis godinave, për të lënë rreth objektit vende të pashfrytëzuara etj., në vend që të luftohet për të shfrytëzuar lartësinë, për të ndërtuar godina disakatëshe dhe jo larg njëra-tjetrës e brenda kufijve minimalë e të lejueshëm. Janë ndërtuar disa pulari dhe të gjitha njëkatëshe, kur, me një punë më të studiuar, mund të ndërtoheshin godina dykatëshe, siç u veprua kohët e fundit në Korçë dhe të kursehej rreth 50 për qind e sipërfaqes së tokës. Blloku i ri i TEC-it të Fierit u ndërtua me një teknologji më të mirë, duke zënë më pak tokë dhe me shpenzime shumë më të pakta për njësi prodhimi, në krahasim me vetë TEC-in që ndërtuam disa vjet më parë. Këta shembuj dhe të tjerë si këta flasin për mundësitë e mëdha që kanë projektuesit për të kursyer trojet dhe sheshet e ndërtimit.

Por për projektuesit kursimi nuk mund të kufizohet vetëm për tokën. Në kuadrin e uljes së shpenzimeve të ndërtimit të veprave, shtrohet detyra që metodat e përparuara llogaritëse, manualët e preventivimit të shtrihen dhe të bëhen të detyruara jo vetëm në sistemin e Ministrisë së Ndërtimit, por në të gjitha degët e tjera të ekonomisë, që gjithashtu kryejnë mjaft ndërtime, si në miniera, në naftë, në bujqësi, në komunikacion, në komunale etj. Po kështu, brenda kufijve të zonave sizmike me intensitet deri 9 ballë, të bëhen pa humbur kohë studime të diferencuara e të thelluara për mikrorajonizimin sizmik të trojeve të ndërtimit, që do të çojë patjetër në uljen e mëtejshme të kostos së veprave.

Puna projektuese dhe rezultatet e arritura lypset të shikohen e të analizohen herë pas here me sy kritik, për t'i ballafaquar e për t'i korrigjuar me kërkimet dhe me arritjet shkencore të vendit tonë e të vendeve të tjera, për të nxjerrë konkluzione në përputhje me kërkesat që shtrohen dhe me situatat që kalojmë.

Për një studim e bashkërendim më të plotë dhe më të saktë të anëve funksionale e teknologjike me anën ndërtimore, Këshilli i

Ministrave të studiojë mundësinë e kalimit dora-dorës të anës ndërtimore në institutet studimore teknologjike. Për këtë të mbahen parasysh konkluzionet dhe përvoja që do të merren nga kalimi i katër sektorëve të Institutit të Projektimeve nr. 4 në varësi të instituteve përkatëse teknologjike.

Për realizimin në kohë të detyrave të planit të ndërtimit të veprave prodhuese, ku kemi pasur dhe kemi më shumë mosplo-tësime, një hallkë e dorës së parë e vendimtare është projektimi, prodhimi dhe dërgimi në objekt nga investuesi i makinerive dhe i pajisjeve, i tubacioneve dhe i materialeve teknologjike që, si rregull, kanë epërsi, si pjesë më aktive e investimeve të ndërtimit të veprës.

Në këtë çështje tani vihet re një ndryshim i dukshëm i asaj që kishim më parë, kur këto pajisje, makineri e materiale teknologjike dërgoheshin pothuajse qysh në fillim të punimeve në veprat dhe kërkoheshin ruajtje e trajtim i kujdesshëm i tyre. Tani, siç po vërteton praktika, për mjaft vepra prodhuese ndërtimet ecin më përpara sesa sigurimi i pajisjeve dhe i makinerive, bile për një sërë veprash vonesat e tyre janë bërë shkak, që të mos përfundojnë në kohë ose të thyhen grafikët e zhvillimit të punimeve e të pengohet procesi i ndërtimit.

Në vitin 1981 nuk u dorëzuan, sipas afateve, 1 210 copë makineri e pajisje për veprat në ndërtim, nga të cilat 1 120 copë nga ndërmarrjet e Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, pa përmendur këtu dhe makineritë që nuk janë importuar nga organet e tregtisë së jashtme.

Pas mbledhjes së Byrosë Politike të qershorit të vitit të kaluar, ku u kritikuan rëndë këto qëndrime e zvarritje, puna u përmirësua, por edhe për vitin 1982 pati 20 për qind të makinerive që nuk u dorëzuan sipas afateve. Kjo tregon se kthesa e kërkuar nuk është realizuar plotësisht, gjë që vërtetohet edhe me faktin se megjithëse plani i prodhimit të makinerive si shtatë-mujor në total është realizuar, në objektet kanë shkuar vetëm 60 për qind e tyre. Këtyre qëndrimeve dhe zvarritjeve u duhet dhënë fund dhe të vihen para përgjegjësisë deri në shkarkim nga detyra të gjithë ata që kanë krijuar këtë prapambetje.

Për të zgjidhur këto probleme, në radhë të parë, duhet të bëhet kujdes i veçantë për projektimin dhe për planifikimin e prodhimit të pajisjeve dhe makinerive, si dhe për importimin e atyre që sillen apo të lëndëve të para të domosdoshme për prodhimin e tyre në vend. Fakti është se edhe në planifikim vërtetohen mjaft herë mospërputhje në kohë e në sasi. Probleme ka gjithashtu në fushën e kooperimit për prodhimin e tyre, që duhen zgjidhur më mirë se deri tani për të siguruar cilësi më të lartë dhe në kohë më të shpejtë. Tani është e nevojshme të studiohet hartimi

i një urdhërese të plotë, ku të caktohen dispozita të qarta e të sakta për projektimin, për prodhimin dhe për kolaudimin e gjithë pajisjeve dhe makinerive që prodhohen në vend. Nga ana tjetër, edhe për importimin e materialeve, të makinerive e të pajisjeve për objektet prodhuese duhet të bëhen plotësimet e nevojshme dhe sanksionet përkatëse në dispozitat në fuqi, për të disiplinuar sigurimin në kohë e me karakteristikat tekniko-cilësore të tyre.

Veç këtyre detyrave të investuesit, rëndësi të veçantë ka projekti teknologjik me përlogaritjet e sakta dhe me skemat e plota teknologjike, mbi bazën e të cilave bëhen dhe montimet me lidhjet e nevojshme të veprës për furnizimin me energji, me ujë apo për evadimin e prodhimeve, të mbetjeve etj. Fakt është se si për projektimin e makinerive dhe të pajisjeve, ashtu dhe për projektimet teknologjike komponimet e linjave dhe të skemave përkatëse po ndeshen edhe me vështirësi e pengesa, që vijnë nga organizimi relativisht i dobët i kësaj pune, po aq të gjerë e të rëndësishme sa dhe projektimi i ndërtimit të veprave. Është e vërtetë se për këto detyra dikasteret investuese përkatëse, për një sërë veprash, kanë organizuar grupe projektuese, me dhe pa shkëputje nga puna, të specialistëve dhe të kuadrove të aftë. Por praktika po tregon se, kur është fjala për linja e reparte të reja për rikonstruksione e zgjerime të pjesshme, këto grupe i kanë përballuar disi mirë dhe në kohë detyrat që u janë vënë, ndërsa kur këto detyra parashikojnë rikonstruksione e modernizime më të plota dhe, aq më tepër, objekte të reja e të mëdha, grupet e punës nuk kanë arritur të sigurojnë në kohë, me nivelin e duhur teknik e shkencor projektet teknike e teknologjike të kërkuara. Kjo është bërë shkak për shtytje nga viti në vit të ndërtimit të disa veprave, siç është rasti i dyfishimit të Uzinës së Sodës në Vlorë, i Fabrikës së Pasurimit të Zhavorrit Bituminoz në Selenicë të Vlorës apo i impiantit të seleksionimit të kromit në Klos të Matit etj., që kanë pasur ndikime negative në planet përkatëse.

Prandaj, për të përballuar më mirë këto detyra, dikasteret investuese fillimisht të krijojnë pranë instituteve të studimeve e kërkimeve teknologjike të tyre sektorët e projekteve teknologjike, ku të tërhiqen nga prodhimi, për një periudhë të caktuar kohe e sipas nevojave, edhe specialistët e profileve më të ngushta dhe me përvojë për ato lloj makinerish dhe për atë teknologji që do të projektohen. Në të njëjtën kohë, ashtu si në ndërtim, edhe në prodhimin e pajisjeve e makinerive duhet të thellohen më tej përqendrimi e specializimi i prodhimit të tyre dhe tipizimi e standardizimi i nyjeve, i agregateve dhe i pajisjeve të gjithanshme (universale) që përdoren në shumë linja e vepra.

## II. Zhvillimi ekonomik-shoqëror i vendit kërkon një nivel më të lartë të studimeve dhe të realizimeve në fushën e urbanistikës dhe të arkitekturës

Ritmet e shpejta të ecjes sonë përpara, shtimi, zgjerimi, rikonstruksioni dhe zbulimi i qyteteve, i qendrave industriale dhe i fshatrave tona kanë shtruar para urbanistikës dhe arkitekturës kërkesa të reja më të gjera, më të ndërlikuara dhe më të larmishme, për zgjidhjen e të cilave duhen studime më të plota e komplekse të një niveli më të lartë shkencor.

Urbanistika, si shkencë, ka karakter të theksuar shoqëror e estetik. Ajo u paraprin dhe disiplinon ndërtimet e të gjitha llojeve, mënjanon dhe parandalon përdorimin pa kriter të tokës, ngritjen e parregullt të godinave, të veprave të prodhimit e të shërbimeve, të ndërlidhjeve rrugore, elektrike etj. Duke harmonizuar anët funksionale ndërtimore me ato sociologjike, demografike e kulturore, deri dhe ato ushtarake, urbanistika ka mundësi të gjera për të përpunuar dhe për të krijuar fizionomi të bukura e të kulturuara të qyteteve e të qendrave të banuara, të komplekseve industriale, bujqësore, të qendrave të shërbimit e të pushimit, të fshatrave dhe të qendrave të kooperativave bujqësore etj.

Si për çdo fushë tjetër, edhe në fushën e urbanistikës sukseset tona janë të dukshme. Qyteteve tona u është ndryshuar pamja e mëparshme dhe janë arritur zgjidhje relativisht të mira të qendrave të tyre e të mjaft rrugëve kryesore. Gjithashtu, në ndërtimin e qyteteve dhe të fshatrave të reja urbanistika ka realizuar studime të thelluara dhe zgjidhje të arritura, duke përpunuar dhe duke saktësuar edhe një sërë kriteresh-bazë për zhvillimin e urbanistikës sonë socialiste.

Urbanistika te ne ka avantazhe të mëdha, që rrjedhin nga ndryshimi rrënjësor i rendit tonë socialist ndaj atij kapitalist e borgjezo-revizionist. Ajo ka mundësinë e shpronësimit të trojeve për ndërtime pa ndërlikimet e njohura, siç ndodh në vendet kapitaliste, punon me plane të njohura e të unifikuara të fondeve, të materialeve dhe të forcave të ndërtimit dhe nuk njeh spontaneitet dhe konkurrencë. Ajo udhëhiqet nga vija dhe politika e drejtë dhe largpamëse e Partisë dhe ndihmohet gjerësisht nga mendimi krijues i masave punonjëse. Këto epërsi të mëdha i hapin rrugë të gjera urbanistikës, e cila duhet t'i shfrytëzojë me efektivitet të lartë.

Megjithëkëtë, në fushën e urbanistikës vërtetohen edhe disa mangësi, si në aspektin studimor e shkencor të zgjidhjeve urbanistike, ashtu dhe në atë organizativ e disiplinor.

Për mangësi të studimeve të thelluara e komplekse, sidomos



për perspektivën, kemi raste që detyrohemi të bëjmë ndryshime të kushtueshme të zgjidhjeve të mëparshme. Nuk ka as dy-tri dekada që ndërtuam qytetin e ri të Laçit dhe të Përrenjasit, por zgjidhjet e tyre urbanistike nuk kënaqin kërkesat, që nga vendvendosja e deri te kompozimi urbanistik, që tani është zor të korrigjohen. Mjaft hyrje të qyteteve, disa sheshe dhe rrugë kryesore të tyre gjithashtu kanë zgjidhje jo të arritura dhe të studiuara mirë. Ndërtuam uzinën «Dinamo» e Uzinën Gjeologjike dhe tani paraqiten vështirësi për zgjidhjen e drejtë urbanistike të zonës përreth, për të realizuar zgjerimin e rikonstruksionin e tyre etj. E njëjta gjë mund të thuhet për një sërë godinash, rajonesh banimi e industriale të qyteteve të ndryshme të vendit, që pengojnë ose vështirësojnë zgjidhjet e goditura e të pranueshme urbanistike që bëjmë ose do të bëjmë në të ardhmen.

Veç këtyre, duke mos pasur parasysh si duhet perspektivën e zhvillimit ekonomik, shoqëror, demografik, që duhet t'i jepet e plotë, e saktë dhe në kohë urbanistikës dhe duke mos studiuar në një nivel të lartë shkencor prirjet e këtij zhvillimi dhe korrelacionet e tyre, krijohen nyje të ngushta e të ndërlikuara të urbanistikës së qyteteve, por dhe të fshatrave, për të cilat jo vetëm detyrohemi të bëjmë shpenzime suplementare, por dhe vetë zgjidhjet i bëjmë të përkohshme. Kështu ndodhi në Tiranë, Durrës, Korçë apo Elbasan, ku studimet perspektive urbanistike, të kryera për vitet 1968-1975 jo vetëm nuk u vërtetuan, por zhvillimi i shpejtë i industrisë dhe shtesa më e madhe e popullatës krijuan probleme të reja që detyruan rishikimin e këtyre studimeve për zgjidhje të reja në planet rregulluese.

**Për t'i zgjidhur drejt nga ana urbanistike planet rregulluese të qyteteve, është e domosdoshme që të studiohet mirë zhvillimi perspektiv ekonomik-shoqëror, demografik, dendrologjik për të harmonizuar aktualitetin me perspektivën, anën funksionale me atë estetike, trashëgiminë historike me të sotmen dhe të ardhmen, kërkesat ekologjike e shëndetësore me ato të mirëqenies etj.**

Në mbledhjen e Sekretariatit të Komitetit Qendror në mars të vitit 1972, shoku Enver theksoi:

«Është gabim të mendohet se të vetmit njerëz kompetentë që mund të gjykojnë për çështjet e arkitekturës e të urbanistikës janë vetëm disa specialistë të këtyre fushave. Për to mund e duhet të gjykojnë edhe masat punonjëse, sepse janë këto që do të rrojnë në qytetet që ndërtohen, do të ecin në rrugët e tyre, do të çlodhen në parqet e gjelbëruara, do të shijojnë rrezet e diellit, të cilat do të depërtojnë kudo, në qoftë se ndërtimet do të kombinohen e do të harmonizohen si duhet. Arkitektura dhe urbanistika

moderne duhet të na japin mundësi të shfrytëzojmë sa më shumë diellin, blerimin, ajrin e pastër etj. dhe t'i harmonizojmë këta faktorë me banesat dhe me ndërtimet e tjera»<sup>1</sup>.

Është për këtë arsye që urbanistët tanë jo vetëm duhet të thellohen në studimet e tyre, por medoemos duhet të krijojnë ato lidhje dhe atë bashkëpunim me masat, me studiuesit dhe me specialistët e këtyre fushave, me institucionet dhe me organet përkatëse, që kanë si detyrë të sigurojnë mbështetje sa më të plotë e të gjithanshme për zgjidhjet urbanistike. Krahas kësaj, Këshilli i Ministrave të studiojë legjislationin e të vendosë për detyrimet që duhet të plotësojnë të gjitha dikasteret e tjera për të siguruar në kohë të dhënat e nevojshme për studimet urbanistike dhe për përsosjen e organizimit të studimeve e projektimeve urbanistike, të shohë mundësitë dhe kohën e krijimit të një instituti të veçantë studimor projektues të urbanistikës dhe të banesave, ndoshta në varësi të Ministrisë së Ekonomisë Komunale, e cila t'i dalë zot trajtimit urbanistik jo vetëm të qyteteve e të qendrave industriale-bujqësore, por dhe të fshatrave e të qendrave të kooperativave. Gjithashtu, për këto detyra të ngarkohen më mirë se deri tani e të fuqizohen zyrat e urbanistikës e të projektimit në rrethe, që shpesh ngarkohen me detyra që nuk u takojnë.

Ka ardhur koha që të mendojmë më mirë edhe për përgatitjen e kualifikimin e urbanistëve, në mënyrë që urbanisti të thotë me kompetencë fjalën e tij për çdo vepër që ndërtojmë.

«...urbanistika, na mëson shoku Enver, më duket se është edhe ajo si kirurgjia në shkencën mjekësore që pastron organizmin nga sëmundjet»<sup>2</sup>.

Ajo pastron në qytetet dhe në fshatrat tona sëmundje dhe plagë të rritjes, të pjekurisë dhe të pleqërisë së tyre. Prandaj, në qoftë se deri tani kemi bërë disa plane të përgjithshme e rajonale të qyteteve tona dhe disa planimetri të fshatrave, vihet detyra që jo më vonë se brenda këtij pesëvjeçari, për fshatrat dhe të pesëvjeçarit të tetë për qytetet, të hartojmë plane urbanistike të plotë me perspektivë sa më të largët dhe të ndiqet në vazhdimësi procesi i studimit dhe i azhurnimit të tyre. Kjo detyrë e rëndësishme të konsiderohet si problem i dorës së parë për institutet dhe për zyrat përkatëse të projektimit, për Ministrinë

1. Enver Hoxha, Vepra, vëll. 48, f. 283-284.

2. Po aty, f. 288.



e Ndërtimit, Ministrinë e Ekonomisë Komunale, për komitetet e Partisë dhe ato ekzekutive të rretheve, si dhe për organizatat-bazë të tyre.

Në urbanistikë vendin qendror e zë arkitektura, e cila u jep studimeve dhe planeve të saj fizionomi konkrete, vëllime e përmasa të harmonizuara, estetike dhe, bashkë me punën e ndërtesave, u jep atyre gjallëri dhe jetë. Prandaj Partia është kujdesur vazhdimisht që arkitektura jonë të ecë në rrugë të drejtë dhe t'u përgjigjet orientimeve dhe direktivave të saj në luftë me gjithë konceptet ekstravagante, degjeneruese, kozmopolite dhe infiltrimeve borgjezo-revizioniste. Kjo ka bërë që arkitektura jonë, e udhëhequr nga mësimet e Partisë e të shokut Enver, të zhvillohet me hapa të sigurt drejt konsolidimit të mëtejshëm të përmbytjes së saj socialiste dhe fizionomisë kombëtare.

Janë të shumta banesat, objektet socialkulturore dhe ato industriale që dëshmojnë për këto arritje. Ndërtime të tilla, si Muzeu Historik Kombëtar, ai i Skënderbeut në Krujë, hotelet e mëdha, spitalet e pallatet e kulturës, objekte sportive si dhe godina të banimit të ndërtuara vitet e fundit, flasin qartë për arritjet e arkitekturës sonë socialiste. Por aty-këtu ka dhe ndërtime që për monotoninë dhe zgjidhjen arkitektonike jo të goditur nuk të tërheqin. Natyrisht, një pjesë e mirë e tyre u takojnë viteve të para të ndërtimit socialist të vendit, por tani që kemi përgatitur me qindra inxhinierë e arkitektë, kemi ngritur një industri të tërë të materialeve të ndërtimit dhe kemi krijuar një sërë institucionesh kërkimore e projektuese në qendër e në rrethe, arkitekturës sonë i janë hapur horizonte të mëdha përpara.

Duke zbatuar orientimet e Partisë, arkitektët tanë, në radhë të parë, duhet të udhëhiqen nga kërkesat që ka shoqëria jonë, njeriu ynë socialist, i çliruar plotësisht nga shtypja e shfrytëzimi, për të punuar, për të banuar e për të plotësuar nevojat e tjera jetësore me thjeshtësi dhe me kushte të mira. Prandaj në çdo vijë që heq arkitekti, në radhë të parë, të ketë parasysh njeriun tonë socialist, të zgjidhë sa më drejt anën funksionale të veprës me të gjitha kërkesat që shtron shoqëria jonë socialiste, të cilave duhet t'u nënshtrohen edhe normat e kriteret teknike.

Veç anës funksionale, karakteri socialist i arkitekturës sonë shprehet edhe në thjeshtësinë, në të bukurën dhe në të kursyerën, sepse, siç dihet, rendi ynë socialist është rendi më kursimtar në historinë njerëzore. Kjo realizohet kur zgjidhjet arkitektonike çlirohen nga teprimet, nga zbukurimet e panevojshme, nga hapësirat e vëllimeve të pashfrytëzueshme etj. Arkitektura duhet të krijojë vepra të larmishme, të bukura dhe të mbështetura në artin shqiptar të ndërtimeve. Kjo kërkesë e rëndësishme nuk ka karakter thjesht artistik, siç interpretohet në ndonjë rast,

kur nën ndikimin e ideologjisë borgjezo-revizioniste, në emër «të së bukurës», «të veçantës» e «të krijimtarisë vetjake», tentohet për të filtruar në arkitekturën tonë «izmat» dekadente borgjezo-revizioniste që shëmtojnë e u marrin frymën qyteteve. Partia jonë nuk i ka lejuar dhe nuk do t'i lejojë kurrë këto qëndrime.

Në urbanistikë e në arkitekturë ka pasur dhe ka edhe çështje të veçanta, për të cilat Partia ka dhënë orientime të qarta dhe porosi konkrete. Kështu, në goftë se u shtrua për zgjidhje lartësia e godinave të qytetit dhe të fshatit, prej kohësh është orientuar se, për të shfrytëzuar kushtet tona klimaterike e tokësore, me përjashtime dhe kur e kërkon studimi urbanistik, nuk është e udhës që tani për tani të ngrihen godina me lartësi të mëdha, që krijojnë vështirësi për ngjitje të banorëve, të ujit, të druve.

Duke respektuar këto kërkesa e orientime, me specifikat e tyre për kryeqytetin, për qytetet e mëdha, për ato më të vogla, për qendrat e banuara jashtë tyre dhe për fshatrat, arkitektët tanë i kanë të gjitha mundësitë të krijojnë vepra të bukura, të larmishme e dinjitoze për kohën që ndërtohen dhe për vitet që vijnë.

Mirëpo të gjithë e shohin se në disa qytete të vendit të zë syri dhe njëfarë monotonie, nga pamja e jashtme, e mjaft godinave të banimit, edhe kur për këto qytete ka veçori që duhen respektuar, si për shembull, qytete bregdetare apo malore, qytete të vjetra dhe me trashëgimi arkitektonike dhe qytetet e ndërtuara nga fillimi etj. Ndodh që ndonjë arkitekt për të justifikuar ndonjë veprë të paarrirë mirë i referohet tipizimit të projekteve të godinave të banimit apo detyrave për kursimin e trojeve të ndërtimit, të fondeve, ose cilësisë e llojit të materialeve të ndërtimit etj. Por gjithë këto justifikime nuk i qëndrojnë kritikës, se kemi ndërtuar kudo edhe godina të bukura e komode, po me këto kritere e tipizime, po me këto materiale e troje ndërtimi. Fakti është se kur flasim për tipizimet, kemi të bëjmë me disa tipa të ndryshëm që disjelojnë vëllimet e konstruksionet-bazë, por jo pamjet e jashtme as dhe dritaret, ballkonet e lozhat, elementet arkitektonike të jashtme, vepra arti, si: afreske, mozaikë, basorelieve, skulptura etj. Për këto jo vetëm ka mundësi për larmi estetike, por edhe fushë të gjerë për krijimtari artistike, individuale dhe kolektive, në të cilën edhe vetë punonjësit e artistët japin me kënaqësi mendime, sugjerime e ndihmesë shumë të vlefshme.

Kjo nuk do të thotë që të mbetemi për një kohë të gjatë vetëm në tipat e miratuar. Në bazë të veçorive të zonave klimatike e veçorive të qyteteve, dora-dorës duhen studiuar dhe tipa të tjerë që të plotësojnë më gjerë kërkesat e kohës. Studimet dhe puna e filluar për këtë problem në Institutin e Studimeve dhe

të Projektimeve të Urbanistikës dhe të Arkitekturës duhen thelluar e shpejtuar, për të pasur sa më shumë tipa për ndërtimin e banesave sipas zonave klimatike e tokësore të vendit që mund të përdoren me krijimtari të larmishme. Gjithashtu, Këshilli i Ministrave të studiojë mundësitë për të bërë ngrohjen qendrore në disa qytete apo lagje kryesore të tyre, duke filluar nga ato ku ekzistojnë ose ku krijohen mundësitë për prodhimin e avullit me shpenzime relativisht më të pakta.

Po kështu mund të thuhet edhe për materialet e ndërtimit, të cilat, ndonëse kanë llojshmëri jo të madhe e të meta cilësore, por me një kujdes e me punë krijuese, sidomos për materialet tradicionale, si guri, druri etj., mund të sigurohen ndërtime me vlera të mira estetike e ekonomike që të përmbushin kërkesat e kohës. Fakt është se në Gjirokastër ose në Krugë, në Fier, në Korçë ose në Vlorë e gjetkë janë këto materiale që janë përdorur për ndërtime të bukura.

Monotoni dhe punë pa fantazi ndeshim dhe në ngjyrat e godinave, në ndriçimet e mobilimet e mjediseve të brendshme, në gjelbërimet rrugore, parqet, ambientet çlodhëse të qyteteve, megjithëse për të gjitha këto kushtet dhe mundësitë tona janë shumë të gjera për larmi e fantazi brenda normave të njohura. Prandaj në të ardhmen të vlerësohen dhe këto çështje të arkitekturës dhe të punohet që të kualifikohen arkitektët dhe në këto drejtime.

### III. Mbi materialet e ndërtimit

Në zhvillimin e ndërtimeve një vend kryesor kanë zënë kurdoherë materialet e ndërtimit, prodhimi i të cilave është rritur me ritme të shpejta, si në sasi, ashtu dhe në llojshmëri. Partia i ka kushtuar kujdesin e duhur industrisë së prodhimit të tyre, për t'u paraprirë ndërtimeve në të gjithë vendin. Nga njëri pesëvjeçar në tjetrin janë rritur si aftësitë prodhuese, po ashtu dhe llojshmëria e cilësia e tyre. Vetëm në këta dhjetë vjetët e fundit këto aftësi janë dy a trefishuar dhe është bërë një shpërndarje më e mirë e tyre midis rretheve. Megjithëkëtë, niveli i arritur, si për sasinë, ashtu dhe për llojshmërinë e tyre, akoma nuk plotëson gjithë kërkesat e ndërtuesve për vëllimet, anën funksionale dhe estetike të objekteve që projektojmë dhe ndërtojmë. Pikërisht për këto çështje **Komiteti Qendror ka kërkuar që të intensifikohen studimet dhe masat konkrete për shtimin dhe për përmirësimin cilësor të prodhimit të materialeve të ndërtimit, duke u nisur gjithmonë nga mundësitë konkrete që kemi për t'i realizuar ato me forcat tona.** Brenda këtij pesëvjeçari, e sidomos në pesëvjeçarin e ardhshëm, është e nevojshme të thellohen

e të zgjerohen këto studime, në veçanti të merren masa të plota organizative për të intensifikuar punën për vënien në jetë të tyre. Fakti është se, në bazë të këtyre studimeve, Qeveria ka marrë dy vendime të rëndësishme për të çuar më shpejt përpara prodhimin e materialeve të ndërtimit, për rritjen e aftësive prodhuese dhe llojshmërinë e tyre. Por mjaft nga këto detyra nuk janë realizuar jo vetëm për dobësi të punës organizuese e drejtuese, por dhe për arsye se në disa raste ky realizim është parashikuar me importime të konsiderueshme, në vend që të mbështetej fuqimisht në prodhimet e vendit. Këto dy vendime duhen realizuar sa më parë dhe Qeveria të rritë kujdesin dhe kontrollin për t'i çuar deri në fund ato dhe për t'u paraprirë detyrave të reja që shtrojmë në këtë Plenum. **Materialet e ndërtimit janë të shumta, por po ndalemi në disa më kryesoret:**

Për sa i përket çimentos në vitin 1985 parashikohet të prodhojmë duke përdorur edhe rreth 200 mijë tonë shtesa, si: skorie, hira, kuarcite etj., të cilat do ta ulin më tej edhe koston e çimentos pa prekur cilësinë e saj. Por në këtë kuadër ne akoma nuk kemi zgjidhur problemin e çimentos së bardhë që vazhdojmë ta importojmë, megjithëse kemi bërë disa studime konkrete dhe ekzistojnë të gjitha lëndët e para për ta prodhuar atë në vend. Shtrohet detyra që, brenda këtij pesëvjeçari, të parashikohet ndërtimi i një fabrike të vogël për çimenton e bardhë dhe të planifikohet prodhimi i saj jo më vonë se viti 1987. Në të ardhmen rritja e aftësive prodhuese të çimentos së bardhë, për të mbuluar nevojat e pesëvjeçarëve që vijnë, të bëhet me teknologji bashkëkohore për kursimin e lëndëve djegëse, për rritjen e rendimentit dhe të cilësisë së saj.

Vëmendje më e madhe t'i kushtohet edhe prodhimit të **gëlqeres**. Është e vërtetë që ne kemi tradita dhe kushte të mira për prodhimin e saj, por fakti është se me rritjen e sasisë, cilësia ka ardhur duke rënë aq, sa sot mbetjet e patretshme arrijnë 35-50 për qind. Për kapërcimin e kësaj gjendjeje duhen ndërmarrë dhe duhen realizuar studime më të plota gjeologjike e teknologjike, që të rritet rendimenti dhe të ulët kostoja e saj. Njëkohësisht ndërmarrjet përdoruese të ndërtimit, për punime të veçanta të tyre, të organizojnë qysh këtë vit e dora-dorës vjetrimin e gëlqeres së shuar për të rritur cilësinë e suvatimeve. Krahas kësaj, të kryhen studimet e nevojshme për prodhimin e gëlqeres së hidratuar dhe në pesëvjeçarin e ardhshëm ajo të sigurohet nga ndërmarrjet prodhuese të gëlqeres.

Materialet bazë dhe masive për ndërtimet tona mbeten akoma ato të **qeramikës**, domethënë tulla, tjegulla, pllaka dekorative e të veshjes së mureve, artikuj hidrosanitarë etj. Në këto prodhime rritjet kanë qenë të mëdha dhe është synuar që ato, tullat e tjegullat, në tërësi e në veçanti, të sigurohen në çdo rreth për



të mënjeluar transportimin e tyre. Por krahas rritjes së sasisë, nuk është ecur kështu për rritjen e cilësisë, për uljen e kostos dhe sidomos për lehtësimin e peshave të tyre. Këtu ka jo vetëm probleme të përmirësimit të teknologjisë dhe të thellimit të studimeve gjeologjike për sigurimin e lëndëve të para të përshtatshme, që janë çështje themelore, por dhe probleme konkrete të organizimit e të drejtimit që lidhen me forcimin e kontrollit të cilësisë së prodhimit, me disiplinën teknike dhe me kualifikimin e punëtorëve. Është e domosdoshme që këto probleme të analizohen me hollësi e të merren masa për zgjidhjen e drejtë të tyre dhe për rritjen e shpejtë të cilësisë dhe të uljes së peshës së këtyre prodhimeve jo vetëm nga Ministria e Ndërtimit dhe organet e saj vartëse, por edhe nga organizatat-bazë të Partisë në këto fabrika. Jo vetëm për kushtet klimaterike të vendit, por dhe për shpejtimin e lehtësimin e ndërtimit të banesave, tullat e plota shkallë-shkallë duhen zëvendësuar me ato me vrima e kanale. Këtij qëllimi duhet t'i shërbejnë rikonstruksionet e një sërë fabrikash të tullave që planifikojmë, si dhe thellimi i studimeve dhe i eksperimenteve të Institutit të Studimeve dhe të Teknologjisë së Ndërtimit.

Vënia sa më parë në shfrytëzim e Fabrikës së re të Tullave në Lushnjë me një teknologji më të përparuar duhet të shërbejë për të nxjerrë konkluzione, si për zgjerimin e llojshmërisë së prodhimeve të fabrikave të tullave, ashtu dhe për uljen e kostos së tyre, prandaj të merren masa që ajo në vitin e ardhshëm të fillojë prodhimin, pra të përvetësohet brenda një kohe sa më të shkurtër.

Gjithashtu, prodhimet prej fajance, gresi, mermeri e allçije nuk plotësojnë tërësisht kërkesat e ndërtimeve, si në sasi, ashtu dhe në cilësi jo pse mungojnë lëndët e para e materialet e nevojshme, porse për prodhimin e tyre nuk bëhet kujdes e punë e thelluar, sidomos në përmirësimin dhe në zbatimin e teknologjisë. Po kështu, në këtë fushë nuk po bëhen kërkime e studime për të kombinuar prodhimin e tyre me materialet e tjera, si: çimento, granile, lëndë plastike dhe pigmente ngjyruese, për t'i vlerësuar më mirë gipset e çmertet, gurët dekorativë e materialet e tjera inerte, me të cilat vendi ynë është i pasur.

Krahas zgjerimit të llojeve dhe përmirësimit të cilësisë së këtyre materialeve të vlefshme ndërtimi, përpjekje shumë më të mëdha duhen bërë për uljen e kostos së tyre. Kjo, sepse kostoja relativisht e lartë, nga njëra anë, rrit shpenzimet e ndërtimeve dhe frenon përdorimin e tyre, kurse, nga ana tjetër, nuk hap perspektiva të gjera për futjen në qarkullimin ekonomik të këtyre lëndëve të para që i kemi me bollëk. Është e papranueshme, për shembull, që një pllakë mozaiku prej çimentoje, me rërë e copëra mermeri, të na kushtojë 2-3 herë më shumë se një pllakë thjesht prej çimentoje e me rërë apo me granil.

Po kështu shumë ngadalë po ulet kostoja e tullave, e tjegullave, e parafabrikateve etj., megjithëse edhe për këto janë bërë një sërë studimesh.

Për kursimin e lëndës së drurit, për të cilën jemi deficitarë dhe nuk balancojmë akoma rritjen me prerjen e saj, është e domosdoshme të bëhet një kthesë serioze jo vetëm për kursimin e saj në procesin e ndërtimeve, duke e staxhionuar më mirë e më gjërësisht atë, por sidomos për zëvendësimin me kallëpe metalike që kanë një jetëgjatësi më të madhe, me përdorime të betonit të armuar të markave të larta e të llamarinës për dritare, me përdorimin e plastikës e të fibrës etj. Në këtë çështje të ecet më shpejt dhe me guxim dhe të merren masa që në këtë pesëvjeçar të ulet 10-15 për qind përdorimi i lëndës së drurit në ndërtime.

Sot dhe akoma më shumë në të ardhmen, parafabrikatet do të marrin përparësi në ndërtimet e të gjitha llojeve. Prodhimi i tyre të ne është i organizuar në poligone të veçanta të disa ndër-marrjeve të ndërtimit dhe në kombinatin «Josif Pashko». Në këta dhjetë vjetët e fundit, prodhimi i parafabrikateve është rritur rreth pesë herë dhe është zgjeruar llojshmëria e tyre. Megjithëkëtë, ato akoma nuk po përballojnë kërkesat e ndërtimit e në veçanti ato të paratensionuarat që shtohen me ritme të ulëta. Kjo vjen, në radhë të parë, për shkallën e ulët të mekanizimit, e cila në poligone të hapura nuk arrin më tepër se 35 për qind, ndërsa në ato pak linja industriale që kemi, shkalla e mekanizimit arrin deri në 75 për qind. Nga ana tjetër, për prodhimin e parafabrikateve, si në poligonet e hapura, ashtu dhe në linjat industriale, duhen marrë masa të shpejta për zgjerimin e aftësive prodhuese me rikonstruksione e përmirësime teknologjike që përshpejtojnë procesin e prodhimit; në të njëjtën kohë duhen zgjeruar e fuqizuar edhe bazat për prodhimin dhe për përqendrimin e inerteve, për prodhimin e fraksionimin e tyre nga gurët e llojeve të ndryshme etj. Gjithashtu, të ngrihet shkalla e mekanizimit të montimit të parafabrikateve, që sot pengon deri në një masë përdorimin e gjerë të elementeve të parafabrikuar. Për këtë çështje të bëhen studime të reja për mekanizma ngritës e montues të këtyre elementeve dhe të organizohet sa më parë prodhimi i tyre në vend.

Prodhimi i parafabrikateve dhe cilësia e tyre duhet të jenë në qendër të vëmendjes së Ministrisë së Ndërtimit. Ajo duhet të merret nga afër dhe seriozisht me tipizimin e standardizimin e tyre, me rritjen e rezistencës dhe të paraqitjes estetike. Rezultatet e arritura në prodhimin e soletave dhe kapriatave të paranderura, të mbulesave tip membranë të shtyllave të centrifuguara etj. duhen çuar më përpara dhe të bëhen të gjitha përpjekjet për të ulur peshën e tyre dhe të të gjitha llojeve të parafabrikateve, duke përfshirë këtu dhe perlitin konstruktiv apo në të ardhmen gazo-betonin.



Detyra të rëndësishme kanë edhe dikasteret e tjera si Ministria e Industrisë dhe e Minierave dhe ajo e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore, që prodhojnë materiale të nevojshme ndërtimi, duke filluar nga çeliqet e lëndët drusore e deri tek ato plastike, qeramike e fajance. Këto dikastere duhet të vlerësojnë më mirë se deri tani kërkesat cilësore të ndërtuesve dhe të ndiejnë përgjegjësi të drejt-përdrejtë për përmirësimin e teknologjisë së prodhimit të tyre.

Punëtorët, specialistët dhe kuadrot që punojnë në industrinë e materialeve të ndërtimit, të mbajnë kurdoherë parasysh detyrën e rëndësishme që vuri shoku Enver në Kongresin e 8-të të Partisë, ku theksoi:

«... projektuesi, teknologët e zbatuesit, si edhe prodhuesit e materialeve të ndërtimit, ... të prodhojnë një gamë të gjerë materialesh ndërtimi me cilësi e rezistencë të lartë, duke zbatuar përvojën e përparuar të vendit dhe atë botërore»<sup>1</sup>,

në mënyrë që t'u japin arkitektëve e ndërtuesve një gamë më të gjerë e më të larmishme të këtyre materialeve, për të krijuar vepra të bukura, të mira e të lira.

Në këto studime dhe eksperimentime të përfshihen jo vetëm prodhuesit e materialeve të ndërtimit, por dhe vetë ndërtuesit, arkitektët, projektuesit e specialistët e fushave të tjera, si gjeologë, teknologë, ekonomistë e të tjerë.

E rëndësishme është, gjithashtu, të thellohen studimet dhe zbatimet jo vetëm për prodhimin, por dhe për organizimin e përqendrimit e tij, për rritjen e shkallës së mekanizimit, etj., sepse sot pak kujdes u është kushtuar nxjerrjes dhe përpunimit të gurit, fraksionimit granulimetric të materialeve inerte, zgjerimit të aftësive për prodhimin e pllakave të shtrojes së dysHEMEVE, prodhimeve plastike për dyer e dritare etj., etj., e pa përmendur këtu masat që do të merren për ngritjen e një fabrike për pllaka me aftësi prodhuese 400 mijë m<sup>3</sup>.

#### IV. Të përsosën vazhdimisht organizimi dhe drejtimi i punës në ndërtimin e veprave

Ndërtimi i veprave fillon që me dorëzimin në kohë të projekteve dhe të preventivave në përputhje të plotë me fondet e planifikuara, me aftësi ndërtuese të ndërmarrjes apo të kanitierit, me bazën materiale e teknike të nevojshme, me fuqinë

1. Shih në këtë vëllim, f. 138.

punëtore e të specialistëve, duke iu përmbajtur plotësisht afateve të planifikuara. Një rol të veçantë këtu luan organizimi i punimeve të ndërtimit të veprës, i cili ka ardhur nga viti në vit duke u përsosur aq, sa sot mund të themi se ai përballon me sukses ndërtimin e çdo vepre, sado e ndërlikuar që të jetë. Megjithatë, Komiteti Qendror ka porositur disa herë që në planet e organizimit të ndërtimit të veprave një vëmendje e veçantë t'i kushtohet shkallëzimit të tyre në kohë. Në qoftë se në planin vjetor parashikohet të përfundojë një vepër ujore, puna duhet organizuar e programuar në mënyrë të tillë që ajo të përfundojë pikërisht në periudhën e ujitjes, që të marrim sa më parë efektivitetin e saj, siç u veprua këtë vit. Jo vetëm kaq, por shkallëzimi në kohë i ndërtimit të veprave të mëdha e komplekse duhet medoemos të parashikojë vënien e tyre në shfrytëzim pjesë-pjesë dhe jo të lihen për vite të tëra objekte pa punë, siç është lënë uzina e lëndës karbonike dhe ajo e telëzimit në Kombinatin Metalurgjik për mungesa relativisht të vogla të nyjeve apo pajisjeve e makinerive, ose siç ndodh në Uzinën e Telave në Shkodër, ku, pa përfunduar zgjerimi i fazës së parë dhe vënia në shfrytëzim e saj, bëhen investime për fazën e dytë.

Përvoja e madhe e fituar nga punonjësit e ndërtimit në tërësinë e saj flet se kur këto detyra organizative studiohen e zgjidhen drejt, kur ato lidhen e bashkërendohen organikisht dhe ndiqen me kujdes, ndërtimi i veprave realizohet në kohë e me cilësi të lartë, sigurohet zbatimi i plotë dhe pa shmangie i projekteve dhe i preventivave, arrihen kursime materiale, financiare dhe kohe. Megjithatë në disa vepra këto masa të rëndësishme organizative nuk studiohen dhe nuk përcaktohen drejt qysh në fillim. Edhe kur ato studiohen e përcaktohen mirë, por në praktikë nuk zbatohen si duhet, veprat nuk realizohen plotësisht sipas projekteve e preventivave, fondet tejkalohen, afatet e ndërtimit shkelen, cilësia e kërkuar nuk realizohet, treguesit e punës dhe ata tekniko-financiarë të planifikuar nuk arrihen, efektiviteti i llogaritur pëson rënie.

Me të drejtë mund të pyetet: Përse ndodh kështu? A nuk kemi ne sot aftësi organizative që të përcaktojmë dhe të zbatojmë të gjitha masat e nevojshme për realizimin e këtyre detyrave? Apo nuk kemi disiplinë të fortë për t'i realizuar ato tërësisht dhe në mënyrë të harmonizuar?

Duke i analizuar këto çështje konkretisht në veprat e mëdha, del se të dyja këto dukuri i ndeshim, ku më shumë e ku më pak, në veprat që nuk janë realizuar sipas planeve, dhe, për pasojë, janë krijuar humbje të kohës, rritje të shpenzimeve materiale e financiare e humbje të prodhimit të planifikuar. Le t'u referohemi disa të dhënave:

Në vitin 1981-1982, sipas planit, ishin për të përfunduar 180

vepra prodhuese, 111 vepra socialkulturore, 18 500 apartamente banimi dhe 46 vepra ujore bonifikuese, për të cilat do të shpenzoheshin 1 miliard lekë. Në fund të vitit 1982, realizimi konkret i këtyre objekteve pati deficite e prapambetje që solli këto pasoja:

Prodhimi industrial i planifikuar nga këto objekte nuk u realizua për 150 milionë lekë, pra nuk u morën 32 milionë lekë akumulim, u ngurtësuan 375 milionë lekë të investuara etj., pa folur këtu për faktin që akoma vazhdojmë t'i kemi 30 për qind më të larta ndërtimet në proces ndaj atyre që përfundojnë brenda një viti, sepse që në planifikim nga të gjitha degët e ekonomisë nuk mbahet parasysh sa duhet porosia e Kongresit të 8-të të Partisë për caktimin e kufijve normativë të investimeve e të ndërtimeve të papërfunduara. Këto shifra janë me të vërtetë shqetësuese dhe çdo njeri me të drejtë mund të pyesë: Përse lejohen, nuk vihet dorë dhe nuk merren masa ndaj atyre që mbajnë përgjegjësi? A ka këtu ndonjë faktor tjetër veç atij subjektiv?

Duke u futur më në hollësi të mangësive dhe të dobësive që ndikojnë drejtpërsëdrejti në këto humbje, del se, veç faktorëve organizativë e drejtues, si dhe faktit që çdo vit planit të ndërtimeve i bëhen ndryshime me shtesa e pakësime, në ndërtime kemi dhe mjaft çështje konkrete, organizative e teknike, siç janë përmirësimi i furnizimit materialo-teknik, sigurimi nga investuesit i pajisjeve e i makinerive të vendit apo të importit, që duhet të zgjidhen më mirë e më shpejt.

Komiteti Qendror dhe personalisht shoku Enver porosin vazhdimisht që të bëhet përqendrimi i ndërtimeve. Megjithëse janë bërë disa përmirësime, prapë gjendja nuk është në nivelin e duhur. Ndërmarrjet e ndërtimit, brenda një viti, punojnë mesatarisht në 1 000-1 200 vepra. Ka dhe ndërmarrje të tilla, si ndërmarrja «21 Dhjetori» e Tiranës, Rruga-Ura ose ajo e Bonifikimit në Durrës, që për këtë vit kanë përkatësisht 119, 18 dhe 27 vepra të planifikuara.

Si mund të kemi organizim, kontroll, disiplinë dhe drejtim në nivelin e kërkuar shkencor në një numër kaq të madh veprash? Si mund të arrihet shfrytëzimi racional i materialeve, i mekanizmave, i specialistëve dhe i transportit, siç e kërkojmë në këto kushte? Natyrisht, kjo çështje nuk zgjidhet vetëm nga punonjësit e ndërtimit, sepse një rol vendimtar këtu kanë dikasteret investuese dhe organet e planifikimit të çdo hallke, të cilat, në vend që t'i përqendrojnë, i shpërndajnë fondet e veprave kufi e nën kufi midis viteve. Po dhe vetë ndërtuesit duhet t'i luftojnë këto prirje dhe të marrin masa që fondet të përqendrohen në veprat që ndërtojmë, duke përsosur dhe organizimin e kontrollin në këtë përqendrim të domosdoshëm. Caktimi i afateve normative nga Këshilli i Ministrave, sipas porosive që dha Kongresi i 8-të i Partisë, do të ndihmojë për t'i disiplinuar këto prirje të shpërndarjes në

vite dhe të zvarritjeve që janë vërtetuar disa herë në dorëzimin e veprave.

Përqendrimi në veprat që ndërtojmë, detyrimisht duhet të lidhet edhe me industrializimin e mëtejshëm të ndërtimeve, si dhe me shfrytëzimin më të mirë të mekanizmave, të makinerive të rënda dhe të transportit në ndërtim.

Industrializimi i ndërtimeve është një rrugë e sprovuar dhe e shpejtë për të përballuar detyrat që kemi përpara. Hapa të rëndësishëm janë bërë pothuajse në të gjitha llojet e ndërtimeve, industriale, bujqësore, qytetare, të transportit e kështu me radhë, por dhe këtu ka një sërë problemesh konkrete, që në të ardhmen duhet të studiohen dhe të zgjidhen më mirë se deri tani. Është fakt që edhe sot banesat me parafabrikate na kushtojnë më shtrenjtë sesa ato me tulla. Po kështu, nuk ka përse të rritet kostoja e veprës nga përdorimi i konstruksioneve të parafabikuara, në krahasim me ato të derdhura. Këto anomali pengojnë zgjerimin e industrializimit të ndërtimeve, pa përmendur këtu atë që është kryesore, rritjen e aftësive prodhuese dhe përmirësimin e teknologjisë e të cilësisë së parafabrikateve, uljen e shpenzimeve të transportit etj., për të cilat duhet punuar më tepër dhe më mirë.

E gjithë lufta dhe përpjekjet e organizatave të Partisë, të organeve drejtuese shtetërore dhe të institucioneve kërkimore e projektuese për këtë problem duhet të synojnë që jo vetëm të thyhen konceptet e rutina frenuese, por dhe të rriten efektiviteti dhe leverdishmëria e përdorimit të parafabrikateve nëpërmjet kursimit të materialeve, uljes së kostonë së tyre, rritjes së shkallës së mekanizimit, shfrytëzimit racional të makinerive, mekanizmave etj.

Një nga çështjet që ka tërhequr vëmendjen Komiteti Qendror i Partisë për ndërtimet, ka qenë dhe mbetet edhe çështja e cilësisë së tyre. Kështu, për shembull, cilësia e hidroizolimeve, e sistemeve hidrosanitare, e shtresave të dyshemesë, e dyerve dhe e dritareve, e suvatim-bojatisjes, e sistemimit të dherave, të kanalizimeve, e rrugëve të asfaltuara etj. lë për të dëshiruar, pra, na shpie në shpenzime suplementare edhe në drejtim të mirëmbajtjes. Ka raste që, pa përfunduar mirë banesa, dalin njolet në mure, shtrembërohen dyert e dritaret, ngrihen copat e parketit apo lëvizin pllakat e dyshemesë, ndoten me llaç e çimento etj. Natyrisht, kështu nuk ndodh kudo, por këto «plagë» i gjejmë aty ku mungojnë ndër-gjegjja e lartë në punë dhe sedra profesionale, ku personeli inxhiniero-teknik rënd më shumë pas globalit dhe harron detyrën e rëndësishme të udhëheqjes teknike, të instruktazhit dhe të kontrollit të çdo procesi e faze ndërtimi, me një fjalë aty ku organizata e Partisë nuk e ka bërë të qartë dhe nuk e ka rrënjosur si duhet në ndër-gjegjen e punonjësve porosinë e Partisë se cilësia është rendiment, kosto, kursim, është, në fund të fundit, kënaqësi profesionale e çdo ndërtuesi. Janë me mijëra ndërtues që populli me të



drejtë i quan duartë, por ka dhe raste që ndonjëri nuk mëson e nuk punon sa duhet për të nxjerrë punë me cilësi të lartë. Me ta duhet punuar në mënyrë të veçantë që të gjithë ndërtuesit të ngrihen në nivelin e kërkuar.

Çështja e cilësisë së dobët në disa vepra, si dhe deficitet e krijuara në ndërtimin e tyre dhe në treguesit ekonomikë e financiarë argumentojnë edhe një herë domosdoshmërinë e përgatitjes dhe të kualifikimit më të mirë të punëtorëve e të specialistëve të ndërtimit. Për këtë qëllim sot kemi 5 shkolla të ulëta dhe 14 shkolla të mesme profesionale, në të cilat përgatiten çdo vit mesatarisht 1700 punëtorë e specialistë të rinj. Siç tregon përvoja e deritanishme, këta nxënës nuk dalin aq mirë e të përgatitur nga ana teknike. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës së bashku me Ministrinë e Ndërtimit duhet ta studiojnë këtë çështje nga afër për të bërë përmirësimet e nevojshme në këto shkolla.

Megjithëkëtë, kryesore mbetet edukimi ideopolitik e profesional në rrugë e në forma nga më të ndryshmet i të gjithë punëtorëve dhe veçanërisht i të rinjve. Këtu është fjala jo vetëm për punëtorët e ndërtimit e të industrisë së materialeve të ndërtimit, por edhe për ata të dikastereve të tjera që ndërtojnë në ekonomi të ndërmarrjeve të bonifikimit, të kooperativave bujqësore, të komunales e deri tek ata të mirëmbajtjes e të riparim-shërbimeve që kanë akoma një nivel të ulët profesional, për vetë faktin se me ata nuk bëhet ndonjë punë e veçantë e sistematike edukuese.

Çështja e kualifikimit të punëtorëve dhe të specialistëve në ndërtim duhet parë e lidhur edhe me fluktuacionin që na krijohet shpesh në ndërmarrjet e ndërtimit e të bonifikimit, ku nga njëri vit në tjetrin, sipas veprave që kanë të planifikuar, numri i fuqisë punëtore lëviz në përqindje të larta. Ky fluktuacion jo vetëm vështirëson sigurimin e numrit të nevojshëm të fuqisë punëtore (si tetëmuajor në këto ndërmarrje nuk janë siguruar mbi 2500 punëtorë), por edhe pengon punën për edukimin e kualifikimin e tyre. Prandaj komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, që janë ngarkuar me sigurimin e fuqisë punëtore, duhet ta shohin këtë çështje jo globalisht, por konkretisht, që në ndërtim të shkojnë jo punëtorë të përkohshëm, por të përhershëm, që të kualifikohen nga viti në vit. Tani ndërtimi duhet konceptuar ndryshe, se punët e thjeshta e voluminoze të gërmimit e të lëvizjes së dherave, ose përgatitjen e llaçit e të betoneve i bëjnë mekanizmat, kurse punëtorët e thjeshtë e pa profesione krahasimisht zënë një përqindje shumë të vogël. Kjo kërkon që edhe puna në kurset e kualifikimit të forcohet nga ana cilësore, meqë sot në këto kurse kemi afro 25 për qind të punëtorëve të ndërtimit dhe 19 për qind të bonifikimit. Organizatat-bazë të Partisë dhe levat e tyre duhet të ndjekin njësoj e me kujdes punën për kualifikimin, të ndihmojnë

e të kontrollojnë për këtë problem, ashtu si dhe për plotësimin e detyrave të planit.

Jo vetëm për punëtorët, por Ministria e Ndërtimit dhe dikastertet e tjera që ndërtojnë duhet të marrin masa dhe të kujdesen më mirë edhe për mjeshtrot e inxhinierët e zbatimit. Këta specialistë të ndihmohen me literaturë e dokumentacione teknike nga praktika jonë dhe ajo botërore, të aktivizohen më gjerësisht në projektimin e veprave që do të ndërtojmë, duke i caktuar dhe konsulentë ose oponentë të projekteve përkatëse.

Të organizohen me ta kurse e seminare dhe të ngulet këmbë për ngritjen e nivelit tekniko-profesional në rrugë e forma të ndryshme.

Për rritjen e efektivitetit të ndërtimeve, rëndësi të veçantë kanë tregues të tillë të rëndësishëm, si: rendimenti, kostoja, shkalla e mekanizimit të punës, apo thjeshtimi e përmirësimi i projekteve nga vetë zbatuesit. Edhe në këtë fushë arritjet janë, gjithashtu, të mira.

Nga të dhënat del se për vitin 1981-1982 dhe për tetëmuajorin e këtij viti rendimenti i punës në ndërtim e në bonifikime është realizuar sipas planit, megjithëse numri i fuqisë punëtore në ndërtim nuk është plotësuar, mungesat pa arsye kanë qenë mesatarisht 3 ditë për çdo punëtor dhe se mbi 18 për qind e punëtorëve nuk kanë plotësuar normat. Të gjitha këto përbëjnë një rezervë konkrete që duhet shfrytëzuar në çdo ndërmarrje për të rritur sa më parë rendimentin e punës.

Faktor me rëndësi për uljen e shpenzimeve, si dhe për rritjen e rendimentit ka qenë dhe mbetet rritja e shkallës së mekanizimit. Për këtë kemi folur vazhdimisht dhe do të flasim, jo pse nuk kuptohet drejt, por se për mekanizimet e vogla ecet mjaft ngadalë.

Është e vërtetë që mekanizimi i madh ka efektivitet më të lartë, kur ai shfrytëzohet teknikisht mirë. Por dhe këtu punët nuk na ecin mirë, megjithëse mekanizmat e makineritë e rënda në ndërtim nuk janë të pakta. Për dy vitet e para të këtij pesëvjeçari ato janë shfrytëzuar 91-96 për qind, ndërsa në këtë tetëmuajor 96 për qind. Sa herë është theksuar e ritheksuar detyra për t'i rritur këta tregues? Komiteti Qendror tërheq vëmendjen, si për këtë gjendje e për këto mangësi në shfrytëzimin e kësaj force të konsiderueshme mekanizimi që kemi sot në ndërtim, ashtu edhe për punën që bëhet në industrinë mekanike për pjesët e ndërrimit të tyre. Prandaj kudo të bëhet një analizë e thelluar e kësaj gjendjeje dhe të merren masa të plota e të studiuar mirë, që shfrytëzimi i makinerive dhe i mekanizmave të rëndë në ndërtimet e në bonifikimet të rritet.

Në qoftë se sot në veprat që ndërtohen nga ndërmarrjet e Ministrisë së Ndërtimit gërmimet e dheut i kemi 80 për qind të



mekanizuara, prodhimin e betonit, të llaçit dhe transportin e tyre e hedhjen në vepër 84-93 për qind, në suvatime e bojatisje, në punimet përfundimtare etj. shkalla e mekanizimit nuk arrin as 50 për qind, gjë që flet edhe për shkallë të ulët të mekanizimit të vogël. Mesatarisht 61 për qind e punëtorëve të ndërtimit punojnë sot me dorë, kur janë mundësitë që ky numër të jetë në një nivel më të ulët, po të prodhohen në seri një sërë pajisjesh, mekanizmash e vegla pune, që janë studiuar dhe janë eksperimentuar prej vitesh. Ministria e Ndërtimit, në bashkëpunim me atë të Industrisë dhe të Minierave dhe me Komisionin e Planit të Shtetit, të studiojnë, brenda vitit, masat që duhen marrë për të rritur prodhimin e mekanizmave të nevojshëm në vitin 1984-1985.

Për sa i takon koston, në ndërtim ka akoma rezerva. Vite më parë Komiteti Qendror kritikoi shumë ashpër tejkalinimin e fondeve të planifikuara, sepse ishte vështirë të gjendej një vepër pa tejkaluar kufijtë financiarë të planifikuar. Tani gjendja ka ndryshuar dhe në përgjithësi janë të rralla rastet e tejkalimit të kufijve të objekteve, si në projektim, ashtu edhe në zbatimin e tyre. Por në këtë çështje ende ka rezerva jo të pakta që fillojnë nga caktimi i kufijve të financimit të veprave, në rezervat në projekte e preventiva dhe në zbatimin e tyre, si dhe tek ato të fondeve rezervë që parashikohen në preventiva, ngritje kantieri, shpenzime plotësuese etj. Por themelore këtu mbetet ulja e koston së vetë materialeve të ndërtimit që zënë rreth 60-70 për qind të shpenzimeve, prandaj projektuesit e preventivuesit **medoemos duhet të shtrëngojnë dorën, të bëjnë llogari të sakta e të kursyera e jo të mjaftohen me atë që janë brenda kufijve financiarë të planifikuar.** Këta kufij, në të shumtën e rasteve, janë parashikuar nga investuesit me mënyra krahasuese dhe me rezerva «për të qenë brenda». Pikërisht projektuesi e preventivuesi duhet t'i zbulojnë këto rezerva dhe jo t'i përdorin ato «për t'u ndihmuar» zbatuesi, që ky të ketë mundësi të mbulojë «të paparashikuarat» dhe dobësitë e tij. Vlerësimi i punës projektuese e preventivuese të bëhet jo vetëm nga vëllimi dhe shpejtësia e projektimit dhe e preventivimit, por, në radhë të parë, nga kursimet që ai realizon me llogaritje të sakta e të shtrënguara dhe me thjeshtim të teprimeve.

Për realizimin e detyrave për përfundimin në kohë dhe me koston e planifikuar të ndërtimeve, **vëmendje e posaçme i duhet kushtuar kontrollit të brendshëm dhe atij financiar e bankar,** për të realizuar prodhimin dhe akumulimin e planifikuar, për të parandaluar tejkalinimin e shpenzimeve materiale dhe monetare, si dhe për të zbuluar rrugë e mundësi të tjera për uljen e koston. E theksojmë këtë, sepse kudo në rrethe, si dhe në qendër, fuqizimit të këtij kontrolli, sidomos atij të brendshëm, nuk po i jepet rëndësia e duhur. Fakti është se organet financiare nuk

po realizojnë si duhet detyrat e kontrollit të investimeve, bile nga 57 specialistë që u shtuan në organikat e Bankës së Shtetit dhe të asaj Bujqësore për forcimin e këtij kontrolli, nuk kanë siguruar deri tani veçse 19 veta. Ky qëndrim është i palejueshëm. Në qoftë se puna zvarritet e nënvleftësohet qysh me caktimin e kuadrit, i cili duhet të jetë i aftë për të kontrolluar në thellësi shpenzimet që bëhen, atëherë aq më keq dhe aq më i paktë e i përciptë do të jetë vetë ky kontroll, megjithëse dihet që po nuk pati kontroll, nuk ka as përpjekje për të ulur shpenzimet, përkundrazi, shpërdorimet kanë rrugë të lirë.

Kontrolli me anë të lekut duhet të bëhet barrikadë e pakapërcyeshme e mbishpenzimeve dhe shpërdorimeve jo vetëm kur vijnë situacionet në bankë, por në vazhdimësi, në objekt dhe me kompetencë. Ai nuk duhet të presë, por të veprojë aktivisht dhe me rigorozitet për çdo lek të shpenzuar pa vend.

**Një problem i rëndësishëm është ai i mirëmbajtjes dhe i meremetimit të të gjitha godinave në shfrytëzim.** Dispozitat ligjore për këtë mirëmbajtje dhe meremetim ekzistojnë. Këto punime në tërësi dhe planifikohen. Por fakt është se shumë objekte jo vetëm industriale dhe të prodhimit, të bonifikimit apo të ujitjes, rrugë e asfaltime, por edhe ndërtesa të banimit shpesh, gjoja për të kursyer shpenzimet, lihen pa mirëmbajtje dhe vjetrohen e dëmtohen aq, sa është e vështirë të mendosh se janë ndërtuar një apo dy dekada më parë. Shembuj konkretë ka në çdo rreth, por fakt është që për to nuk ndalet njeri e t'i analizojë si një qëndrim të dënueshëm, që na rrit më vonë koston e meremetimeve të mëdha apo ripërtëritjet. Ministrinë përkatëse me ndërmarrjet e tyre vartëse, të cilat i shfrytëzojnë këto objekte, që e kanë detyrë ruajtjen dhe mirëmbajtjen e kësaj pasurie të madhe, të planifikojnë e të zbatojnë meremetimet e nevojshme. Ato dhe ndërmarrjet vartëse janë përgjegjëse për shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e kësaj pasurie të madhe që shtohet çdo vit. E theksojmë këtë, sepse edhe kontrollin bankar e financiar nuk mund ta përjashtojmë nga ky kujdes që duhet të bëjnë ato për mirëmbajtjen e trajtimin e këtyre investimeve të kryera dhe të kënaqen me «kursimet» që bëhen, duke dëmtuar e duke amortizuar para kohe objektet që ndërtojmë, pavarësisht se nga derdhjet në buxhet të fondit të amortizimit ato dhe mund të jenë vetëshlyer.

Në tërësinë e tyre, problemet e mangësitë e organizimit e të drejtimit janë kryesisht subjektive dhe varen nga puna e përpjekjet e organizatave-bazë të Partisë, të vetë komunistëve, kuadrove e specialistëve kudo që punojnë, në projektim e në zbatim. Prandaj puna e Partisë duhet të ketë për objektiv imediat e konkret zgjidhjen drejt të këtyre problemeve, kapërcimin e mangësive të vërtetuara në zbatim të direktivave dhe të orientimeve

të Partisë dhe, në radhë të parë, rritjen e shpejtë të efektivitetit të investimeve në tërësi dhe të ndërtimeve në veçanti.

«... çështjet e drejtimit e të organizimit, — theksoi shoku Enver në Plenumin e 7-të të Komitetit Qendror më 15 janar të vitit 1980, — përbëjnë tani një hallkë nga më vendimtarët, pas së cilës duhet të kapemi fort, për t'i çuar më përpara të gjitha punët: ... të ndërtimit e të mbrojtjes së socializmit në vendin tonë»<sup>1</sup>.

Pikërisht kështu duhen kuptuar dhe duhen realizuar detyrat që na vihen përpara për përsosjen e drejtimit dhe të organizimit, me një stil e metodë revolucionare, në luftë me rutinën, me avashllëkun dhe me shfajësimet e pathemelta. Ndryshe, detyrat nuk realizohen, planet nuk plotësohen në të gjithë zërat e treguesit, zhvillimi ynë pengohet.

Sot në ndërtime e bonifikime punojnë një numër i madh komunistësh, që militojnë në shumë organizata-bazë partie. Kjo është një forcë e madhe që i ka të gjitha mundësitë e kushtet të realizojë plotësisht e si duhet detyrat që ka vënë Partia për të çuar përpara ndërtimet dhe për të rritur vazhdimisht efektivitetin e tyre.

Shokë, problemet që u trajtuan më sipër vijnë e konkretizohen me realizimin e detyrave të planit. Sikurse dihet plani i investimeve dhe i ndërtimeve të pesëvjeçarit të shtatë, i miratuar në Kongresin e 8-të të Partisë, për dy vitet e para është realizuar përkatësisht 96 për qind dhe 95 për qind. Këto mosrealizime që e kanë shkakun te mangësitë e të metat që përmendëm, na kanë sjellë dhe pasoja, për të cilat kanë përgjegjësi, në radhë të parë, Ministria e Ndërtimit dhe organet e saj vartëse, Ministria e Bujqësisë dhe ndërmarrjet e bonifikimit, organet e tjera që kryejnë ndërtime, si dhe dikasteret investuese për pengesat e vështirësitë që u kanë sjellë. Por edhe komitetet e Partisë, organet shtetërore dhe ekonomike në rrethe e në bazë, organizatat-bazë të Partisë në to nuk kanë më pak përgjegjësi për dobësitë që janë vërtetuar, sidomos në fushën e organizimit e të drejtimit, të ndihmës e të kontrollit të vazhdueshëm për realizimin e planit.

Edhe në këtë vit, me përjashtim të ndërtimit të Hidrocentralit të Komanit, të disa objekteve industriale në Metalurgji e në Ballsh, të komplekseve blegtorale dhe të hekurudhës Shkodër-Hani i Hotit, për mjaft objekte të tjera, realizimi i detyrave nuk ka ecur sipas planit dhe janë krijuar deficite që duhen mbyllur sa më parë. Jo vetëm kaq, por edhe për objektet që parashi-

1. Enver Hoxha, «Raporte e fjalime 1980-1981», f. 9-10.

kohen të ndërtohen në vitin që vjen, e sipas dispozitave në fuqi, qysh këtë vit duhet të përgatiten brenda muajit qershor projektet e preventivat e plotë, është krijuar një prapambetje serioze. Deri më 31 gusht për të 206 veprat e ndërtimit me fonde kufi, janë përgatitur ose po punohet për projektimin e preventivimin vetëm për 140 vepra, ndërsa për veprat nën kufi, janë përgatitur projektet e preventivat për 90 për qind të tyre. Prapa është sidomos puna për vepra të Ministrisë së Energjetikës, të asaj të Industrisë e Minierave, të Ekonomisë Komunale e kështu me radhë. Në qoftë se zvarriten kështu këto detyra, atëherë dhe veprat nuk do të planifikohen e nuk do të ndërtohen sipas afateve të miratuara në Kongres. Kjo është serioze, prandaj Byroja Politike kritikon dikasteret investuese dhe të ndërtimit dhe porosit që menjëherë të organizohet me forca të përqendruara përfundimi në kohë i këtyre projekteve.

Krahas këtyre detyrave për projektimin e veprave prodhuese, duhet punuar dhe për projektimin e makinerive dhe të pajisjeve që do të vendosen në këto objekte. Ministria e Industrisë dhe e Minierave, vetë organet investuese të marrin masa e të bashkërendojnë detyrat për sigurimin në kohë të tyre, si dhe për importimin e atyre që nuk sigurohen nga prodhimi ynë. Çdo vonesë në këtë çështje është e dëmshme, sepse sjell të njëjtat pasoja, si dhe vetë ndërtimi e vënia në punë me vonesë e këtyre objekteve.

Duke trajtuar disa probleme të kohës për ndërtimet dhe duke përcaktuar edhe detyrat e masat përkatëse për zgjidhjen e tyre, Byroja Politike mendon se puna në ndërtime do të ngrihet në një nivel më të lartë. Ajo ka besim të plotë te ndërtuesit, punëtorë, specialistë e kuadro se, si kurdoherë do të mobilizohen dhe do të vënë të gjitha forcat e tyre mendore e fizike për të realizuar e zgjidhur ato më së miri.

Ndërtuesit janë njerëz të sprovuar e të sakrificës. Të edukuar e të udhëhequr nga Partia, ata kanë ngritur në çdo skaj të atdheut tonë vepra të mëdha e të rëndësishme që i kanë shtuar forcën ekonomisë sonë dhe kanë ngritur nivelin e mirëqenies së popullit tonë.

Ata kurdoherë kanë vënë mbi të gjitha interesat e lartë të atdheut e të popullit tonë dhe kanë ecur me vendosmëri në rrugën që ka caktuar Partia. Byroja Politike shpreh bindjen e plotë se edhe në të ardhmen ata do të ecin në këtë rrugë, të mobilizuar e të vendosur për të plotësuar deri në një detyrat që u vihen përpara nga Kongresi i 8-të i Partisë dhe nga mbledhja e këtij Plenumi të Komitetit Qendror.

*Botohet për herë të parë, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## V E N D I M

### I KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI EMËRTIMIN E HIDROCENTRALIT TË KOMANIT HIDROCENTRALI «ENVER HOXHA»

10 tetor 1983

Komiteti Qendror i PPSH në datën 10 tetor 1983,

#### V e n d o s i :

Me rastin e 75-vjetorit të ditëlindjes së shokut Enver Hoxha, dhe për të nderuar veprën e tij si themelues i Partisë dhe i shtetit tonë të ri, si udhëheqës i lavdishëm i Partisë dhe i popullit në luftën për çlirimin e atdheut dhe ndërtimin e socializmit, Hidrocentrali i Komanit të marrë emrin hidrocentrali «Enver Hoxha».

### KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i popullit»,  
nr. 249 (10 991), 15 tetor 1983*

## V E N D I M

### I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR MASAT QË DUHEN MARRË PËR PËRSOSJEN E DISA LEVAVE EKONOMIKE NË MARRËDHËNIET E SHTETIT ME KOOPERATIVAT BUJQËSORE

28 tetor 1983

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, në mbledhjen e datës 28 tetor 1983, pasi shqyrtoi studimin e paraqitur nga Këshilli i Ministrave «Për përsosjen e disa levave ekonomike në marrëdhëniet e shtetit me kooperativat bujqësore»,

#### V e n d o s i :

1. — Levat ekonomike në marrëdhëniet e shtetit me kooperativat bujqësore të synojnë në arritjen e disa objektivave themelore të politikës ekonomike të Partisë në dobi të shtimit të prodhimit bujqësor e blegtoral, rritjes së efektivitetit të shpenzimeve dhe të rentabilitetit të tyre, që të mbajë mirë parasysh punën dhe përpjekjet e kooperativistëve. Krahas këtyre, të arrihet në rritjen e fondit të akumulimit të shtetit e të kooperativave bujqësore për intensifikimin e mëtejshëm të bujqësisë, duke u mbështetur më shumë në forcat dhe në burimet e vetë kooperativave bujqësore.

2. — Miratimin e masave të propozuara nga Këshilli i Ministrave për disa ndryshime në çmimet e blerjes së domateve për eksport dhe në tarifën e punimeve nga SMT-të, të bimëve mjekësore dhe të disa nënprodukteve industriale.

3. — Në klasifikimin e kooperativave bujqësore për derdhjen e të ardhurës neto të centralizuar të shtetit kriteri bazë të jetë fuqia ekonomiko-financiare e tyre dhe, si rregull, shtimi i vazhdueshëm i numrit të kooperativave që do të derdhin të ardhur të



centralizuar, si dhe kalimi i tyre nga tarifa më e ulët në tarifën më të lartë.

4. — Të studiohet, të eksperimentohet dhe të kalohet në blerjen e panxharsheqerit, të lulediellit dhe të ullirit për vaj sipas përmbajtjes së digesties dhe të rrezes së vajit.

5. — Në bazë të përvojës së fituar nga kalimi i disa SMT-ve nga forma e financimit buxhetor në atë të drejtimit të plotë ekonomik, të kalojnë edhe SMT-të e tjera që me të ardhurat mbulojnë shpenzimet.

6. — Rritja e të ardhurave të kooperativave bujqësore dhe e akumulimeve shtetërore e ka bazën në prodhim, prandaj edhe në të ardhmen të luftohet, në radhë të parë, për plotësimin e detyrave të planit në tërë treguesit ekonomiko-financiarë. Për këtë, organet dhe organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë në qendër, në rrethe dhe në kooperativat bujqësore të shtojnë më tej përpjekjet dhe të ngrenë më lart drejtimin teknik, ekonomik e financiar, të cilat të synojnë në plotësimin e detyrave në sasi, në cilësi, në asortiment, në uljen e kostos së prodhimit dhe në rritjen e efektivitetit të prodhimit, të investimeve, të plehrave kimike dhe në shfrytëzimin e plotë të aftësive prodhuese.

7. — Këshilli i Ministrave të marrë masa për zbatimin e këtij vendimi.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## PLENUMI I 8-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 19-20 dhjetor 1983

### K O M U N I K A T E

## E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 19 dhe 20 dhjetor 1983, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror të PPSH, i cili mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Për plotësimin e planit të vitit 1983 dhe detyrat kryesore të projektplanit të vitit 1984», mbajtur nga kandidati i Komitetit Qendror të PPSH dhe kryetar i Komisionit të Planit të Shtetit, shoku Harilla Papajorgji.

Pasi diskutoi gjerësisht rreth raportit të paraqitur dhe dëgjoi konkluzionet që bëri për këtë çështje anëtari i Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH dhe Kryetar i Këshillit të Ministrave të RPSSH, shoku Adil Çarçani, Plenumi i Komitetit Qendror i miratoi ato njëzëri dhe mori vendimet përkatëse.

## PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

## RAPORT

### I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «PËR PLOTËSIMIN E PLANIT TË VITIT 1983 DHE DETYRAT KRYESORE TË PROJEKTPLANIT TË VITIT 1984»

19 dhjetor 1983

Shokë,

Byroja Politike, në analizën që i bëri realizimit të detyrave të planit të vitit 1983 arriti në përfundimin se, me gjithë kushtet e rrethimit e të bllokadës dhe vështirësitë e jashtëzakonshme të krijuara nga thatësira dhe mosrealizimet në energjetikë, u shënuan suksese të mëtejshme në zhvillimin e gjithanshëm të vendit duke u mbështetur plotësisht në forcat tona. Ato mbajnë vulën e mobilizimit e të përpjekjeve të shumta të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste e të inteligjencies popullore për të vënë në jetë detyrat e caktuara nga Kongresi i 8-të i Partisë.

Festimi nga Partia dhe mbarë populli ynë i 75-vjetorit të lindjes së shokut Enver Hoxha, letërkëmbimet e ngrohta dhe inkurajuese për arritjet e shënuara nga rrethe dhe kolektiva të ndryshëm, si dhe takimi me punëtorë e kooperativistë të pararojës u bënë burim i madh frymëzimi për të çuar më përpara punët dhe për të luftuar më me vendosmëri për kapërcimin e pengesave e të vështirësive.

Shpartallimi dhe dënimi i bandës kundërrevolucionare të poliagjentit Mehmet Shehu, Kadri Hazbiut dhe bashkëpunëtorëve të tyre forcoi më tej vigjilencën revolucionare të Partisë dhe të mbarë popullit, çelicosi akoma më shumë unitetin rreth Komitetit Qendror të Partisë me shokun Enver Hoxha në krye, e bëri më të pathyeshme mbrojtjen e atdheut tonë socialist.

## I. Plotësimi i detyrave kryesore të planit të vitit 1983

Gjatë vitit 1983 u realizua riprodhimi i zgjeruar socialist. Produkti shoqëror u rrit 3 për qind dhe mesatarisht gjatë tre viteve të këtij pesëvjeçari mbi 4 për qind. U fuqizua më tej baza materialo-tekhnike në gjithë degët dhe sektorët e ekonomisë. Burimet materiale dhe financiare të vendit përballuan nevojat e zhvillimit të prodhimit, ato social-kulturore dhe të mbrojtjes. Niveli i mirëqenies së popullit u rrit më tej dhe u bë një hap përpara në ngushtimin e dallimeve midis fshatit dhe qytetit.

Në industri, me gjithë vështirësitë në energjetikë, prodhimi i përgjithshëm u rrit 3 për qind dhe si mesatare trevjeçare, 4,6 për qind. Plani realizohet ose tejkalohet në qymyrguri, në prodhimet mekanike, në ato të drurit, të qelq-qeramikës, në disa prodhime ushqimore etj. Edhe pse nuk arrihen plotësisht objektivat e planit, u prodhuan më shumë se viti i kaluar 30 për qind çelique të petëzuara, tuba drenimi, stofra etj.

Në bujqësi, rezultatet e këtij viti janë mjaft më të mira nga çdo vit tjetër i pesëvjeçarit. Në krahasim me vitin 1982, prodhimi i përgjithshëm bujqësor rritet rreth 9 për qind. Në 11 artikuj të rëndësishëm realizohen dorëzimet, në grurë e thekër plani i prodhimit u tejkalua për 26 mijë tonë dhe u arrit rendimenti më i lartë i derisotëm, 31 kv për hektar. Edhe prodhimi i misrit pritet të jetë më i madh nga i vitit 1982, por më pak nga plani. Plani tejkalohet në luledielli, në fruta, në ullinj. Në krahasim me vitin e kaluar pati gjithashtu rritje të ndjeshme në prodhimin e patates, të fasules, të perimeve, të qumështit, të vezëve etj., gjë që është pasqyruar edhe në gjendjen më të mirë të furnizimit të tregut.

Një tipar dallues që po forcohet në bujqësi është se përvoja e përparuar po del përherë e më tepër nga kufijtë e brigadave e të ekonomive të veçanta. Në zonën që intensifikohet me përparësi, në 26 mijë ha, u morën 46,6 kv grurë për hektar. Rrethi i Shkodrës në 2 800 ha dhe ai i Sarandës, në 800 hektarë të zonës fushore, realizuan 80 kv misër për ha. Për rezultate të mira e rendimente të larta në disa kultura u dalluan rrethet e Sarandës, Shkodrës, Tiranës, Durrësit, Gjirokastrës, Vlorës, Lezhës, Kukësit, Skraparit etj. Këto arritje flasin qartë për drejtësinë e vijës së Partisë për zhvillimin në front të bujqësisë dhe për intensifikimin me përparësi në zonën fushore.

Plenumi i 7-të i Komitetit Qendror të Partisë i dha një shtytje të mëtejshme punës në ndërtim dhe çeli perspektiva të reja. Sivjet ndërtimet u vunë më mirë në shërbim të prodhimit dhe të veprimtarive të tjera shoqërore. Deri tani janë vënë në shfrytëzim 62 vepra, prej të cilave 48 prodhuese. U hapën disa miniera

qymyrguri, bakri e kromi, u ndërtua fabrika e prodhimit të kartonit katramat, u zgjeruan fabrika të pasurimit të bakrit, 7 linja të industrisë së lehtë dhe ushqimore, 5 komplekse blegtorale, u vunë nën ujë brenda sezonit mbi 5 000 ha tokë, u ndërtuan hekurudha Shkodër-Bajzë, 3 frigoriferë, mjaft vepra social-kulturore dhe 10 500 apartamente banimi, duke plotësuar detyrat për tre vjetët e pesëvjeçarit të marrë së bashku. Me ritme të shpejta vazhdojnë punimet në ndërtimin e hidrocentralit «Enver Hoxha» në Koman, në uzinën e vajrave lubrifikante, në zgjerimin e fabrikës së superfosfatit në Laç dhe në mjaft vepra të tjera që do të vihen në shfrytëzim në dy vjetët e ardhshëm.

Në vitin 1983 u bënë hapa përpara për zbatimin e politikës së Partisë në fushën e mirëqenies. Të ardhurat reale për frymë të popullsisë u rritën mbi 4 për qind. U rrit fuqia blerëse e popullit dhe qarkullimi i mallrave me pakicë u shtua afro 6 për qind. Hapa të mëtejshëm u bënë në zhvillimin e arsimit, të kulturës dhe të shëndetësisë. U forcua roli i tyre për edukimin e punonjësve dhe për ruajtjen e shëndetit të popullit. Festivali Folklorik i Gjirokastrës ishte një festë e bukur e artit tonë popullor, që manifestoi edhe një herë forcën e tij krijuese dhe edukuese.

Në bazë të objektivave të Kongresit të 8-të të Partisë u zbatuan disa masa për përsosjen e marrëdhënieve në prodhim. Kooperativat e zakonshme në zonën që intensifikohet me përparësi për investimet po trajtohen njëjloj si kooperativat e tipit të lartë. Filloi procesi i kthimit të kooperativave të tipit të lartë më të avancuara në ndërmarrje bujqësore, me ngritjen e ndërmarrjes së Plasës dhe të Grecallisë. U studiua dhe po merren masa për përsosjen e sistemit të grumbullimit, që ai t'i përgjigjet më mirë prodhimit të madh bujqësor dhe të rritë vlerën e tij. Përqendrimi dhe specializimi i kulturave bujqësore po thellohet më tej, kryesisht në zonën që intensifikohet me përparësi. Një masë e rëndësishme është ulja e çmimeve të disa lloj barnave me një përfitim vjetor për popullin prej 17 milionë lekësh.

Byroja Politike, duke vlerësuar realizimet në të gjitha fushat e jetës gjatë vitit 1983, me gjithë vështirësitë e krijuara, arriti në përfundimin se **bilanci i përgjithshëm i luftës, i përpjekjeve dhe i realizimeve është pozitiv e inkurajues**. Kjo është një fitore e madhe për vendin tonë, e realizuar në një kohë kur në botën kapitalisto-revizioniste kriza vazhdon me intensitet, stanjacioni e rënia e prodhimit janë bërë dukuri masive, dhe punonjësit janë të detyruar të mbajnë mbi shpatulla papunësinë, inflacionin, që thellohet dhe koston e jetesës në rritje.

Duke i vlerësuar si pozitive arritjet dhe situatën e përgjithshme të shëndoshë, Partia na mëson që **të analizojmë thellë, me sy kritik dhe me përgjegjësi edhe deficitet e krijuara dhe dobësitë**

**që janë vërtetuar në punën e organeve të Partisë, të shtetit dhe të ekonomisë për plotësimin e detyrave të planit.**

Prodhimi shoqëror ka vazhduar të rritet, por kundrejt objektivave të planit ka deficite...

Viti 1983 vërtetoi edhe një herë drejtësinë e vijës së Partisë e të mësimeve të shokut Enver Hoxha se energjetika është dega më e rëndësishme dhe më nevralgjike, nga e cila përcaktohen në një masë mjaft të madhe mundësia dhe ritmi i zhvillimit në tërësi i forcave prodhuese të vendit dhe plotësimi i nevojave të tjera të shoqërisë. Prandaj asaj i duhet kushtuar kurdoherë një vëmendje e posaçme.

Shkaqet e këtyre mosarritjeve duhet t'i kërkojmë e t'i gjejmë në dobësitë e punës drejtuese e organizuese, në mungesën e përgjegjësisë dhe mosbashkërendimin si duhet të punëve që nga Drejtoria e Përgjithshme, institutet e gjeologjisë e të teknologjisë dhe deri në ndërmarrjet e sistemit të naftës. Në naftë nuk ndihet ai mendim i ri novator për zbatimin e përvojës së përparuar dhe të të rejave të shkencës dhe të teknikës. Akoma në sektorin e naftës vërehen thyerje të palejueshme të disiplinës së punës dhe asaj teknike, që na kanë çuar në avarira me humbje jo të vogla për ekonominë...

Byroja Politike për këtë sektor kërkon të bëhet kthesë rrënjësore, duke vënë, gjithashtu, në dukje nevojën e një lufte më të vendosur nga të gjithë komunistët dhe kuadrot e këtij sektori për të zhdukur pasojat e punës armiqësore që shfaqen në metodën e punës, në një frymë liberale ndaj detyrave etj. Është e nevojshme gjithashtu të rishikohen me sy kritik edhe organizimi i punës e marrëdhëniet ndërmjet organizmave të ndryshëm që veprojnë në këtë sektor.

Si rezultat i thatësirës së zgjatur të këtyre dy vjetëve, në energjinë elektrike për vitin 1983 u krijuar një deficit që rëndoi si ekonominë brenda vendit, ashtu edhe eksportin. Kjo gjendje u kapërcye vetëm me pasoja të pjesshme, në sajë të forcimit të regjimit të kursimit dhe të futjes në shfrytëzim të aftësive rezervë të termocentraleve. Sivjet u vërtetua edhe një herë drejtësia e vijës së Partisë dhe largpamësia e politikës së saj për zhvillimin në kompleks të industrisë energjetike, me naftën e gazin, me prioritetin e hidrocentraleve në krahasim me termocentralet dhe duke rritur peshën e qymyrgurit në bilancin energjetik të vendit.

Në qoftë se për energjinë elektrike nga hidrocentralet nuk kishim çfarë t'u bënim kushteve të motit, në industrinë e kromit apo në Kombinatin Metalurgjik, në Uzinën e PVC-së në Vlorë e në Kombinatin Kimikometalurgjik në Laç apo në sektorë të tjerë mosrealizimet vijnë kryesisht, për të mos thënë tërësisht, për shkaqe subjektive, për shkelje të vazhdueshme të teknologjive, për të meta dhe dobësi në organizimin dhe disiplinën e punës...



E theksojmë këtë sepse, kur Komiteti i Partisë i Rrethit të Elbasanit dhe Ministria e Industrisë dhe e Minierave u morën me seriozisht me Kombinatin Metalurgjik, u mobilizuan organizatat e Partisë dhe kolektivat punonjës, edhe detyrat në tremujorin e katërt u realizuan më mirë.

Industria e lehtë dhe ushqimore e rriti më tej prodhimin, thithi më mirë prodhimet bujqësore e blegtorale dhe përmirësoi në disa drejtime strukturën e produkteve. Megjithatë edhe në këtë degë është e nevojshme të luftohet më mirë për cilësinë e prodhimeve dhe llojshmërinë e tyre, për shfrytëzimin më të plotë të aftësive prodhuese. Më shumë e më mirë duhet punuar gjithashtu për miradministrimin e pronës dhe të luftohet për të mbyllur shtigjet kundër vjedhësve e shpërdoruesve. Në këtë drejtim Ministria e Industrisë së Lehtë e Ushqimore dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve, e në veçanti të atyre që kanë më shumë ndërmarrje të tilla, si: Tirana, Durrësi, Shkoder, Korça etj., të ndalen seriozisht dhe të organizojnë konkretisht punën për të forcuar rregullat administrative dhe për të ngritur në këmbë opinionin shoqëror në luftë kundër keqadministrimit të pronës socialiste.

Në bujqësi, siç u theksua, u arritën rezultate, por deficitet vazhduan edhe këtë vit... Mosrealizime kundrejt planit pati sidomos në misër, në patate, në fasule, në mish, në qumësht, në pambuk dhe në duhan. Rezultate të dobëta në bujqësi patën veçanërisht rrethi i Librazhdit, Mirditës, Gramshit, Korçës (për zonën kodrinore-malore). Në Plenumin e 6-të të Komitetit Qendror u kritikuan rrethi i Fierit e i Lushnjës për mosmarrjen e masave në kohë për plotësimin e objektivave që u caktuan për zonën e intensifikimit me përparësi. Por kthesa e kërkuar nuk u realizua as këtë vit. Me përjashtim të grurit dhe të lulediellit, këto dy rrethe, që përbëjnë qendrën e zonës bregdetare që intensifikohet me përparësi, nuk kanë realizuar planin në mjaft kultura, sidomos në misër, pambuk dhe në mish.

Deficitet jo të vogla në prodhimin bujqësor janë pasojë e prirjeve të dëmshme të njëanshmërisë në drejtimin e prodhimit nga Ministria e Bujqësisë dhe nga komitetet e Partisë dhe ato ekzekutive të rretheve përkatëse. Kjo duket në kujdesin e pamjaftueshëm për bimët industriale e veçanërisht në blegtori. Pa ndryshuar konceptet dhe qëndrimet ndaj bazës ushqimore dhe rritjes numerike, nuk mund të realizohen detyrat që ka caktuar Partia për blegtorinë.

Në sektorin e ndërtimit, kërkohet të mënjanohet prirja e përhapjes në shumë objekte dhe të përdoret më gjerësisht metoda e aksionit për fillimin dhe përfundimin në kohë të veprave. Aksione janë ndërmarrë për banesa me kontribut vullnetar, në një kohë që vëmendja kryesore duhet përqendruar më shumë në ve-

prat e prodhimit që i hapin rrugën edhe vetë zhvillimit të sferës joprodhuese. Kjo duhet kuptuar drejt dhe realisht nga të gjithë. Po nuk eci prodhimi nuk mund të ecin sektorët joprodhues. Numri i objekteve të pavëna në shfrytëzim është ende i madh. Edhe ndërmarrjet e bonifikimit të Ministrisë së Bujqësisë dalin me deficite të ndjeshme. Prandaj duhet të marrim masa të forta për përfundimin në kohë të veprave ujore që kemi në proces, të cilat lidhen me arritjen e detyrave të planit në bujqësi.

Veçanërisht duhet të rritet kujdesi nga ministritë dhe nga komitetet ekzekutive për objektet nën kufi, që sot janë barsa sa 2/3 e investimeve të vitit 1960 dhe që për një pjesë prej tyre mungojnë studimet e nevojshme, por janë dhe të shpeshta rastet që gjatë vitit u ndërrohet destinacioni, duke i kaluar nga prodhuese në joprodhuese. Kjo duhet kontrolluar e duhet parë më seriozisht për investimet e vitit 1984.

**Për mbarëvajtjen e investimeve e të ndërtimeve, siç porosit shoku Enver, figura qendrore duhet të bëhet investitori.** Prandaj është e nevojshme të rritet përgjegjësia dhe veprimi aktiv i tij mbi organet projektuese e zbatuese, mbi prodhuesit e makinerive dhe tregtinë e jashtme, duke luftuar frymën e liberalizmit dhe të lëshimeve reciproke, që ende është e theksuar. Këtu edhe kërkesa e llogarisë duhet të rritet ndaj investitorit nga Këshilli i Ministrave, nga organet e planit e të financës dhe Banka e Shtetit, që kohët e fundit u fuqizua me kuadro për sektorin e investimeve.

Partia i rithekson me forcë këto çështje sepse... investimet bëhen për të marrë prodhim, për të siguruar të ardhura dhe për të zënë njerëzit me punë. Pra për të çelur dhe garantuar perspektivat e reja dhe jo për të rënduar ekonominë.

Duke punuar për të vënë në jetë detyrat e Plenumit të 5-të të Komitetit Qendror, **sektori i transportit** ka kryer sivjet një vëllim pune në ton prej 6 për qind mbi atë të vitit të mëparshëm dhe u rrit diçka pesha e transportit hekurudhor. Por nga aritmitë në prodhim kemi pasur edhe punë me hope në transport. Ashtu sikurse vetë punonjësit e transportit duhet të luftojnë për një manovrueshmëri më të madhe, sepse disa prodhime masive si qymyrguri, lënda drusore, fruta, makineri e pajisje duhet të çohen në destinacion.

Problem mbetet shfrytëzimi më i mirë i aftësive transportuese me hekurudhë ku plani nuk realizohet si edhe të mos lejohet ulja e mëtejshme e treguesve cilësorë të punës së gjithë llojeve të transportit. Po ashtu transporti detar i brendshëm nuk po vlerësohet si duhet dhe nuk po e bën kthesën që kërkohet.

Me kushtet që u krijuan, sidomos nga energjetika, në fushën e tregtisë së jashtme u desh të përballohen probleme më të mëdha e të bëhen një sërë manovrimesh për të shtuar eksportin e disa mallrave dhe për të futur mallra të reja, si dhe për të

kaluar importin e disa mallrave nga një treg në tjetrin. Nga organet e tregtisë së jashtme u bë një punë e mirë për përgjysimin e mallrave që kishin gjendje në depot e tyre dhe vëllimi i eksportit dhe importit u rrit diçka në krahasim me vitin e kaluar.

Por tregtia e jashtme mbetet një sektor nga më të rëndësishmit dhe me probleme delikate për ecurinë e prodhimit dhe prestigjin e vendit tonë. Prandaj plotësimi ritmikisht i detyrave, si nga prodhuesit dhe ndërmarrjet e tregtisë së jashtme mbetet detyrë kryesore. Organet e tregtisë së jashtme duhet të punojnë më me shkathtësi, sidomos për shitjen e mineraleve të reja e të disa produkteve të tjera, për të njohur e shfrytëzuar më mirë koniunkturat dhe për t'u shtrirë në tregje të tjera. Gjithashtu këto organe duhet të luftojnë më shumë për të zbutur edhe efektet financiare negative të strukturës së eksportit. . .

Mosrealizimet në ekonomi kanë bërë që edhe të ardhurat e buxhetit të shtetit të mos arrihen kundrejt planit. Para kësaj gjendjeje, Këshilli i Ministrave mori masa gjatë vitit për të shkurtuar disa shpenzime, me qëllim që buxheti të jetë i balancuar. . .

Nga analiza që po i bëjmë realizimit të planit të vitit 1983 dhe të orientimeve të Plenumit të 6-të të Komitetit Qendror, dalin edhe disa përfundime të cilat duhet t'i mbajmë mirë parasysh për realizimin e detyrave të mëdha që kemi përpara.

Deficitet në energjetikë ishin të ndjeshme, por do të ishte gabim që çdo mosrealizim të justifikohet e të lidhet vetëm me mungesën e energjisë elektrike dhe me kufizimet në karburante. Një gjykim i tillë do na pengonte të bënim një analizë objektive të të gjitha shkaqeve të mosarritjeve dhe të caktonim masat e nevojshme për t'i kapërcyer vështirësitë e pengesat në luftën për plotësimin me sukses të planit pesëvjeçar.

Duhet të jetë e qartë për të gjithë ne se edhe në vitin 1983 nuk janë shfrytëzuar si duhet mundësitë njerëzore, teknike, shkencore, materiale dhe organizative në luftën për realizimin e planit. Një pjesë jo e vogël e mosrealizimeve janë pasojë e të metave subjektive, duke filluar që nga Këshilli i Ministrave dhe Kryesia e tij e deri në ndërmarrje e kooperativa. Këto të meta janë shfaqur në metodën e punës, në dukuritë e dëmshme të njëanshmërisë e të globalizmit në plotësimin e detyrave të planit, si dhe në prirjet e ngushta të frymës dikasteriale, lokale e «të shpirtit të ndërmarrjes», të cilat duken akoma në mjaft raste dhe na dëmtojnë punën.

Lufta dhe përpjekjet e këtij viti na dhanë edhe një përvojë të pasur. Kryesore në kapërcimin e vështirësive është puna e organizatave të Partisë, e organizatave të masave, e organeve të pushtetit dhe të ekonomisë për t'i bërë të ndërgjegjshëm punonjësit e për t'i mobilizuar ata në shkallë më të lartë. Ky është një mësim i madh që vërteton edhe një herë drejtësinë e porosive të vazhdueshme të shokut Enver Hoxha që, kurdoherë, të mbësh-

tetemi fuqimisht te masat, t'u drejtohem atyre për problemet e vështirësitë që na dalin në rrugën tonë dhe të mësojmë nga forca krijuese dhe nga fryma e tyre e sakrificës.

Gjithashtu, në bazë të porosive të Byrosë Politike dhe personalisht të shokut Enver Hoxha, Këshilli i Ministrave dhe organet shtetërore ndoqën më mirë dinamikën e punëve dhe bënë një sërë manovrimesh për çdo tremujor e muaj e deri për periudha më të shkurtra. Këto masa u përqendruan në forcimin e regjimit të kursimit, në shfrytëzimin e aftësive prodhuese në kushtet e mungesës së energjisë, në shtimin e eksporteve, në futjen në qarkullimin ekonomik të disa vlerave materiale që nuk po përdreshin prej vitesh, si dhe në pakësimin e shpenzimeve administrative. Manovrimet të tilla për zbulimin dhe mobilizimin e rezervave të brendshme duhet të sugjerojnë më shumë edhe vetë ministrinë, rrethet dhe ndërmarrjet dhe jo të nxjerrin pengesa kur u bëhen sugjerime për rrugëzgjdhje më efektive.

Në punën për realizimin e planit dhe për kapërcimin e vështirësive, gjeti një vend më të gjerë zbatimi i metodës së aksionit për mobilizimin e rezervave të brendshme, për ndërtimin në afat të disa veprave industriale e të ujitjes që lidheshin me sezonin, për fushatat në bujqësi etj. Me aksion u grumbulluan dhe u futën në përdorim mbi 18 mijë tonë hekur, 2 000 tonë tuba naftë, bateri të automjeteve etj. Rezerva të tilla ekonomia jonë ka pa mbarim, prandaj edhe puna dhe aksionet për mobilizimin e tyre duhet të jenë të vazhdueshme.

Viti 1983 tregoi edhe një herë drejtësinë e vijës së Partisë për krijimin dhe fuqizimin e rezervave operative pranë ndërmarrjeve e dikasterëve, si dhe të rezervës shtetërore materiale e valutore. Efektet e vështirësive të krijuara do të kishin qenë shumë më të mëdha dhe më të ndjeshme në qoftë se nuk do të kishim rezerva të tilla. Prandaj, për rezerva materiale, brenda fondeve që jepen në plan, duhet të mendojë çdo ndërmarrje dhe kooperativë bujqësore, çdo komitet ekzekutiv apo dikaster.

Si përfundim, rezultatet e vitit 1983, në gjithë kompleksin e tyre, duke pasur parasysh edhe vështirësitë e jashtëzakonshme që na dolën, flasin qartë për epërsitë e rendit tonë socialist, për drejtësinë e vijës së Partisë, për qëndrueshmërinë dhe forcën e ekonomisë sonë socialiste që na krijojnë mundësi të ecim kurdoherë përpara.

## II. Detyrat kryesore të planit të vitit 1984

Projektplani dhe projektbuxheti i shtetit për vitin 1984 bazohen në planin e shtatë pesëvjeçar, në orientimet e direktivat e herëpashershme që ka shtruar Partia kohët e fundit, në mësimet



e porosité që shoku Enver Hoxha jep në librin «Për planin e shtatë pesëvjeçar», si dhe në arritjet e vitit 1983. Por ky vit ka veçoritë dhe tiparet e veta, të cilat, siç theksoi Byroja Politike, duhet të mbahen mirë parasysh për realizimin e detyrave që po shtrohen në këtë plenum.

**Plani i vitit 1984 parashikon ritme të larta zhvillimi.** Produkti shoqëror, të ardhurat kombëtare dhe prodhimi industrial parashikohet të rriten përkatësisht mbi 8,5 për qind, ose dy herë më shumë nga mesatarja e tri viteve të këtij pesëvjeçari; prodhimi bujqësor 14,3 për qind nga 9 për qind që u realizua sivjet, të ardhurat financiare 6,2 për qind nga vetëm 0,4 për qind që u rritën këtë vit. Me ritme të shpejta do të ecin gjithashtu eksporti, investimet, transporti, qarkullimi i mallrave etj.

Këto ritme janë të domosdoshme për t'u arritur sepse dikohen nga nevojat e ekonomisë e të popullit, nga zhvillimi i sektorëve sociokulturorë dhe fuqizimi i mbrojtjes. Ato janë të domosdoshme për t'u arritur, me synim që të mbështetet më mirë plani i vitit 1985, ku detyrat do të jenë më të mëdha.

Ritmet e zhvillimit, na mëson Partia, nuk janë një dëshirë. Në to gjejnë materializim kërkesat e ligjeve ekonomike dhe programi i Partisë për zhvillimin e vendit, në rrugën e socializmit. Po të mos arrihen këto, do të krijoheshin vështirësi për zënien me punë të forcave të reja, do të prekej mirëqenia dhe do të frenohet zhvillimi i forcave prodhuese...

Për të pakësuar këtë ndikim u gjetën mundësi për të rritur prodhimin në degë të tilla si në nxjerrjen e qymyrgurit, të kromit, të bakrit, në industrinë mekanike, atë kimike, të drurit e të letrës etj.

**Plani i vitit 1984 është i mbështetur dhe i balancuar me bazën materiale, financiare, valutore dhe me investime.** Por mundësitë e manovrimit do të jenë më të kufizuara, në rast se nuk realizohen detyrat, qoftë edhe në sektorë të veçantë, jo më në degët kyç të ekonomisë. Kjo sepse në disa degë do të hyhet me rezerva relativisht më të vogla të lëndëve të para e të materialeve, sidomos të importit. Gjithashtu tregtisë së jashtme i duhen siguruar mallrat për eksport qysh në ditët e para të janarit dhe çdo muaj me grafik rigoroz, ndryshe s'ka nga gjenden burimet për import. Prandaj organet dhe organizatat e Partisë t'i bëjnë të gjithë kuadrot e punonjësit më të ndërgjegjshëm për domosdoshmërinë e realizimit të planit me mundësitë materiale e financiare që parashikojnë plani dhe buxheti i shtetit.

Viti 1984 përmban gjithashtu detyra mjaft të ngjeshura edhe për rritjen e efektivitetit të ekonomisë. Nivelet e prodhimit, të ndërtimit e të shërbimit bazohen në zbatimin kudo të një regjimi të rreptë kursimi në përdorimin e lëndëve të para, të produkteve energjetike etj. Veçoria e këtij viti në fushën e kostos është se,

megjithëqë kuotat e planit pesëvjeçar në prodhim nuk qe e mundur të arrihen, plani i uljes së kostos për vitin 1984 është mbi kuotat e pesëvjeçarit, dhe arrin shumë prej 353 milionë lekë. Prandaj, lufta për efektivitetin përbën një front të rëndësishëm ku komitetet e Partisë, organizatat-bazë dhe levat e tyre duhet të ndalen seriozisht dhe të rritin frymën e besimit të punonjësve se këto detyra janë plotësisht të realizueshme.

Më poshtë po japim disa nga drejtimit e politikës së Partisë dhe detyrat kryesore të planit për vitin 1984.

**Në industri, siç theksoi shoku Enver në mbledhjen e Byrosë Politike, vëmendja duhet të përqendrohet në zhvillimin e energjetikës, në radhë të parë në naftë, me qëllim që të dilet nga prapambetja, të rritet shkalla e garancisë për plotësimin e detyrave dhe të bëhet një hop i madh përpara për ta përgatitur këtë degë, që, në vitin 1985 të mund të arrijë objektivat e planit pesëvjeçar për këtë vit.**

Në hartimin e planit është mbajtur parasysh orientimi i Kongresit të 8-të të Partisë që nxjerrja e naftës të mbështetet në vendburimet e njohura...

Krahas naftës, në mënyrë të pandarë nga ajo, kërkohet të ndiqet nxjerrja e gazit dhe zbulimi i vendburimeve të reja. Çdo deficit në gaz rëndon në plehrat kimike dhe vështirëson realizimin e detyrave të ngjeshura në bujqësi. Nxjerrja e naftës dhe e gazit rrezaton përnjëherë në të gjitha degët dhe sektorët e ekonomisë. Prandaj çështja e realizimit ritmik dhe e zënies së kuotave të parashikuara për naftë e gaz qysh në fillim të vitit dhe realizimi i grafikëve për çdo muaj e tremujor duhet të jetë në qendër të vëmendies së organeve dhe të organizatave të Partisë, në rrethet dhe në gjithë sistemin e naftës.

Plotësimi i planit të naftës dhe të gazit, duke u përqendruar në vendburimet ekzistuese, kërkohet të shoqërohet me doemos me kryerjen e studimeve e të punimeve për zbulimin e strukturave e të vendburimeve të reja, ku ka prapambetje, me gjithë investimet në rritje që po bëhen. Kështu garantohej më mirë realizimi i detyrave dhe hapen perspektiva më të mira për të ardhmen.

Prodhimi i energjisë elektrike parashikohet të jetë me rritje... Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet shfrytëzimit racional të rezervave ujore të hidrocentraleve, punës me kapacitet të plotë të termocentraleve që punojnë me qymyre, si dhe rritjes së prodhimit nga hidrocentralet e vogla dhe të mesme. Për të fuqizuar e për të rritur sigurinë e sistemit energjetik, gjatë vitit 1984 do të kryhen studime të plota për zgjerimin e prodhimit të qymyrgurit në pellgun e Tiranës për të bërë të mundur ndërtimin në të ardhmen të një termocentrali. Gjithashtu do të kryhen studime të mëtejshme për ndërtimin e hidrocentraleve të vogla, me synim që në një të ardhme të afërt me prodhimin e tyre të plotësohen



të gjitha nevojat e ndriçimit e të konsumit familjar të popullsisë, nga 1/3 që arrihet sot. Në bazë të orientimeve të Partisë, në degën e qymyrgurit janë vënë detyra më të larta nga kuotat e vitit 1984 dhe do të punohet për të ecur me perspektiva më të largëta. Këtu kërkohet që vëmendja të përqendrohet në shfrytëzimin racional të qymyrgureve dhe, sidomos, të mos nënvleftësohen qymyrguret me fuqi të ulët kalorifike, siç ndodh sot. Duke ecur në këtë rrugë do të krijohen mundësi më të mëdha dhe reale për të rritur peshën e qymyrgureve në bilancin energjetik dhe atë valutor.

Mbështetur në rezervat e zbuluara dhe në nevojat e vendit, në planin e vitit 1984 është parashikuar që minerali i kromit të jetë 40 mijë tonë dhe prodhimi i bakër bliserit mbi 1 000 tonë më shumë nga detyra e pesëvjeçarit. Gjithashtu në vitin e ardhshëm parashikohet të futen në shkallë më të gjerë në qarkullimin e ekonomisë edhe pasuri të tjera nëntokësore si zhavori bituminoz, boksitet, kuarci, si dhe minerale të reja. Këto do të fuqizojnë bilancin valutor dhe do të bëjnë të ecet me hapa më të shpejtë në përmirësimin e strukturës së eksporteve tona.

Në Kombinatin Metalurgjik detyrat janë parashikuar të ngjeshura... Për çelikun detyrat duhen rishikuar dhe kjo është e mundur. Sot në Kombinat ka mbi 13 mijë tonë gizë dhe mijëra tonë të tjerë të shpërndarë andej-këndej. Gjithashtu vazhdimi i aksionit për grumbullimin e hekurishteve duhet të ngrihet në një shkallë më të lartë kudo në republikë, për të kompensuar mosmarrjen e gizës nga remonti i furnaltes. Ministria e Industrisë dhe e Minerave duhet të punojë gjithashtu më mirë që të zbatohen plotësisht detyrat e shtruara nga Byroja Politike, kur analizoi gjendjen në këtë kombinat. Synimi duhet të jetë që kombinati të arrijë sa më parë përvetësimin e kapaciteteve prodhuese të projektuara në të gjitha uzinat, si dhe të dalë me efektivitet nga prodhimi kryesor dhe jo të mbulohen humbjet nga uzinat mekanike, ajo e koksit dhe reparte të tjera ndihmëse.

Një analizë e thellë e gjendjes do të bëjë për industrinë kimike. Këtu del nevoja të merren masa të forta organizative e teknike për të garantuar realizimin e planit. Veçanërisht kujdes të madh duhet të tregojë Ministria e Industrisë dhe e Minerave për nxjerrjen nga prapambetja të Sodë-PVC-së, të Kombinativit Pirometalurgjik në Laç, si dhe për të zbatuar një regjim normal pune në uzinat e plehrave kimike.

Në industrinë e lehtë parashikohen rritje në disa prodhime për parashikimet e planit pesëvjeçar, kurse nuk arrihen detyrat në prodhimin e pëlhurave, stofrave, trikotazheve, sheqerit, cigareve etj. Ashtu siç porositi Partia, në industrinë ushqimore kërkohet të bëhet një program i shkallëzuar për thithjen e plotë dhe për një vlerësim më të mirë të prodhimeve bujqësore, si dhe për

miradministrimin e pronës, uljen e kostos dhe rritjen e cilësisë e të llojshmërisë së prodhimeve.

Mundësitë e krijuara dhe nevojat e vendit e bëjnë real dhe të domosdoshëm që **prodhimi bujqësor** në vitin e ardhshëm të rritet mbi 14 për qind, duke u siguruar mbi 90 për qind nga rritja e rendimenteve të kulturave bujqësore dhe e prodhimitarisë në blegtori. Është parashikuar që kudo, në çdo rreth dhe ekonomi, rendimentet të vihen më të larta nga ato të realizuara sivjet...

Për të arritur leverdinë e prodhimit bujqësor janë bërë studime dhe do të zbatohen disa masa për të përmirësuar strukturën e kulturave bujqësore: do të pakësohet 3 000 ha sipërfaqja e mbjellë me pambuk dhe po kaq me sojë, duke u zëvendësuar me 5 000 ha lule dielli dhe me 1 000 ha grurë. Gjithashtu Ministria e Bujqësisë duhet të thellojë studimet dhe të përgatitet për të shtuar më tej sipërfaqen e mbjellë me duhan dhe rritjen e cilësisë me synim që të rritet në mënyrë të ndjeshme eksporti, të sigurohen fronte pune për kooperativistët dhe popullsinë e ndërmarrjeve bujqësore dhe të arrihet efektivitet më i madh nga disa toka me prodhimtari të ulët. **Nuk duhet të lejohet nënvleftësimi që i bëhet nga rrethet dhe nga Ministria e Bujqësisë kulturës së duhanit, ku gjatë tre vjetëve investimet janë realizuar në 1/3 e tyre. Kthesë rrënjësore duhet të bëjnë ministria dhe rrethet edhe për kulturën e pambukut.**

Në zbatim të orientimeve të Partisë, do të thellohet më tej puna për përqendrimin dhe specializimin e prodhimit bujqësor sipas përvojës në Plasë, duke dhënë për këtë qëllim edhe 3 100 ha të tjerë për foragjere dhe duke pakësuar kryesisht sipërfaqen e lulediellit në toka të varfra dhe diçka në perime e në pambuk. Për këtë kërkohet të mbahet mirë parasysh se kjo përvojë është e gjerë dhe jep mundësi që të thellohet intensifikimi dhe të bëhet mobilizimi i rezervave të brendshme në shumë drejtime. Prandaj shoku Enver në mbledhjen e Byrosë Politike theksoi se duhen luftuar si të njëanshme, thjeshtësuese dhe të dëmshme ato koncepte e praktika që e reduktojnë përvojën e Plasës vetëm në një qarkullim bujqësor, apo ç'është më keq, për të rritur sipërfaqen e foragjereve në dëm të kulturave të tjera kryesore.

Nga Ministria e Bujqësisë dhe nga rrethet duhet të luftohen pakujdesitë që tregohen për blegtorinë. Sikurse na mëson shoku Enver, në këtë degë të rëndësishme të ekonomisë **rritja e numrit të krerëve dhe e rendimenteve janë dy binarë mbi të cilët duhet të ecë zhvillimi i blegtorisë në të gjitha rrethet.** Mirëpo për numrin e krerëve, sidomos për lopën, nuk punohet mirë, si nga ministria, ashtu dhe nga rrethet e veçanërisht në rrethet e Krujës, të Elbasanit, të Durrësit etj., si dhe në rrethet Kukës e Tropojë ku ka pasur dëme. Disa rrethe në studimet që kanë bërë për përfundimin e tufëzimit veprojnë në mënyrë të gabuar për t'i zëvendësuar

një pjesë të lopëve me bagëti të imëta, në vend që të rritin, si lopët, ashtu dhe të imëtat. Problem i madh mbetet rritja e rendimentit të kulturave foragjere dhe në përgjithësi nevoja e një kujdesi në rritje për bazën ushqimore. Kjo ka çuar në atë që mishi të sigurohet kryesisht nga skartimet dhe jo nga shtimi i peshës. Numri i planifikuar i shtesës së lopëve, i të imëtave dhe i dosave duhet të arrihet medoemos.

**Detyra të ngjeshura janë vënë edhe për zonën që intensifikohet me përparësi, ku krahas zhvillimit të prodhimit vëmendje më e madhe t'i kushtohet edhe përsosjes së marrëdhënieve ekonomike. E theksojmë këtë, sepse në praktikë disa anë të marrëdhënieve ekonomike nuk po e mbështesin si duhet zhvillimin e prodhimit. Këtu ministritë dhe komitetet ekzekutive të rretheve duhet të studiojnë më shumë përvojën që arrihet dhe të ngrenë probleme e të bëjnë sugjerime që marrëdhëniet në prodhim të luajnë rolin e vet aktiv.**

Një front i rëndësishëm ku do të punohet në vitin e ardhshëm janë **investimet dhe ndërtimet, të cilat përbëjnë një nga shtyllat kryesore ku mbështeten plani dhe çelja e perspektivave të reja të zhvillimit.** Pjesa dërrmuese e mbi 5 miliardë investimeve do të përdoret për sferën prodhuese. Në ndërtimin e objekteve është ndjekur kjo radhë:

— Avancohen punimet e ndërtimit në hidrocentralin «Enver Hoxha» në Koman, në Uzinën e Vajrave Lubrifikante në Ballsh, në disa komplekse blegtorale etj;

— Përparësi u është dhënë përfundimit dhe vënies në shfrytëzim të veprave që vijnë nga viti 1983, për të cilat janë parashikuar edhe detyra prodhimi në vitin 1984;...

— Janë shtuar 29 objekte të tjera që nuk ishin në pesëvjeçar, por që janë të domosdoshme dhe ekzistojnë mundësitë e ndërtimit, siç janë rritja e aftësisë nxjerrëse të minierës së bakrit në Palaj të rrethit të Shkodrës, dy fabrika për përpunimin e frutave në Delvinë e Kukës, linja e tensionit të lartë Lozhan-Maliq për çeljen e perspektivave të qymyrgurit, 5 vepra ujore etj.

Objektivat e rritur të eksportit që këtë vit janë mbi 20 për qind më të mëdhenj dhe ndryshimet strukturore që duhet të realizohen në këtë fushë shtrojnë detyra të mëdha para organeve prodhuese dhe të tregtisë së jashtme. Tani më shumë se çdo herë tjetër duhet kuptuar e duhet zbatuar nga të gjithë parimi themelor i tregtisë sonë të jashtme se «pa eksport nuk ka import».

**Burimet financiare, Partia i ka parë dhe i shikon si një nga mbështetjet më të fuqishme të të gjitha detyrave të planit si dhe tregues përgjithësues që pasqyrojnë shkallën e mobilizimit të rezervave të brendshme, në radhë të parë në prodhim, por edhe në veprimtaritë e tjera shoqërore. Zhvillimi i prodhimit dhe rritja e efektivitetit të tij bëjnë të mundur që në vitin 1984, të ardhurat**

e përgjithshme financiare të jenë në rritje... Pjesa kryesore e rritjes së tyre sigurohet nga ulja e kostos. Prandaj, nën drejtimin e organizatave të Partisë kërkohet t'u bëhet një rishikim ndërmarrjeve dhe aktiviteteve me humbje dhe të mos lejohet shtimi i tyre...

**Zhvillimi i ekonomisë në vitin 1984 garanton dhe rrit më tej nivelin material e kulturor të punonjësve.** Të ardhurat reale për frymë të popullsisë parashikohen të rriten duke i dhënë përparësi rritjes së tyre në fshat. Qarkullimi i mallrave me pakicë do të rritet mbi 6 për qind. Për mallrat ushqimore dhe joushqimore sigurohet rritje e përdorimit për frymë. Megjithatë, disa vështirësi do të ndihen në treg, sidomos për mish dhe djathë në gjashtëmujorin e parë. Prandaj janë parashikuar të hidhen në treg më shumë produkte të tjera. Do të bëhen afrime në shitjet për frymë midis disa rretheve, ku gjatë viteve të kaluara janë lejuar në disa raste diferenca, për të cilat do të punohet gradualisht që të ngushtohen.

Shtimi i prodhimit të grurit na dha mundësi që sivjet, në bazë të porosisë së shokut Enver, fshatarësia të furnizohet më mirë me bukë gruri. Rëndësi ka që kjo fitore të forcohet e të konsolidohet më tej, duke përmirësuar më tej edhe përpjesëtimet midis rretheve. Gjithashtu është pozitiv fakti që konsumi i bukës për frymë të popullsisë, në krahasim me atë që ishte planifikuar, është në ulje. Por mundësitë janë që të ecet më shpejt për këtë çështje të rëndësishme, sidomos në disa rrethe ku ende konsumi i perimeve, i patateve dhe i frutave është relativisht i ulët.

Gjatë vitit të ardhshëm parashikohet të ndërtohen gjithsej 10 mijë e 400 apartamente banimi, duke plotësuar kështu detyrën për katër vjetët e pesëvjeçarit. Do të bëhen rregullime në shpërndarjen e banesave sipas qyteteve, qendrave të punës e ndërmarrjeve bujqësore. Kujdes i veçantë do të tregohet edhe për ndërtimin e banesave në fshat. Në shërbimet komunale do të bëhen përmirësime në qytete e sidomos në fshat.

**Në fjalën e vet në Byronë Politike, shoku Enver e trajtoi gjerë problemën e madh të ngushtimit të dallimeve midis fshatit dhe qytetit. Këtu çështja kryesore është lufta për arritjen e objektivave që parashikohen në plan. Baza e ngritjes së mirëqenies në fshat mbetet shtimi i prodhimit bujqësor e blegtoral, por edhe zbatimi i të gjitha detyrave që kanë degët e ekonomisë ndaj bujqësisë dhe fshatit.**

Në fushën e arsimit e të kulturës gjatë vitit 1983 do të punohet për zbatimin e orientimeve të Partisë, duke e çuar numrin e nxënësve e të studentëve në mbi 725 mijë veta. Në arsimin e lartë pranimet e reja janë parashikuar 700 studentë më pak nga kuota e pesëvjeçarit. Megjithatë objektivat e tre viteve të marra së bashku arrihen mbasi në vitet 1982 dhe 1983 janë bërë pranime më shumë.



Për shëndetësinë do të kryhen 26,5 milionë lekë investime. Ministria e Shëndetësisë dhe organet e saj duhet të punojnë më mirë veçanërisht për cilësinë e shërbimit shëndetësor.

Me projektplanin e vitit 1984 u bë edhe bilanci për të katër vitet e pesëvjeçarit 1981-1984 të marra së bashku, nga i cili del se për treguesit kryesorë të degëve të ekonomisë, kuotat e pesëvjeçarit nuk arrihen plotësisht. Prandaj në vitin 1984 duhen mbyllur edhe disa nga këto deficite, duke e tejkaluar planin. Plotësimi i kësaj detyre është një domosdoshmëri. Me gjithë problemet e mosrealizimit e krijuara, ritmet mesatare vjetore të zhvillimit të prodhimit material gjatë viteve 1981-1984 do të jenë afro 2 herë më të larta nga ritmet e shtimit të popullsisë. Ky zhvillim siguron nevojat për investime dhe për burime të tjera akumulimi, për zënieën me punë të forcave aktive, rritjen e të ardhurave reale dhe të fuqisë blerëse të popullsisë, zbatimin e objektivave të Kongresit të 8-të të Partisë për përsosjen e marrëdhënieve në prodhim dhe për fuqizimin e mbrojtjes së atdheut.

Ndërkohë nga ky bilanc evidencohen edhe një herë disa probleme kyç dhe më delikate të krejt planit të zhvillimit të ekonomisë e të kulturës, siç janë ato të energjetikës, të bujqësisë e të blektorisë, të rendimentit të punës e të efektivitetit të prodhimit shoqëror, të cilat shtrojnë me forcë nevojën e arritjes së objektivave të caktuar. Duke parashtruar këtë bilanc, del edhe një herë se me planin e vitit 1984 kërkohet të bëhet një hap i rëndësishëm për të mënjeluar e zbutur prapambetjet e krijuara në disa drejtime, për të përmirësuar përpjesëtimet kryesore të ekonomisë dhe për t'u futur më të përgatitur për planin e vitit 1985.

### III. Disa drejtime kryesore të punës së Partisë dhe të levave të saj për plotësimin e detyrave të planit

Përvoja e luftës dhe e përpjekjeve të masave punonjëse, të udhëhequra nga Partia, me shokun Enver Hoxha në krye, dhe detyrat e planit të vitit 1984 që po shtrojmë në këtë plenum, si vit i 40-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe me rëndësi vendimtare për krejt pesëvjeçarin, shtrojnë nevojën që organet dhe organizatat e Partisë, organet e pushtetit, ato të ekonomisë dhe levat e tjera të rritin më tej mobilizimin dhe energjitë krijuese të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste dhe të inteligjencies popullore. Vëmendja kryesore të përqendrohet sidomos në këto drejtime:

1. — Të ngrihen në një shkallë më të lartë organizimi dhe drejtimi i ekonomisë. Me bazën materialo-teknike që është krijuar e po fuqizohet vazhdimisht dhe me njerëzit e përgatitur e të edukuar nga Partia, janë të gjitha mundësitë për ritme më të shpejta dhe arritje më të mëdha në çdo fushë. Hallkë kryesore për këtë mbetet organizimi dhe drejtimi më i përsosur i punëve nga organet e Partisë, të pushtetit dhe të ekonomisë. Shoku Enver na mëson se detyrat për prodhimin e zgjeruar socialist dhe zbatimin e ligjeve ekonomike, nuk arrihen vetvetiu dhe automatikisht. Nga puna organizuese e drejtuese varet shumë zbatimin e këtyre ligjësisë, si dhe shfrytëzimi në praktikë i epërsive të rendit tonë socialist, ashtu sikurse ato mund të minimizohen kur nuk punohet e nuk drejtohet mirë.

Partia ka luftuar me kohë kundër dobësive në drejtimin e ekonomisë. Dhe suksese në këtë fushë ka. Megjithatë, ato ende janë të pranishme dhe dëmtojnë jo pak punën për realizimin e planeve. Prandaj kërkohet t'i njohim më thellë ato dhe t'i shkuarim nga rrënjët.

Shoku Enver, edhe një herë në mbledhjen e Byrosë Politike tërhoqi vëmendjen që punën ta matim me plotësimin e detyrave të planit, me arritjen e objektivave që ka caktuar Kongresi i 8-të i Partisë. Kur raportohet e jepet llogari nuk duhet të matemi me hapat që bëhen në krahasim me të kaluarën, por si janë realizuar një për një detyrat e planit. Kështu të raportohet edhe në këtë plenum dhe në analizat e rretheve e të bazës. Mirëpo, në praktikë nuk kuptohet dhe nuk zbatohet plani kurdoherë si ligj i detyrueshëm për t'u realizuar nga të gjithë dhe në kohën e caktuar. Kështu shpjegohet që disa vepra të ndërtimit nuk realizohen në kohë, por kërkesë llogarie dhe mbajtje përgjegjësie për investitorët ose zbatuesit nuk është bërë. Realizimi i planit ka vështirësitë e veta, aq më tepër në kushtet në të cilat ne punojmë. Por këto nuk duhet të bëhen shkas për të justifikuar shkeljet e ligjit të planit dhe disiplinën e tij. Rruga revolucionare që duhet të ndjekim është ajo e mijëra komunistëve e punëtorëve të hidrocentralit «Enver Hoxha» të Komanit e të kombinatit të autotraktorëve «Enver Hoxha», të naftëtarëve të mjaft brigadave në Marinzë, të punëtorëve e kooperativistëve në ekonomitë e rrethet e dalluara, që i rrinë punës mbi kokë dhe nuk vënë në diskutim planin.

Një dukuri tjetër që na dëmton është njëanshmëria në plotësimin e detyrave të planit.

«... Njëanshmëria në drejtimin e ekonomisë, — na mëson shoku Enver, — është liberalizëm ndaj disiplinës së planit, është orvatje për t'u hapur fushë të lirë veprimi fenomeneve të spontaneitetit dhe për krijimin e shpërpjesëtimeve dhe të anomalive të tjera të rrezikshme, është



shmangie nga zhvillimi i planifikuar e proporcional i ekonomisë<sup>1</sup>.

Njëanshmërinë është e nevojshme ta analizojë çdo organ partie dhe organizëm shtetëror apo ekonomik. Në bujqësi ajo shfaqet kryesisht në kujdesin e pamjaftueshëm për blektorinë dhe për bimët industriale; në përqendrimin e vëmendjes për fushën dhe në nënvleftësimin, në ndonjë rast, të zonës kodrinore-malore, siç ka ndodhur në rrethin e Korçës dhe në ndonjë rreth tjetër ose dhe brenda vetë kooperativave.

Njëanshmëria na dëmton edhe në degë e sektorë të tjerë të ekonomisë. Në industrinë minerare, ndërsa përqendrohet vëmendja në nxjerrjen e mineraleve, lihen prapa punimet për përgatitjen e fronteve të punës dhe pak punohet për mënjanimin e humbjeve, të varfërimeve dhe realizimin e cilësisë. Në ndërtim, nga disa rrethe merren masa e ndiqen mirë detyrat për objektet joproduuese, e sidomos për banesat, kurse më pak vëmendje u kushtohet veprave prodhuese. Në industri e tregti njëanshmëria ka çuar që të mos gjenden në treg disa mallra me çmime të ulëta, e sidomos për fëmijë, ashtu sikurse organet e tregtisë e të komunales ende për fshatin interesohen më pak se për qytetin.

Edhe **globalizmi** në thelb është shfaqje e njëanshmërisë. Kjo duket në mungesën e bashkëndimit të anëve të ndryshme të planit të prodhimit, atij financiar, të ndërtimit apo të shërbimit si dhe në deficitet që krijohen për realizimin e tyre. . .

Më me forcë kërkohet të luftohen **disa shfaqje të dikasterializmit, të lokalizmit e të shpirtit të ngushtë të ndërmarrjeve**, si rreziqe që ushqejnë voluntarizmin, subjektivizmin e decentralizmin. E theksojmë këtë, sepse disa herë dikasteret nuk merren vesh mirë me njëri-tjetrin, nuk bashkërendojnë si duhet problemet e punët midis tyre dhe në disa raste qëndrojnë në gjendje pritshmërie, që çështjet të zgjidhen nga organet më të larta, kur vetë ministritë dhe rrethet kanë kompetenca e mundësi jo të pakta për t'u dhënë rrugëzgjdhje problemeve. Me këta interesa të ngushtë janë të lidhura edhe kërkesat e mëdha që u bënë sivjet nga komitetet ekzekutive të rretheve dhe nga dikasteret për investime, për punëtorë për importet.

Në kushtet e sotme një rëndësi të veçantë merr lufta për **ngritjen në një shkallë më të lartë të ndjenjës së përgjegjësisë në të gjitha instancat** dhe veçanërisht lufta kundër frymës së lëshimeve, justifikimeve dhe qëndrimeve sentimentale në kërkesën e llogarisë. Pra, del nevoja që Këshilli i Ministrave dhe organet e tjera shtetërore dhe ekonomike në qendër e në bazë t'i rikthehen edhe një herë protokollit të Byrosë Politike të vitit 1982 për

1. Arkivi Qendror i Partisë.

përsosjen e metodës e stilit në punë, me synim që të thellojmë luftën kundër shfaqjeve të dëmshme dhe për të rrënjësuar kudo koncepte të shëndosha partie për planin e shtetit dhe realizimin e tij.

Në këtë kuadër, para organeve të shtetit e të ekonomisë del nevoja e analizës dhe e **shikimit me sy kritik të disa fenomeneve të dëmshme që na përsëriten**. Vijnë makineri nga importi dhe lihen pa u vënë në shfrytëzim me muaj, për të mos thënë në disa raste edhe me vite. Disa lloje lëndësh të para e materialesh mbahen për vite me radhë në sasira jo të vogla nëpër depo. Po kështu ndodh me miliona lekë mallra të bllokuara e me qarkullim të ngadalshëm në depot e tregtisë, sepse janë prodhuar me cilësi të dobët dhe nuk i përgjigjen kërkesës së konsumatorëve. Xhiroja e tregtisë së brendshme në disa kooperativa nuk realizohet.

Këtu ka mungesë përgjegjësie dhe shkelje të disiplinës së planit, por del edhe nevoja për të studiuar e vendosur nga Partia disa masa organizative dhe ekonomike, që të ndihmojnë për një planifikim e zbatim më të mirë të detyrave dhe për t'u prerë rrugën këtyre fenomeneve negative.

Një përvojë të re të pasur na dha viti 1983 për **organizimin dhe forcën e aksioneve**, ku spikati fryma e gatishmërisë e masave punonjëse dhe gjeti zbatim në mënyrë të përqendruar përvoja e përparuar. Fusha për ndërmarrjen e aksioneve në ekonomi është e gjerë. Çdo ministri, rreth, ndërmarrje e kooperativë duhet të programojë e të përgatitet me kohë për ndërmarrjen e aksioneve. Më shumë aksione duhet të organizohen për të shkurtuar afatet e ndërtimit të objekteve të reja, sidomos të atyre nga të cilat është parashikuar të merret prodhim në vitin 1984. Gjatë tremujorit të parë, Ministria e Ndërtimit, së bashku me rrethet do të përfundojnë me aksion 40 vepra të degëve të ndryshme të prapambetura nga viti 1983. Një fushë e gjerë për të punuar me goditje të përqendruar është edhe bujqësia, ku, siç tregoi përvoja e sivjetme, u arritën rezultate të lavdërueshme, sidomos në fushatën e të lashedave, në mbledhjen e lules së diellit, të fasules, të panxharsheqerit etj. Aksione të rëndësishme duhet të zhvillohen për të çuar në Kombinatin Metalurgjik mbi 25 mijë tonë hekurishte, për të prodhuar në vend pjesën dërrmuese të tullave zjarrduruese. Ministria e Energjetikës, ajo e Industrisë dhe e Minierave, e Mbrojtjes dhe e Ndërtimit të ndihmojnë për të prodhuar 600 pompa për industrinë e naftës. Aksione duhet të merren për rigjenerimin e pjesëve të ndërrimit, për normat e punës dhe normativat e harxhimit të energjisë e të materialeve. Ndërmarrja e aksioneve do të jetë, gjithashtu, një mjet efikas për të revolucionarizuar metodën e punës së aparateve dhe për të luftuar më me forcë shfaqjet e burokratizmit e të teknokratizmit, që ende na pengojnë.

2. — Të merren masa të gjithanshme për të zbatuar kudo një

**regjim të rreptë kursimi dhe për të rritur burimet financiare.** Drejtimi me efektivitet dhe me kursim ka qenë dhe mbetet një tipar i pandryshueshëm i sistemit tonë socialist të ekonomisë. Por kthimi, më shumë se çdo herë tjetër, i fytyrës nga kursimi, duke e bërë atë një problem me theks të veçantë për të gjithë punonjësit, diktohet edhe nga kushtet e situatat konkrete, në të cilat po hyjmë dhe do të punojmë për realizimin e planit të vitit 1984. Në rrugën e drejtë që ecën ekonomia jonë, ashtu siç themi se pa eksport nuk ka import, po ashtu duhet të rrenjose thellë mendimi se **pa të ardhura nuk ka shpenzime. Dhe të ardhurat rriten, kur shtohet prodhimi, kur ulet kostoja dhe kur kursehet kudo.** Ndryshe shteti s'ka nga gjen burime që të financojë shpenzimet dhe të japë pagat. Për të realizuar këtë duhet të punohet në front të gjerë, por edhe duke u përqendruar më shumë në disa pika nevralgjike të ekonomisë e të veprimtarive të tjera shoqërore.

Në vitin 1984, duhet të vazhdojë me intensitet puna për të manovruar e për të marrë masa konkrete që çojnë në **kursimin e energjisë elektrike e të karburanteve.** Në plan është parashikuar që normativat e konsumit për energjinë elektrike të jenë 7 deri 10 për qind dhe për karburantet 5 deri 7 për qind më të ulëta se ato të planit të vitit 1983. Po ashtu me ulje janë parashikuar edhe lëndët e para. Këto ulje të konsiderohen kufi minimal e i domosdoshëm dhe lufta e përpjekjet për kursime të bëhen më të mëdha. Në vitin e ardhshëm do të duhet të zbatohen më mirë edhe detyrat për zëvendësimin e lëndëve djegëse të lëngëta me ato të ngurta, për përdorimin më të gjerë dhe për rritjen e efektivitetit të djegieve të qymyrgurit me fuqi kalorifike më të ulët, ku sot ka mjaft shpërdorime, si dhe për shfrytëzimin racional të mjeteve të transportit, duke i dhënë përparësi shfrytëzimit me kapacitet të madh të transportit hekurudhor e detar dhe atij automobilistik.

Organizatat e Partisë dhe levat e tyre duhet të thellohen më shumë në përvojat e përparuara të ndërmarrjeve e të kooperativave, të reparteve e të sektorëve brenda tyre dhe deri tek individët. Një shembull i lavdërueshëm ishte dhe aksioni i organizuar në kombinatin e autotraktorëve «Enver Hoxha», ku me mobilizim të përgjithshëm, gjatë muajve shtator-tetor, u mbyllën deficitet në zëra dhe u tejkalua plani 9 mujor në të gjithë treguesit, duke punuar me 30 për qind më pak energji elektrike. Shembuj të tillë ka kudo. Çështja shtrohet që aksionet të mos mbeten të veçuara e të përkohshme, por të kthehen kudo në lëvizje të fuqishme revolucionare të mbështetura nga masat punonjëse e të drejtuara mirë nga Partia.

Vitin e ardhshëm, **ulja e koston në prodhim, në ndërtim e kudo gjatë** kërkohet të konceptohet më gjerë dhe të realizohet si një nga objektivat më të rëndësishëm të planit. Në veprën «Për

planin e 7-të pesëvjeçar» shoku Enver Hoxha na mëson se **nuk mund të bëhet fjalë për koston dhe për uljen e saj, pa normativa teknike të përdorimit të energjisë, të materialeve e lëndëve të para, si edhe pa i përsosur ato vazhdimisht.** Kjo është edhe hallka më kryesore ku duhet të kapemi për forcimin e regjimit të kursimit dhe për shtimin e të ardhurave financiare. Por ende nuk është realizuar, në kuptimin e vërtetë të saj, ajo që kërkon Partia, qilizma në kosto. E themi këtë, sepse në industrinë e lehtë e ushqimore shpërdorimet, bile dhe përvetësimet, liqërohen me normativa të reja, disa prej tyre serviren edhe si teknike dhe u vihet kapak me llogarinë «humbje-fitim».

Të ardhurat do të rriten nga shtimi i prodhimit të energjisë elektrike nga hidrocentralet, nga nxjerrja e naftës dhe e gazit, si dy degë nga më rentablet, por ato duhet të rriten edhe duke ulur koston, sidomos në industrinë mekanike dhe në atë të drurit, ku ka mjaft shpërdorime të materialeve dhe po ecet shumë ngadalë për zëvendësimin e tyre; në Kombinatin Metalurgjik dhe në Uzinën e Ferro-Kromit, ku normativat janë larg atyre të projektuar; në miniera dhe në fabrikat e pasurimit, në industrinë e lehtë e ushqimore, ku rrezet kanë prirje të keqësohen, kurse dy dikasteret ia lënë përgjegjësinë njëri-tjetrit, në vend që të marrin masa që ta ndryshojnë situatën, që të mos importojmë aq vaj, sheqer, etj. Për sa kohë do të vazhdojë ekonomia t'i mbajë ndërmarrjet bujqësore me humbje? Si po zbatohen orientimet e Partisë për të ulur dhe eliminuar dotacionet?

Shpenzimet kryhen në reparte e në fabrika, në brigada prodhimi etj. dhe për çdo prodhim industrial apo bujqësor, për çdo objekt ndërtimi apo shërbimi. **Mirëpo, tamam këtu i kemi dobësitë më të mëdha — në planifikimin e brendshëm, në evidentimin dhe në kontrollin e këtyre shpenzimeve. Ende nuk e kemi të konkretizuar si duhet në praktikë porosinë e shokut Enver Hoxha që për çdo material që del nga magazina të dihet destinacioni përfundimtar dhe të kërkohet llogari për përdorimin dhe për efektivitetin e tij.**

Kostot për njësi, preventivat e shpenzimeve, kontot e kulturrave bujqësore të bëhen më shkencore dhe të shtrënguara, sidomos të ndiqet zbatimi i tyre, që të mos mbeten në letër e që çdo drejtor, kryetar kooperative a brigadier t'i ndryshojë ato si të dojë. **Organet e planit e të financës në tërë piramidën, nga Komisioni i Planit dhe Ministria e Financave, në ministritë, në rrethe e deri në bazë, ta konsiderojnë problemin e koston si një aksion të madh dhe ta vënë ashtu siç duhet në rrugë brenda vitit 1984.** Kjo duhet bërë patjetër. Duke vënë në vendin e vet koston, si tregues sintetik, edhe ndërmarrjet do të vihen në pozita më luftarake dhe vlerat materiale e puna e njerëzve do të përdoren në mënyrë më racionale dhe më me efektivitet. Duke vënë thek-



sin në kosto, në të njëjtën kohë kërkohet t'u vihet fre shpenzimeve administrative. Po kështu fryma e drejtë e kursimit duhet të futet më thellë edhe në jetën familjare.

**3. — Të bëjmë kthesë dhe një luftë të vendosur për rritjen e rendimentit shoqëror të punës.** Për tre vjetët e parë të pesëvjeçarit, rendimenti i punës nuk është plotësuar. . .

Në vitin e ardhshëm, nga rritja e rendimentit parashikohet të sigurohet më shumë se gjysma e shtesës së prodhimit. Prandaj dhe themi se duhet bërë kthesë në rendimentin e punës.

Vëmendja duhet përqendruar, në radhë të parë, për shtimin e prodhimit e për mekanizimin e proceseve të punës, veçanërisht në miniera, në shfrytëzimin pyjor, në ndërtim etj., ku niveli i mekanizimit është ende i ulët. Kjo kërkohet edhe për të kufizuar në maksimum tërheqjen e krahëve të punës nga fshati, sidomos në rrethet ku ka mungesë të forcave të punës në bujqësi. Ndjekje shumë të kujdesshme kërkon harxhimi i fondit të pagave, për faktin se po ndodh që të jepen paga pa u justifikuar me prodhim apo me ndërtim. **I duhet vënë fre punës «në ekonomi» që po merr përmasa të palejueshme.** Ajo është e mbar-sur me pasoja inflacioniste dhe ushqen parazitizmin në punë.

Organizatat e Partisë duhet të kërkojnë më shumë dhe më konkretisht nga organet shtetërore dhe Bashkimet Profesionale për normimin e punës, për luftën kundër thyerjeve të disiplinës dhe humbjeve të kohës së punës. Në Bashkimet Profesionale duket njëfarë shkujdesjeje për këto probleme.

Zënia me punë e forcave aktive është një problem tjetër që do lidhur ngushtë me rritjen e rendimentit të punës... Këtu duhen ndërmarrë edhe studime nga Këshilli i Ministrave për zbatimin e orientimeve të Kongresit të 8-të të Partisë për të lëvizur disa forca qoftë brenda rretheve, por edhe midis tyre, veçanërisht për të plotësuar nevojat e rretheve, të Veriut. Me këtë çështje të madhe nuk po merret si duhet as Komiteti Qendror i Rinisë. Ai duhet të lidhet më mirë me rrethet, me problemet që kanë ato në këtë fushë dhe të japë kontributin e vet.

**4. — Të këmbëngulim më shumë për zbatimin e të rejave të shkencës e të teknologjive të përparuara në prodhim.** Sot më tepër se kurrë duhet dije e shkencë. Kërkesa për revolucionin tekniko-shkencor nga ana e Partisë nuk është rastësi, por domosdoshmëri për realizimin e planeve tona në sasi, në cilësi e në kosto. Rezultatet e arritura në bujqësi në rrethet e Sarandës, të Shkodrës dhe në rrethe të tjera, si dhe në ekonomi e në kolektiva të ndryshëm, vërtetojnë drejtësinë e porosive të vazhdueshme të Partisë e të shokut Enver për zbatimin në shkallë më të gjerë të shkencës e të teknologjive të reja, për dëgjimin e vënien më mirë në jetë të mendimit të përparuar të punonjësve e të specialistëve. **Çelësi i zgjidhjes së problemeve të inter-**

**sifikimit dhe të rritjes së efektivitetit të ekonomisë është zhvillimi i pandërprerë i revolucionit tekniko-shkencor, zbatimi i disiplinës së punës e asaj teknike.** Për këtë kërkohet të këmbëngulet më shumë, veçanërisht në industrinë e naftës, në atë kimike, në metalurgjinë e zezë e në disa bimë industriale si duhan, pam-buk, luledielli, etj., ku vihet re një prapambetje dhe nuk ka një lëvizje të mendimit shkencor e teknik, siç e kërkojnë detyrat e planit.

Ndërmarrjet, në mjaft raste, duke mos zbatuar teknologji unike sipas nivelit më të përparuar për procese e produkte të njëjta, krijojnë humbje dhe nxjerrin prodhime me cilësi të dobët. Kështu ndodh me fabrikat e lëkurëve e të këpucëve, me fabrikat e industrisë ushqimore, me fonderitë e uzinave mekanike, me ripërtëritjen e pjesëve të ndërrimit etj. Kapërcimi i kësaj gjendjeje kërkon të bëhen studime e të programohet puna për unifikimin e teknologjive mbi bazën e arritjeve më të përparuara nga ministritë, institucionet kërkimore-shkencore dhe vetë ndërmarrjet e të njëjtit profil.

Objektivat në blegtori nuk mund të arrihen pa futur me guxim teknologjitë e përparuara në të ushqyerit e bagëtive. Dhe këtu nuk është fjala për komplekset blegtorale që sigurojnë vetëm 1/10 e nevojave të vendit për mish, por për masën e blegtorisë, në ndërmarrje e sidomos në kooperativa. Përvoja e Gorresë në rrethin e Lushnjës, si dhe e ndërmarrjes bujqësore të Lezhës, që brenda 2 vjetëve e ngritën rendimentin e mishit përkatësisht në 9 dhe 11 kuinalt e gjysëm për dosë, kryesisht me përmirësimin e strukturës ushqimore, tregon se **teknologjia e re nuk kushtëzohet nga ndërtimet e rënda e të kushtueshme, që vazhdojnë të bëhen e të kërkohen në disa raste në bujqësi.** Lufta duhet të përqendrohet në sigurimin e bazës ushqimore të balancuar dhe jo vetëm në koncentrat, por edhe me anë të njomishteve, kullotave etj., për të cilat ka nënvleftësime.

Nën kujdesin e Partisë janë ngritur 53 institute kërkimore-shkencore, ku punojnë qindra kadro me arsim të lartë. Kjo forcë e madhe duhet t'i përvishet më mirë realizimit të detyrave që ka shtruar Partia për t'i vënë shpatullat pesëvjeçarit. Por jo të gjitha institutet kontribuojnë si duhet për të çuar përpara prodhimin e për t'i paraprirë perspektivës me studime për pesëvjeçarin e ardhshëm. Kjo është shtruar vazhdimisht nga Partia, por tani kërkohet të bëhet një analizë serioze e veprimtarisë së instituteve të dikastereve dhe të organizmave të tjerë shkencorë. Në këtë punë duhet të futet si duhet edhe Komiteti i Shkencës dhe i Teknikës, i cili duhet të përmirësojë rrënjësisht punën e vet, si një organ shtetëror që përgjigjet për përparimin e shkencës e të teknikës në tërë vendin.



Shokë,

Detyrat e planit të vitit 1984, që po shtrohen për diskutim e miratim në këtë Plenum të Komitetit Qendror, janë të mëdha dhe vendimtare për të zbatuar objektivat e Kongresit të 8-të të Partisë për zhvillimin e ekonomisë e të kulturës së vendit. Plotësimi i tyre kërkon, si asnjëherë tjetër, mobilizimin e masave të gjera punonjëse, të organeve të shtetit, të ekonomisë dhe të organizatave të masave nën udhëheqjen e Partisë. Realizimi i këtyre detyrave vitin e ardhshëm do të mplekset, në shkallë më të gjerë, edhe me punën studimore e planifikuese për hartimin e planit të ardhshëm pesëvjeçar. Ky do të jetë një aksion i madh që do të nxitë më tej shpërthimin e mendimit krijues të klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste dhe të inteligjencies popullore, për të mbyllur me sukses planin e shtatë pesëvjeçar dhe për të hapur perspektiva të reja zhvillimi.

Nën udhëheqjen e Partisë me shokun Enver Hoxha në krye, le ta kthejmë vitin 1984, vitin e 40-vjetorit të Çlirimit të Atdheut e të fitores së revolucionit popullor, në një vit tjetër suksesesh të gjithanshme për fuqizimin e pareshtur të ekonomisë e të mbrojtjes dhe për begatinë e atdheut tonë socialist.

*Botohet për herë të parë me disa shkurtime, sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## VENDIM

### I KOMITETIT QENDROR TË PPSH «PËR FESTIMIN E 40-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË ATDHEUT E TË FITORES SË REVOLUCIONIT POPULLOR»

31 janar 1984

Sivjet mbushen 40 vjet nga 29 Nëntori i vitit 1944 kur populli shqiptar, nën udhëheqjen e Partisë, me shokun Enver Hoxha në krye, kurorëzoi fitoren më të ndritur në historinë e tij, çliroi atdheun, vendosi pushtetin popullor dhe hyri në epokën e re, në epokën e socializmit.

Në këta 40 vjet Shqipëria socialiste njohu një lulëzim të pashembullt e të pakrahasueshëm. Ajo është një vend i lirë e i pavarur, me sistemin politik, ekonomik e shoqëror, më të përparuar, ka industrinë e vet të zhvilluar e moderne, bujqësinë e kolektivizuar që është futur në rrugën e intensifikimit, shkollën e kulturën e re socialiste, shkencën e teknikën e përparuar, mbrojtjen e fortë e të pathyeshme, ka politikën e vet të pavarur, të drejtë dhe revolucionare, që gjen përkrahjen e opinionit të gjerë e përparimtar në botë.

Socializmi që po ndërtojmë u ka siguruar punonjësve jetën e lirë, demokratike, të barabartë në të drejta e detyra, i ka hapur rrugë të gjera përparimit të gjithanshëm të tyre, i ka bërë pjesëtarë aktivë në drejtimin e shtetit dhe në qeverisjen e vendit. Jeta e njerëzve tanë është e gëzuar e plot dinjitet. Ajo karakterizohet nga interesa e synime të larta, nga ndjenja e punës dhe dashuria e respekti për njëri-tjetrin.

Fitoret që kemi arritur nuk kanë ardhur vetë, nuk na i ka falur kush. Në themel të tyre qëndron Lufta heroike Nacional-çlirimtare, gjaku i mijëra bijave dhe bijve më të mirë të popullit, qëndrojnë përpjekjet, djersa dhe mundi i masave të gjera punonjëse. Në këto vite u shkruan faqe të reja në historinë e lavdishme, në luftë të pandërprerë e të papajtueshme me armiqtë shumë e të rrezikshëm. të brendshëm e të jashtëm, imperia-

listë e revizionistë. Në këtë luftë u forcua e u çelikos uniteti i popullit, u edukua dhe u kalit njeriu ynë i ri.

Dyzet vjetët që kanë kaluar dhe realiteti i Shqipërisë socialiste kanë vërtetuar plotësisht forcën e marksizëm-leninizmit, vitalitetin e rendit socialist, drejtësinë e vijës që ka ndjekur e ndjek Partia jonë e lavdishme.

Zhvillimi ynë ekonomik-shoqëror bëhet i sigurt e në mënyrë të pandalshme. Ai nuk kushtëzohet nga ndihmat e kreditë e jashtme, por mbështetet në forcat e veta, në pasurinë e vendit, në potencialin ekonomik që kemi krijuar, në aftësitë dhe në punën krijuese të kuadrove e të masave. Udhëheqja e urtë dhe largpamëse e Partisë është siguri e të sotmes dhe e së ardhmes socialiste. Stabiliteti politik, ekonomik e shoqëror i vendit, përparimi dhe zhvillimi me ritme të larta e të qëndrueshme në çdo fushë të jetës, janë faktorë të besimit të patundur të popullit në të ardhmen, faktorë të mobilizimit të tij për mirëqenien dhe begatinë e përgjithshme të shoqërisë.

Vendi ynë ndërton socializmin në kushtet e rrethimit dhe të bllokadës së egër imperialisto-revizioniste, në kushtet e situatave ndërkombëtare të rënduara. Superfuqitë, Shtetet e Bashkuara të Amerikës e Bashkimi Sovjetik dhe fuqitë e tjera imperialiste, me politikën e tyre agresive dhe ekspansioniste, kërcënojnë lirinë dhe pavarësinë e popujve, paqen dhe sigurimin ndërkombëtar. Këto situata kërkojnë një vlerësim e angazhim më të madh në punë për realizimin e detyrave që ka shtruar Partia për ndërtimin e socializmit dhe mbrojtjen e atdheut, kërkojnë të mbahen lart fryma revolucionare dhe vigjilenca e Partisë dhe e popullit.

Perspektiva të reja, edhe më të bukura, kemi përpara për zhvillimin e përparimin e atdheut tonë të dashur socialist. Krenimi i 40-vjetorit të jetë një nxitje e veçantë për fitore të reja në të gjitha drejtimet. Komiteti Qendror, duke përshëndetur nismat dhe aksionet që kanë ndërmarrë me këtë rast punonjësit e qytetit e të fshatit, u bën thirrje klasës punëtore, fshatarësisë kooperativiste, inteligjencies popullore, gjithë punonjësve që të punojnë me një vrull të ri, më të madh e më krijues për plotësimin e detyrave që ka shtruar Partia. Viti i 40-vjetorit të Çlirimit të Atdheut e i fitores së revolucionit popullor të shndërrohet në një vit sulmi të përgjithshëm për të realizuar e tejkaluar detyrat në industri e në bujqësi, në naftë e në miniera, në ndërtim e në arsim, në kulturë e në mbrojtje.

Me qëllim që 40-vjetori i Çlirimit të Atdheut e i triumfit të revolucionit popullor të festohet sa më mirë, Komiteti Qendror i PPSH

## Porosit:

1. — Të organizohet e të zhvillohet një punë e gjerë edukative e propagandistike, kulturore e artistike, brenda dhe jashtë vendit, për të bërë të njohur luftën e lavdishme të popullit shqiptar për çlirimin e atdheut dhe vendosjen e pushtetit popullor, përpjekjet e tij vigane për transformimin socialist dhe mbrojtjen e fitoreve të revolucionit, nën udhëheqjen e Partisë.

Të intensifikohet puna ideologjike e Partisë dhe e organizatave shoqërore për të rrënjësuar te masat punonjëse dhe sidomos te brezi i ri bindjet socialiste, për të mbajtur të ndezur frymën patriotike e revolucionare, për t'i brumosur e kalitur ato me virtytet e larta komuniste, për t'i bërë akoma më shumë luftëtarë të vendosur kundër presionit e rrethimit imperialisto-revizionist e mbeturinave të ideologjive të huaja.

Gjatë vitit jubilar të përkujtohen e të festohen ngjarjet e mëdha historike të luftës e të pasçlirimit, kombëtare e lokale, siç janë 40-vjetori i Kongresit historik të Përmetit, 40-vjetori i formimit të Qeverisë Demokratike në Berat, i kongreseve të Rinisë e të Gruas, përvjetorët e formimit të brigadave partizane etj.

2. — Të organizohet e të shpërthejë në tërë vendin një emulacion i fuqishëm midis individëve, kolektivave e rretheve për të plotësuar e tejkaluar detyrat e planit në të gjithë zërat, në tërë treguesit ekonomik-financiarë, për të forcuar më tej regjimin e kursimit, për të realizuar detyrat që shtroi Plenumi i 8-të i KQ të Partisë.

3. — Veprimtaria kulturore dhe krijimtaria artistike e letrare të pasqyrojë e t'u bëjë jehonë të gjerë luftës e punës heroike të masave tona punonjëse. Krijuesit tanë t'i japin popullit vepra artistike me përmbajtje dhe nivel të lartë, që të pasqyrojnë edhe më shumë jetën shpirtërore të njerëzve tanë. Këtij qëllimi t'i shërbejnë konkurset për vepra letrare, muzikore, për filma dokumentarë e artistikë etj. Të çelen në rrethe ekspozita, dhe me veprat më të mira të hapet në Tiranë, në prag të jubileut, ekspozita qendrore e arteve figurative.

4. — Në muajin tetor të zhvillohen në stadiumin kombëtar «Qemal Stafa» finalët e spartakiadës kombëtare dhe manifestimi i madh fizkulturor-sportiv i brezit të ri.

5. — Të zhvillohet më 29 Nëntor parada ushtarake dhe manifestimi i punonjësve të kryeqytetit.

6. — Organet e shtypit, Radiotelevizioni, Kinostudioja, institucionet e tjera kulturore-artistike të hartojnë programe të posaçme, për të pasqyruar, propaganduar e nxitur përpjekjet dhe veprimtarinë e punonjësve në të gjitha fushat.

7. — Komitetet e Partisë, organizatat shoqërore, organet shte-

tërre dhe ekonomike të marrin të gjitha masat për të siguruar organizimin dhe zhvillimin me sukses e më me nivel të lartë të aktiviteteve që do të ndërmerren për 40-vjetorin.

Komiteti Qendror i Partisë shpreh bindjen se populli shqiptar, i bashkuar ngushtë rreth Partisë së tij, do ta bëjë vitin jubilar të 40-vjetorit të Çlirimit, një vit mobilizimi të paparë, për ta pritur këtë ngjarje historike me suksese të reja në zbatim të vendimeve të Kongresit të 8-të të Partisë.

## KOMITETI QENDROR I PARTISË SË PUNËS TË SHQIPËRISË

*Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë*

*Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i popullit»,  
nr. 31 (11088), 5 shkurt 1984*

## VENDIM

### I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR ZHVILLIMIN, MBROJTJEN DHE SHFRYTËZIMIN RACIONAL TË PYJEVE E TË LËNÐËS DRUSORE

11 prill 1984

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e saj të datës 11 prill 1984, mori në shqyrtim raportin e Ministrisë së Bujqësisë «Mbi disa masa për zhvillimin e shfrytëzimin racional të pyjeve». Ajo, pasi diskutoi gjerësisht për këtë çështje dhe kritikoi ashpër organet përkatëse për prapambetjen e për moszbatimin e plotë të direktivave e të vendimeve të Partisë për këtë pasuri të rëndësishme,

### Vendosi:

1. — Këshilli i i Ministrave të RPSSH të marrë të gjitha masat e domosdoshme dhe të përcaktojë rregullat rigorozë për shtimin, mbrojtjen dhe për shfrytëzimin shkencor e të balancuar të të gjitha sipërfaqeve të pyjeve dhe të shkurreve.

2. — Ministria e Bujqësisë dhe organet përkatëse në rrethe të marrin menjëherë masa për të përcaktuar kriteret shkencore të kategorive dhe të klasifikimit të sipërfaqeve pyjore e të shkurreve sipas llojeve dhe moshave, si dhe të inventarizimit të saktë e shkencor të të gjithë pasurisë drusore, i cili të përfundojë në vitin 1985.

3. — Ministria e Bujqësisë, në bazë të kriterëve shkencorë të trajtimit të masiveve dhe të parcelave pyjore të të gjitha llojeve, për çdo pesëvjeçar të bëjë projektet orientuese të shfrytëzimit të tyre në përputhje dhe me mbulimin e nevojave të planifikuar dhe në qershor të çdo viti, për vitin tejplanifikues të bëhen projekte të plota për trajtimin e pyjeve në bashkëpunim me Ministrinë e Industrisë e të Minierave, me Ministrinë e Ko-



munikacionit dhe me Komisionin e Planit të Shtetit. Po kështu dhe Ministria e Industrisë dhe e Minierave të bëjë projektet përkatëse të shfrytëzimit të tyre.

4. — Këshilli i Ministrave, duke u mbështetur në inventarin e saktë të sipërfaqeve të pyjeve dhe të shkurreve, në masat e marra për mbjelljet e reja, për ripërtëritjet, cungimet, si dhe të trajtimeve intensive, të kursimit e të zëvendësimit të lëndëve drusore te përdoruesit, të përcaktojë në fund të vitit 1985 afatet e shkallëzuara dhe përfundimtare të balancimit të rritjes me prerjen, duke plotësuar nevojat e vendit.

5. — Ministria e Bujqësisë të marrë masa të plota për futjen e llojeve të reja me rritje intensive, si të pishës, të plepit, të gështenjës dhe të kallamit. Rëndësi të veçantë ajo dhe sidomos komitetet ekzekutive të rretheve t'i kushtojnë mbrojtjes së pyjeve nga dëmtimet e prerjet pa kontroll, nga sëmundjet dhe nga zjarret, duke zbatuar me rigorozitet dispozitat ligjore që mbrojnë pyjet. Gjithashtu, të rritet shkalla e mekanizimit të kësaj mbrojtjeje dhe të jepen mjetet e fondet e nevojshme.

6. — Komisioni i Planit të Shtetit, në bashkëpunim me dikasteret e tjera përdoruese të lëndës drusore, të marrin menjëherë masa për kursimin e mëtejshëm të lëndës drusore që përdorin, duke filluar nga rritja e koeficientit të shfrytëzimit të lëndës në këmbë, ulja e normativave ekzistuese e deri te shfrytëzimi i mbetjeve në pyll dhe në qendrat e përpunimit të lëndës drusore.

Vëmendje e veçantë t'i kushtohet shpejtimit të ritmeve për zëvendësimin e lëndës drusore me qymyre, me parafabrikate betoni, me plastikë, me fibër etj.

7. — Të studiohet menjëherë shfrytëzimi i masiveve pyjore të tejpjekura dhe në pesëvjeçarin e tetë të planifikohet që të futet në shfrytëzim 50 për qind e tyre, duke siguruar për to ndërtimin e rrugëve dhe të mjeteve të tjera të transportit të lëndës drusore në pikat e tranzitit.

Gjithashtu, në masivet pyjore në shfrytëzim të meremetohen e të përmirësohen rrugët pyjore të të gjitha kategorive, si dhe të fuqizohen ndërmarrjet e shfrytëzimit pyjor me mekanizma të domosdoshëm për rritjen e rendimentit, sidomos për nxjerrjen e gjithë lëndës drusore të prerë në pikat ku e tërheq transporti.

8. — Ministria e Komunikacionit të marrë masa të plota për tërheqjen ritmike dhe sipas planit të lëndës drusore nga pylli, nga pikat e grumbullimit e të tranzitit dhe të vendosë kontroll rigoroz për tërheqjen dhe dërgimin në afat te përdoruesit të gjithë sasisë së planifikuar, me qëllim që në pyll të mbetet vetëm gjendja e planifikuar për vitin e ardhshëm.

9. — Ngarkohet Këshilli i Ministrave për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi dhe në fund të vitit 1985 të raportojë për zbatimin e tij.

10. — Organet dhe organizatat-bazë të Partisë në rrethe dhe levat e tyre në ndërmarrjet e trajtimit, të shfrytëzimit e të transportit të lëndës drusore të luftojnë e të bëjnë një punë intensive për vlerësimin e drejtë të pasurisë pyjore, për trajtimin e për shfrytëzimin shkencor të saj, si dhe për mbrojtjen e kursimin me ndjenjë të lartë përgjegjësie.

Byroja Politike e Komitetit Qendror shpreh bindjen se punonjësit e këtij sektori të rëndësishëm do të vënë të gjitha forcat për të plotësuar e për të tejkaluar detyrat e këtij vendimi.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## V E N D I M

### **I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR PLOTËSIMIN E DETYRAVE DHE NXJERRJEN NGA PRAPAMBETJA TË INDUSTRISE KIMIKE**

**15 maj 1984**

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 15 maj 1984 mori në shqyrtim raportet e komiteteve të Partisë të rretheve Durrës, Krujë dhe Vlorë «Për plotësimin e detyrave dhe nxjerrjen nga prapambetja të industrisë kimike», kritikoi të metat në punën e Ministrisë së Industrisë e të Minierave, të komiteteve të Partisë të rretheve përkatëse dhe, për të bërë sa më parë përmirësimet e nevojshme,

#### *V e n d o s i :*

1. — Organet dhe organizatat e Partisë, organet drejtuese shtetërore dhe ato ekonomike të rritin më tej kujdesin dhe punën e tyre me njerëzit e të marrin të gjitha masat tekniko-organizative për të arritur aftësitë e planifikuara të prodhimit në çdo uzinë, që detyrat e planit të këtij viti e të viteve që vijnë, të plotësohen e të tejkalohen në të gjithë zërat e treguesit.

2. — Të forcohet kudo disiplina e punës dhe ajo teknike, për të cilat industria kimike ka kërkesa të larta dhe ku vihen re jo pak të meta e dobësi. Moszbatimi i këtyre kërkesave është me pasoja serioze. Për këtë është e nevojshme që, krahas përmirësimit dhe intensifikimit të punës me njerëzit, të merren edhe masa organizative për forcimin e rregullit të brendshëm në këto ndërmarrje.

3. — Të organizohet më mirë nga qendra deri në bazë puna për kualifikimin dhe ngritjen e nivelit teknik të specialistëve, të punëtorëve dhe të kuadrove të kësaj degje.

4. — Të merren menjëherë masa për furnizimin ritmik të

ndërmarrjeve kimike me lëndë të para dhe energjetike, për sigurimin e cilësisë së planifikuar dhe për shtimin e rezervave të tyre.

Në ndërmarrjet kimike të arrihen dhe të ulen më tej normativat e përdorimit të këtyre lëndëve.

5. — Të kompletohen me specialistë të aftë. Të merren masa konkrete organizative, teknike, teknologjike e kontrolluese për mbrojtjen e makinerive e të pajisjeve nga korrozioni.

Bazat mekanike të ndërmarrjeve kimike të shfrytëzohen më mirë për mirëmbajtjen dhe për riaftësimin e makinerive dhe të pajisjeve kimike, duke u lehtësuar nga prodhimet për degët e tjera të ekonomisë.

6. — Këshilli i Ministrave, me ministritë përkatëse, të zbërthejë dhe të ndjekë zbatimin e detyrave që dalin nga ky vendim.

7. — Në fund të këtij viti t'i raportohet Komitetit Qendror të Partisë për realizimin e detyrave që u janë vënë uzinave kimike.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Enver Hoxha*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## PLENUMI I 9-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 27-28 shtator 1984

### KOMUNIKATË

#### E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 27 dhe 28 shtator 1984, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, shokut Enver Hoxha, u mbledh Plenumi i 9-të i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, i cili mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror: «Zbatimi i detyrave për rritjen e efektivitetit të ekonomisë dhe forcimi i financave, problemet dhe masat që duhen marrë», mbajtur nga kandidati i Byrosë Politike dhe zëvendëskryetar i Këshillit të Ministrave të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, shoku Qirjako Mihali.

Pasi diskutoi gjerësisht rreth raportit të paraqitur, Plenumi i Komitetit Qendror të Partisë e miratoi atë njëzëri dhe mori vendimet përkatëse.

#### PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

## R A P O R T

### I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH «ZBATIMI I DETYRAVE PËR RITJEN E EFEKTIVITETIT TË EKONOMISË DHE FORCIMI I FINANCAVE, PROBLEMET DHE MASAT QË DUHEN MARRË»

27 shtator 1984

Shokë,

Çështja që po paraqesim për shqyrtim në këtë mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror nuk është as e re, as edhe e panjohur. Partia dhe shoku Enver problemin e efektivitetit të ekonomisë dhe forcimin e financave e kanë vlerësuar vazhdimisht me seriozitetin më të madh dhe nga pozita të drejta marksiste-leniniste, si një nga faktorët themelorë të politikës ekonomike për ndërtimin e socializmit, duke u mbështetur në forcat tona.

Rritja e efektivitetit të ekonomisë dhe forcimi i sistemit financiar e monetar, të konceptuara e të zbatuara në rrugë marksiste-leniniste, kanë bërë të mundur që ekonomia në vendin tonë të zhvillohet drejt e pa ndërprerje nga njëri pesëvjeçar në tjetrin. Në vitin 1983, në krahasim me vitin 1950, produkti i përgjithshëm shoqëror është shtuar afro 13 herë, ndërsa, i llogaritur për frymë të popullsisë, ai është mbi 5,4 herë më i madh. Gjatë së njëjtës periudhë të ardhurat kombëtare janë shtuar 8,4 herë, gjë që ka lejuar të kryhen investime të mëdha dhe të sigurohet zhvillimi i ekonomisë mbështetur në burimet tona të brendshme. Mbi këtë bazë zhvillimi është fuqizuar më tej sistemi ynë financiar e monetar dhe leku shqiptar është me fuqi blerëse të garantuar e në rritje, pavarësisht nga kriza valutore e botës kapitaliste e borgjezo-revizioniste.

Ecja në vazhdimësi në rrugën marksiste-leniniste të ndërtimit socialist ka rritur besimin dhe ka forcuar bindjen e klasës punëtore, të fshatarësisë kooperativiste dhe të të gjitha masave



të gjera punonjëse në drejtësinë e vijës dhe të politikës ekonomike të Partisë, në mësimet e shokut Enver Hoxha e në mundësitë e pashtershme materiale, financiare e njerëzore që krijojnë rendi ynë socialist.

Me gjithë vështirësitë e pengesat e njohura që na janë krijuar në zbatimin e planit të shtatë pesëvjeçar, efektiviteti i ekonomisë dhe sistemi financiar kanë shënuar arritje edhe gjatë këtyre viteve, duke siguruar akumulimin e nevojshëm për të vazhduar pa ndërprerje riprodhimin e zgjeruar socialist dhe për të garantuar dhe për të përmirësuar më tej mirëqenien materiale e kulturore të popullit.

Pa i zvogëluar sukseset që janë arritur, por edhe pa rënë në vetëkënaqësi, në fushën e rritjes së efektivitetit të ekonomisë dhe të forcimit të financave tona ka disa probleme që po pengojnë zbatimin e plotë të direktivave dhe të orientimeve të Kongresit të 8-të të Partisë.

Cila është arsyeja që Byroja Politike po shtron problemin e rritjes së efektivitetit të ekonomisë dhe të forcimit të financave në këtë mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror?

Me gjithë arritjet e këtyre viteve të pesëvjeçarit të shtatë, **ka edhe mosrealizim të detyrave të caktuara të planit dhe shfaqje të padëshirueshme, që kanë ndikuar negativisht në zhvillimin ekonomik e politiko-shoqëror...**

Edhe për këtë vit, me gjithë përmirësimet që u vunë re pas Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të Partisë, gjatë 8 muajve, në disa sektorë janë krijuar mosrealizime të ndjeshme...

Këto deficite kanë çuar drejtpërdrejt në uljen e efektivitetit të ekonomisë dhe në pakësimin e burimeve materiale, financiare e valutore, dhe, po të lejohet të thellohen, çojnë në pasoja të rënda jo vetëm ekonomike, por edhe politike e shoqërore. Këto bëhen akoma më të mprehta, në kushtet e ashpërsimit të rrethimit e të bllokadës imperialisto-revizioniste dhe të ashpërsimit të luftës së klasave nga elementët armiq.

Kjo është arsyeja që Byroja Politike vendosi që problemet e rritjes së efektivitetit të ekonomisë dhe të forcimit të financave t'i nënshtrohen analizës kritike në këtë mbledhje të veçantë të Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë.

## **I. Realizimi frontalisht i detyrave të planit — kushti themelor për rritjen e efektivitetit**

Edhe pse ekonomia jonë është ekonomi e planifikuar e jo spontane, efektiviteti i saj nuk sigurohet dhe as nuk rritet vetvetiu. Shoku Enver Hoxha na mëson se për të ecur punët mba-

rë në ekonomi ka vetëm një alternativë, që është ajo e arritjes së ritmeve të planifikuara për shtimin e prodhimit, për rritjen e rendimentit të punës dhe të efektivitetit të shpenzimeve e të investimeve që bëhen. Këtej del se rritja e efektivitetit të ekonomisë lidhet, në radhë të parë, me shtimin e pandërprerë të produktit shoqëror dhe të të ardhurave kombëtare, me shpenzime sa më të vogla. Këto kanë gjetur dhe gjejnë pasqyrimin e tyre në planin e shtetit, hartimi dhe realizimi i të cilit është vepër e masave të gjera punonjëse. Prandaj asnjë punonjës, kudo që punon e drejton, nuk mund dhe nuk duhet ta përjashtojë veten nga detyrat për rritjen e efektivitetit.

**1. — Planifikimi shkencor dhe realizimi i detyrave të planit është kushti i parë për rritjen e efektivitetit të ekonomisë.** Planet tona kanë në themelin e tyre ligjet objektive ekonomike dhe politikën ekonomike të Partisë. Mirëpo jo rallë vihet re që projektplanet e hartuara, duke mos iu përmbajtur si duhet kërkesave të këtyre ligjeve, paraqiten me shpërpjesëtime. Në fakt shpenzimet kërkohen të mëdha, ndërsa shtimi i prodhimit dhe i akumulimit parashikohet nën mundësitë reale. Shtimi i prodhimit kërkohet të sigurohet më shumë nga rritja e fuqisë punëtore se sa nga rritja e rendimentit të punës, në vend që të ndodhë e kundërta, ashtu sikurse e diktojnë ligjet objektive. Fonde për investime kërkohen nga të gjithë, bile dhe me këmbëngulje, kurse, kur vjen puna për realizimin e planit dhe për sigurimin e prodhimit të parashikuar, nuk tregohet i njëjti interesim. Me këto koncepte dhe praktika nuk mund të bëhet fjalë për drejtim shkencor të ekonomisë dhe për rritje të efektivitetit të saj. Vetëm kështu mund të shpjegohet fakti që projektplanin e vitit 1985 u paraqit nga rrethet me 258 milionë lekë investime më shumë se kuota e pesëvjeçarit dhe me afro 445 milionë lekë më pak të ardhura se kuota e pesëvjeçarit. Këtu kanë përgjegjësi shokët sekretarë të parë dhe kryetarë të komiteteve ekzekutive të rretheve, sidomos të Krujës, Mirditës apo Dibrës, si dhe shokët ministra që u kanë dhënë rrugë këtyre kërkesave që po na përsëriten nga njëri vit në tjetrin. Po të planifikohet ashtu siç vijnë këto propozime, ekonomia jonë futet në qorrsovak, fillojnë shfaqjet inflacioniste dhe lindin probleme e fenomene negative me karakter të mprehtë politik e shoqëror.

Partia kërkon dhe shtron detyrën që jo vetëm këto praktika të mos përsëriten më, por edhe të bëhen të gjitha përpjekjet që, duke njohur e zbatuar më mirë ligjet objektive të zhvillimit të ekonomisë sonë, të rritet në një shkallë më të lartë edhe efektiviteti i saj.

Përvoja na ka bindur se, pas hartimit të një plani sa më shkencor, ajo që vendos për fatin e efektivitetit është lufta për

**realizimin e planit.** Kushdo që nuk realizon planin, flet në hava për efektivitetin. Dhe kjo luftë nuk mund dhe nuk duhet të kufizohet vetëm me realizimin ritmik të vëllimit të prodhimit, siç ndodh disa herë, por të përfshijë edhe asortimentin e shpërndarjen, cilësinë e koston, rentabilitetin e akumulimin etj. Të gjitha këto nuk mund të shikohen të shkëputura nga njëra-tjetra, sepse përbëjnë një unitet që, në fund të fundit, sintetizon efektivitetin.

Po si mund të flitet për rritjen e efektivitetit në naftë apo në industrinë kimike, në bujqësi apo në transport, kur nuk realizohet plani, gjë që na ka çuar në rritjen e shpenzimeve dhe keqësimin e efektivitetit të këtyre degëve?... Mosrealizimi i planit dhe ngritja e koston në këto degë dhe në ndonjë degë tjetër të ekonomisë ka ulur jo vetëm efektivitetin e këtyre degëve, por edhe të degëve të tjera që lidhen me to.

Lufta për realizimin e planit, siç na mëson shoku Enver, ka qenë dhe mbetet fronti kryesor i punës së Partisë dhe i levave të saj. Prandaj edhe për efektivitetin kërkohet një mobilizim total i Partisë për çdo detyrë të vënë në plan, për ndjekje dhe kontroll, në mënyrë që çdo punonjës të kuptojë dhe të realizojë detyrën e tij me disiplinë të fortë dhe ndjenjë të lartë përgjegjësie.

Është fakt që për mosrealizime të planeve janë bërë jo pak analiza, ballafaqime, kontrolle në vend, janë dërguar ekipe, sidomos në naftë e miniera, në bujqësi dhe në transport, por efektiviteti i kësaj pune ka qenë jo i kënaqshëm, përderisa deficitet kanë vazhduar e vazhdojnë dhe disiplina e planit është shkelur. Prandaj më pak fjalë dhe më shumë punë, më pak mbledhje pa bukë e justifikime pa bukë dhe shumë luftë e aksione konkrete për realizimin e planit.

Për mosrealizime në plan duhet të ndiejnë më shumë përgjegjësi drejtuesit e dikastereve përkatëse, si dhe komitetet e Partisë dhe ato ekzekutive, sidomos të rretheve Fier, Vlorë, Krujë, Lushnjë, Durrës dhe Dibër, ku deficitet janë më të ndjeshme. Kjo tregon se jo nga të gjithë po luftohet sa duhet për të zbatuar atë detyrë të mprehtë që shtroi Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror të Partisë, se plani i vitit 1984 dhe i gjithë pesëvjeçarit të shtatë nuk durojnë më asnjë mosrealizim.

Por për realizimin e planit ka edhe rrethe, ndërmarrje e kooperativa bujqësore që bëjnë një luftë më të organizuar për të arritur jo vetëm detyrat e prodhimit, të ndërtimit e të shërbimeve, por me të njëjtin temp luftojnë edhe për realizimin e asortimentit, të shpërndarjes, të rentabilitetit etj.

Një shembull konkret në këtë çështje na e jep lëvizja revolucionare për rritjen e efektivitetit që liadi në kombinatin e

autotraktorëve «Enver Hoxha» dhe që po mbështetet nga shumë rrethe e ndërmarrje të përparuara të vendit.

Lëvizja revolucionare për rritjen e efektivitetit të prodhimit e këtij kombinati, ku drejton shoku Llambi Gegprifti, është shprehje konkrete e kuptimit të drejtë të situatave dhe të detyrave të shtrua nga Kongresi i 8-të i Partisë për zhvillimin dhe fuqizimin e pandërprerë të ekonomisë. Kjo lëvizje mbështetet në arritjet dhe në mundësitë e mëdha që hap ekonomia socialiste, në mendimin krijues të masave e të specialistëve, në përhapjen e gjerë e shkencore të përvojës së përparuar. Gjithashtu kjo lëvizje synon për një ngritje në shkallë më të lartë të organizimit e të drejtimit në çdo hallkë dhe qelizë të ekonomisë sonë. Ajo ka vlera të mëdha edukative për revolucionarizimin e mëtejshëm të ndërgjegjes së punonjësve, për rritjen e ndjenjës së lartë të përgjegjësisë individuale e kolektive për realizimin frontalisht të detyrave të planit dhe për harmonizimin më të mirë të interesit personal me atë të përgjithshëm.

E rëndësishme është që kjo lëvizje të shtrihet më tej e të mbahet gjallë, duke luftuar çdo shfaqje të spontaneitetit e të formalizmit. E theksojmë këtë se, me gjithë porositë e dhëna nga Komiteti Qendror i Partisë, kjo lëvizje nuk po shohim që të përkrahët nga degë të tilla të rëndësishme të ekonomisë, si nafta, kromi, bujqësia, industria e lehtë e ushqimore, transporti etj., aq më tepër kur në këto degë dhe në degë të tjera kemi mosrealizime e probleme që duhen kapërcyer medoemos.

2. — Lufta për realizimin e planit kërkon medoemos realizimin e planit të uljes së koston, që është një nga kolonat kryesore për rritjen e efektivitetit të ekonomisë. Shoku Enver ka theksuar që në këtë fushë të synohet në uljen e shpenzimeve të prodhimit, të ndërtimeve, të shërbimeve etj. Vëmendja të përqendrohet në uljen e shpenzimeve materiale, duke ulur normat e harxhimit për njësi, duke zëvendësuar materialet e shtrenjta me materiale më të lira, ato të importit me të vendit, duke rritur rendimentin e punës së gjallë dhe kursimin e gjithanshëm. Në asnjë hallkë të ekonomisë sonë nuk mund të drejtohet pa njohur thellë koston e asaj që prodhohet. Prandaj po ai interes, po ato përpjekje dhe ajo luftë që kërkohen për të siguruar sasinë e planifikuar të produkteve e të mallrave, duhen të bëhen për të llogaritur e ndjekur edhe koston e prodhimit. Me këtë shqetësim duhet të jetojnë jo vetëm drejtuesit, ekonomistët e financierët, por edhe inxhinierët e specialistët e tjerë e të gjithë punonjësit e degëve të ndryshme të ekonomisë.

Në planin e vitit 1984 është caktuar detyra që nga ulja e koston së prodhimit të sigurohet 70 për qind e shtesës së të ardhurës neto të ndërmarrjeve. Duke qenë të vetëdijsëm për rëndësinë e madhe të kësaj detyre, Komiteti Qendror i Partisë dhe



orientimin që gjatë këtij viti të ndërmerret një aksion i organizuar për uljen e kostos së prodhimit. Deri tani në mjaft ndërmarrje të rretheve Tiranë, Shkodër, Durrës, Korçë etj., është bërë një punë e mirë. Dallohen për punë të mirë në këtë drejtim, përveç Kombinatit të Autotraktorëve, edhe një varg ndërmarrjesh të tjera, si ndërmarrja e ndërtimit të hidrocentralit «Enver Hoxha» në Koman, ku drejton Heroi i Punës Socialiste Ismail Ahmeti, NB në Lukovë, ku drejton shoku Vasil Anagnosti, NRGJ në Maliq, NB në Sukth, Uzina e Telave në Shkodër, uzina e instrumenteve «Petro Papi» në Korçë, Miniera e Qymyrgurit në Memaliaj etj.

Drejtnesit e këtyre ndërmarrjeve ndjekin me laps në dorë çdo shpenzim që bëhet në prodhim e në ndërtim, si dhe efektivitetin që ai siguron. Këtë e kërkojnë edhe nga vartësit e tyre, prandaj edhe kanë rezultate të mira në realizimin e detyrave. Por ka edhe rrethe, si Berati, Fieri, Kruja ose ndërmarrje të tilla, si Kombinati Kimiko-Metalurgjik në Laç, ndërmarrjet e nxjerrjes së naftës, disa komplekse blegtorale për mishin e gjedhit etj., të cilat, në vend që t'i ulin shpenzimet materiale, gjatë gjash-tëmujorit të parë i kanë rritur ato. Këto tregojnë se drejtnesit e këtyre rretheve dhe ndërmarrjeve nuk po punojnë mirë dhe nuk po merren me tërë seriozitetin e duhur me këto probleme jetike të ekonomisë.

Në mjaft rrethe e ndërmarrje problemet e kostos konceptohen si detyra vetëm të ekonomistëve e të financierëve. Është e vërtetë që ekonomistët e financierët kanë rolin e tyre të rëndësishëm në çështjen e kostos, por këta nuk po e kryejnë si duhet këtë rol. Megjithatë ulja e normativave të materialeve e të kohës së punës, shfrytëzimi me efektivitet i aftësive prodhuese, ulja e firove dhe e skarciteteve etj. në radhë të parë janë në dorë të punëtorëve e të kooperativistëve, të inxhinierëve, të agronomëve, të zooteknikëve, të teknologëve e të specialistëve të tjerë, të cilët si detyrë themelore kanë pikërisht drejtimin teknik e teknologjik të prodhimit, me qëllim që të arrihet ulja e ndjeshme e shpenzimeve materiale. Ky duhet të jetë edhe metri, me të cilin lipset të matet puna e tyre e rezultatet e saj.

Realizimi i planit të kostos, si dhe avancimi i mëtejshëm i uljes së shpenzimeve materiale gjatë aksionit që po vazhdon, kërkon që personeli drejtnes inxhiniero-teknik, si specialistët, teknologët dhe ekonomistët në ndërmarrjet ekonomike e kooperativat bujqësore, të përmirësojnë më tej bashkërendimin e punës së tyre për çdo gjë që lidhet me koston. E theksojmë këtë, sepse shumë ndërmarrje, si shtatëmujor kanë tejkaluar koston kundrejt asaj të planifikuarës. Këshilli i Ministrave ngarkohet që brenda këtij viti të studiojë sanksionet që u duhen vënë drejtnesve

të ndërmarrjeve dhe institucioneve për tejkalimin e kostove dhe të shpenzimeve.

**Forcimi i gjithanshëm i regjimit të kursimit,** veçanërisht në përdorimin e lëndëve të para, lëndës djegëse, energjisë elektrike, mbetet kurdoherë një problem i dorës së parë. Kujdes i madh kërkohet të bëhet për zëvendësimin e mjaft lëndëve të para të importit me ato të vendit, sepse ato zënë 67 për qind të importeve tona.

Me gjithë uljet e importit të tullave refraktare, me fillimin e prodhimit në vend të tyre edhe për vitin 1985 dikasteret kërkojnë të importojnë të tilla. Kjo nuk duhet lejuar. Në Kombinatit Metalurgjik sot prodhohen mbi 50 lloje e marka çeliqesh, por akoma vazhdohet të importohen në sasira të mëdha çelique ekzagonal, balestre, kuadrate dhe disa lloje çeliqesh të leguara, të cilët medoemos duhen prodhuar aty. Ministria e Industrisë dhe e Minierave këtë çështje ta saktësojë bashkë me Komisionin e Planit për planin e prodhimit të kombinatit në vitin e ardhshëm. Aktualisht, fibrat sintetike zënë 8 për qind të lëndëve të para për tekstile, kur prej kohësh është shtruar detyra për t'u futur ato gjerësisht, për faktin se fitohet shumë për çdo ton pambuk të zëvendësuar me to. E njëjta gjë duhet thënë për lëkurët sintetike, që sot zënë vetëm 25 për qind, apo për kauçukun sintetik. Shembuj të tillë ka kudo, prandaj dikasteret përkatëse dhe qendrat e punës të programojnë masat dhe të veprojnë me shpejtësi e shkathtësi, duke luftuar çdo qëndrim liberal dhe pa përgjegjësi.

Po kështu kërkohet që lëndët e para e materialet e shtrenjta e deficitare të zëvendësohen me ato më të lira dhe që i disponon në sasira më të mëdha ekonomia jonë. Në këtë fushë kërkohet të merren masa për zëvendësimin e metaleve me plastikë, fibër dhe gomë, të lëndës së drurit me xhame dhe fibra etj. Ministrinë përkatëse të kalojnë menjëherë në prodhimin e mallrave të lehtësuara, si për tekstilet, mobiljet, makineritë e pajisjet, para-fabrikatet etj., nga ku mund të kursehen disa miliona valutë dhe lekë. Në këtë fushë të aktivizohet më mirë mendimi krijues i masave, i specialistëve dhe i institucioneve kërkimore dhe arsimore. Këto detyra janë shtruar disa herë nga Komiteti Qendror, por në institute dhe në shkolla të larta këto gjëra po ecin shumë ngadalë, ashtu sikurse edhe prodhimi duhet të vërë më shpejt në zbatim arritjet dhe rekomandimet e studimeve shkencore. Komiteti i Shkencës dhe i Teknikës të ndjekë, të kontrollojë dhe të vërë para përgjegjësisë të gjithë ata që pengojnë në këtë fushë. Kjo ka të bëjë drejtpërdrejt me efektivitetin e studimeve të kryera.

Komiteti Qendror i Partisë ka kërkuar vazhdimisht që kudo të punohet me norma të mbështetura teknikisht dhe po kështu



të bëhet **unifikimi i normativave të harxhimit të materialeve** për prodhime të njëjta e në kushte të përafërta prodhimi. Por zbatimi i kësaj detyre, për shkaqe të karakterit thjesht burokratik, nuk po realizohet nga dikasteret e nga rrethet, sidomos nga Ministria e Industrisë dhe e Minerave, si dhe nga Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore, të cilat janë më prapa nga të tjerët. Kjo nuk duhet të lejohet më tej. Prandaj, duke filluar nga viti 1985 dhe për pesëvjeçarin e ri që po hartohet, të merren të gjitha masat që plani të hartohet detyrimisht me normativa të mbështetura shkencërisht dhe të unifikuara. Kjo punë të merret mirë në dorë dhe të kontrollohet me rreptësi nga të gjitha dikasteret, ndërsa Komisioni i Planit të Shtetit dhe Ministria e Financave të mos pajtohen me këtë gjendje, por të kërkojnë me këmbëngulje vënien në jetë të orientimeve të dhëna nga Komiteti Qendror.

Një luftë më e vendosur duhet bërë për mënjanimin e firove, të skarciteteve, të dëmtimeve e të shpërdorimeve. Nuk mund të durohen më gjatë skarcitetet e mëdha në industrinë e qelqit, në industrinë e cigareve, në fabrikat e tullave, po kështu në metalurgjinë e zezë dhe me ngjyra, në industrinë mekanike e në atë kimike etj. Këto skarcitete, në radhë të parë, vijnë nga që nuk respektohen kushtet teknike në pranimin dhe në përgatitjen e lëndëve të para, nuk bëhet kudo mesatarizimi i tyre, ose, si pa gjë të keq, dëmtohet cilësia gjatë transportimit të tyre.

Shqetësuese është se teknologët tanë, që nuk janë pak, janë familjarizuar me këto nivele skarcitetesh dhe, ç'është më e keqja, ata nuk marrin as masa për të mos lejuar më prirjen, që vihet re, për rritje të mëtejshme të këtyre skarciteteve, si dhe përdorimin e dobishëm të mjetëve teknologjike. Ku është atëherë efektiviteti i punës së teknologëve? Ç'bëjnë organizatat e Partisë, administratat dhe kolektivat punonjës në këto ndërmarrje për të përmbysur këtë situatë?...

3. — Shoku Enver Hoxha në Kongresin e 8-të të Partisë theksoi:

«Puna e njerëzve, me cilësi e me rendiment të lartë, është faktori vendimtar për të siguruar rritjen e efektivitetit të prodhimit e për të çuar përpara tërë ekonominë»<sup>1</sup>.

Por rezultatet e këtyre tre viteve, me gjithë sukseset e arritura, tregojnë se kjo direktivë e rëndësishme e Partisë nuk është kuptuar kudo e si duhet. Kjo detyrë nuk është plotësuar, sidomos në naftë, në metalurgji, në industrinë kimike, në nxjerrjen e qy-

1. Shih në këtë vëllim, f. 147.

myrgurit, të kromit, në industrinë ushqimore etj. Kjo ka bërë që të shkelet një nga ligjësitë kryesore të ekonomisë, që prodhimi për vete të realizohet më shumë se prodhimi për shoqërinë. Kjo do të thotë që të marrësh më shumë nga shoqëria nga sa i jep asaj. Me të drejtë vihet pyetja: Çfarë bëjnë organet e Partisë dhe të pushtetit dhe gjithë levat e tyre? Ato shqetësohen për shpërndarjen e zënien në punë të të gjitha burimeve të reja të punës dhe mirë bëjnë që shqetësohen, por ky shqetësim duhet çuar me vazhdimësi gjer në fundin e vet logjik, që këto forca të zihen kryesisht në punë të dobishme efektive dhe jo në çfarëdo lloj pune, që rendimenti i punës të rritet pa ndërprerje e jo të ulet. Kjo duhet analizuar kudo në rrethe dhe nuk duhet lejuar për asnjë rast, bile edhe kur krijohen rrethana të përkohshme që e vështirësojnë rritjen e pandërprerë të rendimentit të punës. Nuk janë të drejta edhe presionet që bëhen nga shokët e rretheve, si për shembull nga rrethi i Krujës, i Durrësit, i Elbasanit, i Tiranës e ndonjë tjetër që bëjnë kërkesa për të çelur fronte pune të reja, pa i bashkërenduar mirë ato me detyrat për rritjen e rendimentit të punës dhe me kërkesat e tregut. Sidomos kërkesa bëhen për shtimin e investimeve në pemëtari, ku prodhimi merret pas disa vjetëve, për rritjen e prodhimeve artistike e të disa lloj konfeksioneve, mjaft prej të cilave kanë qarkullim të ngadalshëm.

Rendimentin e dëmton shumë prirja, që vihet re në këto vitet e fundit, për të shtuar me ritme më të shpejta numrin e punëtorëve ndihmës, në kurriz të punëtorëve kryesorë. Kjo është rrjedhojë e kontradiktës që është krijuar midis nivelit të mekanizimit në proceset kryesore të prodhimit dhe prapambetjes së tij në proceset ndihmëse e të shërbimit. Për këtë çështje shtrohet detyra që në çdo ndërmarrje industriale e kooperativë bujqësore të bëhet një rishikim me sy kritik i raportit midis punëtorëve kryesorë e ndihmës, me synim që të rritet numri i punëtorëve kryesorë, të ulet numri i punëtorëve ndihmës, duke rritur shkallën e mekanizimit të proceseve ndihmëse dhe përsosjen e organizimit të vetë këtyre proceseve.

Gjithashtu, kohët e fundit, me vend dhe pa vend, po shtohen organikat. Komiteti Qendror i Partisë e shikon këtë si një shfaqje drejtpërdrejt të burokratizmit. Prandaj, pa humbur kohë, në ndërmarrje, në institutet studimore, në rrethe dhe në qendër, të bëhet një rishikim me sy kritik i organikave, me qëllim për t'i reduktuar dhe për t'i bërë më të manovrueshme ato.

Një faktor i dorës së parë për rritjen e rendimentit mbetet vendosja e normave teknike të punës dhe rishikimi i normave ekzistuese për t'i përputhur ato sa më shumë me detyrat për shtimin e prodhimit dhe për rritjen e rendimentit. Mirëpo në këtë fushë më shumë bëhet zhurmë, sesa punë konkrete që të

sigurojmë një rritje reale të rendimentit. Është e pashpjegueshme që, nga njëra anë, çdo vit na thuhet se normat e punës janë përmirësuar në mijëra operacione pune, ndërsa, nga ana tjetër, rendimenti i planifikuar nuk realizohet. Kështu, në uzinën «Dinamo» në rrethin e Tiranës, ku normimi i punës shtrihet në mbi 7 mijë e 400 operacione pune, mbi 6 mijë e 900 prej tyre raportohen si norma teknike. Në fakt mjaft prej tyre nuk janë të bazuara në dokumentacionin teknik të prodhimit dhe të argumentuara shkencërisht. Shembuj të tillë ka dhe në ndërmarrjet e rretheve të tjera. Kjo s'është gjë tjetër veçse një punë globale, një punë për bujë dhe me doza të mëdha formalizmi, kundër së cilës duhet të ngrihen organet dhe organizatat e Partisë, organet ekonomike e shtetërore. Problem është edhe fakti që numri i punëtorëve që nuk plotësojnë normat e punës vazhdon të jetë i lartë...

Në mënyrë të veçantë për këto çështje duhet të interesohen dhe të ngrënë zërin organizatat e bashkimeve profesionale. Këshilli Qendror i Bashkimeve Profesionale dhe drejtuesit e tij duhet t'i dalin për zot kësaj çështjeje, të organizojnë punën në mënyrë të atillë, që të bëhet një kthesë e dukshme në këtë fushë. Edhe Komiteti i Punës dhe i Pagave nuk po merret si duhet me problemet që lidhen me rendimentin, normimin dhe shpërblimin e punës.

4. — Faktor themelor për rritjen e efektivitetit dhe për shfrytëzimin e rezervave të brendshme në ekonomi është thellimi dhe zhvillimi i revolucionit tekniko-shkencor. Tani, kur ekonomia jonë ka hyrë në një stad të ri zhvillimi intensiv, rritja e efektivitetit të produktit shoqëror përcaktohet në një shkallë të lartë nga niveli i zhvillimit të shkencës e të teknikës, nga përdorimi i tyre në teknologji, nga organizimi i mirë i punës dhe i prodhimit. Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror të Partisë i vitit 1980 për shkencën shtroi shumë detyra konkrete për këto çështje.

Në zbatim të tyre janë shënuar arritje të afirmuara në praktikë, si aplikimi i teknologjive të reja të prodhimit të farërave hibride dhe të kultivimit të tyre, futja me guxim e ekranit betonarme në ndërtimin e digës së hidrocentralit të Komanit, përmirësimet strukturore në industrinë e tekstileve dhe të këpucëve, duke përdorur më gjerë lëndët e para sintetike, zbatimimi i derdhjes së pandërprerë dhe asaj preçize në metalurgjinë e zezë, krijimi i linjave në bazën e ngjashmërisë teknologjike të prodhimit në industrinë mekanike, përmirësimi i strukturës së telave elektrike etj. Këto arritje teknologjike kanë çuar jo vetëm në shtimin e prodhimit, por edhe në përmirësimin e treguesve të efektivitetit të tij.

Mirëpo nuk ndodh kështu në nxjerrjen e naftës dhe të mine-

raleve që vazhdon të bëhet me koeficientë të ulët përfitimi të mineraleve të dobishme. Në kërkimin e naftës duhet të rritet efektiviteti i metodave komplekse të studimit dhe të shfrytëzohen në mënyrë sa më racionale aparaturat dhe mjetet gjeofizike, të cilat sot përdoren jo më shumë se 50 për qind. Akoma nuk po kapërcehet prapambetja në teknologjinë e të ushqyerit të bagëtitve, pavarësisht nga rezultatet që janë arritur në disa komplekse blegtorale, dhe jo si në kompleksin e qengjave në Sarandë e në ndonjë tjetër që nuk justifikojnë investimet e shpenzimet që bëhen. Zbatimi i teknologjive të reja ka një fushë të gjerë edhe në degë e sektorë të tjerë, por këtu ka një javashllëk dhe pakujdesi të palejueshme që duhet të kapërcehet sa më parë. Çfarë u kërkojnë komitetet e organizatat e Partisë, vetë drejtuesit e ndërmarrjeve, teknologëve, inxhinierëve, agronomëve, ekonomistëve e financierëve, që i kemi me dhjetëra dhe qindra nëpër ndërmarrje, apo i lejojnë ata të punojnë pa plane konkrete dhe pa perspektivë? Nëse ata lejohen të punojnë kështu, thotë shoku Enver, ata shtojnë numrin e administratës e të furnitorëve të ndërmarrjeve, pra puna e tyre, kështu siç veprohet, është pa efektivitet.

Zgjidhja e problemeve të teknologjisë e të teknikës në këto fronte kërkon që brenda vitit 1985 t'u jepet rrugë këtyre problemeve dhe të sigurohet kthesa që kërkohet. Është e domosdoshme që institutet kërkimore-shkencore të bëjnë bilance të efektivitetit të studimeve të tyre dhe të punës shumëvjeçare të çdo bashkëpunëtori. Gjer më sot prodhimi dhe ekonomia e kanë ndërjerë shumë pak rolin dhe ndihmën e Institutit të Studimeve dhe Projektimeve të Gjeologjisë, të Minierave, të Teknologjisë, të Industrisë së Lehtë e Ushqimore, të Perimeve e të Patates, të Dhanit, të Pambukut, të Instituteve të Naftës, etj. Njëkohësisht Këshilli i Ministrave t'i ndjekë me përparësi këto probleme dhe të vërë më mirë në lëvizje organet e tij vartëse, sidomos Komitetin e Shkencës dhe të Teknikës.

## II. Të rritet efektiviteti i bazës materialo-teknike ekzistuese dhe të investimeve që do të bëhen në të ardhmen

Përpunimi dhe zbatimimi i një politike të drejtë marksiste-leniniste nga Partia dhe shoku Enver kanë bërë të mundur që te ne të krijohet një bazë e shëndoshë materialo-teknike që shfrytëzon në një shkallë të lartë lëndët e para dhe burimet energjetike të vendit, e aftë të përballojë nevojat në rritje të ekonomisë dhe të popullit. Është kjo politikë e drejtë dhe kjo strukturë ekonomike e krijuar që ka bërë themelin e efektivitetit të ekonomisë.



Efektivitet dhe akumulim më të madh ne duhet të kërkojmë në të gjitha degët dhe sektorët e ekonomisë, por, në radhë të parë, të kërkojmë në ato degë e sektorë, ku janë bërë dhe bëhen investime më të mëdha, si në naftë, në miniera dhe në fabrikat e pasurimit, në metalurgji, në industrinë kimike e mekanike, në ndërmarrjet bujqësore, në transportin hekurudhor etj. Këta sektorë duhet jo vetëm të mbulojnë shpenzimet e prodhimit dhe të përballojnë zhvillimin e mëtejshëm të tyre me të ardhurat e veta, por të bëhen sa më shpejt edhe një bazë e fuqishme për akumulacionin financiar.

Për zhvillimin e industrisë së naftës Partia dhe shteti ynë me të drejtë kanë dhënë me përparësi fonde dhe mjete të konsiderueshme materiale, financiare e valutore. Mbi këtë bazë është arritur që kjo degë të jetë me efektivitet, që ajo të bëhet një nga shtyllat kryesore për zhvillimin e pavarur të ekonomisë dhe për sigurimin e të ardhurave të valutës. Por, në krahasim me mundësitë që ka kjo degë, efektiviteti i saj është akoma i ulët. Problemet e naftës, për vetë rëndësinë e madhe e të njohur që paraqesin, kanë zënë një vend të veçantë në plenumet e kohëve të fundit të Komitetit Qendror. Mirëpo, me gjithë ndonjë ngritje të vogël që vërehet në këto muajt e fundit, përsëri jemi larg detyrave të planit. Komunistët, punëtorët, specialistët dhe kuadrin në naftë duhet të kenë mirë të qartë se nga niveli i zbulimit dhe i nxjerrjes së naftës përcaktohen në një shkallë të lartë edhe ritmet e zhvillimit dhe investimet që do të kryhen në pesëvjeçarin e ardhshëm. Ne sot investojmë në naftë çdo vit shuma të mëdha, por nuk po zbulohen vendburime të reja. Me sakrificat të mëdha sigurohen sondat, aparaturat gjeofizike, agregatet, traktorët e pastrimit etj., por shfrytëzimi i tyre është larg asaj që kërkon gjendja në naftë, sepse disa sonda shfrytëzohen me rendiment të ulët, rreth 200 puse rrinë të ndalur, avaritë janë ende të larta, koha e përvetësimit të puseve zvarritet etj. Nuk duhet të lejohet më praktika e zëvendësimit të planeve me grafikë nën plan, as edhe hezitimi për sanksione dhe masa, kur këto plane nuk realizohen. Prandaj, organizatat e Partisë në sektorin e naftës dhe në rrethet përkatëse, si dhe Ministria e Energjetikës dhe shokët e Plenumit që punojnë në këtë sektor, të ndiejnë më tepër përgjegjësinë për shqetësimet e mëdha që i kanë krijuar ekonomisë dhe të kërkojnë më shumë nga vetja dhe organet shtetërore e ato ekonomike të sektorit të naftës.

Ndërtimi i kombinatit metalurgjik «Çeliku i Partisë», siç kanë theksuar Partia dhe shoku Enver Hoxha, është një fitore e madhe e popullit tonë. Në analizën që bëri dhe detyrat që vuri, Byroja Politike ka shtruar me forcë domosdoshmërinë e rritjes së mëtejshme të efektivitetit në këtë kombinat. Nuk mund të pranohet që, pas kaq vitesh që është ngritur kombinati, të mos

kemi përcaktuar dhe të mos kemi arritur kapacitetet e prodhimit në kombinat, që të tejkalohen si pa të keq normativat e harxhimit, sidomos të koksit dhe të energjisë elektrike, që thyerjet e disiplinës dhe fluktuacioni i fuqisë punëtore të bëhen pengesë për arritjen e treguesve ekonomikë e financiarë. Prandaj organizata e Partisë dhe drejtuesit e kombinatit, në vend që të bëjnë diskutime e të justifikojnë mosarritjet, t'i shtrohen punës dhe t'u futen një për një detyrave që ka shtruar Byroja Politike për këtë kollos të ekonomisë.

Në industrinë e kromit, që në eksport zë vendin e dytë, me mbi 16 për qind të të gjitha eksporteve tona, këta tre vjet dhe si tetëmuajor janë krijuar deficite serioze, sidomos për kromet e pasura në minierën e Bulqizës. Jo vetëm kaq, por edhe perspektiva nuk është e qartë, sepse në punimet minerare janë krijuar deficite, në një kohë kur Partia ka shtruar detyrën që rezervat e gatshme, të planifikuara për t'u nxjerrë, të jenë përgatitur një vit përpara, ndërsa sot nuk kemi as për dy muaj. Sigurimi dhe stabiliteti i fuqisë punëtore, si dhe krijimi i kushteve të punës e të jetesës së tyre janë çështje që lidhen drejtpërdrejt me realizimin e detyrave të planit dhe me rritjen e efektivitetit të prodhimit. Komiteti i Partisë i Rrethit të Dibrës duhet të kuptojë se aktualisht detyra numër një e tij është nxjerrja nga prapambetja e minierës së Bulqizës. Po ashtu edhe Ministria e Industrisë dhe e Minerave, si dhe Këshilli i Ministrave, të zgjidhin atë çka varet dhe e kanë në kompetencën e tyre. Brenda fundit të vitit duhet të dilet medoemos me plan të realizuar.

Duke ndjekur një politikë të drejtë agrare, në bujqësi janë investuar shuma të mëdha për bonifikimin dhe sistemimin e tokave, për mekanizimin dhe kimizimin e prodhimit, për blegtorinë dhe pemëtarinë, nga të cilat pritet të merret një efektivitet më i lartë. Këto investime, me punën e punonjësve të bujqësisë, kanë dhënë rezultate në drithërat e bukës dhe në ndonjë kulturë tjetër. Por, sikurse është analizuar në plenumet të mëparshme të Komitetit Qendror të Partisë, në bujqësi e blegtori, për tre vjetët e këtij pesëvjeçari, gati gjysma e deficitit të krijuar në prodhimin shoqëror i takon kësaj dege, i cili ka dhënë goditje serioze në prekjen e rezervave dhe në bilancin valutë.

Këto mosrealizime kanë çuar edhe në keqësimin e efektivitetit të shpenzimeve dhe të investimeve të kryera, ndërsa në disa kooperativa, megjithëse prodhimi është shtuar, të ardhurat për krahasim janë dhe për frymë kanë qëndruar në vend ose janë ulur. Këtë gjendje Ministria e Bujqësisë, rrethet dhe çdo ekonomi duhet ta analizojnë konkretisht dhe të programojnë e të marrin masa për ndryshimin e saj.

Është fakt se masat e marra në zonën e intensifikuar me përparësi po e justifikojnë veten. Por një analizë më e thellë e re-



zultateve të arritura në këtë zonë nxjerr se jo kudo investimet dhe puna e bërë kanë dhënë efektivitetin e duhur. Kështu, vitin e kaluar, ndaj vitit 1981, në 55 kooperativa bujqësore të kësaj zone të ardhurat për 100 lekë shpenzime materiale janë rritur vetëm 1,4 për qind. Ndërsa në rrethet Tiranë, Elbasan dhe Durrës kooperativat që përfshihen në këtë zonë i tejkaluan të ardhurat, ato të rrethit të Fierit i realizuan vetëm 88 për qind, të Lushnjës 91 për qind dhe të Beratit 95 për qind. Kjo ndodhi kryesisht, sepse në zonën e intensifikuar, në një sipërfaqe prej 5 300 ha të mbjellë me misër, u morën 36 kv për hektar, në një kohë kur rrethi i Gjirokastrës mori në malësi 49 kv për hektar dhe ai i Përmetit 38 kv për hektar. Në pambuk, ndërsa rrethi i Beratit mori 12 kv për hektar, rrethet e Fierit dhe të Lushnjës, që kultivojnë 2/3 e sipërfaqes, morën 8,4 kv për hektar, afërsisht sa në vitin 1978. Rezultate jo të kënaqshme të efektivitetit të prodhimit kanë dhe 14 ndërmarrje bujqësore të kësaj zone, të cilat në vitin 1983 në prodhime të veçanta rezultuan me humbje.

Edhe këtë vit mjaft kooperativa të kësaj zone, sidomos në rrethet Durrës, Lushnjë e Fier, krijuan deficite të ndjeshme në grurë dhe nuk sigurojnë as prodhimin e misrit sipas planit. Kjo, veç të tjerave, vjen ngaqë nuk janë harmonizuar në shkallën e duhur faktorët e rritjes së prodhimit me shpenzimet për punën e gjallë e të materializuar për njësi prodhimi. Nuk po duken të bëhen edhe përmirësimet e premtuara për sigurimin e bazës ushqimore e të teknologjive të reja, për rritjen e numrit të krerëve, për përmirësimin racor në blegtori, si dhe për shtimin e prodhimit të mishit e të qumështit, në një kohë kur në dispozicion të blegtorisë janë vënë mijëra hektarë tokë për foragjere dhe dhjetëra mijëra tonë misër. Për dobësitë që vihen re në rrethet që përmendëm të zonës që intensifikohet me përparësi, si dhe për blegtorinë, duhet të ndiejnë një përgjegjësi të thellë jo vetëm drejtuesit e këtyre rretheve, por edhe drejtuesit e Ministrisë së Bujqësisë.

Problemet e uljes së kostos dhe të rritjes së efektivitetit në industri, në bujqësi dhe në degë të tjera duhet t'i shikojmë lidhur ngushtë edhe me tregtinë e jashtme. Partia ka theksuar kurdoherë se ulja e kostos dhe përmirësimi i cilësisë në prodhimet që eksportojmë, çon në rritjen edhe të rentabilitetit në tregtinë e jashtme. Por edhe tregtia e jashtme ka fushën e vet për rritjen e të ardhurave valutore nëpërmjet zgjerimit të tregjeve, shfrytëzimit të koniunkturave, nivelit të çmimeve etj. Në tregtinë e jashtme të punohet më mirë për të shitur më shumë mallra, krahas tregut në klering, edhe në atë të valutës së lirë, për të zgjeruar në shkallë më të gjerë tregtinë me kompensim, për të gjetur treg shitjeje për mineralet e reja dhe për disa mallra të tjera, të punohet më mirë për t'i hapur rrugë prodhimit, por edhe vetë prodhuesit duhet t'u përgjigjen më mirë kërkesave

të tregut të jashtëm në sasi dhe në cilësi. Tregtia e jashtme, gjithashtu, duhet të rritë më tepër bashkëpunimin me organet prodhuese dhe të ndikojë mbi të, duke informuar për kërkesat e tregut të jashtëm dhe për nivelin e çmimeve, gjë që, edhe pse u është përsëritur disa herë organeve të saj, ato nuk po e kryejnë mirë këtë funksion. Asnjë mall nuk ka arsye të shitet e të blihet pa leverdi, dhe jo siç ndodh sot me disa prodhime tekstili, me perimet, me gomat e automjeteve që blihen me cilësi të dobët etj. Edhe Ministria e Financave, Komisioni i Planit të Shtetit dhe Komiteti i Çmimeve dhe i Standarteve duhet të ushtrojnë një kontroll më të fortë në veprimtarinë e organeve të tregtisë së jashtme. Këshilli i Ministrave, nga ana e vet, të studiojë e të përcaktojë kriteret për llogaritjen e leverdishmërisë së mallrave që eksportohen dhe importohen.

**Rritja e efektivitetit të prodhimit kërkon ngritjen në një shkallë më të lartë të mendimit ekonomik.** Për këtë Partia dhe shoku Enver kanë tërhequr vazhdimisht vëmendjen dhe në këtë fushë ka përmirësime. Por detyrat e mëdha, që ka shtruar Partia, kërkojnë që kuadrot, specialistët dhe punonjësit e të gjitha profileve, në qendër e në bazë, të përvetësojnë më thellë politikën ekonomike të Partisë, të thellohen në njohuritë ekonomike, në mënyrë që realizimi i detyrave dhe zgjidhja e problemeve teknike e teknologjike të paraprihen medoemos nga mendimi ekonomik. Dhe ky mendim të materializohet në shtimin e prodhimit, në realizimin e tij me shpenzime e kosto sa më të ulët, në leverditë ekonomike të investimeve, duke zgjedhur variantet më të mira, në gjetjen e rrugëve për shtimin e eksporteve të reja dhe për pakësimin e importeve, në mënjanimin e ndërmarrjeve, aktiviteve dhe të prodhimeve të veçanta me humbje dhe në rritjen e rentabilitetit të ekonomisë. Shoku Enver na mëson:

«Është bërë tashmë më se e domosdoshme që të vihen në lëvizje gjithë mendjet e njerëzve. Kjo është një forcë e madhe revolucionare e pallogaritshme. Neve na duket se një gjë të tillë e kemi bërë dhe vazhdojmë ta bëjmë, nuk rrimë me duar lidhur. Por duhet njohur, dhe do të jetë një humbje e madhe, po të mos e njohim, se nuk i kemi vënë në lëvizje si duhet e gjerësisht mendjet e njerëzve, të cilat, të ndriçuara nga ideologjia marksiste-leniniste, janë armë nga më të fuqishmet të sistemit tonë socialist. Këto armë s'duhet kurrë t'i lëmë në gjumë, nuk duhet në asnjë rast t'i lëmë të ndryshken.

Detyrat e përditshme shtetërore dhe ekonomike, në trurin politik të njerëzve tanë, — vazhdon shoku Enver, — nuk duhet të pengojnë përvetësimin e të rejave të shkencës, të cilat janë shumë komplekse dhe që ne sapo kemi

kapërcyer pragun e derës së tyre. Në këtë derë ne duhet të hyjmë brenda me guxim, me pjekuri dhe në mënyrë të organizuar»<sup>1</sup>.

Nga këto mësimë të çmuara të shokut Enver del edhe një herë qartë se çështjet që lidhen me rrënjosjen e thellë të politikës ekonomike të Partisë dhe të ligjësive që drejtojnë proceset e zhvillimit të ekonomisë sonë socialiste, në çdo qelizë të saj dhe deri në shkallë kombëtare, nuk duhet të mbeten fakultative. E theksojmë këtë se, me gjithë përmirësimet e bëra, ka ende shfaqje të nënvleftësimit të mendimit ekonomik, që arrijnë deri në diletantizëm në drejtimin e ekonomisë, që janë me pasoja të rënda ekonomiko-shoqërore dhe frenojnë zhvillimin e ekonomisë.

Kërkohej që ky mendim ekonomik t'u japë zgjidhje më të mira një vargu problemesh që kemi përpara. Kështu, brenda strukturës ekzistuese të ekonomisë, mund dhe duhen bërë përmirësime sasiore e cilësore që çojnë në rritjen e mëtejshme të efektivitetit. Orientimet e dhëna nga Partia për hartimin e pesëvjeçarit të ardhshëm dhe për më tej, për kërkimin dhe zbulimin e mineraleve të pasura, për rritjen e shkallës së përpunimit në vend të tyre, sidomos në industrinë e naftës, të qymyrgurit, të hekurnikelit, të kromit, të bakrit etj., mbeten drejtime shumë të rëndësishme, ku duhen përqendruar studimet dhe përpjekjet për të përcaktuar drejt përparësitë dhe ritmet e zhvillimit.

Intensifikimi i bujqësisë në stadin aktual dhe sigurimi i bukës në vend kanë shtruar problemin që, duke ruajtur kurdoherë përparësinë e drithërave, struktura e degëve dhe e kulturave të ndryshme të bëhet më e manovrueshme, me synim që të plotësohen më mirë nevojat e vendit dhe të përmirësohet bilanci valutator. Me këtë sy duhen parë disa bimë industriale që janë me peshë të madhe në eksport-import, si duhani, pambuku, luledielli dhe ulliri. Për efektivitetin që ka, një kthesë rrënjësore duhet të bëhet në kulturën e duhanit, që të rritet sipërfaqja e tij, përfshi këtu edhe ndërmarrjet bujqësore, ku kemi forca pune të mjaftueshme. Krahas kësaj, investimet për duhanin në bujqësi e në industri të jenë disa herë më të mëdha nga 3-6 milionë lekë që kanë qenë në vitet e fundit, në të ardhmen, ashtu sikurse u veprua në vitin 1984, të jenë 25 deri në 30 milionë lekë në vit për të mbështetur rritjen e sipërfaqes, të prodhimit dhe sidomos përmirësimin e cilësisë, duke zgjeruar më shpejt duhanet gjethemëdhenj. Jo më pak vëmendje kërkon pambuku, sepse nga deficitet që kemi sot në këtë kulturë, importi i tij ka arritur në vendin e dytë në vlerë, pas qymyrit të koksifikueshëm.

Edhe mundësitë, edhe nevojat kanë nxjerrë në plan të parë

problemin e zhvillimit të blegtorisë, për të plotësuar nevojat e popullit me mish e produkte të tjera blegtorale. Në kuadrin e blegtorisë, praktika ka vërtetuar se prodhimi i mishit të dërrit e i shpendëve realizohet me kosto më të ulët dhe me afate më të shkurtra, të cilat, nga 36 për qind që zënë sot, në pesëvjeçarin e ardhshëm, duhet të arrijnë në 49 për qind. Për këtë qëllim të organizohet më mirë puna për majmërinë, duke ngritur edhe në kooperativa e ndërmarrje bujqësore sektorë dhe qendra të veçanta të majmërisë, si dhe të sigurohet për to baza e nevojshme ushqimore. Ministria e Bujqësisë këtë ta reflektojë qysh me planin e vitit 1985 dhe ta ndjekë me seriozitet.

Duke pasur bazë rritjen e zakonshme të bagëtisë, nga do të sigurohet gjithsej 74 për qind e prodhimit të mishit, do të duhet të kërkohej efektivitet më i lartë nga komplekset blegtorale, për të cilat vetëm gjatë këtij pesëvjeçari janë investuar rreth 321 milionë lekë. Realizimi i kësaj kërkon të bëhet një punë më e madhe për përgjithësimin e zbatimin e përvojës së kooperativës së Gorresë në Lushnjë, të Bregut të Matës në Lezhë, të NB Gosës, etj., që kanë rezultate të mira në prodhimin e mishit të dërrit.

Veç kësaj, shtimi i prodhimit bujqësor duhet shoqëruar me doemos edhe me rritjen e aftësive të përpunimit të tij nga industria ushqimore. Në këtë fushë ka mundësi dhe pritet të bëhen shumë ndryshime në strukturë e në cilësi, me artikuj e asortimente të reja, për të rritur vlerën e produkteve bujqësore.

Stadi i arritur shtrun tani në rend të ditës para mendimit ekonomik e atij teknik detyrën që aftësitë prodhuese dhe, në tërësi, bazën materialo-teknike që kemi krijuar, ta shfrytëzojmë e ta përdorim me efektivitet edhe më të lartë. Mirëpo në këtë drejtim vihen re disa dukuri që ndikojnë për të keq në shfrytëzimin me efektivitet të saj, siç është, në radhë të parë, mosarritja e aftësive prodhuese të projektuara në disa ndërmarrje industriale e bujqësore, të transportit e të ndërtimit, edhe pse ka kaluar një kohë relativisht e gjatë që kur ato janë vënë në shfrytëzim. Kjo gjendje po e rëndon ekonominë tonë. Ajo është më e theksuar në pika të tilla, si Uzina e Pirometalurgjisë në Laç, fabrikat e tullave, të tekstilit etj. Me një mprehtësi të veçantë po paraqitet kohët e fundit edhe mosshfrytëzimi i aftësive prodhuese, për shkak se ka munguar furnizimi ritmik i tyre, në sasi e në kohë, me lëndët e para dhe materialet e nevojshme. Dhe këtu nuk është fjala për mungesa lëndësh të para e materialesh të importit, për sigurimin e të cilave organet shtetërore dhe ato të tregtisë së jashtme duhet të punojnë me doemos shumë më mirë, por për lëndët të para e materialet që sigurohen në vend dhe që mungojnë, sepse prodhohen dhe shpërndahen me aritmi të palejueshme dhe të përsëritur, ose, në disa raste, harxhohen më shumë për njësi prodhimi, nga sa janë harxhuar në periudha të mëparshme.

1. Enver Hoxha, «Për planin e shtatë pesëvjeçar», f. 455-456.



Pengesa të mëdha në furnizimin material të ndërmarrjeve po krijon edhe **transporti**, sidomos me thyerjen e kontratave e me trajtimin jo të mirë të mallrave. Për zhvillimin e kësaj dege të rëndësishme të ekonomisë dhe rritjen e efektivitetit të saj Partia mbajti një Plenum të veçantë, ku u caktuan detyra dhe rrugët e zgjidhjes së tyre. Megjithatë transporti vazhdon të mbetet një pikë e dobët që pengon ecjen përpara të ekonomisë. Përparime shumë të pakta ka në intensifikimin e transportit hekurudhor dhe atij ujqor të brendshëm, kur dihet se efektiviteti i këtyre lloj transportesh është shumë më i leverdishëm se ai automobilistik. Edhe në transportin automobilistik po ecet me ngathtësi për përdorimin më të gjerë të rimorkiove dhe të makinave me dy ndërresa, për përdorimin me përparësi të makinave me tonazh të madh, faktorë këta që shpjen në rritjen e efektivitetit të transportit automobilistik. Prandaj Ministria e Komunikacioneve dhe drejtuesit e saj të bëhen më të vetëdijshëm se puna e tyre organizuese e drejtuese nuk po u përgjigjet nevojave të ekonomisë dhe detyrave që ka caktuar Plenumi. Ata tërë punën e tyre ta shohin me sy kritik, për të arritur ata koeficientë e tregues të shfrytëzimit të mjeteve që caktoi Plenumi, në vend që të kërkojnë mjete suplementare të reja.

Gjatë pesëvjeçarit të shtatë janë bërë përpjekje për të rritur frytshmërinë në përdorimin e investimeve, por janë vërejtur edhe disa dukuri negative, të cilat kanë ndikuar në uljen e saj. Gjatë zbatimit të planit të investimeve rrethet ndjekin më me përparësi ndërtimin e objekteve joproduuese, si banesat, objektet kulturore, të tregtisë etj. dhe lënë pas dore ato produuese. Ka disa objekte produuese, përfundimi dhe vënia në shfrytëzim e të cilave po zvarritet, si Uzina e Fermentimit të Duhanit dhe zgjerimi i Trikotazhit në Korçë, Uzina e Antibiotikëve, zgjerimi i Fabrikës së Birrës dhe zgjerimi i Fabrikës së Porcelanit në Tiranë etj. Në kuadrin e 40-vjetorit, për këto dhe vepra të tjera të organizohen aksione për shpejtimin e punimeve dhe për vënien në shfrytëzim të mjaft prej tyre. Mospërfundimi në kohë i studimeve tekniko-ekonomike, i projekteve të zbatimit dhe i preventivave përfundimtare gjatë pesëvjeçarit të shtatë, bënë që të mos përfshihen në plan sipas parashikimeve disa vepra të domosdoshme...

Në hartimin e pesëvjeçarit të tetë 1986-1990 është e domosdoshme që të bëhet një kujdes i madh për investimet kapitale, duke vendosur përparësi për ato vepra të domosdoshme, por dhe me afat më të shkurtër vetëshlyerje, të harmonizuara dhe të mbështetura këto me nevojat që kanë të gjithë sektorët dhe degët e ekonomisë.

Nuk mjafton që të ndërtojmë vetëm objekte të reja, por vitet e fundit po del mjaft në evidencë mirëmbajtja dhe ripërtëritja e

fondeve themelore. Për qëndrim të pakujdesshëm që tregohet ndaj fondeve themelore, si dhe «të shtyrë nga dëshira» për të mbyllur deficitet që krijohen nga aritmia në plotësimin e detyrave të planit, shpesh lihen pa u bërë ose shtyhen remontet kapitale, gjë që ka çuar në konsumin fizik të parakohshëm të këtyre fondeve. Prandaj, Këshilli i Ministrave, nga ana e vet, të rishikojë me sy kritik të gjitha rregullat e dispozitat ligjore që ekzistojnë për këtë problem dhe të bëjë plotësimet e nevojshme, duke e vlerësuar remontin e fondeve themelore njëjloj si investimet.

### III Shëndoshja e mëtejshme e financave kërkon shtimin e akumulimit dhe përdorimin me efektivitet të tij

Ekonomia dhe financat janë të pandara, ato formojnë një unitet të vetëm dialektik, në teori e në praktikë. Partia ruajtjen e këtij uniteti e ka konsideruar si një nga momentet kyç në përcaktimin e politikës së saj ekonomiko-financiare. Shoku Enver Hoxha ka theksuar:

«Teoria marksiste-leniniste na mëson dhe praktika jonë e vërteton katërcipërisht se nuk duhet të ketë në asnjë mënyrë shkëputje midis riprodhimit të zgjeruar socialist në natyrë apo në vlera konsumi, nga ai në vlerë, në të ardhura»<sup>1</sup>.

Partia shpeshherë ka tërhequr vëmendjen dhe ka kërkuar që ndaj lekut kursimit dhe përdorimit të tij me efektivitet të mbahet një qëndrim shumë serioz. E theksojmë këtë, sepse në praktikë ndeshen prirje ose koncepte që, kur është fjala për shpenzime korente ose investime në lekë, në krahasim me ato që bëhen ose kërkohen në valutë, disa drejtues dhe organe ekonomike e shtetërore tregohen shumë dorëlëshuar. Prandaj ndodh që për mbishpenzimet në valutë kërkohet llogari diçka më shumë. Dhe kjo është gjë e mirë. Ndërsa kur bëhen mbishpenzime në lekë, madje jo në mijëra, por edhe në miliona, kjo kalohet përciptazi dhe lehtë.

Këto prirje dhe koncepte janë të dëmshme për ekonominë tonë dhe për efektivitetin e saj. Dhe kjo ndodh sepse nuk kuptohet që shpenzimet në lekë përfaqësojnë kurdoherë edhe një sasi të caktuar valute. Prandaj shpenzimet me dorë të lirë në lekë për fondin e pagave, për investime e shpenzime administra-

1. Enver Hoxha, «Për planin e shtatë pesëvjeçar», f. 115.



tive na dëmtojnë njëlloj, pra ato krijojnë një varg pasojash negative në rast se nuk parandalohen. Është edhe ky moskuptim që në shtatëmujorin e këtij viti një numër ndërmarrjesh rezultuan me mbishpenzime në fondin e pagave. Në një kohë kur të ardhurat nuk janë realizuar, asnjë dikaster apo rreth nuk bën propozime për të ulur shpenzimet që buxheti të dalë i balancuar. Këto qëndrime detyrojnë Komitetin Qendror të Partisë dhe Këshillin e Ministrave të marrin masa nga lart. Kjo dikton nevojën e një kuptimi, mendimi e veprimi më aktiv, duke filluar nga baza deri në qendër. Për çdo sasi lekësh që shpenzohet të sigurohet një efektivitet sa më i lartë në sferën e prodhimit dhe në atë social-kulturorë. Kjo është një nga rrugët kryesore që jo vetëm e ruan, por edhe e forcon fuqinë blerëse të lekut.

U bënë vite të tëra që po flasim për humbjet në ekonomi, megjithatë ato vazhdojnë të jenë të pranishme e të ndjeshme, ndërsa masat që merren për mënjanimin e tyre janë ende të pamjaftueshme. Kjo dukuri shumë e dëmshme për ekonominë tonë, në vend që të vlerësohet e të cilësohet me emrin e saj të vërtetë si një ngjarje e jashtëzakonshme, në disa ndërmarrje po bëhet si një gjë e zakonshme dhe me këtë pajtohen si rrethi, ashtu edhe dikasteri. Ndryshe s'ka si shpjegohet fakti që, ndërsa Partia ka ngulur këmbë vazhdimisht që të luftohet për t'i pakësuar ndërmarrjet që planifikohen me humbje, gjersa të arrihet që ato të mënjahen krejtësisht, po lejohet që gjendja të keqësohet edhe në ndërmarrje që kanë qenë të dalluara për stabilitet në treguesit ekonomik-financiarë, si uzina e bakrit në Kukës, Kombinati i Trikotazhit në Korçë, kombinati i tekstileve «Stalin» dhe Ndërmarrja e Fruta-Perimeve në Tiranë etj. Gjatë tre vjetëve Uzina e Pirometalurgjisë në Laç, për shkaqe objektive e subjektive, rezultoi me një humbje të tillë që përfaqëson afro gjysmën e vleftës së vetë objektit.

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 1984 ato u shtuan edhe me ndërmarrje të tjera me humbje dhe e keqja është se peshën kryesore këtu e ka sistemi i industrisë dhe i minierave, energjëtika, bujqësia dhe industria e lehtë e ushqimore, që zënë vendin kryesor në prodhimin material.

Qeveria të studiojë, pa humbur kohë, të gjitha rrugët e masat që duhen marrë, të përcaktojë detyrat konkrete dhe sanksionet që duhen vënë, në mënyrë që asnjë ndërmarrje të mos dalë me humbje në fund të pesëvjeçarit të ardhshëm, duke bërë për këtë brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 1985 një program të shkallëzuar nga çdo dikaster, të miratuar nga Këshilli i Ministrave. Me të njëjtin seriozitet duhet analizuar edhe puna e atyre ndërmarrjeve që nuk realizojnë të ardhurën neto të planifikuar, sepse në të dyja rastet akumulimi dhe të ardhurat financiare të shtetit pakësohen njësoj.

Pavarësisht nga përpjekjet që janë bërë nga organet e financës e të bankës, rritja e efektivitetit në përdorimin e mjeteve xhiruese dhe të kreditit bankar duhet të mbahet më mirë në qendër të vëmendjes së tyre. Sot ndodh që planifikimi i rezervave materiale në natyrë nuk lidhet e nuk harmonizohet si duhet me planifikimin e burimeve të rregullta financiare. Por edhe në këtë rast kryesore është mosrealizimi i planit, gjë që bëhet shkak për krijimin e pengesave reciproke. Për rrjedhojë, gjatë tre viteve të fundit një pjesë e madhe e rezervave materiale në ndërmarrjet e degët e ekonomisë mbulohen me borxhet e njëri-tjetrit. Një praktikë e tillë është bërë shkak për lindjen e paaftësisë paguese dhe për shkaputjen e anës materiale nga ajo financiare të riprodhimit, ka penguar derdhjen e të ardhurave në buxhetin e shtetit dhe kthimin e kreditit bankar në afat etj.

Ndërkohë që për planifikimin e prodhimit janë bërë hapa mjaft të rëndësishëm përpara, për planifikimin e mjeteve xhiruese ka ende empirizëm. Është e palejueshme që, me gjithë porosinë e dhëna, akoma nuk janë përcaktuar normativat në ditë të rezervave materiale, si faktor kryesor për përputhjen e anës teknologjike me atë ekonomik-financiare. Pa këto nuk mund të flitet për planifikim shkencor të mjeteve xhiruese dhe të kreditit, për regjim të rreptë kursimi dhe për përdorim me efektivitet të vlerave materiale. Prandaj dikasteret të studiojnë sa më parë dhe të paraqesin brenda gjashtëmujorit të parë të vitit 1985 në Qeveri norma shkencërisht të bazuara për mjetet e xhiros. Në këtë fushë të synohet që të parandalohet krijimi i stoqeve dhe i mbinormativave në materiale e mallra, duke rritur nëpërmjet përdorimit të levës së kreditit rolin e Bankës së Shtetit dhe të Bankës Bujqësore.

**Problemet e fuqisë blerëse të popullsisë, mbulimi i saj me mallra e shërbime dhe qarkullimi monetar kanë qenë dhe mbeten objekt kryesor i politikës ekonomike të Partisë.** Qëndrueshmëria e tregut dhe e fuqisë blerëse në qytet e në fshat janë një fitore e madhe e rendit tonë socialist.

Thelbi i mbështetjes në forcat tona është që si shtet e si ekonomi të konsumojmë aq sa prodhojmë, bile ca më pak, që të krijojmë edhe një farë rezerve për situata të veçanta e të papritura. Kjo nuk po kuptohet e nuk po realizohet si duhet, pavarësisht se të gjithë e pohojnë domosdoshmërinë e saj. Në qoftë se rrethi apo ekonomia, për shembull, kërkon të ketë më shumë perime apo mish, të marrin masa dhe t'i sigurojnë prodhimet e tyre e jo të drejtohen sytë nga importi, apo të shkojnë domatet, që kanë mbi 95 për qind ujë, nga Shkodra në Pukë e në Bajram Curri, duke shpenzuar për transport e karburante, për të cilat jemi kaq nevojtarë. Dhe po kështu, ministritë, në qoftë se duan të kenë lëndë të para e materiale sipas planit nga importi, më

parë të realizojnë e të tejkalojnë naftën e bitumin, kromin dhe hekurnikelin, duhanin e cigaret, drithin dhe mishin dhe pastaj t'u lindë e drejta të konsumojnë; ndryshe të marrin masa dhe të gjejnë rrugët për ta ulur këtë konsum dhe të përgjigjen para Partisë dhe popullit për pasojat e këtyre uljeve. Gjendja e pakët e mishit në treg është po për faj të atyre që prej vitesh nuk po kryejnë detyrat as për shtimin numerik të blegtorisë, as dhe për sigurimin e bazës së nevojshme të ushqimit të tyre. Nuk mund të lejohet që ne, me gjithë këto mundësi e tradita për blegtorinë, të drejtojmë sytë nga importi për mish, në vend që ta sigurojmë atë, në sasi të mjaftueshme për vete e ndoshta dhe për eksport. Po kështu dhe për perimet, për patatet e fasulet, për frutat, për yndyrnat, sheqerin, pambukun etj., konsumi i të cilave duhet të përballohet kryesisht dhe dora-dorës tërësisht nga prodhimi i vendit, duke zbatuar mësimin e shokut Enver që, përpara se të kërkojmë nga shoqëria, duhet t'i japim asaj. Ne vetë jemi prodhues dhe konsumatorë, dhe me këtë këndvështrim duhet të shikojmë edhe kërkesat tona në rritje.

Problemi i furnizimit të popullatës me sende konsumi, si në qytet ashtu dhe në fshat, ka karakter të theksuar politik e shoqëror. Por disa quadro e specialistë në ministri, në rrethe, në ndërmarrje e kooperativa, të rrëmbyer nga rutina burokratike, tregojnë shumë pak kujdes për të dhe e shikojnë si të parëndësishme mungesën e këtij apo atij artikulli në treg, megjithëse të tillë ka e mund të sigurohen nga prodhimi ynë. Është e papranueshme që për vite me radhë detyrat e tregtisë kooperativiste nuk realizohen më shumë se 85 për qind, kur dihet që ajo tregton prodhimet që realizohen nga vetë kooperativat. Pse të mos furnizohet rregullisht fshatari me perime, fasule apo bulmet, kur ai e sheh që aty prodhohen? Nuk është në interes të ekonomisë, por as të kooperativistit e të qytetarit që boshllëku që krijohet nga mungesa e perimeve, e bulmetit dhe e fasuleve, të zëvendësohet me bukë e makarona, me sheqer, oriz apo yndyrna.

Janë këto arsye që në lëmin e qarkullimit monetar është shfaqur ndonjë shpërpjesëtim midis sasisë së parave në qarkullim dhe mbulimit të saj me mallra. Prandaj Këshilli i Ministrave këto probleme të mprehta t'i ndjekë më mirë në proces dhe të marrë masa për të harmonizuar më mirë fuqinë blerëse me qarkullimin monetar.

Në kushtet aktuale të zhvillimit intensiv të ekonomisë me forcat e veta dhe të thellimit të luftës së klasave, një rëndësi më të madhe ekonomike, politike dhe ideologjike **merr ruajtja dhe administrimi më i mirë i pronës socialiste**. E theksojmë këtë, sepse edhe në këtë fushë ka të meta e veprime të dënueshme, që dëmtojnë të ardhurat financiare të shtetit. Kështu, gjatë

tre viteve të fundit nga mungesat, dëmet dhe shkeljet e disiplinës financiare humbasin dhjetëra milionë lekë...

Këtu duhet bërë një luftë e vendosur, duke ngritur në këmbë opinionin shoqëror dhe duke forcuar kontrollin financiar, ekonomike e shoqërore, në mënyrë që vjedhësit e shpërdoruesit të vihen me shpatulla për muri, duke luftuar shfaqjet e indiferentizmit e të liberalizmit, që nga kuadrot kryesorë.

Gjithashtu, organet e kontrollit ekonomiko-financiar, të inspektimit të shtetit, të arbitrazhit dhe të drejtësisë të rritin më tej efektivitetin dhe rolin e tyre parandalues ndaj dëmtimeve, vjedhjeve e shpërdorimeve të pronës, si dhe për realizimin e kontratave. **Themelore këtu mbetet forcimi i kontrollit të brendshëm në çdo njësi e hallkë të ekonomisë.**

Të gjitha çështjet që përmendëm më sipër, lufta dhe puna për rritjen e efektivitetit, rritja e forcës së planit dhe e rolit të organeve të financës dhe të bankës, përdorimi aktiv i levave ekonomike ka të bëjë në fund të fundit **me kursimin kudo dhe në çdo gjë**. Kursimi të ne asnjëherë nuk ka qenë çështje fushate, por ai buron nga natyra e rendit tonë ekonomiko-shoqëror socialist. Mirëpo, ashtu siç thamë për efektivitetin, as kursimi nuk arrihet vetvetiu.

Regjimi i kursimit duhet të forcohet në sferën e prodhimit, por ai duhet të forcohet jo më pak edhe në sferën joprodhuese, në fushën e arsimit, të shëndetësisë, të kulturës, të shërbimeve, të mbrojtjes e deri në familje, dhe kjo nuk i duhet lënë spontaneitetit, por të ndiqet me kujdes nga organizatat-bazë të Partisë dhe levat e saj.

Ekonomia dhe financat, në të gjitha hallkat, tashmë kërkojnë drejtim të kualifikuar dhe nuk durojnë shfaqjet e formalizmit e të burokratizmit, punën me hope e fushata, pritmerinë, konstatimet ose frymën e justifikimeve. Financa, si levë e Partisë, ka përgjegjësinë dhe detyrat e veta në këtë fushë.

Për të rritur rolin dhe ndikimin më aktiv të sistemit financiar dhe të bankës në fushën e efektivitetit, është e nevojshme të përsoset më tej edhe vetë mekanizmi financiar e bankar. Kjo përsosje duhet të përfshijë levën e çmimeve, kanalet e tërheqjes së të ardhurave në buxhet, kreditin etj.

Në sistemin ekzistues të çmimeve të synohet që, për disa produkte, ato të ndërtohen duke kombinuar parametra të ndryshëm (peshë, rreze etj.), në mënyrë të atillë që efekti ekonomik i shkeljes së tyre të rëndojë mbi prodhuesin dhe jo mbi përdoruesin. Të thellohet më tej edhe diferencimi midis cilësive e çmimeve me shumicë e të grumbullimit të disa produkteve industriale dhe bujqësore.

Për sa i përket kreditit bankar me afat të shkurtër, të merrren masa për të këputur zinxhirin e paafetësisë paguese në ato

ndërmarrje, ku është burimi i paaftësisë së përkohshme, me qëllim që me anën e kësaj leve të ushtrohet presion për përmirësimin sa më shpejt të gjendjes.

Zgjidhja e gjithë këtyre problemeve kërkon të ngrihet në një shkallë më të lartë nivel i punës së Partisë, që nga organizata-bazë e deri në komitetet e Partisë, për të sqaruar, frymëzuar, për të mobilizuar e për të bërë të ndërgjegjshëm komunistët dhe masat që problemet e efektivitetit të kuptohen e të realizohen në përputhje me këto situata dhe me detyrat e mëdha që kemi përpara.

Në këtë kuadër organet dhe organizatat-bazë të Partisë t'u futen më mirë problemeve të efektivitetit, të planit e të financës, të njohin më thellë metodologjinë e planifikimit ekonomik e financiar, rregullat dhe aktet juridike që drejtojnë prodhimin dhe shpërndarjen.

Rritja e efektivitetit të ekonomisë, forcimi i rolit aktiv të planit dhe të financës varen drejtpërdrejt nga fakti se sa u bëhen të qarta dhe sa kuptohen ato nga punonjësit e specialistët, sa punohet për të rritur mobilizimin dhe sa ata bëhen të ndërgjegjshëm e marrin përgjegjësi për realizimin e detyrave. Kudo duhet të reflektojmë më shumë në mësimin e shokut Enver që

«... sa të rëndësishme janë buka e çeliku, nafta e çimentoja, tekstilet dhe artikujt ushqimorë, po aq të rëndësishme janë edhe burimet financiare e valutore... Kush nuk e kupton e nuk thellohet në këtë, — vazhdon shoku Enver, — nuk ka kuptuar abëcënë e doktrinës ekonomike marksiste-leniniste...»<sup>1</sup>.

Njohuritë ekonomike e financiare janë të domosdoshme për çdo kuadër dhe specialist të çdo fushe, ndryshe prodhimi nuk mund të drejtohet në mënyrë racionale, me llogari, leverdi dhe kontroll, nuk mund të zbulohen dhe të mobilizohen rezervat e brendshme dhe përvoja e përparuar. Duke e trajtuar problemin në këtë prizëm, është koha të shihet dhe të zgjidhet më drejt edhe përgatitja e kadrove dhe e specialistëve të ndryshëm, sidomos nga shkollat tona të larta, duke lidhur më organikisht njohuritë teknike me ato ekonomike, ashtu sikurse edhe përgatitja e ekonomistëve të harmonizohet më shumë me dijet e proceseve e të arritjeve të teknikës dhe të teknologjisë. Kësaj çështjeje duhet t'i rikthehet Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, duke filluar nga programet mësimore deri te praktikat, në bashkëpunim me dikasteret përkatëse.

Në këtë Plenum u ndalëm në disa probleme e drejtime për

1. Enver Hoxha, «Për planin e shtatë pesëvjeçar», f. 115.

rritjen e mëtejshme të efektivitetit të ekonomisë dhe forcimit të financave tona. Detyra shtrohet që organet e organizatat-bazë të Partisë dhe levat e tyre, duke pasur në themel direktivat e Partisë dhe vrullin revolucionar që ka shpërthyer në të gjithë vendin për nder të 40-vjetorit të Çlirimit të Atdheut dhe të fitores së revolucionit popullor, të ngrenë në një nivel më të lartë shkencon punën për drejtimin me efektivitet sa më të lartë të prodhimit.

*Botohet për herë të parë, me  
ndonjë shkurtim, sipas origji-  
nalit që gjendet në Arkivin  
Qendror të Partisë*



## V E N D I M

### I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR ZHVILLIMIN E MËTEJSHËM TË INDUSTRISE SË LEHTË DHE USHQIMORE

12 shkurt 1985

Byroja Politike e Komitetit Qendror të Partisë, në mbledhjen e datës 12 shkurt 1985, mori në shqyrtim raportin e Ministrisë së Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore «Mbi gjendjen e industrisë së lehtë dhe ushqimore, problemet që dalin, dhe masat që duhen marrë për zhvillimin e mëtejshëm të saj» dhe, pasi diskutoi rreth tij,

#### V e n d o s i :

1. — Organet dhe organizatat e Partisë, organet drejtuese shtetërore dhe ato ekonomike të industrisë së lehtë dhe ushqimore të rritin më tej luftën dhe përpjekjet e tyre për të zgjeruar llojshmërinë e prodhimit, për të përmirësuar cilësinë e mallrave dhe ambalazhimin e tyre, për të plotësuar më mirë kërkesat në rritje të tregut të brendshëm dhe të eksportit. Të kapërcehen vështirësitë e krijuara në këtë sektor të ekonomisë duke futur progresin në organizim, në prodhim, në teknologji dhe të sigurohet një përmirësim i treguesve ekonomiko-financiarë.

2. — Këshilli i Ministrave të avancojë në kohë disa nga objektet e industrisë së lehtë dhe ushqimore të parashikuara në skicidenë e pesëvjeçarit të tetë. Për këto objekte të punohet në front, duke përdorur dhe metodën e aksionit, që të kryhen investimet kapitale të caktuara dhe të shkurtohet afati i ndërtimit dhe i përvetësimit të aftësive prodhuese e të teknologjive të reja.

3. — Ministria e Bujqësisë të marrë masa që t'i sigurojë industrisë ushqimore lëndët e para në sasinë dhe në përmbajtjen e duhur të përbërësve të dobishëm. Kurse Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore të thithë dhe të përpunojë tërë prodhimin

bujqësor dhe blegtoral për industrializim duke përballuar në rrugë të ndryshme dhe periudhën e prodhimit më të madh.

4. — Organet e tregtisë së jashtme, të industrisë e të minierave, të energjetikës, të transportit dhe institucionet shkencore të realizojnë planet e caktuara dhe të mbështetin fuqimisht prodhimin e mallrave të konsumit të gjerë. Për këtë, qysh në planifikim, të tregohet kujdes më i madh për sigurimin e rezervës së nevojshme teknologjike.

5. — Të rritet gama e artikujve të imët dhe të përdorimit shtëpiak për të përballuar më mirë kërkesat e tregut në sasi, në cilësi dhe në asortiment. Të luftohet për një paraqitje më estetike të tyre.

6. — Këshilli i Ministrave, me ministrinë përkatëse, të zëbërthejë dhe të ndjekë zbatimin e detyrave që dalin nga ky vendim.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Enver Hoxha

Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë

## VENDIM

### I BYROSE POLITIKE TE KQ TE PPSH PER FUQIZIMIN E BAZES USHQIMORE DHE SHTIMIN E PRODHIMIT TE MISHIT

9 prill 1985

Byroja Politike e Komitetit Qendror te Partise, ne mbledhjen e datës 9 prill 1985, mori ne shqyrtim raportin e paraqitur nga Ministria e Bujqesisë «Për fuqizimin e bazës ushqimore dhe realizimin e planit të prodhimit të mishit» dhe, duke u nisur jo vetëm nga nevojat, por edhe nga disa dukuri pozitive në këtë fushë,

Vendosi:

#### I. Për fuqizimin e bazës ushqimore të blegtorisë

1. — Ministria e Bujqesisë, komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve dhe ekonomitë bujqësore, brenda vitit 1985, të përcaktojnë strukturën më të përshtatshme të bimëve foragjere sipas qëllimit që do të përdoren, me synim që të kalohet në masë nga mënyra e të ushqyerit të bagëtive nga fusha në stallë, në mënyrën e të ushqyerit fushë-depo-stallë. Për këtë qëllim të njësohet përdorimi i bazës materiale dhe i plehrave kimike, siç veprohet edhe për kulturat e tjera, duke i konvertuar ato në bazë të sasisë së prodhimit.

Të shtohet sasia e silazhit të misrit me kalli, duke programuar masat e nevojshme që, gjatë vitit 1986, të silazhohen 900 mijë tonë dhe në vitin 1987 jo më pak se 1 milion tonë.

2. — Për të kapërcyer prapambetjen në prodhimin e farnave foragjere, të caktohen sipërfaqet e nevojshme të veçanta dhe të forcohet disiplina shkencore për kultivimin dhe manipulimin e tyre. Duke filluar nga viti 1986, të prodhohen rreth 700

tonë farë jonxhe, 4-5 mijë tonë farna të bimëve leguminoze dhe 100 tonë farna për kultivimin e kullotave.

Instituti i Foragjereve dhe i Kullotave të thellojë punën gjetniko-përzgjedhëse për prodhimin dhe shumëzimin e farnave me aftësi të lartë prodhuese.

3. — Në bazë të përvojës së kooperativave të Këmishtajt, të Çajës, të Bradasheshit dhe të Ndërmarrjes Bujqësore të Vurgut, në ekonomitë bujqësore të ngrihen linja e, sipas nevojës, edhe sektorë për përpunimin kimik, mikrobiologjik e hidrobarotermik të ushqimeve të ashpra. Objektivi të jetë që, në fund të vitit 1986, të arrihet të përpunohen rreth 250 mijë tonë nënprodukte të tilla. Ndihmë të gjithanshme për pajisje të japin për këtë qëllim edhe ndërmarrjet ekonomike në rrethe.

4. — Ministria e Bujqesisë dhe rrethet, në bazë të një studimi, të konkretizojnë radhën e investimeve dhe përdorimin me efektivitet të tyre për rritjen e aftësive prodhuese të kullotave natyrore. Brenda vitit 1986 të përfundojë ndërtimi i lerave të nevojshme në kullotat malore, duke u marrë aksion kombëtar nga rinia.

#### II. Për shtimin e prodhimit të mishit

1. — Brenda vitit 1985, sipas përvojës së rrethit të Lushnjës, në të gjitha kooperativat dhe ndërmarrjet bujqësore të zonës fushore të organizohen sektorë të veçantë për majmërinë e gjedhit. Gjithashtu, të punohet që të ngrihen njësi e brigada të veçanta edhe në kooperativat e tjera të vendit. Njësi të tilla të organizohen edhe për prodhimin e mishit të derrit dhe të bagëtive të imëta. Të kalojnë në majmëri edhe bagëtitë që theren për furnizimin me mish të kooperativistëve.

2. — Duke filluar nga ky vit, të parashikohet mbajtja e do-save dhe rritja e derrit në kooperativat bujqësore, duke u mbështetur dhe në traditën e popullit për mbarështimin ekstensiv e gjysmintensiv të tyre. Deri në fund të vitit 1986 kjo të shtrihet në shumicën e kooperativave bujqësore.

3. — Duke filluar nga viti 1985, të krijohet baza për mbajtjen e pulave dhe për prodhimin e vezëve në të gjitha ekonomitë bujqësore. Në vitin 1986 çdo kooperativë bujqësore dhe çdo rreth të sigurojë vetë furnizimin me vezë të tregut e të fshatit.

4. — Ministria e Bujqesisë dhe Komisioni i Planit të Shtetit, duke filluar nga viti 1985, të përcaktojnë çdo vit me plan detyrën për vënien në majmëri të gjedhit, të qengjave e të kecave në kullotat verore.

5. — Ministria e Bujqesisë, rrethet dhe ndërmarrjet përkatëse të marrin masa të gjithanshme për të arritur sa më parë

shfrytëzimin e plotë të aftësive prodhuese në komplekset blegtorale dhe sidomos për të rritur efektivitetin e prodhimit në to, duke ulur koston e produkteve.

6. — Të gjitha ekonomitë që kanë sektorë të veçantë të pemëtarisë, që këtë vit, sipas përvojës së Ndërmarrjes Bujqësore të Lukovës, të organizojnë mbajtjen e lopëve ose të viçave e të qengjave për mish.

7. — Të zgjerohet kryqëzimi industrial në gjedhë e në dhen me raca mishatake, me synim që kjo metodë, çdo vit të pesëvjeçarit të ardhshëm, të shtrihet në mbi 40 mijë krerë lopë dhe në mbi 100 mijë krerë dhen.

8. — Ministria e Bujqësisë dhe Komisioni i Planit të Shtetit, gjatë planifikimit, të mbajnë parasysh ngarkesën akoma të ulët të numrit të krerëve për lloje të ndryshme bagëtitish në disa rrethe, për t'i njësuar gradualisht ato me rrethet në kushte të krahasueshme.

9. — Të përmirësohet puna për rritjen e pjellorisë në të gjitha llojet e bagëtive. Për këtë, veç masave për luftimin e shterpësisë, pranë Institutit të Kërkimeve Zooteknike të krijohet laborator i për prodhimin e serumit të pelave barrsë dhe, duke filluar nga ky vit e deri në fund të vitit 1986, delet e ekonomive të zonës kodrinore e fushore, para se të skartohen, të përpunohen me këtë serum, siç kanë vepruar disa ekonomi në rrethet Shkodër, Krujë, Vlorë etj.

10. — Instituti i Foragjereve dhe i Kullotave, Instituti i Kërkimeve Zooteknike dhe ai i Kërkimeve Veterinare, duke u mbështetur në detyrat që shtrohen për blegtorinë, të marrin më mirë përsipër futjen e të rejave shkencore dhe të përqendrojnë më shumë punën e ndihmën e tyre në prodhimin e gjerë.

Instituti i Lartë Bujqësor të rishikojë e të përmirësojë programet për përgatitjen e studentëve me njohuri më të thella për bimët foragjere, kullotat dhe, në tërësi, për mbarështimin e kafshëve.

11. — Të merren masa konkrete për rritjen e shkallës së mekanizimit në bimët foragjere e në blegtori.

Ministria e Industrisë dhe e Minerave të zgjidhë problemin e prodhimit të makinerive e të pajisjeve për korrjen, grirjen dhe përpunimin e ushqimeve, si dhe problemin e prodhimit të disa lëndëve minerare për ushqim kafshësh.

Ministria e Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore të zgjerojë llojshmërinë dhe të sigurojë prodhimin me cilësi e të standardizuar të nënprodukteve të industrisë që përdoren si ushqim për blegtorinë.

12. — Komitetet e Partisë të rretheve të zërthejnë e të nxjerrin detyrat e tyre politike e organizative, të nxitin kudo iniciativën e vetëveprimin për zbatimin e këtij vendimi dhe të marrin

masa për të ngritur opinionin dhe mobilizimin e njerëzve, ashtu siç u veprua me detyrën e shtruar për sigurimin në vend të dritërave të bukës. Të merren, gjithashtu, masa që në sektorët e majmërisë së kafshëve dhe në brigadat e sigurimit të bazës ushqimore të ngrihen organizata-bazë partie.

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për të zërthyer dhe për të konkretizuar zbatimin e këtij vendimi.

Sekretari i Komitetit Qendror të PPSH

*Ramiz Alia*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*



## PLENUMI I 11-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 13 prill 1985

### KOMUNIKATË

#### E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Për të nderuar e për të përjetësuar emrin dhe veprën e pavdekshme të udhëheqësit të lavdishëm të Partisë, shokut Enver Hoxha, sot, më 13 prill 1985, u mbledh Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të PPSH.*

*Plenumi nderoi me dy minuta heshtje kujtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Enver Hoxha.*

*Në Plenum shoku Ramiz Alia foli për jetën dhe për veprën e shkëlqyer të shokut Enver Hoxha si revolucionar e marksist-leninist i madh, që mbrojti me besnikëri dhe zhvilloi me sukses e Marksit, Engelsit, Leninit e Stalinit, si themelues, organizator e udhëheqës i Partisë, organizator e strateg i Luftës Nacional-çlirimtare dhe i revolucionit popullor, krijues e drejtues i pushtetit të diktaturës së proletariatit, arkitekt i ndërtimit të socializmit, themelues e Komandant i Përgjithshëm i Forcave tona të Armatosura, biri më i shtrenjtë dhe figura më e madhe historike e popullit dhe kombit tonë, që tërë jetën e tij ua kushtoi Partisë, popullit, atdheut, kauzës së komunizmit.*

*Për të përjetësuar emrin dhe veprën e shokut Enver Hoxha Plenumi nxori vendimin përkatës.*

*Plenumi njëzëri zgjodhi Sekretar të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokun Ramiz Alia.*

#### PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

## VENDIM

### I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH PËR PËRJETËSIMIN E EMRIT DHE TË VEPRËS SË SHOKUT ENVER HOXHA

13 prill 1985

Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur në datën 13 prill 1985, për të përjetësuar emrin dhe veprën e shokut Enver Hoxha, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë, Kryetar i Këshillit të Përgjithshëm të Frontit Demokratik të Shqipërisë, Komandant i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë, udhëheqës i madh e i lavdishëm i Partisë dhe i popullit tonë,

#### Vendosi:

1. — Të ngrihet përmendorja e shokut Enver Hoxha në kryeqytetin e atdheut, Tiranë, në vendlindjen e tij Gjirokastër dhe në qytetin e Korçës.
  2. — Universiteti i Tiranës të marrë emrin universiteti i Tiranës «Enver Hoxha».
  3. — Organizata e Pionierit të marrë emrin «Pionierët e Enverit».
  4. — Porti Detar i Durrësit të marrë emrin porti detar i Durrësit «Enver Hoxha».
  5. — Ndërmarrja Bujqësore me qendër në Plasë të rrethit të Korçës të marrë emrin ndërmarrja bujqësore «Enver Hoxha».
- Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Këshilli i Ministrave të RPSSH.

#### PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

*Botuar për herë të parë në gazetën «Zëri i popullit», nr. 89 (11459), 14 prill 1985*

**V E N D I M**  
**I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR FURNIZIMIN**  
**E POPULLIT**

10 maj 1985

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 10 maj 1985, mori në shqyrtim raportin e Ministrisë së Tregtisë së Brendshme dhe të Ministrisë së Bujqësisë «Për masat për furnizimin e popullit sidomos në fshat», dhe pasi diskutoi rreth tij,

*V e n d o s i :*

1. — Plotësimi i kërkesave të domosdoshme të popullit me mallra e shërbime, të kuptohet më thellë në planin politik, ekonomik e shoqëror nga organet dhe organizatat e Partisë, nga organet e shtetit e të ekonomisë, nga të gjithë punonjësit që merren me prodhimin dhe me shpërndarjen e tyre.

2. — Plotësimi i detyrave të planit dhe shtimi i prodhimit, sidomos në bujqësi dhe në industri, të konsiderohen faktorë vendimtarë për të zgjeruar konsumin e popullit në rrugë të drejtë e me perspektiva të sigurta. Për këtë të angazhohen në mënyrë energjike mundësitë e mëdha njerëzore, materiale, shkencore dhe organizative që janë krijuar dhe që po fuqizohen edhe në këtë sektor jetik të ekonomisë.

3. — Ministria e Bujqësisë, komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve rëndësi të veçantë t'i kushtojnë realizimit dhe tejkalimit të planit të prodhimit të perimeve, fasuleve, patateve, qumështit dhe mishit për të siguruar një furnizim gjithëvjeter të popullit të qytetit e të fshatit me këto prodhime.

Për shtimin e prodhimit të tyre, pa rritur sipërfaqet e planifikuara për kulturat e para, të shfrytëzohen për mbjellje më shumë toka hamullore nën ujë, tarracat dhe masivet frutore, me

synim që qysh këtë vit dhe në vitin e ardhshëm nga këto sipërfaqe të merren 10-15 mijë tonë perime, 15-20 mijë tonë patate dhe 1 500-1 600 tonë fasule.

4. — Të përdoren kudo rezervat e brendshme për të prodhuar artikuj të rinj dhe sidomos artikuj të vegjël, duke luftuar mungesën e iniciativës dhe shfaqjet e dëmshme të punës për bujë. Gjithashtu, të rishikohet praktika e specializimit të ngushtë në prodhimin e mallrave të konsumit të gjerë që kufizon prodhimin dhe sjell rritje të shpenzimeve të transportit.

5. — Të luftohet kudo për rritjen e prodhimit nga bagëtitë e tufëzuara. Të orientohet më mirë mbjellja e ngastrës së oborrit kooperativist, sidomos me perime, patate dhe fasule.

6. — Ministria e Tregtisë së Brendshme dhe ajo e Industrisë së Lehtë e Ushqimore të marrin masa të plota e të gjithanshme për të tërhequr gjithë sasinë e prodhimit bujqësor e blegtoral të destinuar për treg e për industrializim.

Për trajtimin dhe ruajtjen e tyre për periudha më të gjata të shfrytëzohen më mirë se deri tani frigoriferët dhe mjediset me ftohje, depot, tunelet dhe të bëhen konservime tradicionale e industriale në sasi të mjaftueshme për furnizimin gjithëvjeter.

7. — Ministria e Tregtisë së Brendshme dhe ndërmarrjet e saj të jenë më të shkathëta në veprimet e tyre, të vënë kurdoherë në plan të parë furnizimin e popullit. Nga ana e tyre të rritet forca nxitëse mbi prodhimin, veçanërisht për cilësinë e asortimentin, për produkte të reja e të imëta.

8. — Ministria e Tregtisë së Brendshme dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve të krijojnë koncepte të drejta për ta parë tregtinë kooperativiste njëjloj si tregtinë shtetërore dhe të interesohen në front të gjerë për mbarëvajtjen e saj. Prandaj së bashku me Ministrinë e Bujqësisë të futen deri në planifikimin e sasive e të strukturës së produkteve bujqësore dhe blegtorale për nevojat e kooperativistëve.

Mbi bazën e shtimit të prodhimit bujqësor e industrial të synohet në përmirësimin e mëtejshëm të raporteve e të normave të konsumit për frymë midis fshatit e qytetit për disa artikuj të nevojës së parë e të konsumit të përditshëm.

9. — Të merren masa më të plota për përmirësimin e cilësisë së bukës sidomos në fshat.

10. — Nga tejkalimi i prodhimit, shfrytëzimi i rezervave dhe i kursimeve në gjithë degët e ekonomisë, Këshilli i Ministrave të studiojë mundësitë për të shtuar rezervat në depot e tregtisë në përgjithësi dhe në zonat që izoloohen në veçanti.

11. — Komitetet e Partisë të rretheve të nxjerrin detyrat e tyre politike dhe organizative për zbatimin e këtij vendimi, të marrin masa për të ngritur opinionin dhe mobilizimin e njerëzve,

që të sigurohet prodhimi dhe furnizimi normal i popullit.  
Ngarkohet Këshilli i Ministrave me ndjekjen dhe me zbatimin e këtij vendimi.

**Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë**

**Ramiz Alia**

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

**VENDIM  
I BYROJË POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR PËRMIRËSIMIN  
E PUNËVE NË TRANSPORT**

**15 qershor 1985**

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 15 qershor 1985, mori në shqyrtim raportin e Ministrisë së Komunikacioneve «Për disa masa për përmirësimin e punës në transport». Në këtë analizë ajo kritikoi Ministrinë e Komunikacioneve për punë të pamjaftueshme në zbatim të vendimeve të Plenumit të 5-të të Komitetit Qendror dhe për deficitet e krijuara në plotësimin e planit të këtij viti, të cilat kanë krijuar vështirësi në realizimin e detyrave nga shumë sektorë të ekonomisë.

Për të përmirësuar gjendjen në transport, Byroja Politike,

**Vendosi:**

1. — Organet dhe organizatat e Partisë, organet shtetërore dhe të ekonomisë të rritin mobilizimin dhe shkallën e përgjegjësisë së punonjësve të transportit për të plotësuar detyrat e planit dhe nevojat për transport që lindin nga nismat revolucionare për tejkalimin e detyrave të prodhimit.
2. — Të rritet rendimenti i mjeteve në hekurudhë. Për këtë të fuqizohen e të zgjerohen bazat mekanike në stacionet hekurudhore dhe të futen në një shkallë më të gjerë teknologjitet e reja në përpunimin dhe transportin e mallrave.
3. — Për rritjen e shpejtësisë së lëvizjes së trenave të përmirësohet gjendja e linjës hekurudhore dhe e veprave të saj të artit. Nga Këshilli i Ministrave dhe Ministria e Komunikacio-



neve të parashikohen në kohë dhe në sasi linjat që do të merretohen dhe linjat e dyta që do të ndërtohen të reja.

4. — Të merren masa për ruajtjen dhe për miradministrimin e mallrave gjatë transportimit. Këshilli i Ministrave të shikojë mundësinë që ruajtja e disa stacioneve hekurudhore dhe veprave kryesore të artit në hekurudha t'i kalojë Policisë Popullore.

5. — Për përsosjen e drejtimit, Drejtorja e Hekurudhave në Durrës, në bazë të organikës ekzistuese, të organizohet si Drejtori e Përgjithshme e Hekurudhave me qendër në Durrës. Rajoneve hekurudhore t'u jepen kompetenca më të plota në fushën e planifikimit dhe të zbatimit të treguesve ekonomiko-financiarë, të kuadrit, të furnizimit materialo-teknik. Të merren masa për përsosjen e normimit dhe të formave të shpërblimit të punës në hekurudhë.

6. — Të merren masa që të shtohet puna me rimorkio, mjetet me dy shoferë dhe repartet e riparimit të automjeteve të kthehen me dy ndërresa. Këtij organizimi t'i përgjigjet dhe puna në ndërmarrjet prodhuese dhe pritëse të mallrave.

7. — Në transportet e afërta, të brendshme dhe në zona të thyera pyjore e minerare, të përdoret në shkallë më të gjerë transporti me teleferikë, dekovile e lugje. Ministria e Industrisë dhe e Minerave, brenda muajit korrik 1985, t'i paraqitë Këshillit të Ministrave studimin për prodhimin, montimin dhe përdorimin e teleferikëve. Të bashkërendohet më tej puna që automjetet e të gjitha dikastereve të shfrytëzohen më mirë për transportin e mallrave edhe të sektorëve të tjerë. Pranë Inspektimit të Shtetit, me vendqëndrim në rrethet të ngrihet sektori i kontrollit të zbatimit të ligjshmërisë në transportin e ekonomisë. Organika për këtë sektor të sigurohet nga shkurtimi që do të bëhet në personelin e Drejtorisë së Kontrollit e të Shfrytëzimit të Automjeteve.

8. — Për të lehtësuar transportin hekurudhor dhe automobilistik të shfrytëzohet më mirë transporti i brendshëm detar. Për këtë, gjatë gjashtëmuajorit të dytë të këtij viti, të kalojnë në transportin detar 20 mijë tonë mallra më shumë se plani i kësaj periudhe dhe, për vitin 1986, të kalojnë edhe 60-70 mijë tonë mallra të tjera. Brenda tremujorit të tretë të lidhet shpërblimi i ekui-pazheve të anijeve me realizimin e treguesve sasiorë e cilësorë të planit.

9. — Organet e tregtisë së jashtme t'i japin përparësi përdorimit të anijeve dhe mjeteve tona të transportit si burim i rën-

dësishëm i të ardhurave në valutë. Në këtë drejtim të zgjidhen drejt edhe marrëdhëniet financiare midis ndërmarrjeve të transportit dhe atyre të tregtisë së jashtme.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Ramiz Alia

Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë

## V E N D I M

### I SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH PËR FORCIMIN E MËTEJSHËM TË PUNËS PËR RITJEN E VIGJILENCËS NË KUFË

1 korrik 1985

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 1 korrik 1985, mori në shqyrtim raportet e paraqitura nga komitetet e Partisë të rretheve Sarandë e Pogradec dhe nga Ministria e Punëve të Brendshme «Mbi punën që bëhet për forcimin e mëtejshëm të vigjilencës revolucionare në zonën e brezit kufitar». Ai konstatoi se komitetet dhe organizatat-bazë të Partisë të rretheve kufitare, populli i zonave, si dhe Ministria e Punëve të Brendshme, të udhëhequra nga mësimet e Partisë dhe të shokut Enver Hoxha dhe në zbatim të tyre, kanë bërë një punë të gjithanshme për edukimin ideopolitik të masave e të kufitarëve për të kryer me vigjilencë e korrektësi të lartë detyrat për ruajtjen e kufirit.

Megjithatë, duke pasur parasysh situatat që zhvillohen në botë dhe rritjen e veprimtarisë armiqësore që zhvillohet edhe nëpërmjet kufirit shtetëror, duke u ballafaquar me gjendjen, me problemet dhe me detyrat që shtrohen në kushtet aktuale për rritjen e mëtejshme të vigjilencës, të gatishmërisë dhe të korrektësisë në kufi, Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH,

#### V e n d o s i :

1. — Komitetet e Partisë të rretheve kufitare, të udhëheqin e të drejtojnë më mirë punën për forcimin e vigjilencës e të gatishmërisë luftarake. Ato, si edhe levat e tyre të thellojnë pu-

nën ideopolitike me komunistët e masat për edukimin me frymën e atdhedashurisë dhe për kuptimin më të gjerë të vigjilencës, për zbatimin e rregullave të regjimit kufitar etj. Më mirë se gjer tani puna e Partisë të rrënjosë te secili mendimin dhe bindjen «se kufirin e ruan dhe e mbron gjithë populli».

Me ushtarët dhe me kuadrot e kufirit, organet dhe organizatat-bazë të Partisë të bëjnë më tepër punë të kualifikuar ideopolitike, për të brumosur e për të kalitur në ta virtytet më të mira të popullit tonë, mësimet e Partisë dhe idetë e pavdekshme të shokut Enver e ndërgjegjen e lartë të atdhedashurisë. Puna edukative e Partisë të bëhet konkrete «speciale» dhe «specifike» ashtu siç na mëson shoku Enver Hoxha. Rëndësi t'i kushtohet njohjes së thellë të situatës dhe të armikut përballë.

2. — Partia në rrethet kufitare të bëjë më shumë punë për forcimin ekonomik e socialkulturor të kooperativave bujqësore të zonës kufitare dhe të kërkojë që organet shtetërore të rritin më tej kujdesin për furnizimin me përparësi të popullit në këto zona. T'u jepet atyre ndihmë më e madhe për ndërtimet ekonomike e socialkulturore.

3. — Çështjet e bashkërendimit e të bashkëpunimit, midis organeve të pushtetit, organizatave të masave, organeve të Punëve të Brendshme dhe ushtrisë të merren më mirë në dorë nga komitetet e Partisë të rretheve kufitare. Të shikohet kjo si një masë me rëndësi për forcimin e luftës parandaluese në ruajtjen e mbrojtjen e kufirit shtetëror.

4. — Ministria e Punëve të Brendshme të përmirësojë më tej punën për rritjen e efektivitetit të shërbimit në kufi e të mjeshhtërisë kufitare. Punë e veçantë dhe e kujdesshme të bëhet me banorët e kufitarët për të njohur thellë taktikat e metoda të veprimtarisë armiqësore. Përgatitja ushtarake profesionale të ngrihet mbi baza më shkencore. Të forcohet më tej bashkërendimi midis sektorëve të organeve dhe reparteve të Punëve të Brendshme për të parandaluar që në embrion çdo veprimtari armiqësore e keqbërëse që mund të zhvillohet nëpërmjet kufirit.

5. — Byrotë dhe komitetet e Partisë në degët e Punëve të Brendshme nën drejtimin e komiteteve të Partisë të rretheve të marrin masa politike, ideologjike dhe organizative për gjallërimin e mëtejshëm të organizatave-bazë të Partisë të Armës së Kufirit, duke luftuar shfaqjet e familjaritetit të sëmurë dhe të ngurimit për pranimet në Parti nga radhët e ushtarëve.

6. — Organet përkatëse të studiojnë e të marrin të gjitha masat e duhura për plotësimin sa më të mirë të kushteve të jetesës e të shërbimit të kufitarëve. Të studiojnë me kujdes e





3. — Në veprimtarinë e organeve të pushtetit të bëhet një kthesë e menjëhershme, që të zbatohen deri në një dhe me rigo-rozitet të gjitha normat e legjislacionit tonë, që mbrojnë e favo-rizojnë nënën dhe fëmijën. Për këtë, brenda fondeve, që kanë, dhe mundësi të reja që u krijohen, të marrin menjëherë masa për të siguruar ndërtimin e shtëpive të lindjes dhe të reparte-ve pediatrike aty ku nuk ka të tilla dhe të rritin kujdesin për mje-diset e fëmijëve në çerdhe e kopshte, për të plotësuar nevojat që ata kanë për ushqime e pajisje higjieno-sanitare.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Ramiz Alia

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## PLENUMI I 12-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 8-9 korrik 1985

### KOMUNIKATË

#### E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 8 dhe 9 korrik 1985, nën drejtimin e Sekretarit të Parë të Komitetit Qendror të PPSH, shokut Ramiz Alia, u mbledh Plenumi i 12-të i Komitetit Qendror të PPSH, i cili mori në shqyr-tim raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Të luftohet për realizimin frontal të detyrave të planit me një regjim të fortë kursimi», mbajtur nga anëtari i Byrosë Politike dhe Kryetar i Kë-shillit të Ministrave të RPSSH, shoku Adil Çarçani.

Pasi diskutoi gjerësisht rreth raportit të paraqitur, Plenumi i Komitetit Qendror e miratoi atë njëzëri dhe mori vendimet për-  
katëse.

Me propozimin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të Partisë, Plenumi zgjodhi njëzëri sekretar të Komitetit Qendror të Partisë shokun Foto Çami<sup>1</sup>, kandidat i Byrosë Politike të Kom-i-  
tetit Qendror të PPSH.

Në mbyllje të Plenumit foli edhe shoku Ramiz Alia, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të PPSH.

#### PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

1. Në Kongresin e 9-të të PPSH, u zgjodh anëtar i Byrosë Politike të KQ të PPSH,

## RAPORT

### I BYROSE POLITIKE TË KQ TË PPSH «TË LUFTOHET PËR REALIZIMIN FRONTAL TË DETYRAVE TË PLANIT ME NJË REGJIM TË FORTË KURSIMI»

8 korrik 1985

Shokë,

Kaluan tre muaj nga dita kur u nda fizikisht nga ne shoku Enver. Gjatë kësaj kohe gjithë punonjësit e vendit tonë dhimbjen e papërshkruar e kanë kthyer në forcë të madhe, siç na mësonte e na frymëzonte vetë ai. Këtë ata po e shprehin çdo ditë e më shumë me nismat, zotimet e lëvizjet revolucionare në fushën e prodhimit, të edukimit e në veprimtari të tjera shoqërore, përgjithësisht në qëndrimin ndaj punës e pronës socialiste, për fuqizimin e ekonomisë dhe mbrojtjen e fitoreve të arritura.

Ky optimizëm e mobilizim i madh, ky hov i paparë e gatishmëri e lartë e masave punonjëse të qytetit e të fshatit, i rinisë e i veteranëve, deri te pionierët e Enverit, që flet edhe një herë për energjitë e pashtershme, mundësitë e forcat e pallogaritshme që ekzistojnë në gjirin e popullit, është fryt i asaj pune dhe edukate revolucionare me të cilën janë ushqyer i madh e i vogël te ne nga Partia e shoku Enver, është dëshmi e lidhjeve dhe e unitetit të çeliktë Parti-popull, e vendosmërisë për të ecur në rrugën që na udhëheq Partia. Ky qëndrim kaq revolucionar, kjo pjekuri e madhe e masave punonjëse, na detyrojnë të forcojmë edhe më tej punën drejtuese, të përmirësojmë në të gjitha drejtimet e në të gjitha hallkat metodën dhe stilin e punës sonë, për të plotësuar e tejkaluar detyrat e planit. Vrullit revolucionar të klasës punëtore, të rinisë, të kooperativistëve, të inteligjencias, organet e organizatat e Partisë dhe organet e pushtetit e të ekonomisë duhet t'i përgjigjen me organizim shembullor, me shpirt iniciative dhe shkathtësi operative, duke flakur tej çdo shfaqje

të burokratizmit e të papërgjegjësisë, që do t'i vinte fre e do t'i kundërvihet hovit të papërmbajtur të masave.

Në këto rrethana detyra jonë, e të gjithë komunistëve është të jemi kurdoherë pranë masave punonjëse, të jetojmë e të luftojmë së bashku me to, për të kapërcyer pengesat e vështirësitë që dalin në punë e sipër, me qëllim që kudo dhe çdo ditë të realizohen në front dhe me regjim të fortë kursimi detyrat e planit, që çdo punonjës të rritë rendimentin, cilësinë dhe efektivitetin e punës e të prodhimit e të çojë përpara ndërtimin socialist të vendit, që kudo e kurdoherë të rritet vigjilenca revolucionare e gatishmëria për mbrojtjen e atdheut, ashtu siç na porosiste vazhdimisht shoku Enver.

Kaluan gjashtë muajt e parë të këtij viti dhe nga të dhënat operative del se në mjaft degë e sektorë të ekonomisë është kapërcyer ose po kapërcehet prapambetja e përkohshme e shkaktuar dhe nga reshjet e mëdha të dëborës, vështirësitë e transportit, deficitet e eksport-importit etj. Për këtë flasin sidomos arritjet e mira të këtyre dy muajve të fundit dhe përgjithësisht realizimet e tremujorit të dytë të këtij viti që, në krahasim me ato të muajve të mëparshëm, shënojnë një rritje të dukshme në të gjithë treguesit e prodhimit shoqëror e të efektivitetit të tij. Si kurrë ndonjëherë punonjësit e bujqësisë u hodhën në sulm për të realizuar, në kushte mjaft të mira, mbjelljet e pranverës dhe i përballuan ato me sukses, duke thyer mjaft koncepte të pritshmërisë, që kanë penguar më parë. Më të përgatitur se çdo herë tjetër ata u futën me të gjitha mjetet e forcat në fushatën e korresjes e të shirjes së grurit, për ta përballuar atë me sukses dhe me firo sa më të pakta. Të dhënat operative tregojnë se në zonën e ulët, nga Saranda deri në Shkodër, kjo fushatë përfundoi këtë vit më shpejt se çdo herë tjetër.

Vite me radhë Miniera e Valiasit nuk plotësonte detyrat e planit duke vënë kështu në vështirësi edhe një numër përdoruesish të qymyrgurit. Tani gjendja në këtë minierë ka ndryshuar dhe për këtë nuk u bënë investime a plotësime të reja për pajisje e makineri, shtesa në organikat etj. Ajo që u shtua ishte puna me njerëzit dhe për njerëzit, u forcuan disiplina dhe ndërgjegjia e punës, u nxit dhe u mobilizua më mirë mendimi krijues i punëtorëve dhe i specialistëve, u forcuan organizimi e drejtimi i prodhimit dhe miniera doli nga prapambetja, duke dhënë mbi planin 3700 tonë koncentrat qymyrguri. Po kështu minatorët e Ndërmarrjes Minerare të Bakrit në Pukë, me gjithë vështirësitë e dimrit të këtij viti, dhanë si gjashtëmujor 9000 tonë mineral bakri mbi planin. Të njëjtën gjë po bëjnë minatorët e qymyrgurit në Memaliaj e Mborje-Drenovë, ata të bakrit në Gjegjan të Kukësit, të hekur-nikelit në Përrenjas etj.

Duke i përgëzuar punonjësit e këtyre minierave për sukseset

e arritura, Komiteti Qendror i Partisë kërkon që një punë e tillë të bëhet nga të gjitha minierat e vendit dhe sidomos nga minierat e kromit, ku deficitet janë ende të mëdha dhe pasojat në bilancin valutor mjaft të ndjeshme. . . Prandaj, organizatat-bazë të Partisë në të gjitha minierat e vendit veçanërisht në ato të kromit, komitetet e Partisë të rretheve përkatëse e sidomos ato të rretheve Dibër e Mat dhe vetë Ministria e Industrisë dhe e Minerave të ndiejnë thellë përgjegjësinë që kanë, të ngrenë në një shkallë më të lartë organizimin e drejtimin e punës, të arrijnë medemos që deri në fund të vitit jo vetëm të plotësojnë planin, por edhe ta tejkalojnë atë në shembullin e minierave të përparuara.

Edhe në mbledhje të mëparshme të plenumit jemi ndalur në detyrat për nxjerrjen e naftës e të gazit, i kemi analizuar ato me hollësi dhe kemi arritur në përfundimin se detyrat e kërkimit dhe të nxjerrjes së naftës e të gazit, me mobilizim e përpjekje më të mëdha, janë të realizueshme. Mirëpo këto detyra edhe këtë vit nuk po arrihen sipas planit për shkaqe subjektive. E vërteta është se, si gjithë punonjësit e vendit, edhe punëtorët e mjaft ndërmarrjeve të naftës e të gazit kanë shtuar përpjekjet dhe mobilizimin e tyre, gatishmërinë e vendosmërinë për të mbajtur fjalën e dhënë. Por kjo nuk po ndodh në të gjitha ndërmarrjet e këtij sektori, sidomos në ato të nxjerrjes së naftës. Kjo, sepse mobilizimi në këto ndërmarrje nuk është në shkallën e duhur, kurse drejtimi dhe organizimi, metoda e punës e kuadrove, duke filluar nga ministria e Drejtoria e Përgjithshme e Naftës, deri në institutet dhe në ndërmarrjet e kërkimit a të nxjerrjes së naftës e të gazit, nuk janë në nivelin e kërkesave të kohës, nuk u përgjigjen vrullit dhe entuziazmit të masave. . .

Kjo situatë e pakënaqshme në këtë degë jetike të ekonomisë ngarkon me përgjegjësi të veçantë, përveç Ministrisë së Energjetikës, edhe komitetet e Partisë të rretheve Fier, Vlorë e Berat. Komunistët dhe kuadrot në industrinë e naftës, specialistët dhe institucionet e saj shkencore duhet t'i shqetësojë shumë kjo gjendje dhe, të mbështetur në gatishmërinë dhe në nismat e naftëtarëve, të udhëhequr nga mësimet e shokut Enver, duke vlerësuar me ndërgjegje të lartë politike përgjegjësinë e madhe përpara Partisë dhe popullit për vështirësitë e mëdha që i kanë krijuar ekonomisë, të realizojnë patjetër këtë vit një kthesë të rëndësishme në zbulimin e vendburimeve të reja të naftës e të gazit dhe në nxjerrjen e tyre sipas planit, që prej vitesh pret nga ata Komiteti Qendror i Partisë. Janë ata që duhet të përcaktojnë me saktësi shkencore e me përgjegjësi radhën e atakimit të strukturave naftë e gazmbajtëse, masat konkrete për rritjen e nivelit ditor të nxjerrjes së naftës, metodat ndihmëse e intensifikuese për të rritur debitin e puseve etj.

Mbi këtë bazë e në këtë rrugë, duke forcuar disiplinën pro-

letare në punë e atë shkencore, duke vënë në lëvizje të gjerë mendimin krijues të të gjithë naftëtarëve, të merren masa që në gjashtëmuorin e dytë të këtij viti të intensifikohet me të gjitha mënyrat nxjerja e naftës dhe e gazit. **Për gazin natyror dhe shoqërues**, nga shfrytëzimi më optimal i puseve, sidomos në vendburimet ekzistuese. . . dhe nga shpimi i puseve të reja të arrihet që në muajin dhjetor të këtij viti niveli ditor i nxjerrjes të rritet dhe të bëhen punime gjeologo-gjeofizike për zgjerimin e mëtejshëm të këtyre vendburimeve. **Për nxjerrjen e naftës**, krahas intensifikimit të punimeve në puset aktive dhe kalimit në shtresa të reja, të vihen në punë edhe puse të fondit të ndalur dhe të jepen për shfrytëzim mbi planin puse të reja. Gjithashtu, për t'i paraprirë nxjerrjes së naftës e të gazit nga vendburimet e reja, të shpohen e të përvetësohen puset e kërkimit në jo më pak se 18-20 struktura të reja, duke synuar në të njëjtën kohë që në 4-5 prej tyre të merren debite industriale.

Punonjësit e naftës, me komunistët në krye, nën udhëheqjen e komiteteve të Partisë të rretheve përkatëse, duke vlerësuar, në radhë të parë, politikisht domosdoshmërinë e realizimit të detyrave të caktuara, të mobilizohen si kurrë ndonjëherë dhe me aksion pas aksioni të punojnë me besim e vendosmëri jo vetëm për arritjen e planit të këtij viti, por edhe për t'u futur plotësisht të përgatitur në vitin 1986 dhe për të gjithë pesëvjeçarin e tetë që po hartojmë. Ministria e Energjetikës dhe organet e saj vartëse, duke ndërjerë thellë përgjegjësinë e madhe që kanë, të shkundin rutinën burokratike, të organizojnë punën mbi baza më të shëndosha shkencore dhe të forcojnë disiplinën e kërkesën e llogarisë për zbatimin e detyrave. Këshilli i Ministrave të mbështetë më mirë industrinë e naftës në aksionet që do të organizohen, sidomos me bazën e nevojshme materiale e teknike, duke mobilizuar për këtë qëllim edhe degë të tjera të ekonomisë, për arritjen sa më shpejt të objektivave të caktuar.

Pa dashur të errësojmë arritjet e mira në shumë degë të industrisë, sidomos në nxjerrjen e gymyrit, të hekur-nikelit e të bakrit, të plehrave kimike, në prodhimet e industrisë mekanike, në tekstilet e trikotazhet etj., u ndalëm më tepër në ata sektorë e ndërmarrje që kanë krijuar deficite të ndjeshme dhe që, me gjithë përpjekjet e këtyre dy muajve, nuk i kanë plotësuar ato. Gjendja ende e prapambetur në këto degë flet, në radhë të parë, për atë se puna drejtuese e organizuese e organeve të Partisë, të pushtetit e të ekonomisë në disa rrethe nuk po u përgjigjet si duhet vrullit dhe gatishmërisë së masave, se nga metoda e stili i punës së tyre duhen mënjanuar shfaqjet burokratike e teknokratike, globalizmi e liberalizmi, për t'iu përgjigjur më mirë e me vendosmëri situatave të reja, detyrave që ato na shtrojnë.

Në të gjitha ato ndërmarrje, rrethe e ministri ku detyrat e



prodhimit industrial nuk janë arritur sipas planit, për të gjithë zërat e treguesit e tij, organizatat-bazë, plenumet e komiteteve të Partisë të rretheve dhe levat e tyre, ministrinë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, me mbylljen e gjashtëmujorit të analizojnë thellë shkaqet që kanë penguar në arritjen e detyrave. Mbi këtë bazë, me masa të plota e të kontrollueshme organizative e teknike, me një kuptim të thellë të situatave, me luftë e punë më këmbëngulëse për kapërcimin e vështirësive të çdo natyre, të ngrenë të gjithë punonjësit në këmbë për të plotësuar të gjithë treguesit e planit, duke shfrytëzuar si kurrë ndonjëherë mundësitë e rezervat e shumta që janë kudo.

**Në frontin e prodhimit bujqësor e blegtoral kërkohet që këtë vit të arrihen tregues të lartë.** Kjo jo vetëm sepse gjendja e bimëve dhe e kafshëve është më e mirë se e vitit të kaluar, në sajë të një punë të madhe e të kujdesshme që është bërë në fushatën e mbjelljeve të pranverës, në shërbimet e kohës, si dhe në blegtori, sidomos për numrin e krerëve, por edhe sepse fshatarësia kooperativiste, punëtorët e të gjitha ndërmarrjeve bujqësore, duke nxjerrë mësim nga viti i kaluar dhe të përfshirë në lëvizjen revolucionare «Flamurtarë të zbatimit të mësimave të shokut Enver Hoxha», po punojnë më mirë e janë hedhur në sulm për realizimin dhe tejkalimin e rendimenteve të planifikuara. Çështja shtrohet tani që me optimizëm, por pa kaluar në vetëkënaqësi, me masa e detyra konkrete, të mbahet e të vijë duke u rritur ky hov e mobilizim në punë dhe të përballohen në kohë dhe me efektivitet të gjitha detyrat në bujqësi.

Fushata e korrje-shirjes së grurit është pothuaj në kulmin e saj. Deri tani kanë realizuar planin e prodhimit të grurit rrethi i Lushnjës dhe ai i Durrësit, që shënon një sukses të rëndësishëm e të lavdërueshëm dhe po kështu pritët të plotësojnë planin rrethi i Beratit, ai i Fierit, i Tiranës, i Elbasanit etj., kurse nuk e realizojnë plotësisht planin rrethi i Sarandës, i Gjirokastrës, i Krujës, i Lezhës, i Shkodrës etj. Është për t'u kritikuar qëndrimi i disa rretheve që, nga pasiguria në plotësimin e prodhimit të grurit, kanë ngurruar e ngurrojnë të thonë fjalën e tyre për plotësimin e planit. Një qëndrim i tillë, i cili flet për mungesën e një njohjeje të thellë e të plotë të gjendjes, është i dëmshëm, sepse pengon dhënien e orientimeve e veçanërisht marrjen e masave për të gjetur rrugë e mundësi për realizimin në përgjithësi të planit të drithërave të bukës. Aktualisht, fushata e korrje-shirjes së grurit vazhdon në pjesën tjetër të vendit dhe detyrat janë të mëdha. Prandaj puna e kujdesi duhet të rriten kudo për ta përfunduar shpejt e pa humbje këtë aksion të madh. Ulja e firove dhe e humbjeve në të gjitha hallkat e teknologjisë së prodhimit, të ruajtjes dhe të përpunimit, përbën një ndër problemet

më të rëndësishme për vetë prodhuesit dhe ekonominë në përgjithësi.

E rëndësishme është në këto momente puna që duhet bërë, sidomos në zonën fushore e kodrinore të vendit, për shfrytëzimin me efektivitet më të lartë të tokave që lirohen nga gruri, si rezervë për të shtuar prodhimet bujqësore e blegtorale, sidomos me mbjelljen mbi planin të misrit, të foragjereve të dyta dhe të perimeve, të patates e të fasules. Në të njëjtën kohë, frontalisht dhe pa rënë në njëanshmëri, është e domosdoshme të rritet ritmi i punës për bimët e pranverës, sidomos për misrin, që në disa zona ka nevojë për ndërhyrje e shërbime plotësuese, për bimët industriale, perimet dhe foragjeret, të cilat tani janë në fazat vendimtare për të siguruar arritjen dhe tejkalimin e rendimenteve të planifikuara.

Organet dhe organizatat e Partisë, organet e pushtetit dhe të ekonomisë, organizatat e masave të tregohen më të shkathëta, sidomos për organizimin e aksioneve të njëpasnjëshme, me afate të shkurtëra e me detyra konkrete për të përballuar me sukses të plotë detyrat e stinës. Deficitet e krijuara deri tani në prodhimin e qumështit, të mishit, të vezëve e të perimeve, sidomos në rrethet: Shkodër, Krujë, Durrës, Fier, Berat, Korçë, Gjirokastrë, Tropojë jo vetëm që është e domosdoshme të plotësohen në çdo rreth dhe ekonomi, por të realizohen edhe prodhime mbi planin, për të përmirësuar furnizimin e popullit në qytet e në fshat e për të krijuar rezervat e nevojshme për periudhën e dimrit.

**Sigurimi i prodhimit industrial e bujqësor ritmikiht e sipas planit dhe tejkalimi i tij do të ndikojnë edhe në bilancin tonë valutor...**

Detyra e organeve prodhuese është jo vetëm të realizojnë sipas planit mallrat për eksport, por edhe t'i dorëzojnë ato në kohë e me cilësi në organet e tregtisë së jashtme, të cilat të sigurojnë nisjen e tyre te blerësit në një kohë sa më të shpejtë. Nuk është e lejueshme ajo gjendje e madhe e mallrave për eksport që është krijuar në depot e Durrësit në një kohë kur deficitet në bilancin valutor janë të ndjeshme. Ministria e Tregtisë së Jashtme të ndjejë më thellë përgjegjësinë që ka, jo vetëm për shitjen më shpejt të tyre, por të luftojë shumë më tepër se deri tani për të gjetur tregje të leverdishme edhe për mjaft mallra të reja, disa prej të cilave si minerale, materiale inerte e ndërtimi, ujë i pijshëm, bimë dhe esenca të florës sonë e artikuj të tjerë, vihen në plan prej vitesh, por nuk po u gjendet treg shitjeje. Organet e tregtisë së jashtme të tregohen më të zgjuara e më të shkathëta për shitjen e mallrave tona të eksportit, të çajnë e të futen patjetër në më shumë tregje jo vetëm të Evropës, por edhe në Afrikë, në Azi, në Oqeani etj., ku pothuajse nuk janë futur fare. Në të njëjtën kohë të shtojnë përpjekjet e tyre për uljen e mallrave të importit, duke

u bërë barrikadë për ato mallra që mund të sigurohen në vend nga gjendja ose nga prodhimi i ri. Nuk janë të pakta rastet që, megjithëse një mall mbetet pa u përdorur, siç ishte rasti i sojës ose i orizit në organet e grumbullimit, i llamarinës në kantierin detar e në disa uzina mekanike etj., artikuj të tillë kërkohen e vihen në planet e importit, sepse si vetë rrethet, ashtu edhe dikas-teret nuk e kanë si duhet nën kontroll gjendjen e mallrave në depo e aq më pak shpërndarjen e përdorimit të tyre.

Deficitet e vitit të kaluar, si dhe ato të deritanishme jo vetëm që kanë ndikuar në uljen e importeve tona, por na kanë detyruar të përdorim edhe rezerva valutore e të preket bilanci valutor i vendit. Kjo duhet kuptuar e vlerësuar thellë politikisht dhe ekonomisht dhe të punohet që çdo detyrë që vihet për eksport-im- portin e mallrave, me çdo kusht të realizohet. Organet dhe orga- nizatat-bazë të Partisë, në të gjitha degët e ekonomisë e të kulturës, të ndjekin e të kontrollojnë me përgjegjësi gjithë punën që duhet të bëjnë organet ekonomike dhe ato shtetërore për rritjen e ek- sportit dhe uljen e importit, duke e kuptuar e realizuar seriozisht në praktikë direktivën e Partisë se pa eksport nuk ka import. Ato vetë dhe levat e tyre të analizojnë në çdo hallkë gjendjen dhe të marrin masa të plota për të vepruar energjikisht dhe me inicia- tivë për përmirësimin e bilancit valutor të çdo dege të ekonomisë e të çdo rrethi për ta ndryshuar sa më shpejt gjendjen aktuale të pakënaqshme.

**Ka kohë që Komiteti Qendror i Partisë po tërheq vëmendjen për prapambetjen e theksuar në transport, por megjithëkëtë nuk po shikojmë ato përmirësime që kërkohen nga ky sektor nevrall- gjik për ekonominë.** Si vitin e kaluar edhe këtë vit ekonomisë i ja- në shkaktuar shqetësime të mëdha dhe të vazhdueshme nga mos- realizimi i detyrave të planit në transport. Ministria e Komuni- kacioneve dhe komitetet e Partisë në rrethe nuk kanë luftuar sa duhet për të vënë në jetë vendimet e Plenumit të 5-të të Kom- itetit Qendror, sidomos për transportin hekurudhor e automobilistik dhe ende nuk po heqin dorë nga drejtimi rutinë, nga zvarritjet e moszgjidhjet në kohë e me nivel shkencor të problemeve të transportit, duke filluar nga ato të bashkërendimit të tri llojeve të transportit, deri te përballimi i nismave dhe i aksioneve të puno- njësve të ekonomisë për tejkalimin e detyrave. Duke analizuar gjendjen në transport, Byroja Politike kritikoi seriozisht Ministri- në e Komunikacioneve dhe kërkoi prej saj që të bëjë sa më parë kthesën e duhur për realizimin e planeve dhe të të gjitha detyrave të caktuara. Me ndërmarrjet e saj vartëse, duke u mbështetur edhe nga ndërmarrjet nisëse e pritëse të mallrave, ajo të marrë sa më parë masa konkrete për rritjen e gatishmërinë teknike të mje- teve të transportit, të sigurojë një lëvizje më të shpejtë të mjeteve, një shfrytëzim më të plotë të tyre si në ngarkesë, ashtu edhe në

kohë, dhe të rritë shkallën e mekanizimit të ngarkim-shkarki- meve me mjete të thjeshta e teknologji të reja, në bazë të detyrave që ka vënë Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të PPSH.

**Në tremujorin e parë të këtij viti, për furnizimin e popullit me sende ushqimore e mallra të tjera të përdorimit të gjerë, patëm disa vështirësi e mungesa.** Me masat e marra tani gjendja e tregut pothuaj është normalizuar, sidomos në qytet, kurse problemi i furnizimit të fshatit ende nuk është vënë në rrugën e zgjidhjes së plotë, sipas porosive të Partisë e të shokut Enver.

Kohët e fundit Byroja Politike e ka analizuar me vëmendje të veçantë këtë problem dhe ka përcaktuar detyra konkrete për shtimin e prodhimit dhe shpërndarjen e mallrave të përdorimit të gjerë, të cilat duhet të zbatohen deri në një. Plotësimi i nevojave të domosdoshme të popullit me mallra të përdorimit të gjerë e të përditshëm të kuptohet e të vlerësohet nga Partia dhe nga organet e pushtetit e të ekonomisë si një problem i madh e i rëndësishëm politik, ekonomik dhe shoqëror, sepse ka të bëjë me mirëqenien e popullit, e cila ka qenë dhe mbetet në qendër të politikës ekono- mike të Partisë dhe qëllimi kryesor i prodhimit socialist. Ai duhet trajtuar e zgjidhur me përparësi e në çdo periudhë të vitit, në radhë të parë, në fushën e prodhimit të mallrave të konsumit, por edhe në fushën e shpërndarjes, ku ka gjithashtu probleme të mprehta që u duhet dhënë zgjidhje rrënjësore, praktike e më të shpejta. Kjo kërkon të merren masa të gjithanshme e shumë më të efektshme për plotësimin e nevojave në rritje të popullit.

Është e papranueshme për ne që të mos jemi në gjendje të plotësojmë nevojat e popullit me qumësht e me perime, me fasule e me patate dhe të rritim importin e mallrave të tjera ushqimore për zëvendësimin e tyre, ashtu siç është e palejueshme që të nën- vleftësohen e të mos prodhohen në sasi të nevojshme artikuj të imët e të vegjël. Partia kurdoherë ka porositur që kërkesat e popu- lit për mallra të përdorimit të përditshëm të përbëjnë bazën e pla- nifikimit të tyre në sasi, lloje, cilësi e asortiment, kurse treguesit e planit të prodhimit të jenë kurdoherë pasqyrim i këtyre kërke- save e mundësive për plotësimin e tyre.

Krahas shtimit më të shpejtë të prodhimit, të sigurohet në çdo rrethanë edhe tërheqja e tyre për treg, për ruajtje e për in- dustrializim, jo vetëm për të mos u dëmtuar këto prodhime, por edhe për të zgjatur kohën e përdorimit dhe për të shtuar rezervat. Asnjë justifikim nuk duhet të pranohet nga organet e Partisë për këtë problem, përkundrazi të detyrohen organet e tregtisë, të in- dustrisë e të transportit dhe vetë kooperativat bujqësore që, pa humbur kohë, të marrin të gjitha masat për të siguruar tërheqjen, ruajtjen, përpunimin dhe shpërndarjen e tyre, duke përfshirë këtu edhe sasi të që do të përdorin vetë kooperativat për furnizimin e anëtarëve.



Të gjitha komitetet e Partisë të rretheve të ndjekin në kompleks e me rigorozitet zbatimin e vendimit të Byrosë Politike të shkurtit<sup>1</sup> për prodhimin e mallrave të përdorimit të gjerë, atë të muajit prill<sup>2</sup> për fuqizimin e bazës ushqimore dhe shtimin e prodhimit të mishit, si dhe atë të muajit maj<sup>3</sup> të vitit 1985 për furnizimin e popullit, të cilat, të marra së bashku, u japin rrugë-zgjidhje të drejtë e të shpejtë problemeve të furnizimit të popullit.

**Luftën për realizimin e planeve Partia gjithmonë e ka lidhur ngushtë me forcimin e gjithanshëm të regjimit të kursimit.** Ajo vazhdimisht ka porositur që të luftojmë për realizimin e planit, por në të njëjtën kohë të rritim përpjekjet për të kursyer vazhdimisht, kudo e në çdo gjë.

Plenumi i 9-të i Komitetit Qendror të Partisë theksoi me forcë që të konsumojmë aq sa prodhojmë, duke mbajtur parasysht edhe rritjen e rezervave, por ngaqë s'është kuptuar si duhet kjo direktivë, viti 1984 rezultoi me mbishpenzime, që sollën prekjën e rezervave materiale, financiare dhe të atyre valutore, pa përmendur këtu frenimin që iu bë zhvillimit të ekonomisë, duke ulur investimet dhe importin. Edhe si gjashtëmujor shpenzimet e planifikuara të prodhimit janë tejkaluar dhe në bilancin valutator është thelluar zbalancimi.

Kjo gjendje serioze tregon se këto probleme të rëndësishme nuk u ndoqën me përgjegjësi jo vetëm nga kuadrot e dikastereve prodhuese e të ndërtimit, por edhe nga shokët e Ministrisë së Financave e të Komisionit të Planit të Shtetit, nga vetë shokët e Plenumit të Komitetit Qendror të Partisë, nga organet e organizatat e Partisë e të pushtetit në rreth e në bazë. Kjo ngarkon me përgjegjësi të madhe secilin për punën që i është besuar. Detyrat që kemi përpara kërkojnë që të ngrihet në këmbë i madh e i vogël për të forcuar në të gjitha fushat regjimin e kursimit. Me një kuptim të thellë revolucionar të situatave që kalojmë, me mendim krijues e me shpirt praktik, kudo të punohet për të gjetur rrugë e mundësi të reja, që detyrat të plotësohen me normativa më të ulëta materiale, të lëndëve të para dhe energjetike, me më pak import e investime dhe me rendiment e cilësi më të lartë në punë.

Byroja Politike e Komitetit Qendror dhe shoku Enver, qysh vitin e kaluar, në kuadrin e forcimit të regjimit të kursimit, dhanë orientimin që të shihen edhe një herë me sy kritik burimet materiale, financiare e valutore të planifikuara për vitin 1985, me synim që të ulet më tej përdorimi i tyre, pa cenuar prodhimin, shërbimet dhe furnizimin e popullit. Nga shqyrtimi që bënë grupet e

1. Shih në këtë vëllim, f. 504.

2. Shih në këtë vëllim, f. 506.

3. Shih në këtë vëllim, f. 512.

ngritura për këtë qëllim, u gjetën mundësi që të kursehen rreth 80 milionë lekë vlera materiale. Gjithashtu, nga ulja e vleftave të plota, lehtësimi dhe thjeshtimi i projekteve dhe heqja nga plani e disa investimeve të parakohshme, kryesisht joprodhuese, vetëm për vitin 1985 u pakësuan investimet. . .

Byroja Politike i miratoi këto kursime dhe porositi që kjo punë të vazhdojë të thellohet gjatë gjithë vitit nga çdo kolektiv punonjës, për të siguruar fonde të reja materiale e financiare për shtimin e prodhimit dhe për të shëndoshur gjendjen e rezervave në çdo ekonomi. Nga e tërë kjo punë që u bë, është e nevojshme të nxjerrin mësim organet tona të planifikimit e të financës, nga qendra e deri në bazë, si dhe organet e Partisë e të pushtetit në rreth, për të forcuar regjimin e kursimit qysh në procesin e hartimit të planeve, aq më tepër që jemi përpara hartimit të projektplanit të vitit 1986 dhe të kreyt pesëvjeçarit të tetë.

Organet dhe organizatat e Partisë është e nevojshme të nxitin më shumë për këtë qëllim mendimin krijues të punëtorëve, të specialistëve e të kuadrove, të kapen fort pas përvojës së përparuar e nismave revolucionare të ndërmarra nga uzina e instrumenteve «Petro Papi», nga kombinati i drurit «Misto Mame» etj. Sidomos me rëndësi të madhe ideopolitike, ekonomike e shoqërore është lëvizja e kombinatit të autotraktorëve «Enver Hoxha»: «Flamurtarë të zbatimit të mësimave të shokut Enver Hoxha». Si një lëvizje me objektiva të gjerë, që ka të bëjë me ngritjen e mëtejshme të mendimit e të veprimit revolucionar të punonjësve, ajo vë në qendër të saj jo vetëm realizimin e detyrave të planit, por, mbi të gjitha, edukimin komunist të tyre, rritjen e frymës së aksionit dhe të disiplinës, forcimin e vigjilencës dhe të mbrojtjes së atdheut, sipas mësimave të shokut Enver.

Forcimi i regjimit të kursimit shtrihet në të gjitha fushat e jetës ekonomike e shoqërore të vendit, por Byroja Politike mendoj të ndalet në mënyrë të veçantë në këto drejtime:

**a) Plotësimi i planit në të gjitha pjesët, zërat e treguesit e tij përbën drejtimin kryesor për forcimin e regjimit të kursimit dhe për rritjen e efektivitetit të ekonomisë.**

Partia vazhdimisht ka kritikuar shfaqjet e globalizmit dhe të njëanshmërisë në hartimin dhe në realizimin e planit dhe ka kërkuar që ai të trajtohet si një unitet që pasqyron dhe harmonizon ligjësitë e zhvillimit tonë socialist. Lufta për realizimin e planit të prodhimit e të shpërndarjes, të rendimentit e të kostos, të ardhurave financiare etj., përbën kursimin më të madh për çdo ndërmarrje, rreth e në shkallën e të gjithë vendit.

Në mjaft raste, si pasojë e kuptimit të njëanshëm të detyrave të planit, nënvleftësohet roli aktiv i shpërndarjes në zhvillimin e pandërprerë të prodhimit, në plotësimin e nevojave të popullit e të mbrojtjes. Për pasojë, krijohen një varg vështirësish artificia-



le në sektorë e degë të ndryshme të ekonomisë për mungesë të lëndëve të para, të materialeve, lëndëve djegëse etj., edhe pse ato janë prodhuar. Në ndërmarrjet e nxjerrjes së qymyrgurit dhe në stacionet hekurudhore krijohet gjendje e madhe qymyri, në një kohë që mjaft ndërmarrje konsumatore ndërpresin prodhimin për mungesë të tij. Si furnizimi i popullit me mallra të përdorimit të gjerë, sidomos me vaj, makarona e perime, ashtu edhe bujqësia, për evadimin e prodhimit dhe furnizimin me plehra kimike, shpesh janë penguar për mosdërgimin në afatet e caktuara të produkteve e të mallrave dhe për moskthimin me kohë të ambalazheve. Probleme të kësaj natyre ka e vazhdojnë të krijohen edhe për lëndën e drurit, për drutë e zjarrit, karburantet, materialet e ndërtimit etj.

Të gjitha këto vështirësi që e kanë burimin në thyerjet e disiplinës së planit të shpërndarjes e kanë bërë, aktualisht, problemin e furnizimit materialo-teknik një nga faktorët më kryesorë që pengon realizimin e detyrave të planit. Pajtimi me këtë situatë nuk është i lejueshëm për organet dhe organizatat e Partisë, veçanërisht të ndërmarrjeve si dhe të vetë Ministrisë së Industrisë dhe të Minierave, të asaj Energjetike, të Bujqësisë, të Industrisë së Lehtë dhe Ushqimore, të Komunikacioneve e të Tregtisë së Jashtme, të cilat duhet të marrin menjëherë masa rrënjësore për përmirësimin e gjendjes. Në të njëjtën kohë masa të marrë edhe Këshilli i Ministrave, sepse gjendja e krijuar ndikon negativisht jo vetëm në ndërmarrjet ku drejtuesit po shndërrohen në furnitorë, por edhe në metodën e punës të aparateve të dikastereve dhe të aparatit të Këshillit të Ministrave, të cilët shpesh kryejnë punën e dispeçerit dhe të arbitrit për mangësitë në furnizimin dhe shpërndarjen e prodhimeve.

Me gjithë porositë e vazhdueshme të Komitetit Qendror për t'u mbështetur fuqimisht te përvoja pozitive, përsëri nuk shohim të zbatohet si duhet kjo direktivë e Partisë. Në ndonjë rast më tepër bëhet zhurmë e bujë, bile edhe në shtyp, sesa ndjehen efektet pozitive të zbatimit të saj. E keqja është se shumë kuadro të Partisë e drejtues të ekonomisë, si dhe organizatat e Partisë dhe organet ekonomike në ndërmarrje e në kooperativa e shohin këtë çështje si fakultative, në vend që të krijojnë kudo bindje të plota e të forcojnë disiplinën për zbatimin e përvojës së përparuar si **të detyrueshme.**

Zbatim i përvojës së më të mirëve hedh poshtë në mënyrë kategorike të gjitha justifikimet për mosarritjen e objektivave. Në vitin 1984, me gjithë vështirësitë e krijuara nga thatësira dhe përsërisht nga mungesa e plehrave azotike, pati jo vetëm ekonomi, por edhe rrethe që tejkaluan detyrat në grurë. Në misër rrethi i Shkodrës dhe ai i Sarandës morën mbi 55 kv për hektar, kurse ishin të shumta ekonomitë që morën mbi 70 kv për hektar, si

kooperativa bujqësore e Dajçit në Shkodër, Ndërmarrja Bujqësore e Vrinës, ndërmarrja bujqësore «29 Nëntori» e Lushnjës etj. Në pambuk rrethi i Durrësit dhe i Lushnjës vitin e kaluar morën mbi 15 kv për hektar, kurse ndërmarrja bujqësore «29 Nëntori» mbi 29 kv për hektar etj. Në duhan rrethi i Elbasanit i realizoi detyrat, kurse nga rritja e cilësisë dhe e prodhimit në shkallë vendi u morën 93 milionë lekë të ardhura më shumë se një vit më parë. Këto dhe rezultatet e mira të disa rretheve dhe të shumë ekonomive të përparuara, që realizojnë e tejkalojnë edhe prodhimin e grurit të këtij viti, flasin për mundësi e rezerva që ka kudo për rritjen e rendimenteve dhe për uljen e shpenzimeve nëpërmjet forcimit të regjimit të kursimit, duke zbatuar përvojën e përparuar.

Nëse në ndërmarrjet bujqësore të Gosës apo të Roskovecit, në atë të Lezhës apo në kooperativat e Domgjonit në Mirditë e të Gorresë në Lushnjë prodhimi i mishit të derrit realizohet me rendiment të mirë dhe kosto të ulët, s'ka pse kjo përvojë të mos gjejë zbatim në të gjitha ekonomitë që kanë tufa derrash për prodhim mishi. Nëse në parkun e Laçit apo në atë të Elbasanit arrihen plotësimi i planit dhe i objektivave që caktoi Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror, s'ka pse të mos i arrijnë ato edhe parqet e tjera të mëdha, si ai i Urës Vajgurore, i Fushë-Arrëzit, i Shkodrës etj. Organet dhe organizatat e Partisë është e nevojshme të merren konkretisht dhe hap pas hapi me zbatimin e përvojës së përparuar dhe të kërkojnë nga të gjithë komunistët që edhe në këtë çështje të jenë në pararojë.

Këto mangësi dhe shumë të tjera që janë theksuar disa herë, e në mënyrë të veçantë në Plenumin e 8-të dhe të 9-të të Komitetit Qendror, duhet të bëhen objekt i analizave të thella në të gjitha hallkat, me synim që të korrigojnë sa më parë, për të mos krijuar vështirësi në plotësimin frontalisht të detyrave të planit të vitit 1985 e të mbarë pesëvjeçarit të ardhshëm.

**b) Forcimi i regjimit të kursimit nuk mund të kuptohet pa forcuar rregullin e disiplinën në përdorimin e administrimin e vlerave materiale dhe të punës së njerëzve.**

Shpenzimet materiale zënë një peshë të madhe në tërë prodhimin shoqëror. Kryesor mbetet sidomos kursimi i energjisë elektrike, veçanërisht në furrat elektrike të industrisë dhe të minierave, në turnet e treta në të gjitha degët e prodhimit, rritja e koeficientit të fuqisë dhe pakësimi i humbjeve të energjisë elektrike në rrjetet. Gjendja e rëndë aktuale e bilancit të energjisë elektrike që është krijuar nga thatësira dhe niveli i ulët në liqenet e hidrocentraleve, kërkojnë që të shtohen shumë masat organizative e teknike, të detyrueshme për kursimin e energjisë elektrike nga të gjithë, por sidomos nga Ministria e Industrisë dhe e Minierave, si dhe nga të gjitha rrethet e vendit e veçanërisht nga rrethe të tilla si Elbasani, Fieri e Tirana.

Lufta për kursimin e **karburanteve** përbën një drejtim tjetër të rëndësishëm të Partisë e të levave të saj, ku mund të kursehen vlera të mëdha materiale e valutore. Më shumë përpjekje duhet të bëjnë sidomos Ministria e Bujqësisë dhe ndërmarrjet e saj, që harxhojnë afro një të tretën e gjithë benzines e gazoilit që përdor ekonomia, si dhe Ministria e Komunikacioneve që harxhon afro një të katërtën e tyre. Masat në këtë drejtim të përqendrohen, kryesisht, në rishikimin me sy kritik të normativave, në mënjanimin e kryqëzimeve e të lëvizjeve të panevojshme, në zëvendësimin e motorëve që konsumojnë shumë karburant etj. Këtyre problemeve organet e pushtetit e të ekonomisë t'u futen me laps në dorë me masa e objektiva konkretë.

Vendi ynë konsumon shumë **çelique e hekur** në vit... Në përdorimin e tyre duhet shtrënguar dora fort dhe të përdoren më gjerësisht stampimet e farkëtimet që rritin koeficientin e shfrytëzimit të çeliqueve, të zbatohet gjerësisht prerja e përqendruar e prokateve dhe gjysmëfabrikatet e derdhura, duke ulur edhe skarcitetet, si dhe peshat e konstruksioneve betonarme, të makinerive e të pajisjeve... Në të njëjtën kohë është vënë detyra që ministritë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullore të rretheve të marrin masa për grumbullimin e 30-40 mijë tonë hekurishteve si dhe të metaleve me ngjyra, burim ky i rëndësishëm edhe për prodhimin e çeliqueve të cilësive më të mira.

Për kursimin e **lëndës së drurit** të merren masa për të rritur koeficientin e shfrytëzimit të saj në të gjitha fazat e përpunimit, për prodhimin e lëndës drusore me përmasa sipas nevojave të përdorimit, për zëvendësimin me materiale të tjera jodrusore dhe për lehtësimin e prodhimeve që bëhen me lëndë druri, për rritjen e jetëgjatësisë së ambalazheve e të kallëpëve prej druri etj. Të bëhemi plotësisht të ndërgjegjshëm, shokë, se nuk mund të ecet me këto ritme kaq të ngadalshme në zëvendësimin e lëndës së drurit me materiale jodrusore, sidomos për prodhimin e mobiljeve, të orendive e të arkave të ambalazhit, për prodhimin e kallëpeve të armaturave e të skelerive në ndërtim. Vetë Ministria e Bujqësisë, duhet të luftojë për ta zëvendësuar lëndën e drurit të sharruar, ashtu siç kërkon me të drejtë ndaj konsumatorëve të tjerë, që të arrijmë sa më parë balancimin e prerjes me rritjen vjetore, sipas detyrës që ka shtruar Komiteti Qendror i Partisë. Janë të gjitha mundësitë që qysh këtë vit të realizohet kudo një kursim i lëndës së drurit jo më pak se 3-4 për qind dhe për vitin e ardhshëm jo më pak se 5 për qind nga ulja e normativave të harxhimit të lëndës së drurit për prodhimin e mobiljeve e të orendive, të ambalazheve, në ndërtim e në gjithë llojet e përdorimit të saj.

**Në industrinë tekstile** të merren masa për lehtësimin e mëtejshëm të tekstileve e trikotazheve, sepse vazhdon të importohet,

shumë pambuk, në kushtet kur në koniunkturat e sotme çmimi i tij vjen duke u rritur (2 000-3 000 dollarë toni), në një kohë që çmimet e shitjes së disa mallrave tona të eksportit, si karburante, çimento etj. vijnë duke u ulur. Puna për lehtësimin e tekstileve ka filluar dhe qysh tani del e qartë se vetëm në kombinatin e tekstileve «Stalin», duke ulur 20 gram normativat e konsumit të pambukut për çdo metër kabot dhe 12 gram për çdo metër basmë, kursehet në vit rreth 110 tonë pambuk. Rezervat në këtë drejtim janë të shumta dhe kjo punë duhet vazhduar jo vetëm në kombinatin e tekstileve «Stalin», por në të gjithë industrinë e tekstileve e të trikotazheve.

**Në industrinë e qelq-qeramikës** kërkohet sa më parë të ulen në mënyrë të ndjeshme skarcitetet në prodhimin e thyerjet gjatë transportimit dhe të përdoruesit. Të rritet rezistenca e produkteve që prodhohen në fabrikat e qelqit, për të ulur jo më pak se një të tretën skarcitetin e thyerjet ndaj atyre ekzistuese. Kjo do të ulte edhe përdorimin e solarit në këto fabrika.

**Në industrinë ushqimore** të ulen në mënyrë të ndjeshme firot gjatë grumbullimit, ruajtjes dhe manipulimit të lëndëve të para bujqësore e blegtorale, të rritet rrezja e shfrytëzimit të tyre, duke mënjeluar skarcitetet. Të luftohet gjithashtu për të rritur qarullimin e ambalazheve nëpërmjet riparimit të tyre dhe grumbullimit nga popullsia.

**Në përdorimin e letrës** të mendohet e të punohet gjithashtu për sa më shumë kursime, duke ulur tirazhet e tepërta e të panevojshme, për pakësimin e përdorimit të letrës nga administratat, për organizimin e përdorimit disa herë të librave shkollorë, për rritjen e prodhimit të kartonit e të kartonçinës nga mbeturinat, me shtimin e grumbullimit të tyre etj.

Komitetet e Partisë dhe levat e tyre, dikasteret dhe institucionet përkatëse të ndjekin me vëmendje të veçantë punën për realizimin në praktikë të këtyre masave për kursimin e lëndëve të para e të materialeve dhe të veprojnë që në çdo tremujor kontingjentet e kursyera të hiqen nga plani i furnizimit. Këshilli i Ministrave të ndjekë dhe të kontrollojë aksionet për kursimet dhe t'i drejtojë e t'i përdorë ato jo vetëm për tejkalimin e detyrave të këtij viti, por edhe gjatë gjithë pesëvjeçarit të tetë.

Me të njëjtin shqetësim e kujdes duhet ndjekur edhe **përdorimi me rendiment të lartë i fuqisë punëtore e kooperativiste**, ku kemi mangësi dhe qëndrime të palejueshme. Në shkallë ekonomie, mbi një e dhjeta e punëtorëve punon pa norma, kurse në fshat, në periudha të caktuara, kjo arrin më tepër se 15 për qind. Edhe aty ku punohet me norma nuk po zbatohet si duhet porosia e Komitetit Qendror të Partisë për t'i rishikuar e përmirësuar ato në përputhje me progresin teknik, me përvojën e më të mirëve dhe me përsosjen e organizimit e të drejtimit të punës e të prodhi-



mit. Shpesh për këto ka më shumë zhurmë sesa punë konkrete, sepse edhe ato përmirësime që bëhen nuk prekin proceset masive dhe kryesore të prodhimit, operacionet bazë të tij, por ato ndihmëse dhe me efekt fare të vogël. Më shumë duhet punuar për shfrytëzimin e plotë të kohës së punës dhe për rritjen e shkallës së mekanizimit.

Partia dhe levat e saj, veçanërisht Bashkimet Profesionale, duhet të rritin punën me njerëzit që të kuptohet e të realizohet drejt e nga të gjithë domosdoshmëria e rritjes së pandërprerë të rendimentit të punës, si ligj ekonomik i socializmit. Edhe në këtë çështje komunistët të jenë në krye dhe, me shembullin e tyre personal, të nxitin e të tërheqin gjithë kolektivat punonjës.

**c) Lufta për kursimet të ngrihet në një nivel më të lartë edhe në fushën e investimeve e të ndërtimeve.**

Investimet për këtë vit arrijnë më shumë nga sa u investua gjatë gjithë pesëvjeçarit të dytë. Kjo përbën një fushë të rëndësishme pune për kursime në përdorimin e tyre, sidomos në bujqësi e në industrinë energjetike, që zënë peshën më të madhe, rreth 55 për qind të të gjitha investimeve. Vëmendje e posaçme t'i kushtohet sidomos lehtësimit të konstruksioneve dhe përdorimit të materialeve të lehta të ndërtimit.

Lufta për kursimet duhet të fillojë që nga studimet dhe projektimet teknologjike, të cilat shpesh bëhen me rezerva dhe kërkesa të fryra. Të hiqet dorë nga konceptet dhe nga prirjet për teknologji supermoderne e të parakohshme që kërkojnë investime të mëdha dhe të mbështetemi fuqimisht në përvojën dhe në traditën tonë, në arritjet e mendimit shkencor, për të ndërtuar thjeshtë dhe lirë. Nga një studim paraprak, vetëm nga përmirësimi i normativave dhe ulja e firove në një pjesë të mirë të veprave të planifikuara, del se mund të kursehen gjatë ndërtimit mbi 2 mijë tonë çimento, 2 mijë tonë bitum, 260 mijë m<sup>2</sup> katramat etj., gjë që flet se në ndërtim ende ka rezerva që duhen shfrytëzuar, si në projektim, ashtu edhe në zbatim.

Prandaj është caktuar edhe detyra që, në të gjitha objektet e ndërtimit të vitit 1985 dhe atyre që kanë filluar e përfundojnë në vitin 1986 të kursehen jo më pak se 135 milionë lekë kundrejt vleftave të ndërtim-montimeve të planifikuara. Kjo punë të thellohet më tej në pesëvjeçarin e ardhshëm për të arritur në një kursim edhe më të madh. Nga studimet e deritanishme është gjetur e mundshme që, duke futur më gjerësisht metodat e reja llogaritëse dhe rishikimin e normativave e të kushteve të projektimit teknologjik e ndërtimor, si dhe nëpërmjet lehtësimit të konstruksioneve dhe përdorimit të materialeve më të lira, të ulen 4-8 për qind vleftat e plota të parashikuara në skicidenë e pesëvjeçarit të tetë. Po kështu, nga rishikimi i manualeve të preventivimit në drejtim të uljes së normativave të harxhimit të materialeve,

uljes së firove, shkurtimeve të distancave të transportit dhe të shpenzimeve suplementare e për ngritje kantieri, të ulet kostoja e veprave jo më pak se 5 për qind.

Këtë vit do të punohet në 270 vepra kufi dhe parashikohet të vihen në shfrytëzim 145 prej tyre. Para punonjësve të ndërtimit, si dhe para vetë investitorëve shtrohet detyra për t'i shkurtuar afatet e ndërtimit dhe për t'i vënë objektet sa më shpejt në shfrytëzim, për të marrë sa më parë prodhim prej tyre. Përvoja që u fitua gjatë tremujorit të fundit të vitit të kaluar për t'i përfunduar e dorëzuar objektet me përqëndrim forcash e mjesh, duke ulur mjaft ndërtimet në proces, tregon qartë se çfarë rezervash ka në këtë fushë.

Që në Plenumin e 7-të u vu theksi për domosdoshmërinë e kursimit të trojeve të ndërtimit, sepse çdo vit zihen rreth 1-2 mijë ha tokë për ndërtime, kur ekzistojnë mundësi për ta kursyer atë me ndërtime vertikale kudo, deri edhe në ekonomitë bujqësore. Të vlerësohet shumë më tepër çdo metër katror e truallit të ndërtimit, sepse toka është pasuri e pazëvendësueshme dhe ne e kemi të pakët atë, prandaj duhet ta shtojmë e ta kursejmë.

Për bonifikimet, për vaditjen dhe për sistemimet agrare janë bërë e bëhen investime të mëdha, por fondet e caktuara për këtë qëllim nuk janë vlerësuar kurdoherë e si duhet për t'i shfrytëzuar në kohën e duhur dhe me efektivitetin e planifikuar. Në disa vepra të bonifikuara si në Hoxharë, Karavasta, Akërnë etj. e në disa objekte vaditjeje me rëndësi nuk po arrihet efektiviteti i parashikuar, sepse, megjithëse veprat ujëmbledhëse kanë përfunduar, ato nuk janë vënë në shfrytëzim të plotë në afatet e caktuara, sepse nuk janë bërë në kohë kanalet e dyta e të treta. Vetëm në rrethin e Krujës mbi 5 000 ha ujiten sot me elektropompa dhe traktopompa, kur nga studimet që bëri vetë rrethi, del se janë mundësitë që me kanalet e dyta e të treta të futen këto sipërfaqe nën ujë e të kursehet kështu nafta apo energjia elektrike. Thjeshtime të tilla duhen bërë edhe në objektet e mbrojtjes dhe në ato socialkulturore.

Të gjitha këto kërkojnë që në procesin e ndërtimit të rritet shumë më tepër edhe kontrolli i investitorëve, si dhe i organeve të bankës, të planit e të financës, në mënyrë që çdo lek i investuar të sigurojë jo vetëm efektivitetin e planifikuar, por edhe një kursim të madh në vlera materiale, në kohë e në cilësi.

**c) Forcimi i regjimit të kursimit në bujqësi kërkon një konceptim të drejtë për përdorimin më me efektivitet të forcave njerëzore dhe të bazës materialo-teknike.**

Rezervat e mundësitë e bujqësisë janë të mëdha, si shfrytëzimi i tokës, i plehrave organike e kimike, përdorimi i kafshëve të punës dhe mekanizimi i thjeshtë, përdorimi sa më racional i bazës ushqimore, rritja e pjellorisë dhe ulja e dëmtimeve për si-



gurimin e numrit të krerëve etj. Për këto probleme Partia vazhdimisht ka tërhequr vëmendjen, megjithatë vërehet se ende për to nuk ka një kuptim të thellë. Kritikat që bëri Byroja Politike me rastin e shqyrtimit të skicidesë së pesëvjeçarit të tetë, të kuptohen mirë nga Ministria e Bujqësisë, nga organet e saj vartëse dhe të pasqyrohen në punën për realizimin e planit qysh këtë vit. Nga organet e bujqësisë të kuptohet thellë vërejtja e shokut Enver lidhur me punën që duhet bërë për harmonizimin e faktorëve të rritjes së prodhimit, duke kombinuar më drejt rrugët intensive me ato ekstensive të tij, detyrë kjo që është e domosdoshme të mbahet parasysh edhe nga sektorët e tjerë të ekonomisë. Zbatimi i teknologjive të reja nuk duhet të çojë në zbehjen e traditave të mira në zhvillimin e prodhimit tonë socialist, që me objekte të thjeshta, të mira e më pak të kushtueshme, të merret më shumë prodhim.

Me gjithë arritjet që ka zona e intensifikuar me përparësi, objektivat e caktuar për rendimentet dhe efektivitetin ekonomik nuk janë realizuar dhe në disa prodhime janë marrë rendimente më të ulëta sesa në zonën fushore që nuk është përfshirë në intensifikimin me përparësi. Kështu, në misër, rrethi i Lushnjës, i Beratit dhe i Fierit kanë marrë rendiment më të ulët se rrethi i Shkodrës dhe i Sarandës. Të pakënaqshme janë edhe rendimentet në luledielli, sojë e fasule. Këto rezultate nuk justifikojnë investimet më të mëdha që janë bërë në këtë zonë, prandaj kërkohet një ndjenjë më e lartë përgjegjësie nga komitetet e Partisë dhe ato ekzekutive të këtyre rretheve. Niveli më i ulët i rendimenteve të arritura në vitin 1984 ndaj vitit 1983, sidomos në misër, në fasule, në luledielli e në ndonjë bimë tjetër nuk mund të justifikohen për këtë zonë me kushtet e motit, sepse shumica e sipërfaqes nën kulturë është nën ujë dhe me një shkallë mekanizimi më të lartë. Është e nevojshme që organet e Partisë e të pushtetit të rretheve, ku përfshihet zona e intensifikimit me përparësi, Ministria e Bujqësisë dhe vetë Këshilli i Ministrave të analizojnë thellë problemet që dalin, të nxjerrin konkluzionet përkatëse dhe të marrin masa më të efektshme për zbatimin e detyrave të rëndësishme që ka caktuar Kongresi i 8-të i Partisë për këtë qëllim.

Një kthesë rrënjësore pritet në efektivitetin e prodhimeve blegtorale dhe të shpenzimeve e investimeve të mëdha që ka bërë e bën shteti në këtë sektor. Ne do të vazhdojmë të ndërtojmë edhe komplekse moderne për prodhimin e mishit, të qumështit, të vezëve, sigurisht me maturi e me kosto më të ulët, por baza e prodhimit dhe e furnizimit të popullit me këta artikuj, në qytet e në fshat, ka qenë dhe mbetet prodhimi i gjerë në kooperativat e në ndërmarrjet bujqësore. Këtu kërkohet, në radhë të parë, siç theksoi kohët e fundit Byroja Politike në vendimin përkatës, të rriten rendimentet dhe të përmirësohet struktura e foragjereve për të

siguruar ushqim të balancuar për blegtorinë, që të merret prodhim i madh me kosto të ulët. Vëmendje të posaçme kërkon vlerësimi dhe trajtimi kudo i kullotave natyrore dhe në veçanti i masiveve kryesore të vendit, si në Shishtavec, Lenije, Gramoz, Korab, Mal të Gjerë, Lurë etj. për të arritur që ato të mbajnë dy dhe tre herë më shumë krerë bagëti, sesa mbajnë aktualisht, duke organizuar për këtë edhe një kooperim më të mirë të ekonomive bujqësore të fushës me ato të malësisë, sidomos për tufat e majmërisë.

**d) Shkenca t'i shërbejë më mirë prodhimit dhe forcimit të regjimit të kursimit.**

Është fakt se pas Plenumit të 8-të të Komitetit Qendror të Partisë të vitit 1980, veprimtaria shkencore në vendin tonë ka pësuar një rritje sasiore e cilësore. Shkenca është lidhur më mirë me prodhimin, duke mbështetur realizimin e planeve dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë. Por mosrealizimet në prodhim në degë të ndryshme të ekonomisë, rritja e shpenzimeve të prodhimit dhe efektiviteti i ulët i tij në disa drejtime janë pasojë edhe e punës dhe përpjekjeve të pamjaftueshme të organizmave shkencorë, në qendër e në bazë. Organizatat e Partisë dhe organet shtetërore të luftojnë për të shmangur njëfarë voluntarizmi e spontaneiteti që ende vihet re në punën shkencore dhe tematika e punës së tyre të planifikohet e të zbatohet në përputhje me nevojat e realizimit të planit të ekonomisë e të zhvillimit të saj.

Nga punonjësit shkencorë dhe specialistët në institute e në bazë, në ndërmarrje e në kooperativa bujqësore, Partia pret që t'u jepen rrugëzgjidhje problemeve të tilla të rëndësishme për ekonominë si: zbulimi dhe vënia në shfrytëzim e rezervave të naftës e të gazit, rritja e shkallës së rikuperimit të mineraleve dhe pakësimi i humbjeve, gjetja e mineraleve të reja që sot detyrohemi t'i importojmë, siç janë qymyret e koksifikueshme, hekuri pa nikel, fosforitet me përmbajtje të lartë fosfori, kaolinat, prodhimi i farërave hibride në bujqësi, problemet komplekse të korrozionit, të ndotjes së mjedisit, të erozionit të tokës bujqësore etj.

Më shumë duhet ta ndiejnë përgjegjësinë punonjësit e Institutit të Perimeve e Patates, të Institutit të Kërkimeve të Zooteknisë në Tiranë, të Institutit të Kërkimeve Bujqësore në Lushnjë për problemet e pambukut dhe të fasules, të Institutit të Kërkimeve Veterinare për problemet e mbrojtjes së shëndetit të kafshëve, të Institutit të Studimeve të Tokave për problemet e ujitjes, të kullimit e të plehërimit, të Institutit të Studimeve dhe të Projektiveve Teknologjike të Mineraleve, të Institutit të Studimeve dhe Projektiveve të Industrisë së Lehtë e Ushqimore etj. Ministrinë përkatëse dhe Komiteti i Shkencës dhe i Teknikës të vënë më mirë në lëvizje institucionet shkencore, t'i orientojnë, t'i mbështetin, të bashkërendojnë dhe të kontrollojnë punën e tyre. Specialistët e kuadrot e këtyre institucioneve të hidhen në veprime

më konkrete, krah për krah me njerëzit e prodhimit, me specialistët e me novatorët, për të çuar përpara teknikën e teknologjinë e prodhimit, që përbën një ndër rrugët më efektive e më me pak shpenzime për kursime sa më të mëdha.

Gjithashtu, të gjenden rrugë e forma më konkrete, me qëllim që potenciali i forcave të kualifikuara shkencore të universitetit të Tiranës «Enver Hoxha» dhe të shkollave të tjera të larta, si dhe studimet e tyre të vihen më mirë në shërbim të prodhimit. Më mirë e me detyra konkrete e të ngjeshura duhet të ngarkohen edhe specialistët e prodhimit e byrotë teknike e teknologjike, ku punon edhe pjesa më e madhe e potencialit tonë shkencor, rezultatet e punës së të cilit do të ndikojnë në mënyrë më të drejt-përdrejtë e të ndjeshme edhe në kursimin e vlerave materiale e të punës së punonjësve.

Realizimi i detyrave të mëdha që kemi përpara kërkon të përmirësojmë më tej punën për zbrërthimin, kontrollin dhe zbatimin e vendimeve, që sintetizojnë politikën ekonomike të Partisë dhe përbëjnë edhe një nga aspektet themelore të metodës së punës të organeve të Partisë, të pushtetit e të ekonomisë.

Çdo vendim apo direktivë e Partisë, para së gjithash, ka nevojë të zbrërthet për t'u njohur e për t'u përvetësuar nga ata që do t'i zbatojnë. Jeta na ka provuar se kur kjo punë është bërë mirë, edhe përfundimet kanë qenë të mira. Por vetëm zbrërthimi i vendimit, pa marrë në të njëjtën kohë të gjitha masat e nevojshme organizative, nuk është i mjaftueshëm. U zhdukën në kohë pasojat e dëborës së madhe në rrethet e Veriut, në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave, vetëm sepse u përcaktuan shpejt e u zbatuan plotësisht të gjitha masat organizative të nevojshme. Po kështu po zbatohet edhe vendimi për organizimin e punëve gjatë fushatës së korrje-shirjeve të grurit dhe po ecet më mirë se çdo vit tjetër. Por nuk u veprua kështu në përcaktimin e masave organizative me rastin e tufëzimit të bagëtive të imëta e të trasha dhe dihen rrjedhimet e pakënaqshme që patëm në pakësimin e numrit të tyre. Edhe vendimi i fundit për pakësimin deri në 15 për qind të konsumit të energjisë elektrike do të mbetet si një vendim thjesht administrativ e pa efekt, nëse nuk do të shoqërohet me një varg masash teknike e organizative që duhet të përcaktohen nga rrethet e ministritë, në vend që të bëjnë presione e të kërkojnë shtesë të energjisë elektrike.

Shumë qartë e konkretisht përcaktohen detyrat në vendimin e Byrosë Politike për fuqizimin e bazës ushqimore të blegtorisë. Për zbrërthimin e konkretizimin e mëtejshëm të tyre, nga Këshilli i Ministrave u bënë edhe aktive në bazë zone, ku u shkëmbye përvoja e mirë e u rrahën mendime për rrugët e zbatimit të tij. Megjithëkëtë, deri tani në silazhin pranveror është krijuar deficit

ndaj planit, sidomos nga rrethet Shkodër, Krujë, Berat, Lezhë, Fier etj., pikërisht sepse nuk u morën me kohë të gjitha masat e nevojshme organizative për zbatimin e këtij vendimi të rëndësishëm.

Zbatimi i vendimeve është një proces kompleks që kërkon punë të thelluar, si për zbrërthimin e tyre dhe për marrjen e të gjitha masave organizative, ashtu edhe për kontrollin sistematik e luftën këmbëngulëse për vënien e tyre në jetë. Nënveleftësimi ose moszbatimi i njërës a i tjetrës hallkë të këtij procesi bën që vendimet të vihen në jetë me mangësi. Të drejtosh, na mëson shoku Enver, do të thotë, në radhë të parë, të kontrollosh zbatimin e vendimeve të marra. Partia vazhdimisht ka theksuar se atje ku mungon kontrolli, krijohet fushë e lirë veprimi për burokratizmin e liberalizmin, atje ku ai është i dobët edhe ndjekja e zbatimi i vendimeve çalon. Në këtë aspekt të rëndësishëm të metodës e të stilit të punës duhet këmbëngulur më shumë në të ardhmen për të siguruar realizimin frontal të planeve.

**Kjo kërkon që zbatimi i detyrave të planit t'i nënshtrohet kudo dhe vazhdimisht kontrollit të vërtetë të Partisë, kontrollit shtetëror dhe të masave.** Ky kontroll, në shumicën e rasteve, ka pasur karakter konstatues, regjistrues dhe nuk ka vënë para përgjegjësisë njerëzit që duhet të japin llogari para Partisë dhe popullit për gabime, neglizhenca, paaftësi, shpërdorime ose edhe faje, që kanë çuar në moskryerjen si duhet të detyrave. Kemi afro 10 mijë punonjës të kontrollit cilësor, financiar, teknik etj., që paguhen për zbatimin e ligjeve në fushën e prodhimit, të qarkullimit e të shpërndarjes, megjithatë janë mjaft mallra që prodhohen me cilësi të keqe, me skarcitet, që shpërdorohen, humbasin, vidhen e si pa të keq justifikohen. Janë me dhjetëra kooperativat që dalin me mbishpenzime, sepse nuk ndiqet e nuk kontrollohet si duhet fati i prodhimeve, kurse shpenzimet bëhen dhe paradhënie jepen pa u konfrontuar me gjendjen reale të prodhimit e me perspektivën e tij. Mirë veprohet që kontrollohen fletëshërbimet, biletat e udhëtimit etj., sepse edhe këtu kemi shpenzime jo të pakta që duhen ulur, mirëpo më pak shqetësohemi për të kontrolluar dokumentacionin e vlerave materiale, lëvizjen e mallrave, prodhimet në proces e në ruajtje, ku dëmet janë shumë më të mëdha. Si mund të pranohet që miliona tonë mallra të lëvizin me hekurudhë pa i pasur kush në ngarkim dhe pa kontrolluar sigurinë e tyre?

Kësaj shtate i duhet dhënë fund. Kudo e nga të gjithë të rritet kontrolli, në të gjitha format dhe rrugët, për të forcuar edhe nëpërmjet tij regjimin e kursimit. Organet e kontrollit shtetëror dhe të kontrollit punëtor e fshatar të veprojnë më aktivisht për të ndrequr gjithçka që shkon në kundërshtim me direktivën e Partisë, të vënë para përgjegjësisë atë që nuk zbaton ligjet

e vendimet në fuqi dhe në veçanti për të parandaluar çdo veprim që bie në kundërshtim me interesat e ekonomisë e të popullit.

Detyrat e mëdha që kemi përpara dhe situatat e krijuara kërkojnë të nxitim e të ngremë në një shkallë më të lartë mendimin krijues të punonjësve dhe t'i mbështetim ata në iniciativat e tyre.

«Çdo gjë mund të bëjnë njerëzit tanë, — thekson shoku Enver, — njëlloj si nga më të mirat e vendeve të tjera, mjaft që të zhvillojmë më tej mundësitë e punës dhe të studimit»<sup>1</sup>.

Punonjësit kanë plot mendime racionale, bëjnë propozime për përmirësime të procesit teknologjik ekzistues, në nyja të veçanta të prodhimit, të cilat nuk kërkojnë fonde valutore, por sjellin si rezultat rritjen e rendimentit, kurtime në përdorimin e materialeve, të energjisë elektrike e rritjen e efektivitetit të prodhimit. Duhet luftuar me forcë konceptet frenuese të disa kuadrove e specialistëve, të cilët përmirësimin e treguesve të efektivitetit e lidhin vetëm me ngritjen e linjave, me teknologjitë e reja e disa herë supermoderne, që kërkojnë fonde të konsiderueshme valutore. Përvoja e deritanishme na provon se edhe pa linja me teknologji të reja, prodhimi është rritur edhe tej kapaciteteve të projektuara, si rezultat i racionalizimeve dhe i mendimit krijues të masave. Në kushtet aktuale kjo është një nga hallkat më të rëndësishme për rritjen e efektivitetit të prodhimit, prandaj kuadrot e specialistët, me në krye komunistët, ta vlerësojnë më shumë, të nxitin me të gjitha mjetet lëvizjen novatore e racionalizuese dhe të krijojnë kudo kushte e të marrin masa që mendimi krijues i punonjësve të vihet sa më mirë në jetë e të zbatohen sa më shpejt, në luftë me qëndrimet burokratike e teknokratike.

Detyrat që po shtrojmë në këtë mbledhje të Plenumit të Komitetit Qendror janë sa të rëndësishme, aq edhe të ngutshme. Ato lidhen me situatat që kalojmë, me luftën që do të duhet të bëjmë për t'i përballuar ato, pa ulur ritmet e zhvillimit tonë ekonomik e shoqëror, pa prekur nivelin e jetesës së masave punonjëse dhe, si gjithmonë, pa i shtrirë dorën askujt.

Vështirësitë që hasim, si nga ndikimi i krizës e i rrethimit imperialisto-revizionist, ashtu edhe nga dobësitë e mangësitë tona, janë plotësisht të kapërcyeshme, kur Partia ngrihet në këmbë me tërë forcën e saj, kur vë në pozita luftarake pune levat, organet e

1. Enver Hoxha, Vepra, vëll. 36, f. 466.

pushtetit e të ekonomisë, organizatat e masave, kur vë në lëvizje si duhet energjitë e pashtershme krijuese e transformuese të masave.

Gjendja e shëndoshë moralo-politike që sundon në të gjithë vendin, gatishmëria e mobilizimi i gjithanshëm i masave punonjëse për të nderuar me punë emrin e veprën e shokut Enver, për të zbatuar kudo direktivat e Partisë dhe mësimet e tij, janë garancia më e sigurt për fitore të reja edhe më të mëdha në të ardhmen. Prandaj duke u mbështetur në heroizmin e mobilizimin e masave, t'i përvishemi punës me seriozitetin më të madh dhe me përgjegjësi të plotë nga secili për të plotësuar deri në një detyrat që shtrojmë në këtë Plenum.

Lufta për kurtime është pjesë e pandarë e punës së Partisë për edukimin komunist të masave, prandaj me veprimtarinë e vet e të levave të saj, Partia të bëjë të ndërgjegjshëm çdo punonjës për domosdoshmërinë e kursimit, për mbrojtjen e fuqizimin e pronës socialiste, për plotësimin e tejkalinimit e planeve në të gjithë treguesit, si rruga më e rëndësishme për zbatimin e një regjimi të fortë kursimi.

Komiteti Qendror i Partisë ka bindjen e plotë se punonjësit e vendit tonë do t'i kuptojnë drejt dhe thellë këto detyra dhe do të mobilizohen si një trup i vetëm rreth Partisë, Komitetit të saj Qendror me shokun Ramiz Alia në krye, për t'i plotësuar e tejkalkuar ato me frymë luftarake, me disiplinë dhe me shpirt praktik krijues, për të fuqizuar më tej ekonominë, për të ngritur mirëqenien e popullit dhe për të forcuar aftësinë mbrojtëse të atdheut tonë socialist.

*Botohet për herë të parë me  
disa shkurtime, sipas origjinat  
lit që gjendet në Arkivin  
Qendror të Partisë*



## VENDIM

### I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH MBI REALIZIMIN FRONTALISHT TË DETYRAVE TË PLANIT ME NJË REGJIM TË FORTË KURSIMI

9 korrik 1985

Plenumi i 12-të i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur më 8 dhe 9 korrik 1985, pasi dëgjoi e diskutoi gjerësisht rreth raportit të Byrosë Politike të Komitetit Qendror: «Të luftohet për realizimin frontal të detyrave të planit me një regjim të fortë kursimi», të mbajtur nga anëtarë i Byrosë Politike e Kryetar i Këshillit të Ministrave, shoku Adil Çarçani, si dhe fjalën që mbajti shoku Ramiz Alia, Sekretar i Parë i Komitetit Qendror të PPSH,

#### Vendosi:

1. — Të miratojë raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror të PPSH «Të luftohet për realizimin frontal të detyrave të planit me një regjim të fortë kursimi».

2. — Të porositë organet dhe organizatat-bazë të Partisë, organet shtetërore e të ekonomisë dhe organizatat e masave që të marrin të gjitha masat e nevojshme politiko-shoqërore dhe organizativo-teknike për të zbërthyer detyrat e këtij raporti në çdo qelizë të ekonomisë. Këto të marrin masa që detyrat të plotësohen e të tejkalohen në të gjithë zërat e treguesit e planit me një ndjenjë të lartë përgjegjësie e kursimi të vlerave materiale, monetare, valutore dhe të punës së gjallë në qytet dhe në fshat.

3. — Të gjitha organet dhe organizatat e Partisë, organet shtetërore e të ekonomisë, si dhe forumet e organizatave të masave të zbatojnë një stil e metodë pune më të zhdërvjellët e dinamike për t'iu përgjigjur vrullit revolucionar të punonjësve dhe

vendosmërisë së tyre për ta kthyer në forcë dhimbjen e thellë për humbjen e themeluesit e udhëheqësit të Partisë e të Shqipërisë socialiste, shokut Enver Hoxha.

## PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

### VENDIM

Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë

## V E N D I M

I SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH PËR VENDOSJEN E  
BUSTEVE DHE TË SIMBOLEVE PËRKUJTIMORE NË SHENJË  
RESPEKTI E DASHURIE PËR SHOKUN ENVER HOXHA

9 shtator 1985

Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë, në datën 9 shtator 1985, duke marrë parasysh propozimet e shumta që janë bërë për të vendosur simbole përkujtimore në shenjë respekti e dashurie për shokun Enver Hoxha dhe me qëllim që të zbatohen kritere të drejta e unike në shkallë vendi,

## V e n d o s i :

1. — Të vendosen buste të shokut Enver Hoxha në të gjitha ato institucione, ndërmarje, kooperativa bujqësore apo njësi ushtarake që mbajnë emrin e tij. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës, në bashkëpunim me rrethet përkatëse, të përcaktojë bustet dhe kohën kur do të vendosen.

2. — Të vendosen pllaka përkujtimore dhe simbole të tjera si basorelieve, lapidarë etj. në ato vende që lidhen me jetën dhe me veprën e shokut Enver dhe që kanë të bëjnë me ngjarje të rëndësishme politike në historinë e Partisë e të popullit. Për të gjitha rastet të merret pëlqimi i aparatit të Komitetit Qendror të Partisë.

Për ndjekjen dhe për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen komitetet e Partisë të rretheve e të njësive, Ministria e Arsimit dhe e Kulturës dhe aparati i Komitetit Qendror të PPSH.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Ramiz Alia*

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## V E N D I M

I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR NGRITJEN  
E MUZEUT «ENVER HOXHA»

2 tetor 1985

Me qëllim që të përjetësohet figura e ndritur dhe epoka e lavdishme e shokut Enver Hoxha, që komunistët dhe gjithë ata që u rritën, luftuan e punuan në kohën e tij, si edhe brezat e ardhshëm, të kujtojnë e të nderojnë prijësin e tyre legjendar, të edukohen me shembullin e me mësimet e tij, të frymëzohen për ta mbrojtur e për ta çuar gjithnjë përpara veprën e tij të pavdekshme, Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 2 tetor 1985

## V e n d o s i :

1. — Të ngrihet në Tiranë muzeu «Enver Hoxha», si qendra e pasqyimit, e studimit dhe e propagandimit të jetës dhe të veprimtarisë revolucionare të udhëheqësit të madh të Partisë e të popullit shqiptar.

2. — Në muze të paraqitet rruga e rritjes dhe e formimit komunist të shokut Enver Hoxha, roli i tij si themelues dhe udhëheqës i Partisë, si strateg i Luftës Nacionalçlirimtare dhe i fitores së revolucionit popullor; kontributi i tij për krijimin e bashkimit të popullit shqiptar në Frontin Demokratik, për vendosjen dhe forcimin e pushtetit popullor dhe për krijimin e modernizimin e Ushtrisë Popullore; merita e tij në ndërtimin e ekonomisë dhe në zhvillimin e kulturës socialiste, në përpunimin e zbatimin e politikës së jashtme të Partisë e të shtetit tonë socialist. Muzeu të pasqyrojë figurën e shquar të shokut Enver Hoxha si mendimtar marksist-leninist dhe internacionalist proletar.

3. — Për realizimin e kësaj vepre të krijohet Komisioni Qendror i kryesuar nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të

PPSH, Ramiz Alia, dhe i përbërë nga shokët: Adil Çarçani, Lenka Çuko, Manush Myftiu, Foto Çami, Prokop Murra, Nexhmije Hoxha, Shefqet Peçi, Pilo Peristeri, Tefta Cami, Farudin Hoxha, Sotir Koçollari, Lumturi Rexha, Mehmet Elezi, Aleks Buda, Pirro Kondi, Dritëro Agolli.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Ramiz Alia

Botohet sipas origjinalit që  
gjendet në Arkivin Qendror  
të Partisë

Botuar për herë të parë në  
gazetën «Zëri i popullit»,  
nr. 247 (11 617), 15 tetor 1985

**VENDIM**  
**I BYROSË POLITIKE TË KQ TË PPSH PËR RRRITJEN E ROLIT**  
**TË BANKËS NËPËRMJET FORCIMIT TË KONTROLLIT**  
**ME ANË TË LEKUT**

2 tetor 1985

Byroja Politike e Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 2 tetor 1985, pasi shqyrtoi raportin e paraqitur nga Drejtorja e Përgjithshme e Bankës së Shtetit dhe nga Drejtorja e Përgjithshme e Bankës Bujqësore «Për rolin dhe ndikimin e bankës në rritjen e efektivitetit të ekonomisë nëpërmjet forcimit të kontrollit me anë të lekut»

Vendosi:

1. — Organet e bankës të rritin forcën kontrolluese, planifikuese e studiuese për problemet e mëdha të ekonomisë dhe të japin ndihmesë më efektive në ecurinë e tyre. Për këtë, organizatat e Partisë në rrethe, në dikastere, në vetë institucionet bankare, si dhe në ndërmarrjet ekonomike dhe në kooperativat bujqësore, të punojnë dhe të kërkojnë vazhdimisht që të kuptohet e të realizohet plotësisht orientimi i Partisë për rolin aktiv të bankës dhe të financës në planifikimin dhe në realizimin e planeve, duke luftuar ato koncepte dhe praktika jo të drejta që i vënë këto organe vetëm ose thjesht në pozitat pasive të shërbimit, të regjistrimit dhe të punës konstatuese.

2. — Banka dhe financa të futen në kohë e plotësisht në procesin e hartimit dhe të realizimit të planeve dhe të thonë fjalën e vet me peshë për investimet dhe për eksport-importin, për fondin e pagave e rendimentin e punës, për strukturën e koston e prodhimit dhe për shpërndarjen e tij, me qëllim që të rritet efektiviteti i ekonomisë dhe t'u dilet përpara problemeve e vështirësive, të arrihet që në çdo situatë, përgjithësisht, të mbahen përpjesëtime të drejta në zhvillimin e ekonomisë.



3. — Këshilli i Ministrave dhe organet drejtuese të Bankës së Shtetit dhe të Bankës Bujqësore të përcaktojnë dhe të zbatojnë masa të posaçme ideoprofesionale, organizative dhe në fushën e kompetencave, për të realizuar një kontroll më të plotë, më të thellë, të shkathët dhe më operativ të bankës në respektimin nga kushdo të ligjeve e të rregullave në fuqi.

4. — Për të rritur rolin dhe përgjegjësinë e organeve të bankës, të përsoset puna për aktivizimin e plotë të levave në kuadrin e të gjithë mekanizmit ekonomiko-financiar, sidomos në përdorimin e fondit të pagave, në forcimin e aftësisë paguese, në format e në radhën e pagesave dhe në sferën e forcën e veprimit të kreditit me afat të shkurtër e të gjatë. Masat shtrënguese dhe sanksionet individuale e kolektive që, sipas kompetencave, i takojnë bankës, duhet t'i marrë ajo vetë dhe të mos bëjë lëshime në zbatimin e tyre nga organet e tjera shtetërore dhe ekonomike.

5. — Problemet e fuqisë blerëse dhe të mbulimit të saj, të strukturës e të qarkullimit të mjeteve të xhiros dhe të forcimit të aftësisë paguese të ndërmarrjeve të ndiqen dhe të zgjidhen më mirë nga çdo ministri, rreth e ndërmarrje në përputhje me vendimet përkatëse të Komitetit Qendror. Këto çështje të mëdha të vlerësohen seriozisht nga organet e Partisë, të shtetit e të ekonomisë, duke pasur mirë parasysh se në këto fusha kalojnë e përqendrohen shumë fije të zbatimit të politikës ekonomike të Partisë. Për ecurinë e tyre të bëhen analiza të thelluara e sistematike, të caktohen masa reale ekonomike, organizative e teknike për realizimin e planeve dhe t'u shkohet punëve deri në fund, duke nxjerrë përgjegjësitë direkte personale e kolektive për të metat e dobësitë që vërtetohen.

6. — Dikasteret qendrore, komitetet e Partisë dhe komitetet ekzekutive të këshillave popullorë të rretheve, si dhe organizatat e Partisë dhe drejtuesit e ekonomisë në bazë t'i konsiderojnë organet e bankës si ndihmëse të afërta të Partisë e të shtetit në përdorimin e lekut të popullit, t'i vlerësojnë e të kërkojnë më shumë nga ato studime e ngritje problemesh dhe të tregojnë kujdes për vendosjen në bankë të punonjësve me përvojë e të përgatitur nga pikëpamja ideopolitike dhe profesionale.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

*Ramiz Alia*

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## PROTOKOLL

### I SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH PËR PUNËN SHKENCORE NË UNIVERSITETIN «ENVER HOXHA» TË TIRANËS DHE NË INSTITUTIN E LARTË BUJQËSOR DHE MASAT QË DUHEN MARRË PËR TA ÇUAR ATË MË PËRPARA

19 nëntor 1985

Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë, në mbledhjen e datës 19 nëntor 1985, pasi analizoi punën shkencore që bëhet në universitetin e Tiranës «Enver Hoxha» dhe në Institutin e Lartë Bujqësor, vuri në dukje se veprimtaria shkencore në këto shkolla të larta është vënë në rrugë të mbarë dhe ka ecur përpara, janë rritur pesha dhe roli i saj në ngritjen e nivelit të procesit mësimor dhe në zgjidhjen e problemeve të ndërtimit socialist të vendit.

Por, me qëllim që puna kërkimore-shkencore t'i shërbejë edhe më me frytshmëri veprimtarisë së shkollës së lartë, që ajo të integrohet më mirë me prodhimin, që arsimi i lartë të mbështetet fort në një punë shkencore të qëndrueshme dhe të kapërcen mangësitë dhe ritmet e ngadalshme që vërehen, Sekretariati i Komitetit Qendror të Partisë,

#### Porosit:

1. — Organizatat e Partisë në universitetin e Tiranës «Enver Hoxha» dhe në Institutin e Lartë Bujqësor të Kamzës të zhvillojnë një punë më të thellë e të vazhdueshme politiko-ideologjike me punonjësit për një angazhim më të madh e me cilësi më të lartë në veprimtarinë kërkimore-shkencore, duke luftuar kundër frymës së të kënaqurit me pak, nivelit mesatar e të ulët, mefshtësisë e ambientimit me një punë të rëndomtë, me qëllim që shkollat e larta të bëhen gjithnjë e më shumë qendra të mendimit më të kualifikuar shkencor të kohës.

2. — Për t'iu përgjigjur më mirë detyrave në rritje që shtron ndërtimi socialist i vendit, të konsolidohet më tej e të çohet më përpara puna shkencore për trajtimin e temave të mëdha e komplekse dhe me shkallë të gjerë kooperimi. Temat e disertacioneve që do të ndërmerren të jenë kryesisht pjesë përbërëse e temave komplekse. Përpykjet më të mëdha të bëhen për harmonizimin e studimeve për probleme aktuale e perspektive, teorike e aplikative. Të vendosen raporte më të drejta në angazhimin e pedagogëve me punë mësimore e shkencore, si edhe me hartimin e teksteve dhe me punën e mirëfilltë shkencore. Për tekstet e shkencave natyrore e teknike të shfrytëzohet më mirë përvoja botërore, duke bërë përkthime e përshtatje të teksteve më të arrira, si nga ana shkencore, ashtu edhe nga ana pedagogjike. Vëmendje më e madhe t'i kushtohet angazhimit më efektiv të punonjësve me grada e tituj shkencorë në punën e drejtpërdrejtë shkencore, në udhëheqjen e studimeve dhe në kualifikimin e kuadrit të ri. Për të rritur më tej efektivitetin e punës së kuadrove shkencorë Ministria e Arsimit dhe e Kulturës të marrë masa për të përmirësuar raportin ndërmjet kuadrit të lartë dhe kuadrit ndihmës teknik, si dhe ndërmjet ngarkesës mësimore e punës shkencore të kuadrit të shkollave të larta.

3. — Rritja e rendimentit dhe e nivelit të punës kërkimore-shkencore të shoqërohet me forcimin e frymës së debatit e të kritikës shkencore në katedrat dhe në këshillat shkencorë të fakulteteve të shkollave të larta, si edhe në organet e shtypit shkencor, ku vihen re mangësi e dobësi.

4. — Të përshejtohen ritmet e kualifikimit të pedagogëve të rinj dhe të përgatitjes së tyre me nivel të ngritur shkencor, duke shfrytëzuar edhe kualifikimin me shkëputje nga puna. Të konsolidohet e të ngrihet në një shkallë më të lartë puna për kualifikimin e specializimin pasuniversitar, duke tërhequr në këtë sistem specialistët më të aftë. Të shtohen përpjekjet për të zgjeruar tërheqjen e studentëve në punën kërkimore-shkencore dhe të thellohet puna e katedrave me talentet e reja.

5. — Të ndërmerren studime e të përcaktohen masa për lëvrimin e drejtimeve të reja shkencore, sidomos në disa fusha të rëndësishme e me perspektiva zhvillimi në të ardhmen, duke shfrytëzuar më mirë mundësitë e specializimit të kuadrit edhe jashtë shtetit, si edhe duke siguruar shkallë-shkallë edhe bazën e nevojshme materialo-laboratorike.

6. — Këshilli i Ministrave të shikojë mundësitë e zgjerimit të sipërfaqeve të mjediseve dhe të kushteve të punës, të pasurimit dhe fuqizimit të bazës materialo-laboratorike për mbështetjen e kërkimit shkencor, si në fushat ekzistuese, ashtu edhe në ato të reja. Të rriten përpjekjet për pasurimin e bazës materialo-laboratorike me forcat e vetë shkollave të larta, duke forcuar

kooperimin me dikasteret. Të merren masa që baza materialo-laboratorike, në mënyrë të veçantë aparaturat dhe pajisjet unikale, të shfrytëzohen plotësisht sidomos në kuadrin e një integrimi më të thellë të punës kërkimore-shkencore të shkollave të larta me prodhimin.

7. — Të punohet me ritme më të shpejta për kryerjen e studimeve, si edhe për zbatimin sa më të shpejtë të tyre në jetë. Dikasteret përkatëse të marrin masa për zbatimin e studimeve të përfunduara, duke i përfshirë këto në planet e drejtorive dhe të ndërmarrjeve të tyre vartëse. Të rritet ndikimi i tyre ndaj shkollës së lartë në tërë veprimtarinë e saj, në procesin mësimor, në punën shkencore dhe në pasurimin e bazës laboratorike.

8. — Të zgjerohet më tej veprimtaria botuese dhe të rritet niveli ideologjik e shkencor i saj, me qëllim që universiteti dhe shkollat e tjera të larta të bëhen qendra të rëndësishme të botimeve shkencore. Ministria e Arsimit dhe e Kulturës t'u japë rrugzgjidhje propozimeve të bëra «Për shtëpinë botuese universitare», si edhe «Për kompetencat e universitetit».

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Ramiz Alia

*Botohet për herë të parë si-  
pas origjinalit që gjendet në  
Arkivin Qendror të Partisë*

## PROTOKOLL

### I SEKRETARIATIT TË KQ TË PPSH PËR DISIPLINËN NË PUNË DHE BASHKËRENDIMIN E MASAVE EDUKATIVE, DISIPLINORE, ADMINISTRATIVE E PENALE PËR FORCIMIN E SAJ

19 nëntor 1985

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH, në mbledhjen e datës 19 nëntor 1985, shqyrtoi raportin e Këshillit të Përgjithshëm të BPSH, të Gjykatës së Lartë e të Prokurorisë së Përgjithshme «Për disiplinën në punë dhe bashkërendimin e masave edukative, disiplinore, administrative e penale për forcimin e saj» dhe

#### Vërejtji:

Këshilli i Përgjithshëm i BPSH, Gjykata e Lartë dhe Prokuroria e Përgjithshme kanë zbatuar drejt orientimet e Partisë dhe kanë ngritur në një shkallë më të lartë veprimtarinë e tyre për forcimin e disiplinës në punë, duke ndikuar në këtë mënyrë në parandalimin e shkeljeve të disiplinës, në forcimin e qëndrimit socialist ndaj punës e pronës, në ngritjen e opinionit shoqëror në luftë kundër shfaqjeve të huaja në këtë fushë.

Por, ende vihen re thyerje të disiplinës proletare në punë, prodhime me cilësi të dobët, shpërdorime dhe keqadministrime të pronës, prirje nga disa punonjës për të punuar privatisht me materiale të shtetit, çka tregon se në punën e Këshillit të Përgjithshëm të BPSH dhe të organeve vartëse, në punën e Gjykatës së Lartë dhe të Prokurorisë së Përgjithshme ka mangësi. Në luftën për parandalimin e shkeljeve këto organe nuk janë kapur siç duhet pas problemeve themelore dhe jo gjithmonë i konceptojnë drejt detyrat për bashkëpunimin dhe bashkërendimin e punës midis tyre për zbatimin e masave edukative dhe atyre shtrënguese. Për këtë:

1. — Të shtohet puna edukuese, sqaruuese e bindëse e organeve dhe organizatave të BPSH për të ngritur në një shkallë më të lartë rolin aktiv e vetëveprues të klasës punëtore kundër lëshimeve e shkeljeve të kërkesave të disiplinës socialiste në punë. Vëmendja e tyre të përqendrohet në ata sektorë e kategori punonjësish, ku shkeljet e disiplinës janë më të shumta, duke bërë një punë të diferencuar e konkrete dhe duke luftuar kundër çdo qëndrimi liberal e burokratik. Ato duhet të rritin rolin dhe ndikimin e tyre që administratat e ndërmarrjeve dhe organet shtetërore të marrin të gjitha masat organizative, materiale e teknike për forcimin kudo të rregullit e të disiplinës në punë. Të rritet, gjithashtu, kujdesi i tyre për krijimin e kushteve të domosdoshme të punës e të jetesës së punonjësve që asgjë të mos bëhet shkak për thyerje të ndryshme disiplinore, si edhe për zgjidhjen e drejtë të mosmarrëveshjeve që lindin në punë.

2. — Gjykata e Lartë dhe organet e saj vartëse të rritin efektivitetin e veprimtarisë së tyre për të parandaluar shkeljet e disiplinës në punë. Ato të përdorin forma të larmishme për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në punë, si gjykimet para kolektivave punonjës, popullarizimin në qendrat e punës të vendimeve gjyqësore për shkelje të disiplinës në punë, bisedat me punonjësit etj. Gjyqtarët të armatosen më mirë me mësimet e Partisë e të shokut Enver për të përcaktuar kritere të sakta e unike për shkeljet e kërkesave të disiplinës e për të mbajtur qëndrime të drejta në çdo rast. Kur preken interesat e socializmit e të vetë punonjësve, kur dëmtohet, shpërdorohet e vihet dorë mbi pasurinë e popullit, ata të zbatojnë me rreptësi ligjet e shtetit pa hezitime dhe shfaqje sentimentalizmi e liberalizmi.

3. — Veprimtaria e organeve të Prokurorisë t'u përgjigjet më mirë detyrave që ka shtruar Partia për forcimin e disiplinës në punë. Prokuroria të forcojë kontrollin për respektimin e legjislacionit të punës dhe të luftojë e të ndeshet me cilindo organ, nëpunës ose punonjës që cenon ligjshmërinë socialiste. Organet e Prokurorisë të ushtrojnë në masë të plotë kompetencat e tyre që organet shtetërore dhe ekonomike të zbatojnë me përpikëri rregullat e përcaktuara nga ligji për t'i mbyllur rrugën çdo çrregullimi e shpërdorimi, për të forcuar qëndrimin socialist ndaj punës e pronës.

4. — Të forcohet më tej bashkërendimi i punës për forcimin e disiplinës socialiste në punë midis organeve e organizatave profesionale dhe gjykatës e prokurorisë. Kjo të kuptohet si një kërkesë e domosdoshme për të fuqizuar veprimtarinë e tyre të përbashkët për njohjen dhe zbatimin e ligjeve, për bashkërendimin e masave dhe zgjidhjen e drejtë të çështjeve, për rritjen e nivelit të punës studimore e përgjithësuese të tyre në qendër e në bazë. Ky bashkëpunim të forcohet e të lidhet më mirë me



problemet kryesore që përballojnë Partia e shteti në fushën e disiplinës së punës.

5. — Organet dhe organizatat e Partisë të rritin rolin udhëheqës e kontrollues ndaj organeve të bashkimeve profesionale dhe atyre të drejtësisë, që veprimtaria e tyre për forcimin e disiplinës në punë në të gjithë sektorët e jetës.

Sekretariati i Komitetit Qendror të PPSH shpreh bindjen se komunistët, kuadrot dhe gjithë punonjësit e këtyre organeve do të punojnë për ngritjen e mëtejshme ideologjike e profesionale të tyre dhe do t'i kryejnë me sukses detyrat për forcimin e disiplinës në punë në të gjithë sektorët e jetës.

Sekretari i Parë i Komitetit Qendror  
të Partisë së Punës të Shqipërisë

Ramiz Alia

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## PLENUMI I 13-TË I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Tiranë, 26-27 dhjetor 1985

### KOMUNIKATË

#### E PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH

Në datën 26-27 dhjetor 1985 u mbledh Plenumi i 13-të i Komitetit Qendror të PPSH, i cili mori në shqyrtim raportin e Byrosë Politike të Komitetit Qendror «Përvojën e fituar në luftën për kapërcimin e vështirësive të këtij viti ta vëmë në veprim për realizimin e planit të vitit 1986», mbajtur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Ramiz Alia.

Pasi diskutoi gjerësisht rreth raportit të paraqitur, Plenumi i Komitetit Qendror e miratoi atë njëzëri dhe mori vendimet përkatëse<sup>1</sup>.

#### PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

1. Në mbyllje të punimeve të Plenumit, shoku Ramiz Alia mbajti një fjalim të rëndësishëm. (Shih: Ramiz Alia, «Fjalime e biseda, 1985», f. 427.)

problemi kryesor që përballon Partia dhe populli është...  
plini e punës.  
5. — Organet dhe organizatat...  
heqja e kontrollit...  
dhe atyre të drejtuar...  
shprehje të punës...

Sekretariat i Komitetit Qendror të PPSH...  
Komiteti Qendror të PPSH...  
Komiteti Qendror të PPSH...  
Komiteti Qendror të PPSH...

## V E N D I M

### I PLENUMIT TË KOMITETIT QENDROR TË PPSH PËRVOJËN E FITUAR NË LUFTËN PËR KAPËRCIMIN E VËSHIRËSIVE TË KËTJ VITI TA VËMË NË VEPRIM PËR REALIZIMIN E PLANIT TË VITIT 1986

27 dhjetor 1985

Plenumi i 13-të i Komitetit Qendror të PPSH, i mbledhur më 26 dhe 27 dhjetor 1985, pasi dëgjoji dhe diskutoi gjerësisht rreth raportit «Përvojën e fituar në luftën për kapërcimin e vështirësive të këtij viti ta vëmë në veprim për realizimin e planit të vitit 1986», të mbajtur nga Sekretari i Parë i Komitetit Qendror të PPSH, shoku Ramiz Alia,

#### V ë r e j t i :

Gjatë vitit që po mbyllet, Partia dhe populli, tërë shoqëria jonë kaluan një provë shumë të madhe me humbjen e shokut Enver Hoxha dhe përballuan me sukses vështirësitë serioze që krijuan dimri i ashpër dhe thatësira e tejzgjatur. Në situatën e jashtëzakonshme që u krijua, shkëlqyen me madhësi uniteti i çeliktë Parti-popull, forca kolosale organizuese e Partisë dhe vitaliteti i rendit tonë socialist, pjekuria ideopolitike e popullit dhe gatishmëria e tij për punë e sakrifica, energjitë krijuese e realizuese të masave punonjëse.

Detyrat e planit të një viti të tillë të vështirë kërkonin mobilizim të jashtëzakonshëm dhe hov revolucionar, organizim të përsosur dhe frymë aksioni e kursimi. Klasa punëtore, fshatarësia kooperativiste, inteligjencia, i madh e i vogël deri te «Pionierët e Enverit», në mbarë vendin, me komunistët në krye, të përfshirë në lëvizjen e madhe revolucionare «Flamurtarë të zbatimit të mësimëve të shokut Enver Hoxha» bënë të pamundurën

për t'i minimizuar në maksimum pasojat e vështirësive që u hasën.

Në luftë për realizimin e planeve u zbuluan dhe u përdorën rezerva të rëndësishme. Me 20-25 për qind të burimeve energjetike më pak se plani, për një periudhë të gjatë të vitit, dhe me kufizime të tjera materiale e teknike të ardhurat kombëtare në tërësi dhe burimet financiare të shtetit u rritën më tej, në krahasim me vitin 1984. Degë të tëra të ekonomisë, duke punuar në dy turne, realizuan detyrat e tre turneve, dhe në 6 orë detyrat e 8 orëve. Njerëzit tanë reflektuan më thellë për zbatimin e orientimeve të Partisë dhe të mësimëve të shokut Enver në lidhje me harmonizimin e rrugës intensive dhe asaj ekstensive të prodhimit, thjeshtësimin e projekteve të ndërtimit dhe kursimin e materialeve e të fondeve të investimeve, kuptimin e drejtë të mundësi të përparimit teknik në kushtet tona.

Hovi dhe mobilizimi i masave u materializuan në arritje të rëndësishme në ekonomi, në kulturë, në mbrojtje e kudo gjetkë. Në industri detyrat e planit realizohen e tejkalohen në disa produkte të rëndësishme, si në qymyrguri, në mineralet e kromit e të bakrit, në zhavorin bituminoz, në makineri, në pajisje e pjesë ndërrimi dhe në mjaft mallra të përdorimit të gjerë. Përparime u arritën edhe në metalurgjinë me ngjyra, në industrinë kimike etj. Fitore e madhe është qëndrueshmëria dhe rritja e prodhimit bujqësor. Prodhimi i grurit u realizua 98 për qind dhe u tejkalua në mënyrë të dukshme ai i pambukut. Në grurë, në pambuk, në oriz e në duhan u realizuan rendimentet më të larta që janë arritur deri sot. Numri i krerëve të bagëtive u shtua më tej.

Suksese të rëndësishme u arritën edhe në fushën e ndërtimit. U vu në shfrytëzim turbina e parë e hidrocentralit «Enver Hoxha» të Komanit dhe së shpejti do të vihet turbina e dytë. Këtë vit përfunduan, gjithashtu, hekurudhat Shkodër-Hani i Hotit dhe Fier-Vlorë, linja 400 kilovoltëshe Koman-Elbasan dhe Elbasan-Kufi, si dhe mjaft vepra të tjera të reja, zgjerime e rikonstruksione në degë e sektorë të ndryshëm të ekonomisë e të kulturës.

Kudo u punua me ndjenjë të lartë përgjegjësie, me shpirt sulmues dhe me metodë aksioni. Vetëm më 13 tetor, në «Ditën e Enverit», morën pjesë<sup>1</sup> në punë vullnetare 1 milion e 300 mijë punëtorë, kooperativistë, veteranë, të rinj e ushtarë. Një shembull të madh të shpirtit sulmues dhe të frymës së aksionit revolucionar për realizimin dhe tejkalimin në front të detyrave dha rrethi i Lushnjës. Përvojë me vlerë dhanë edhe rrethet e tjera, si ai i Elbasanit, i Tiranës, i Vlorës, si dhe shumë ndërmarrje e kooperativa bujqësore, të cilat i plotësuan mirë detyrat dhe i kapërcyen vështirësitë e krijuara, duke u mbështetur fuqimisht në

1. Në të gjithë vendin.

forcat e veta dhe në rezervat e brendshme njerëzore, materialo-  
-teknike e organizative.

Komiteti Qendror i Partisë përshëndet klasën punëtore, fshat-  
tarësinë kooperativiste, komunistët, kuadrot e specialistët për  
rezultatet e arritura, për përvojën e madhe që krijuan, për fry-  
mën e aksionit që i karakterizoi, për ndjenjën e lartë të përgje-  
gjësisë që treguan në kapërcimin e vështirësive dhe në kryerjen  
e detyrave, për besimin e tyre të patundur te Partia dhe vitaliteti  
i socializmit.

Kjo përvojë e pasur, kjo frymë e lartë revolucionare është  
një shkollë e madhe për organet e Partisë, për kuadrot e gjithë  
punonjësit. Prej tyre duhet të mësojnë të gjithë se si të përballojnë  
vështirësitë dhe detyrat, si të zgjidhin me iniciativë e me forcat  
e tyre problemet që u dalin, si të zbulojnë dhe të shfrytëzojnë  
aftësitë prodhuese dhe rezervat e shumta në ndërmarrje e koo-  
perativa, si të forcojnë besimin në mundësitë që kanë në gjirin  
e tyre kolektivat punonjës.

Me gjithë vështirësitë e krijuara dhe mosrealizimet e pjes-  
shme, niveli i mirëqenies materiale e kulturore të popullit nuk u  
prek, sepse barrën kryesore e ka mbajtur shteti. Te ne as çmimet  
u ngritën, as shpenzimet socialkulturore nuk u cenuan, as i shtri-  
më dorën njeriu, por gjithçka e përballuam dhe po e përballojmë  
me forcat tona, me rezervat tona.

Duke e vënë theksin te përvojat pozitive dhe tek arritjet e  
shumta të këtij viti, Komiteti Qendror i Partisë tërheq vëmendjen  
se, si pasojë e kushteve të motit, por edhe të dobësive të drejtimit  
e të organizimit të punës së Partisë dhe të levave të saj, viti 1985  
pati dhe disa mosrealizime, sidomos në nxjerrjen e naftës e të  
gazit, në prodhimin e energjisë elektrike, në industrinë e letrës,  
në atë tekstile dhe të materialeve të ndërtimit. Në bujqësi, re-  
zultatet më të dobëta u morën në misër. Mosrealizime pati edhe  
në prodhimin e lulediellit, të patates, të panxharsheqerit e në  
disa produkte blegtorale.

Të gjitha këto kanë sjellë disa anomali në ekonomi, kundër  
të cilave duhet të bëjmë një luftë të madhe e të gjithanshme për  
të siguruar kurdoherë ritmet e domosdoshme të zhvillimit, për të  
shpejtuar rritjen e rendimentit të punës dhe të të ardhurave  
reale të punonjësve, veçanërisht në fshat, për të rritur më tej  
burimet e akumulimit përmes uljes së kostos dhe forcimit të  
regjimit të kursimit, për të fuqizuar më tej mundësitë investuese  
dhe rezervat e domosdoshme.

Duke u mbështetur në arritjet e vitit 1985 dhe në orientimet  
themelore për planin e tetë pesëvjeçar, Plenumi i Komitetit Qe-  
ndror të PPSH

## Vendosi:

1. — Të miratojë detyrat e planit të zhvillimit të ekonomisë  
e të kulturës për vitin 1986. Karakteristikat kryesore të këtij plani  
janë: ritmet e larta të zhvillimit, përmirësimet strukturore të  
prodhimit, sidomos në bujqësi, forcimi i regjimit të kursimit,  
zgjerimi i fronteve të punës dhe fillimi i punimeve të ndërtimit  
në një varg objektesh të reja. Do të rriten të ardhurat dhe kon-  
sumi i popullit, do të ngrihet niveli kulturor i punonjësve, do të  
fuqizohet më tej aftësia mbrojtëse e atdheut.

Në krahasim me realizimin e pritshëm të këtij viti, prodhimi  
shoqëror do të rritet rreth 9,5 për qind, prodhimi i përgjithshëm  
industrial — mbi 7,3 për qind dhe ai bujqësor — 17 për qind; vë-  
llimi i investimeve themelore do të rritet rreth 3,1 për qind. Po  
kështu rritje të ndjeshme do të bëhen në eksportin dhe në impor-  
tin e mallrave.

2. — Realizimi i këtyre detyrave është kusht i domosdoshëm  
për të vënë në rrugë të drejtë disa përpjesëtime themelore në  
zhvillimin e ekonomisë që kanë të bëjnë me ligjësitë bazë të  
riprodhimit të zgjeruar socialist. Plotësimi me çdo kusht i detyrave  
të planit nga të gjitha degët e sektorët e ekonomisë, nga rrethet  
dhe ekonomitë ka qenë dhe mbetet rruga kryesore dhe e vetme  
për zhvillimin e shoqërisë sonë mbështetur në forcat e veta, për  
të përballuar çdo vështirësi, për të forcuar pavarësinë e fuqinë  
mbrojtëse të atdheut, për të ecur vazhdimisht përpara.

Arritja e objektivave të caktuar të vitit 1986 kërkon rritjen  
e efektivitetit të ekonomisë në të gjitha degët e sektorët e saj.  
Kjo do të thotë të rritet prodhimi me më pak shpenzime mate-  
riale, të ngrihet rendimenti i punës, të shfrytëzohen më mirë  
kapacitetet prodhuese, të realizohen në kohë, me vlerën e cak-  
tuar dhe të hyjnë në prodhim në afat gjithë objektet që do të  
ndërtojmë, të thellohet përparimi tekniko-shkencor dhe të akti-  
vizohen më mirë kudo rezervat e brendshme. Kursimi të jetë  
kurdoherë e kudo në rendin e ditës. Gjithashtu të merren masa  
të gjithanshme edukative, organizative dhe administrative për  
t'u prerë rrugën dëmtimeve, shpërdorimeve dhe vjedhjeve të  
pronës socialiste.

3. — Partia kërkon të merren masa të forta për mbarëvaj-  
tjen e punëve në disa degë kyç të ekonomisë. Në degën e naftës  
dhe të gazit puna të përqendrohet sidomos për futjen e shkencës  
dhe të teknologjive më të përparuara në prodhim, për përdorimin  
më të plotë të bazës materialo-teknike dhe për zbulimin e vend-  
burimeve të reja. Gjithashtu të shpejtohet zbatimi i orientimeve  
të Partisë për t'u përqendruar më shumë në vendburimet ekzi-  
stuese me rezerva të mjaftueshme dhe me kohë të shkurtër shpimi  
e përvetësimi të puseve, pa nënvleftësuar kërkimet rreth zonave



të njohura dhe në zona të tjera. Komiteti Qendror i Partisë u drejtohet klasës punëtore të naftës, komiteteve të Partisë dhe organeve të pushtetit në rrethe e në qendër, komunistëve dhe kuadrove, që nga baza e deri në ministri, për ta çuar me vull përpara këtë sektor jetik të ekonomisë.

Për nxjerrjen e kromit kujdes i veçantë duhet të tregohet sidomos për tremujorin e parë, sepse pothuaj çdo vit mosrealizimet e tij kanë rënduar tërë planin vjetor. Organizatat e Partisë dhe drejtuesit e këtyre minierave duhet ta kenë të qartë se kromi në vitin 1986 do të zërë një vend tepër të rëndësishëm në eksportet tona. Të punohet më mirë për të siguruar mineralin e pasur, për të kryer me kohë punimet përgatitore, që të jetë e hapur kurdoherë perspektiva.

Në kombinatin metalurgjik të punohet për të ngritur më tej efektivitetin e prodhimit. Për këtë të përdoren edhe 40 mijë tonë hekurishte dhe skrap. Organizatat e Partisë dhe komunistët duhet të ngrenë në këmbë punëtorët e specialistët në kombinat dhe, së bashku me ta, të plotësojnë medoemos detyrat. Nga ana e tyre rrethet t'i japin fund atij nënvleftësimi që tregojnë për grumbullimin dhe çuarjen në destinacion të të gjitha mbetjeve të hekurit e të çelikut. Në vitin 1986 ky duhet të jetë një aksion i madh për organet shtetërore e sidomos për bashkimet profesionale.

4. — Detyrat e mëdha që shtrohen në bujqësi kërkojnë që të mobilizohen dhe të harmonizohen në një shkallë më të lartë të gjithë faktorët e prodhimit, që nga ata ideopolitikë e organizativë, e deri te masat materialo-teknike. Të përfitohet nga përvoja e këtij viti për organizimin e aksioneve në momentet vendimtare të prodhimit, si në mbjellje, në kryerjen e shërbimeve, në ujitje e në grumbullimin e produkteve, duke i bërë ato sistem pune.

Vëmendje e veçantë t'i kushtohet prodhimit të drithërave të bukës. Të kuptohet mirë se realizimi i planit të prodhimit të drithërave ka të bëjë jo vetëm me bukën e popullit, por edhe me zhvillimin e blegtorisë. Mundësitë e mëdha që na ofron potenciali i lartë prodhues i kulturës së misrit, sidomos tani që ajo është vendosur në toka nën ujë, duhet të shfrytëzohen nga të gjitha rrethet. Prodhimi i bimëve industriale mbetet një preokupacion tjetër i madh për bujqësinë dhe ekonominë tonë. Zgjerimi i sipërfaqes së mbjellë me duhan dhe rritja e cilësisë së kësaj bime të mbështetet si duhet me masat e domosdoshme në kooperativat dhe në ndërmarrjet bujqësore.

Në blegtori kërkohet një konceptim më i gjerë i detyrave, duke synuar që të rritet pesha e prodhimit blegtoral në bujqësi, të realizohen përmirësime të rëndësishme në strukturën e blegtorisë, të rritet prodhimi foragjer dhe të shfrytëzohen të gjitha burimet e mëdha kullimore të vendit. Të punohet kudo për një

kooperim më të plotë e të efektshëm midis bujqësisë e blegtorisë dhe për një harmonizim më të drejtë midis zhvillimit të gjedhit dhe bagëtive të imëta.

5. — Detyrat e rëndësishme të planit të vitit 1986 të mbështeten me investimet e nevojshme. Rëndësi e veçantë t'i kushtohet efektivitetit të këtyre investimeve nëpërmjet vënies në shfrytëzim të veprave në afatet e planifikuara, thjeshtimit të projekteve dhe kursimeve gjatë ndërtim-montimeve.

6. — Problemet e eksport-importit të ndiqen me preokupim të veçantë nga të gjitha organet dhe organizatat-bazë të Partisë, nga organet shtetërore dhe ekonomike që prodhojnë mallra për eksport dhe nga vetë organet e tregtisë së jashtme. Kudo të këmbëngulet për të siguruar në kohë, në sasi dhe në cilësi mallrat e destinuar për eksport. Të luftohet koncepti i ndarjes së mallrave në «të fortë» e «të dobët» dhe të rriten përpjekjet për të shitur në kohë e me leverdi çdo mall të caktuar për eksport. Të kuptohet e të zbatohet me rigorozitet e nga të gjithë parimi se pa eksport nuk ka import.

7. — Plotësimi dhe tejkalimi i detyrave të planit të shërbejë më mirë për furnizimin e popullit me artikuj ushqimorë dhe industrialë. Shoku Enver gjithnjë ka ngulur këmbë që të tregojmë kujdes të dorës së parë për furnizimin e popullit, sepse njerëzit gjithnjë e më mirë duhet të ushqehen, të vishen e të plotësojnë gjithë nevojat e jetesës së tyre të përditshme. Prandaj këto probleme të konceptohen kurdoherë drejt edhe në aspektin politik e shoqëror.

Për të përmirësuar furnizimin e popullit me produkte blegtorale, me perime, patate etj. të ecet duke përdorur më mirë të dy rrugët, intensive dhe ekstensive, duke shfrytëzuar avantazhet e tufave të mëdha të blegtorisë në komplekse, si edhe rezervat që ka prodhimi i gjerë blegtoral në fushë, në kodra e në malësi. Të shtohet prodhimi i perimeve në ndërmarrjet bujqësore për furnizimin e qyteteve e të qendrave të punës.

Në këtë kuadër Komiteti Qendror i Partisë përgëzon dhe inkurajon nismat që kanë lindur në mjaft kooperativa për të mbajtur në çdo brigadë të arave e të pemëtarisë një numër të kufizuar lopësh (deri 10 krerë) ose bagëti të imëta (deri 50 krerë), si dhe për të mbjellë një deri dy hektarë me fasule e patate hamullore. Këto nisma, që zhvillohen duke ruajtur parimet e pronës kooperativiste, të shërbejnë për të shtuar burimet e furnizimit të fshatarësisë dhe të ndikojnë për të shtuar shitjet në shtet nga kooperativat.

Prodhimi i qumështit, i patateve dhe i fasules që sigurohet nga tufëzat e vogla të bagëtive dhe nga sipërfaqet hamullore të caktuara për brigadat, t'u shpërndahet anëtarëve të tyre kundrejt pagesës. Këto nisma të përhapen sa më shpejt në kooperativat e

fushës dhe kudo ku është kryer tufëzimi i lopëve, si edhe gjetkë ku ekzistojnë mundësitë, pa prekur planet e prodhimit dhe të zhvillimit të tufave të mëdha të kooperativave. Gjithashtu, të ecet me vendosmëri, që brenda vitit 1986 çdo rreth, veç Tiranës, të sigurojë për vete të gjitha nevojat e popullsisë së qytetit dhe të fshatit me vezë, me perime, me fasule e sipas mundësive edhe me patate.

Industria e mallrave të konsumit të gjerë të përdorë më mirë mundësitë që ka për të nxjerrë produkte me cilësi më të mirë për të ripërtërirë dhe për të plotësuar asortimentet, duke shfrytëzuar më mirë edhe mbetjet teknologjike për të thithur e për të përpunuar, me plan e jashtë planit, të gjitha produktet që jep bujqësia. Masa të forta të merren për të zgjeruar dhe për të përmirësuar shërbimet ndaj popullit, si dhe për shpërndarjen e drejtë të mallrave të destinuara për konsum.

Populli ynë ka një ndërgjegje të lartë politike, ai e kupton drejt direktivën e Partisë se do të konsumojmë aq sa prodhojmë dhe nuk kërkon atë që nuk e kemi. Por punonjësit nuk i pranojnë neglizhencat dhe anomalitë në shpërndarjen e mallrave që kemi dhe në shërbimet ndaj tij. Fuqisë blerëse dhe rritjes së kërkesave të popullit duhet t'u përgjigjemi gjithnjë e më mirë me mallrat dhe me shërbimet e nevojshme. Ky ka qenë dhe duhet të jetë preokupimi kryesor i organeve të Partisë, të pushtetit e të ekonomisë në qendër e në bazë.

**Zbatimi i detyrave të mëdha të planit të vitit 1986, në ekonomi dhe në fusha të tjera, kërkon medoemos forcimin e punës së Partisë.** Sot kërkohet një aktivitet më i gjerë, më i dendur, më efektiv nga të gjithë komunistët, nga të gjitha organizatat e Partisë. Detyrë e komunistëve është t'i njohin e të jetojnë intensivisht kërkesat e kohës dhe të ecin në një hap me të, duke iu përgjigjur situatave me një veprimtari më të kualifikuar e më të efektshme. Në momente si këto që po jetojmë, më shumë se kurdoherë, vihen në provë cilësitë e komunistëve. Të mbajmë gjithmonë parasysh mësimin e shokut Enver që vendi i nderit për komunistët është të jenë në ballë të luftës, të punës, të prodhimit.

Organet dhe organizatat e Partisë, kuadrot e të gjitha niveleve të luftojnë rutinën dhe punën e rëndomtë. Ato të lidhen ngushtë me masat dhe të jenë të shkathtë e kurdoherë aktive. Sot kërkohet më shumë intuitë e fantazi revolucionare në kuptimin dhe në zbatimin krijues të orientimeve të Partisë, në gjallërimin e formave të komunikimit me njerëzit. Masat punonjëse duhen vënë në lëvizje me një mendim të përparuar revolucionar, me mësimet e shokut Enver, me përvojat e më të mirëve.

**Përsosja e drejtimit, e organizimit dhe e kontrollit të zbatimit të detyrave të vlerësohet si një nga hallkat më të rëndësishme të punës së Partisë e të levave të saj,** ku duhet të mbështetemi më shumë për të nxitur më tej veprimtarinë krijuese të njerëzve dhe për t'i përdorur më efektivisht potencialet materialo-teknike që kemi.

Objektivi kryesor i punës drejtuese dhe organizuese të Partisë dhe levave të saj të jetë kurdoherë plotësimi frontalisht i detyrave të planit në të gjitha degët e sektorët e ekonomisë. Partia dhe levat e saj të mbajnë lart frymën e mobilizimit, vrullin dhe mendimin krijues e novator të masave, duke i mbështetur fuqimisht ato në aksionet e njëpasnjëshme të tyre.

Në punën drejtuese e organizuese të Partisë dhe të organeve shtetërore-ekonomike të ngrihen në një shkallë më të lartë të gjitha format e kontrollit. Të forcohet në mënyrë të veçantë kontrolli punëtor e fshatar, si dhe kontrolli i brendshëm në ndërmarrje e kooperativa, për t'u dalë zot punëve, administrimit dhe ruajtjes së pasurisë socialiste. Gjithashtu, të rritet forca e kontrollit me anë të lekut. Organet e planit, të financës e të bankës të kontrollojnë dhe të kërkojnë zbatimin deri në një të rregullave në fushën e investimeve dhe të pagave, të mjeteve të xhiros dhe të kreditit, për shpenzimet në prodhim dhe në sektorët socialkulturore.

**Për realizimin me sukses të planit të mobilizohet dhe të vihet më mirë se deri tani në shërbim të zhvillimit të ekonomisë e të zgjidhjes së problemeve të saj gjithë potenciali i madh tekniko-shkencor që ka vendi ynë.** Këtë e diktojnë detyrat e mëdha që kemi përpara për rritjen e prodhimit dhe të efektivitetit të tij. Të ecet me ritme më të shpejta në studime, në projekte e në zbatim. Shkencëtarët e specialistët të lidhen më shumë me jetën, sidomos me novatorët e racionalizatorët, me njerëzit e përparuar të prodhimit, të mbështeten më shumë në mundësitë tona materiale e teknike dhe në përvojën e përparuar. Edhe mendimi i njerëzve të shkencës të dëgjohet e të vlerësohet me kujdes nga Partia dhe levat e saj.

Viti 1986 është viti i parë i pesëvjeçarit të ri, i cili i hap perspektiva të reja zhvillimit të gjithanshëm ekonomiko-shoqëror të vendit në rrugën e socializmit. **Ky do të jetë viti i Kongresit të 9-të të Partisë dhe i 45-vjetorit të themelimit të saj, që do të jenë ngjarje të mëdha historike për gjithë Partinë, për gjithë popullin tonë.** Prandaj le të mobilizohemi të gjithë më shumë se kurrë për të plotësuar dhe për të tejkaluar detyrat e planit të vitit të ardhshëm. Të vemi duarplot në Kongresin e 9-të të Partisë dhe në 45-vjetorin e themelimit të saj. Të ngremë më lart flamurin e Partisë sonë, pararojës së popullit shqiptar, veprën monumentale të shokut Enver Hoxha.

Plenumi i Komitetit Qendror shpreh bindjen e thellë se komunistët dhe gjithë punonjësit e vendit do t'i presin, siç u ka hije, ngjarjet e mëdha që kemi përpara dhe do të mobilizohen me të gjitha forcat, pa kursyer energjitë, aftësitë dhe talentin e tyre krijues, për t'i plotësuar me sukses detyrat e mëdha të vitit 1986.

## PLENUMI I KOMITETIT QENDROR TË PPSH

*Botohet për herë të parë sipas origjinalit që gjendet në Arkivin Qendror të Partisë*

## TREGUESI I LËNDËS

	Faqe
Parathënie .....	5
<b>1980</b>	
1. Konkluzione të Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi përmirësimin e punës me farnat dhe racat. 24 shtator 1980 .....	9
2. Letër e Komitetit Qendror të PPSH drejtuar gjithë organizatave-bazë të Partisë «Për thellimin e luftës kundër disa shfaqjeve të huaja». 1 tetor 1980 .....	13
3. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për disa probleme të marrëdhënieve të shpërndarjes sipas punës, të planifikimit dhe të forcimit të kontrollit të zbatimit të planit ekonomiko-financiar. 4 nëntor 1980 .....	17
4. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi disa masa për kufizimin e mëtejshëm të oborrit kooperativist dhe për tufëzimin e bagëtive të familjeve kooperativiste. 4 nëntor 1980 .....	19
5. Konkluzione të Sekretariatit të KQ të PPSH për disa probleme të punës së Partisë për edukimin e rinisë. 6 nëntor 1980 .....	25
<b>1981</b>	
6. Konkluzione të Sekretariatit të KQ të PPSH për disa probleme të konsolidimit të mëtejshëm të shkollave të lira ushtarake. 9 shkurt 1981 .....	31
7. Konkluzione të Sekretariatit të KQ të PPSH për pasqyrimin e realitetit socialist në letërsi dhe në arte. 9 shkurt 1981 .....	36



8. Plenumi i 9-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 25-26 shkurt 1981 .....	
— Komunikatë .....	40
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Përfundimet e arritura në plotësimin e planit të vitit 1980 dhe detyrat për vitin 1981». 25 shkurt 1981 .....	41
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH për thirrjen e Kongresit të 8-të të zakonshëm të Partisë së Punës të Shqipërisë. 26 shkurt 1981 .....	73
9. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH për fushatën e 40-vjetorit të Themelimit të PPSH dhe të Kongresit të saj të 8-të. 9 mars 1981 .....	75
10. Protokoll i Sekretariatit të KQ të PPSH mbi gjendjen dhe disa probleme për rritjen e cilësisë së emisioneve televizive. 4 prill 1981 .....	78
11. Protokoll i Sekretariatit të KQ të PPSH për punën e organeve të prokurorisë për të zbatuar detyrat që shtroi Plenumi i 7-të i KQ të Partisë për kontrollin e zbatimit të ligjeve, sidomos në sferën ekonomike. 4 prill 1981 .....	84
12. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për krijimin e urdhrit «40-Vjetori i PPSH». 4 maj 1981 .....	87
13. Protokoll i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi përsosjen e drejtimit e të strukturave të organeve shtetërore dhe ekonomike në qendër e në bazë. 4 maj 1981 .....	89
14. Protokoll i Sekretariatit të KQ të PPSH për punën dhe detyrat e organeve e organizatave të Partisë dhe komandave për ngritjen në një nivel më të lartë të edukimit e të përgatitjes së gjithanshme të efektivit të Policisë Popullore. 6 maj 1981 .....	95
15. Konkluzione të Sekretariatit të KQ të PPSH për specializimin dhe kualifikimin pasuniversitar të kadrove me arsim të lartë. 6 maj 1981 .....	102
16. Udhëzim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për dhënien e urdhrit «40-Vjetori i PPSH». 4 qershor 1981 .....	106
17. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për përmirësimin e punës në shkollat pa shkëputje nga puna. 4 qershor 1981 .....	108

18. Plenumi i 10-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 15-16 qershor 1981 .....	
— Komunikatë .....	110
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH mbi miratimin e projektdirektivave të Kongresit të 8-të të PPSH për planin e shtatë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të RPSSH për vitet 1981-1985. 16 qershor 1981 .....	111
19. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH për ndryshimin e programeve të kurseve të larta të ngritura pranë Shkollës së Partisë «V. I. Lenin». 4 shtator 1981 .....	112
20. Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 13-15 tetor 1981 .....	
— Komunikatë .....	114
21. Kongresi i 8-të i Partisë së Punës të Shqipërisë. Tiranë, 1-7 nëntor 1981 .....	115
— Raport i mbajtur në Kongresin e 8-të të PPSH nga Sekretari i Parë i KQ të PPSH shoku Enver Hoxha «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të Partisë së Punës të Shqipërisë». 1 nëntor 1981 .....	117
— Vendim i Kongresit të 8-të të Partisë së Punës të Shqipërisë për miratimin e raportit «Mbi veprimtarinë e Komitetit Qendror të PPSH». 6 nëntor 1981 .....	254
— Vendim i Kongresit të 8-të të Partisë së Punës të Shqipërisë për miratimin e raportit «Mbi direktivat për planin e shtatë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për vitet 1981-1985». 6 nëntor 1981. ....	255
— Vendim i Kongresit të 8-të të Partisë së Punës të Shqipërisë për miratimin e raportit të Komisionit Qendror të Kontrollit e të Revizionimit të PPSH. 6 nëntor 1981 .....	256
— Vendim i Kongresit të 8-të të Partisë së Punës të Shqipërisë për miratimin e direktivave për planin e shtatë pesëvjeçar të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë për vitet 1981-1985. 6 nëntor 1981 .....	257
— Direktivat e Kongresit të 8-të të PPSH për planin e shtatë pesëvjeçar (1981-1985) të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të RPSSH. 6 nëntor 1981 .....	258

22. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH mbi disa masa për zbatimin e detyrave për tufëzimin e bagëtive të familjeve kooperativiste. 24 shkurt 1982 .....	279
23. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për miratimin e Projektkodit të familjes të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë. 24 prill 1982 .....	283
24. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH për disa çështje të ngritjes së nivelit të edukimit marksist-leninist të komunistëve e të kuadrove. 26 prill 1982 .....	284
25. Protokoll i Byrosë Politike të KQ të PPSH për përmirësimin e mëtejshëm të drejtimit e të organizimit të punës së organeve shtetërore. 29 maj 1982 .....	288
26. Letër e Komitetit Qendror të PPSH drejtuar organizatave-bazë të Partisë. 15 qershor 1982 .....	301
27. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për ngritjen e mëtejshme të cilësisë së punës mësimore-edukative të shkollës. 25 qershor 1982 .....	305
28. Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH. 24 shtator 1982 .....	311
29. Plenumi i 5-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 13-14 tetor 1982 .....	312
— Komunikatë .....	
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi gjendjen e transportit dhe masat që duhen marrë për forcimin e organizimit dhe të zhvillimit të tij në shërbim të ekonomisë dhe të popullatës». 13 tetor 1982 .....	314
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH për gjendjen e transportit dhe masat që duhen marrë për forcimin e organizimit dhe të zhvillimit të tij në shërbim të ekonomisë dhe të popullatës. 14 tetor 1982 .....	335
30. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH për të përkujtuar 100-vjetorin e vdekjes së Karl Marksit. 17 nëntor 1982 .....	337
31. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për masat që duhen marrë për intensifikimin me përparësi në 6 rrethet e zonës fushore e bregdetare të vendit. 10 dhjetor 1982 .....	339

32. Orientime të Byrosë Politike të KQ të PPSH për ritmet dhe kriteret e shtimit të radhëve të Partisë për periudhën 1982-1986. 20 janar 1983 .....	341
33. Plenumi i 6-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 24-25 janar 1983 .....	
— Komunikatë .....	344
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Për plotësimin e planit të vitit 1982 dhe detyrat kryesore të projektplanit të vitit 1983» 25 janar 1983 .....	345
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH për përfundimet e arritura në plotësimin e planit të vitit 1982 dhe detyrat kryesore të projektplanit të vitit 1983. 25 janar 1983. ....	371
34. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për zhvillimin e mëtejshëm të zonave kodrinore-malore. 25 shkurt 1983 .....	373
35. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për kalimin e disa kooperativave të tipit të lartë në ndërmarrje bujqësore. 25 shkurt 1983 .....	376
36. Protokoll i Sekretariatit të KQ të PPSH për kryerjen e punës drejtpërdrejt në prodhim nga kuadrot. 28 shkurt 1983 .....	378
37. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për miratimin e studimeve për pesëvjeçarin e tetë (1986-1990). 28 mars 1983 .....	383
38. Orientime të Byrosë Politike të KQ të PPSH për kryerjen e studimeve për hartimin e projektplanit të pesëvjeçarit të tetë (1986-1990) të zhvillimit të ekonomisë dhe të kulturës të RPSSH. 28 mars 1983 .....	384
39. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH për përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetesës së punëtorëve. 30 mars 1983 .....	392
40. Protokoll i Sekretariatit të KQ të PPSH për përmirësimin e kushteve të punës dhe të jetesës së grave dhe fëmijëve. 9 maj 1983 .....	394
41. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për riorganizimin e hetuesisë dhe veçimin e saj nga organet e Punëve të Brendshme. 8 qershor 1983 .....	397

42. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH për disa ndryshime në udhëzimet ekzistuese të Komitetit Qendror mbi stazhin e kandidatit për anëtar partie. 10 qershor 1983 ..... 400
43. Protokoll i Sekretariatit të KQ të PPSH për disa probleme të forcimit të lidhjeve e të bashkëpunimit ushtri-terren. 10 qershor 1983 ..... 403
44. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për masat që duhen marrë për vënien në baza më shkencore të sektorit të blegtorisë. 15 shtator 1983 ..... 409
45. Plenumi i 7-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 20-21 shtator 1983 .....

— Komunikatë ..... 411

— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Mbi gjendjen e ndërtimeve dhe problemet që dalin». 20 shtator 1983 ..... 412

46. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH mbi emërtimin e Hidrocentralit të Komantit hidrocentrali «Enver Hoxha». 10 tetor 1983 ..... 442

47. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për masat që duhen marrë për përsosjen e disa levave ekonomike në marrëdhëniet e shtetit me kooperativat bujqësore. 28 tetor 1983 ..... 443

48. Plenumi i 8-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 19-20 dhjetor 1983 .....

— Komunikatë ..... 445

— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Për plotësimin e planit të vitit 1983 dhe detyrat kryesore të projektplanit të vitit 1984». 19 dhjetor 1983 ..... 446

## 1984

49. Vendim i Komitetit Qendror të PPSH «Për festimin e 40-vjetorit të Çlirimit të Atdeut e të fitores së revolucionit popullor». 31 janar 1984 ..... 469

50. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për zhvillimin, mbrojtjen dhe shfrytëzimin racional të pyjeve e të lëndës drusore. 11 prill 1984 ..... 473

51. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për plotësimin e detyrave dhe nxjerrjen nga prapambetja të industrisë kimike. 15 maj 1984 ..... 476

52. Plenumi i 9-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 27-28 shtator 1984 .....

— Komunikatë ..... 478

— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Zbatimi i detyrave për rritjen e efektivitetit të ekonomisë dhe forcimi i financave, problemet dhe masat që duhen marrë». 27 shtator 1984 ..... 479

## 1985

53. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për zhvillimin e mëtejshëm të industrisë së lehtë dhe ushqimore. 12 shkurt 1985 ..... 504

54. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për fuqizimin e bazës ushqimore dhe shtimin e prodhimit të mishit. 9 prill 1985 ..... 506

55. Plenumi i 11-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 13 prill 1985 .....

— Komunikatë ..... 510

— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH për përjetësimin e emrit dhe të veprës së shokut Enver Hoxha. 13 prill 1985 ..... 511

56. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për furnizimin e popullit. 10 maj 1985 ..... 512

57. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për përmirësimin e punëve në transport. 15 qershor 1985 ..... 515

58. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH për forcimin e mëtejshëm të punës për rritjen e vigjencës në kufi. 1 korrik 1985 ..... 518

59. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH për mbrojtjen e shëndetit të nënës dhe të fëmijës. 1 korrik 1985 ..... 521

60. Plenumi i 12-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 8-9 korrik 1985 .....



— Komunikatë .....	523
— Raport i Byrosë Politike të KQ të PPSH «Të lufto- het për realizimin frontal të detyrave të planit me një regjim të fortë kursimi», 8 korrik 1985 .....	524
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH mbi realizimin frontalisht të detyrave të planit me një regjim të fortë kursimi. 9 korrik 1985 .....	546
61. Vendim i Sekretariatit të KQ të PPSH për vendosjen e bus- teve dhe të simboleve përkujtimore në shenjë respekti e da- shurie për shokun Enver Hoxha. 9 shtator 1985 .....	548
62. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për ngritjen e muzeut «Enver Hoxha». 2 tetor 1985 .....	549
63. Vendim i Byrosë Politike të KQ të PPSH për rritjen e rolit të bankës nëpërmjet forcimit të kontrollit me anë të lekut. 2 te- tor 1985 .....	551
64. Protokoll i Sekretariatit të KQ të PPSH për punën shken- core në universitetin «Enver Hoxha» të Tiranës dhe në In- stitutin e Lartë Bujqësor dhe masat që duhen marrë për ta qar atë më përpara. 19 nëntor 1985 .....	553
65. Protokoll i Sekretariatit të KQ të PPSH për disiplinën në punë dhe bashkërendimin e masave edukative, disiplinore, adminis- trative e penale për forcimin e saj. 19 nëntor 1985 .....	556
66. Plenumi i 13-të i Komitetit Qendror të PPSH. Tiranë, 26-27 dhjetor 1985 .....	
— Komunikatë .....	559
— Vendim i Plenumit të Komitetit Qendror të PPSH përvojën e fituar në luftën për kapërcimin e vësh- tirësive të këtij viti ta vëmë në veprim për realizimin e planit të vitit 1986. 27 dhjetor 1985 .....	560

Tirazhi 10.000 kopje

Format 60x92/16

Stash 2204-82

Shtypur: Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «8 Nëntori» — Tiranë, 1986